

Buletini i Konferencës Shkencore Ndërkombëtare
Zbornik Naučnih Radova Međunarodne Konferencije
International Scientific Conference Proceedings

XII INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE

*KONFERENCA E XII-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
XII-ta NAUČNA MEDJUNARODNA KONFERENCIJA*

*CHALLENGES FOR QUALITY VOCATIONAL AND ACADEMIC EDUCATION AND TRAINING “
“SFIDAT PËR CILËSINË NË ARSIMIN AKADEMIK DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL”
“IZAZOVI KVALITETNOG STRUČNOG I AKADEMSKOG OBRAZOVANJA I
OSPOSOBLJAVANJA”*

“

IV INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE

*KONFERENCA E IV-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
ČETVRTA MEĐUGRANIČNA NAUČNA KONFERENCIJA*

*TRASHËGIMIA KULTURORE DHE IDENTITETI SI POTENCIALE TË FAVORSHËME
ZHVILLIMORE
KULTURNA BAŠTINA I IDENTITET KAO POVOLJNI RAZVOJNI POTENCIJAL
CULTURAL HERITAGE AND IDENTITY AS FAVORABLE DEVELOPMENT POTENTIALS*

3 Prill/April, 2020

Ulqin / Ulcinj

ISSN 2337-0521 (Online)

Newsroom

Prof.Ass. Dr. Shefket Jakupi (chief)

Dr. Ylvije Kraja

Phd.Nazli Tyfekqi

MA.Kastriot Blakaj

Directory

MA. Adela Šehović-Osmanović

Editor of the Scientific Magazine

MA. Adela Šehović-Osmanović

Publishing house:

D.OO.MONTE,,Ulcinj Montenegro

SCIENTIFIC COMMITTEE

- Prof.Dr. Adem Bekteshi (Albania) - President,
 - Prof.Dr. Predrag Goranović, (Montenegro) – Co.President
- Academician Slobodan Nešković, (Serbia)*
Academician Konstantin Pochivalov, (Russia)
Academician Dragoljub Mirjanić, (Serbian Rep.)
Prof.Dr Nevenka Žarkić-Joksimović, (Serbia)
Prof.Asoc.Dr. Vehbi Ramaj (Kosovo)
Prof.Dr. Slađana Benković FON (Serbia)
Prof.Dr. Armand Krasniqi (Kosovo)
Prof. Dr. Dragoljub Jankovic (Montenegro)
Prof.Dr. Isak Mustafa (Kosovo)
Prof.Dr. Ibish Mazreku (Kosovo)
Prof.Dr. Tonin Gjuraj (Albania)
Prof.Dr. Anatoly Avdenko (Ukraine)
Prof.Dr. Valentin Nedeff (Romania)
Prof.Dr. Fahrush Rexhepi (Kosovo)
Prof.Dr. Piotr Pietrzak (Bulgaria)
Prof.Dr. Constantin Bungau (Romania)
Prof.Dr. Vladimir P. Sergienko (Belarus)
Prof.Dr. Predrag Dašić (USA)
Prof.Dr. Hidajet Shehu (Albania)
Prof.Asc.Dr. Halit Shabani (Kosovo)
Prof.Asc. Dr. Husnija Bibiljica (Kosovo)
Prof.Dr. Laszlo Karpati (Hungary)
Prof.Ass. Dr. Shefket Jakupi, (Kosovo)
Prof.Dr. Diana Shehu (Albania)
Prof.Dr. Shkëlqim Fortuzi (Albania)
Prof.Dr. Seadin Xhaferi (Macedonia)
Prof.Dr. Naser Raimi (Macedonia)
Prof.Dr. Astrit Mehmeti (USA)
Prof.Dr. Azeta Tartaraj (Albania)
Prof.Dr. Edmond Beqiri (Kosovo)

Prof.Dr. Artan Nimani (Kosovo)
Prof.Dr. Kerstin Bree Carlson (Danska)
Prof.Dr. Robert Dimitrejski (Macedonia)
Prof.Dr. Michael Minch (USA)
Dr. Fitim Maçani (Kosovo)
Dr.) Rexhep Suma (Kosovo)
Prof.Asoc.Dr.Theranda Beqiri (Kosovo)
Prof.Asoc.Dr.Qazim Tmava (Kosovo)
Prof.Dr.Shyqeri Kabashi (Kosovo)
Prof.Dr.Muharem Karamujić (Bosnia and Herzegovina)
Prof.Dr.Arben Malaj (Albania)
Prof. Dr. Michael Minch (USA)
Prof.Dr.Marija Popović (MNE)
Prof.Dr. Armend Kadriu (Macedonia)
Prof.Asc.Dr. Blerta Dragusha (Albania)
Prof.Dr. Niké Wentholt (Netherland)
Prof.Dr. Drita Kruja (Albania)
Prof.Dr. Sulo Haderi (Albania)
Prof.Asc.Dr. Brilanda Bushati (Albania)
Prof.Dr. Besa Xhaferi (Macedonia)
Prof.Dr. Arta Bilalli (Macedonia)
Prof.Dr. Laszlo Karpati (Hungary)
Prof.Dr. Miodrag Brzaković (Serbia)
Prof.Asc.Dr. Darko Lacmanović (MNE)
Prof.Dr. Salvator Bushati (Albania)
Prof.Dr. Sofronija Miladinoski (Macedonia)
Prof.Dr. Daniel Dobrev, (Bulgaria)
Prof.Dr. Andrej Raspor (Slovenia)
Prof. Dr. Zoran Mastilo (B&H)
Prof.Ass.Dr. Halil Kukaj (Kosovo)
Prof.Dr. Mirsad Nuković (Serbia)
Doc. Dr. Nazmije Merko Zabzun (Maced.)
Prof.Dr. Tibor Petres (Hungary)
Prof.Asc. Dr. Mirijam Dibra (Albania)

Prof.Dr. Heinrich Meister (Switzerland)
Prof.Ass. Dr. Kamber Kamberi (Kosovo)
Prof.Ass. Dr. Xhevat Sopi(Kosovo)
Prof.Dr. Jusuf Mustafai (Macedonia)
Prof.Asc. Dr. Fatos Ukaj (Kosovo)
Prof.Asc Dr. Elidiana Bashi (Albania)
Prof.Dr. Radovan Stojanović (MNE)
Prof. Dr. Biljana Ciglovska (Macedonia)
Prof.Dr. Zoran Todorović (MNE)
Doc.dr. sc. Dean Sinkovic, (Croatia)
Prof.Dr. Sonja Vitanova (Macedonia)
Prof.Asoc.Dr.Elinda Ramadani (Albania)
Prof.Asc.Dr. Shaip Bytyqi (Kosovo)
Prof.Asc.Dr.Alba Robert Dumi(Albania)
Prof.Dr.Baki Koleci(Kosovo)
Dr. Ylvije Borici (Albania)
Dr.Sc.Shaqir Elezaj(Kosovo)
Dr,Alva Dani(Albania)

Contents

KONTRIBUTI I STUDIUESVE SHQIPTARË PËR MËNYRËN LIDHORE - VËSHTRIM DIAKRONIK	6
Agnesa Hasimja – Pasha	
TEKNIKAT DHE MJETET E KËRKIMIT TË PROVËS NË ZBULIMIN E VEPRËS PENALE TË VRASJES.....	16
LLM Dea Toçi	
VETËQEVERISIA LOKALE NË KOSOVË.....	29
PhD.Cand. Kastriote Vlahna / Dafina Vlahna	
DIFERENCAT E ZHVILLIMIT SEKTORIAL DHE RAJONAL NË MAQEDONIN E VERIUT	43
Prof. Dr. Petrit Pollozhani	
TRENSFERIMI STRUKTOROR EKSTENZIV NË ATE INTENZIVË SI FAKTOR PËRSHPEJTUES I ZHVILLIMIT NË MAQEDONINË E VERIUT	57
Prof. Dr. Seadin Xhaferi	
IDENTIFIKIMI I NXËNËSVE ME VËSHTIRËSI NË TË FOLUR DHE NË TË SHKRUAR NGA ANA E MËSIMDHËNËSVE KLASOR.....	67
Rinë Lami Kolgeci	
PERIODIKU FETAR DHE TOLERANCA NDËRFETARE NË KOMBIN SHQIPTAR	76
Dr.Rexhep Suma	
FJALËSI GJUHËSOR DHE ESTETIK I VEPRËS LETRARE TË BEQIR MUSLIUT.....	85
Prof. dr. sc. Begzad Baliu	
Phd. cann. Faton Krasniqi	
FORTIFIKIMI I QAFË THANËS	94
Ervin Kujtila	
PRILOZI ZA POSTICANJE DIJALOGA O FENOMENU TURIZMA.....	100
Akademik Dr. Šefket Krcić	
DALLIMI MES KONTRATAVE DHE KONTRATAT ELEKTRONIKE.....	104
(E drejta biznese në aspektin e ekonomisë digjitale)	104
Prof. Ass. Dr. Besnik HAJDARI	
<i>FORMAT E MENAXHIMIT TE SHPERBLIMEVE TE BURIMET NJEREZORE</i>	<i>121</i>
Msc. Besim Tahiri	
RËNDËSIA TURIZMIT KULTUROR NË QYTETIN E PRIZRENIT	136
NEVRUZ ORUQJ, PhD ¹ .	
XHELIL BEKTESHI, PhD ² .	
NDIKIMI I FAKTORËVE TË RISKUT NË PERFORMANCËN FINANCIARE TË NDËRMARRJËVE	144
Vait Nikaj	
CURTURAL HERITAGE AND IDENTITY AS FAVORABLE DEVELOPMENT POTENTIALS	151
Dr.Sc.Shqipe Kastrati	

STRUKTURA LIGJORE E “SHPËRLARJES SË PARAVE DHE KONTRIBUTEVE TJERA NGA VEPRA PENALE E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT” E PRODUKTEVE TË VEPRËS PENALE SI VEPËR PENALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË VERIORE.....	160
Dr. sc. Mitasin Beqiri	
NDIKIMI I POLITIKAVE FISKALE NE ZHVILLIMIN E BIZNESIT NE KOSOVE	164
Prof.Ass.Dr. Artan Haziri	
Ass.Msc.Hazbi Kadriu	
NDIKIMI I SEKTORIT TË TURIZMIT NË RRRITJEN E PUNËSIMIT	178
Msc. Servete Lleshi Ligataj	
Msc. Manjola Striniqi Xhahysa	
HISTORIA DHE TEORIA E GJEOPOLITIKËS AMERIKANE.....	186
Doc. Dr. Ebrar Ibraimi	
TREGU I PUNES DHE ROLI I GRUAS SIPERMARRESE NE AKTIVITETET TREGETARE DHE EKONOMIKE.....	196
Prof. Dr Alba Dumi ¹ / <u>Dr Gerti Dajçi</u> ²	
FORTIFIKIMI I DRAGOSTUNJËS.....	209
Ervin Kujtila	
PADENJËSIA DHE HEQJA DORË NGA TRASHËGIMIA, DY KONCEPTE TË TRASHËGIMISË NË SISTEMIN CIVIL LAW, TRAJTUAR NË NJË KËNDVËSHTRIM KRAHASUES	220
Xhuana Abazi	
Florida Arrinaj	
AUTONOMIA E QEVERISJES VENDORE. DECENTRALIZIMI I PUSHTETEVE NË KUADËR TË REFORMËS SË RE ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	226
Florida Arrinaj / <u>Xhuana Abazi</u>	
SFIDAT E PËRKTIMIT TË NJË POEZIE MISIONARE: “FJALËT E QIRIRIT”.....	227
Dr. Alva Dani	
IMPORTANCE OF ELECTRONIC HEALTH SYSTEM IN KOSOVO.....	233
MA. Elmedina Bajgora, PhD candidate Dr. Ndue Jetishi Dr. Donika Jetishi Komani	
Ass.Dr. Hateme Hoxha Nimani	
GRAPHIC ART IN KOSOVO: ARTIST SHYQYRI NIMANI.....	245
Mr. Sc. Jeton Rexhepi, PhD.c	
PËRGJEGJËSIA PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT NË QEVERISJEN E KORPORATËS.....	250
Qëndresa Agolli	
NETWORKED DATABASES AND THEIR ROLE IN THE FINANCIAL REPORTING OF KOSOVO COMMERCIAL COMPANIES.....	268
Edmond Beqiri / Violeta Beqiri	

KONTRIBUTI I STUDIUESVE SHQIPTARË PËR MËNYRËN LIDHORE - VËSHTRIM DIAKRONIK CONTRIBUTION OF ALBANIAN STUDIES FOR LEADERSHIP - DIACRONIC OVERVIEW

Agnesa Hasimja – Pasha

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Kosovë,
agnesa.hasimja@uni-pr.edu

Abstract

The connecting way is inherited, but also recreated. In the Albanian language, she expresses the modality of possibility, necessity, obligation, probability, etc. In the beginning it is thought, according to some scholars, that the meaning of the conjunction was the volitional, deliberative, prospective meaning, which are also presented to our old authors, such as: Buzuku, Budi or Matrënga, etc.

In terms of structure, it is distinguished by the demonstrative mode, first of all by the grammatical participle of, which is preceded by the main verb, and then also by some changes of the themes and personal endings in the singular. The relational mode is much more often present in dependent sentences than in independent ones, in which it performs various syntactic functions. In terms of usage, this way comes after the demonstrator, which is the most used way in the Albanian language.

In this paper, the relational way in Albanian in diachronic view will be treated according to some Albanian scholars; for the peculiarities and commonalities that characterize their studies regarding the relational mode. Ways such as grammatical categories in Indo-European will be discussed; hence the connecting mode; this way will be treated in the Albanian language: what were the meanings with which it came out from the beginning, and what were its functions; as well as the origin of the grammatical particle “to” of the conjunction.

Abstrakt

Mënyra lidhore është mënyrë e trashëguar, por edhe e rikrijuar. Në gjuhën shqipe ajo e shpreh modalitetin e mundësisë, të domosdoshmërisë, të detyrimit, të gjasës etj. Në zanafillë mendohet, sipas disa dijetarëve, se kuptimi i lidhores ka qenë kuptimi volitiv, deliberativ, prospektiv, që paraqiten edhe te autorët tanë të vjetër, si: Buzuku, Budi apo Matrënga etj.

Për nga struktura ajo dallohet nga mënyra dëftore, në radhë të parë nga pjesëza gramatikore të, që i paravendoset foljes kryesore, e më pastaj edhe nga disa ndryshime të temave dhe mbaresave vetore në numrin njëjës. Mënyra lidhore shumë më shpesh paraqitet te fjalitë e varura sesa te të pavarurat, në të cilat kryen funksione të ndryshme sintaksore.

Për nga përdorimi, kjo mënyrë vjen pas dëftores, e cila është mënyra më e përdorur në gjuhën shqipe.

Në këtë punim do të trajtohet mënyra lidhore në shqipen në vështrim diakronik sipas disa studiuesve shqiptarë; për veçantitë dhe të përbashkëtat që i karakterizojnë studimet e tyre lidhur me mënyrën lidhore. Do të diskutohet mënyra si kategori gramatikore në indoevropianishte; rrjedhimisht edhe mënyra lidhore; do të trajtohet kjo mënyrë në gjuhën shqipe: cilat ishin kuptimet me të cilat dilte që në fillim, dhe cilat ishin funksionet e saj; si dhe zanafilla e pjesës gramatikore “të” të mënyrës lidhore.

Fjalë çelës: mënyra, mënyra lidhore, modaliteti

1. Hyrje

1.1.Lidhorja në indoevropianishte

Gjuhëtarë të ndryshëm kanë mendime të ndryshme për kuptimin zanafillës të mënyrës lidhore. Disa mendojnë se kuptimi i saj ka qenë volitiv a voluntativ, d.m.th. kuptimi i të shprehurit të vullnetit të folësit. Por, disa të tjerë e kanë shprehur mendimin se lidhorja në zanafillë ka pasur kuptim prospektiv, d.m.th. kuptimin e së ardhmes. Brugmani (te Demiraj,2015:303) dallon tri kuptime të lidhore: 1) *kuptimin volitiv ose voluntativ*; 2) *kuptimin deliberativ* (në pyetje, nëpërmjet të cilave pyetet për ç’duhet bërë a ç’duhet të ndodhë); 3) *kuptimin prospektiv*, nëpërmjet të cilit shprehet një parashikim. Edhe Demiraj (2015:303) shprehet se mënyra lidhore në zanafillë duhet të jetë përdorur nëpër fjali të pavaruara me kuptim volitiv a voluntativ. Si rrjedhim, kuptimet e tjera modale të kësaj mënyre (mundësi, gjasë, detyrim etj.) duhet të jenë diakronikisht dytësore sipas tij. Edhe përdorimi i lidhore me kuptimin e mënyrave dëshirore dhe urdhërore duhet të jetë diakronikisht dytësor. Burimi i lidhore indoevropiane, sipas Likaj (2005:141), lidhet me prirjen e krijimit të një forme karakteristike për shprehjen e mundësisë me kuptim pohues. Ai, lidhoren e karakterizon nga kuptimi volitiv, të cilit më vonë iu shtua edhe kuptimi real, prandaj në mjaft gjuhë ajo kishte një përdorim të trefishtë me këto emërtime:

- *coniunctivus deliberativus*,
- *coniunctivus perspectives* dhe
- *coniunctivus adhortativus*.

Për shprehjen e dy funksioneve të fundit, siç thekson Risch-u (cit. te Likaj,2005:141), me kohë, u përdorën forma të tjera, sepse gjendja e krijuar shkaktonte një pështjellim kuptimor.

Lidhorja e mirëfilltë u zhvillua gjerësisht në hapësirën indoevropianolindore dhe në mënyrë të pavarur edhe në gjuhën latine dhe kelte. *Coniunctivus deliberativus* e kishte përdorimin kryesor, i cili e ruajti edhe modalitetin e mundësisë.

Meiser-i vëren se lidhorja formantet *-e/-o*, të cilat vendoseshin midis mbaresës dhe temës. Duke u nisur nga gjatësia e zanoreve formante, Meiser-i thekson se prej kohësh janë dalluar dy lloj lidhoresh: 1. lidhore me zanore të shkurtër (*me -e/-o*); 2. lidhore me zanore të gjatë (*me -ē/-ō*). Lidhorja me zanore të shkurtër u përftua nga format atematike, kurse lidhorja me zanore të gjatë u përftua nga bashkimi i zanores formant të saj me zanoren tematike (te Likaj, 2005:141).

Nuk ka një mendim të përbashkët mbi burimin e formave zanafillëse të mënyrës lidhore. Gjithsesi, është e qartë se kjo mënyrë në gjuhë të ndryshme i.e., nën ndikimin analogjik të mënyrës dëftore, ka zhvilluar edhe forma kohore në kundërvënie midis tyre (Demiraj, 2015:303).

2. Mënyra lidhore në gjuhën shqipe

Mënyrat foljore kryesore të shqipes janë, në thelb, të trashëguara nga një periudhë e hershme i.e. Por gjatë evolucionit të saj kjo gjuhë i ka zhvilluar më tej kundërvëniet modale (Demiraj,2015:256). Shumë mënyra janë zhdukur në shumë gjuhë indoevropiane, po ka edhe rikrijime. Janë formacione të shqipes: - dëshirorja, sipas H.Pedersenit është një “aorist i lidhore”; habitorja, është një krijim i shqipes (Çabej,1986:142), që gjatë evolucionit të saj historik ka krijuar edhe disa forma foljore (Demiraj,1988:905). Edhe për lidhoren, Çabej (1986:142) thotë se përmban elemente të trashëguara, po është njëkohësisht edhe rikrijim. Ai e merr si shembull, foljen *shkoj*, dhe e bën krahasimin në dëftore dhe lidhore: *shkoj*, në dëftoren *unë shkoj, ti shkon, ai shkon; ne shkojmë, ju shkoni, ata shkojnë*; në lidhoren *unë të shkoj, ti të shkosh, ai të shkojë; ne të shkojmë, ju të shkoni, ata të shkojnë*. Pra, vetëm veta e dytë dhe e tretë e njëjësit dallohen, përndryshe katër të tjerat janë njësoj. Domethënë, sipas Çabejt, erdhi një periudhë e shqipes ku këto dy mënyra u puqën në format e tyre.

Në gjuhën shqipe, ashtu si në gjuhët e tjera ballkanike, mënyra lidhore i është nënshtruar një evolucionit të shumanshëm. Faktorët, që i kanë dhënë shkas këtij evolucionit të shumanshëm, kanë qenë të ndryshëm. Demiraj (2015:304) e lidh këtë evolucion, në radhë të parë, me prirjen e gjuhëve ballkanike për ta përdorur lidhoren edhe nëpër fjali të nënrenditura, kryefjala e të cilave në shumë raste ndryshon nga ajo e fjalisë kryesore. Si rrjedhim, në shqipen e dokumentuar lidhorja përdoret më shumë nëpër fjali të nënrenditura.

Bokshi (2012:34) përmend kohën kur protoshqipja nuk kishte paskajore, lidhorja nuk do të mund të mbetej pa u begatuar me funksione të fjalive të varura. Sipas Demirajt (2015:304) format e lidhore, sidomos ato të kohës së tashme, përdoren edhe nëpër fjali kryesore, përkatësisht të mëvetësishme. Ato përdoren edhe pas foljeve modale *mund* dhe *duhet*, pas të cilave në shumë gjuhë të tjera përdoret pajkajorja. Bokshi (2012:35) thotë se nuk mund të mendohet po ashtu që lidhorja të mos ketë krijuar që atëherë (protoshqipe, kur mungonte paskajorja) edhe shprehje të tipit *dua të shkoj, mund të shkoj, lypset të shkojmë, duhem të shkoj* etj. e që paskajorja të mos i ketë gjetur këto shprehje të krijuara para saj. E një përdorim i tillë i lidhore, sipas Demirajt, nuk ndeshet vetëm në të folmet jugore, por edhe në të folmet veriore. Në këto të fundit një përdorim i tillë duhet të jetë relativisht i vjetër, siç na dëshmojnë edhe shkrimet e Buzukut, Budit etj.

Për shembull:

Buzuku: 1. *E tek u vete, ju nukë mundë (=mund të) vini.* 2. *E ata s munda merrnë (=s'mund ta merrnin) se ai flit.*

Budi: *A muna dish... (A mund ta dish...), Si munë jetë (mund të jetë) ujëtë e vdra e akullit të tre nja?* (Demiraj, 2015:304). *Sā mā të fëdigësh, aqë mā mirë ke me i mbaruom gjithë kafshëtë..., ... tue i lutunë qi për arësye të shtampohetë..., ...e rekomendonj e e porësit ndër dorë të zotënisë sāj... kafshënë ma të dahunënë qi të keshë përmbi dhët, ndōnëse me pak fëdigë mbasi ta kini bukurë ndëgjuom, t ini të zotë...* (Demiraj, 2015:306).

Sipas Mansakut (1979:141), te Buzuku në rreth 226 raste që përdoret folja *mund* si modale, 136 herë ndiqet nga lidhorja, 38 ndiqet nga paskajorja.

Përdorimi i lidhore pas foljes modale *mund* është zhvilluar sidomos si rrjedhim i faktit që kjo folje modale në shqipen e dokumentuar, kur përdoret me vlerën e kohës së tashme (e aty-këtu edhe me vlerën e së pakryerës) del me një formë të ngurosur (Demiraj, 2015:304).

Format “kohore” të mënyrës lidhore (sidomos ato të “kohës së tashme”) në shqipen e dokumentuar përdoren edhe nëpër fjali të thjeshta, përkatësisht kryesore, të paraprirë nga ndonjë folje modale, në të tri kuptimet e parashtruara nga Brugmani. Këtu do shënuar se Buzuku e përdor relativisht dendur “të tashmen” e lidhore me kuptim prospektiv në vend të formave të mirëfillta të së ardhmes, si p.sh. *...E aj qi të vinjë tek u, u nukë ta qes (=do ta qes) jashtë...* (Demiraj, 2015:305). Konjuktivi në funksion prospektiv te Buzuku ka pothuajse të njëjtën vlerë si trajta e futurit “kam+infinitiv”, dhe Camaj, i cili ndër të parët e argumenton këtë veçori të gjuhës së Buzukut, sjell shembuj të saktë të përdorimit të të dy formave (Fiedler,1978:29).

Sipas Fiedler-it (1978:29) është e mundur që në kohën paraletrare kuptimi i së ardhmes së lidhore të ketë qenë i përhapur në mbarë shqipen; më së fundi është fjala për një fenomen të gjuhës bazë indoevropiane, i cili shfaqet më së miri në latinishten, ku i tërë futuri vjen ekskluzivisht nga trajta konjuktive. Edhe Bardhyl Demiraj (2012:44) flet për përdorimin e mënyrës lidhore me vlerën e së ardhmes, e cila bashkë me formën futurit *kam+paskajore*, e kishin ngadalësuar përdorimin e së ardhmes me do+lidhore në dialektin verior. Gjithashtu Mansaku (2012:79) jep një shembull nga Buzuku për një përdorim të tillë të lidhore, p.sh.: *Ju për të vërtetë të pini (=do të pini)*.

Gjithashtu, sipas Demiraj, përdorimi i dendur i lidhore ka marrë shkas edhe nga mënjanimi i plotë (ose i pjesshëm) i paskajores, dukuri kjo e paraqitur edhe në gjuhët e tjera ballkanike, për të cilin mënjanim të paskajores në shqipen Mansaku e kundërshton (2012:75).

Mënyra lidhore shpreh veprime të mundshme, të dëshiruara, të supozuara ose irrealë. Ajo mund të shprehë edhe urdhra, lutje, urime etj., duke e zëvendësuar në këto kuptime mënyrën urdhërore dhe dëshiroren (Topalli,2010:177), për përdorimin e të cilave Demiraj (2015:308) mendon se është relativisht i hershëm në gjuhën shqipe. Me këto kuptime modale, duke shprehur veprime subjektive ose të parrealizuara, mënyra lidhore i kundërvihet mënyrës dëftore, që shpreh veprime objektive, reale dhe konkrete. Duke hyrë në lidhje të tilla opozicionale, lidhëria është mënyra më e përdorur pas dëftores, me të cilën shprehet një mendim më i përpunuar e më abstrakt (Topalli,2010:177).

Në shqipen, ashtu si në greqishte, rumanishte, bullgarishte e maqedonishte, mënyra lidhore (sidomos “koha e tashme” e saj), siç thekson Demiraj (2015:308), përdoret dendur me kuptim deliberativ, veçanërisht nëpër fjali pyetëse dhe pyetëse-thirrmore, që nisin (ose jo) me një fjalë pyetëse. Është fjala për përdorime të tipit *Të rrosh a të mos rrosh?* (Noli). *Ç’të bëj? Ku të vete?* etj. Konjuktivi deliberativ nuk ekziston vetëm në toskërishten moderne dhe gegërishten moderne, por edhe te Buzuku është shumë i shpeshtë (Fiedler,31), edhe Demiraj (2015:308). Shembuj nga Buzuku: *Qish t i lypinj?*; *E i tha ati Toma: Zot, na nukë dimë ku vete e si na të dimë udhënë?*

Te Buzuku, Fiedler-i vëren edhe përdorimin e konjuktivit: *polemik*, për shembull: *E këti të thuosh ngjënim.*; (1978:33); *të papërcaktuar-koncesiv*, për shembull: *A s mundë banj qish të duo...?* (1978:34); *kondicional* etj.

Pra, lidhëria në gjuhën shqipe, në bazë të kuptimeve të ndryshme modale të saj, gjatë evolucionit të kësaj gjuhe ka marrë edhe funksione, që në zanafillë nuk i kishte.

Ky zgjerim i funksioneve të lidhore në gjuhën shqipe i ka dhënë shkas edhe shndërrimit të shkallëshkallshëm të funksionit të saj zanafillës si një formë foljore modale në një mënyrë të foljes, ku modaliteti është gërshetuar edhe me kategorinë e kohës. Si rrjedhim, është bërë e mundur që edhe te kjo mënyrë e foljes të zhvilloheshin kundërvëniet formash kohore, siç janë ato midis së tashmes, së pakryerës, së kryerës dhe më së kryerës. Ky evolucion është kryer qysh shumë kohë para shpërnguljeve të arbreshëve për në Greqi dhe Itali. Kështu, e vetmja “kohë” e mirëfilltë e lidhore së shqipes është ajo e “së tashmes”, e cila gjithashtu ka pësuar ndryshime të rëndësishme si në temën ashtu edhe në mbaresat vetore të saj (Demiraj,2015:308).

3. Përdorimi i pjesëzës gramatikore *të* të lidhore

Pjesëza gramatikore *të* u përdor për të dalluar një mënyrë të re, lidhoren, nga dëftorja, që sipas Çabejt (1986:143) ishte një mbeturinë e një dëftori. *Të*-ja e lidhore nuk ishte lidhëz që e jepte kuptimin e qëllimit, siç ka pandehur Sandfeldi. Me origjinën e saj përemrore, ajo ishte indiferente ndaj kuptimeve të trashëguara të lidhore së lashtë dhe u bë lidhëz e funksioneve të kufizuara të fjalive të varura të kësaj mënyre. Dhe vetëm për shkak të neutralitetit të tillë, ajo u bë pjesë e pandashme e mënyrës lidhore, d.m.th. u përdor edhe kur lidhorja dilte në funksione të fjalisë së pavarur a kryesore (Bokshi,2010:66). Demiraj (2015:307) mendon se pjesëza *të* ka qenë burimisht një lidhëz nënrenditëse, që shërbente për të lidhur një fjali të nënrenditur, ku folja ishte në mënyrën lidhore. Me kalimin e kohës ajo u bë pjesë e pandashme e formave foljore të lidhore, prandaj u bë e pamungueshme edhe kur format foljore të lidhore përdorëshin nëpër fjali jo të nënrenditura. Në krye të herës kjo dukuri është shfaqur me format “e kohës së tashme” të lidhore e më pas është shtrirë për analogji edhe në format e tjera “kohore” të kësaj mënyre. Edhe Topalli (2005:178), shprehet se pjesëza *të*, në krye të herës do të ketë qenë lidhëz. Sipas tij, ajo mund të ketë shërbyer edhe për të bashkuar foljen e mënyrës dëftore me atë të mënyrës lidhore, afërsisht ashtu siç përdoret sot lidhëza *që* për këtë qëllim. Kjo lidhje i ka dhënë shkas edhe krijimit të shumë togjeve foljore, disa prej të cilave kanë marrë atributet e një forme të vetme foljore (*khs. do të shkoj, duhet të shkoj, mund të shkoh, le të shkojë etj.*). Dhe meqenëse kategorinë e vetës e të numrit në këto togje i shpreh folja e mënyrës lidhore, folja e parë në mënyrën dëftore, ka pësuar reduktim të ndjeshëm duke i kthyer shpesh në fjalë të ngurosura (*khs. do të isha, mund të shkojmë, le të nisen, duhet të isha nisur*).

Edhe në rumanishten, në një periudhë më të lashtë ka një lidhore pa *sa*, e cila i përgjigjet në funksion të saj shqipes *të, sa vie* “unë dua që të vijë”, kjo *sa* në disa tekste të vjetra rumune nuk ishte shfaqur ende. Së këndejmi, edhe atje lidhorja, për ta dalluar nga dëftorja, u pajis me një pjesëz (Çabej, 1986:143).

Në kapitullin e parë (Periudha deri në përfundim të shekulli V), në veprën *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes* të Besim Bokshit, në të cilën pjesë diskutohet edhe për pjesëzën *të*, format e futurit *do të punoj, kam të punoj* dhe format *duhet të punoj e mund të punoj* tregojnë se në këtë kohë lidhorja e kishte përfutur pjesëzën *të* në funksione të fjalisë së varur dhe dilte me të vetëm në këto funksione. Në këto forma lidhorja del në funksion të fjalisë kryefjalore e kundrinore. Në kohë më të vona, duket që nga fillimi i periudhës së shek. XIII-XV, pjesëza *të* do të jetë bërë pjesë e pandashme e lidhore, e përdorshme në të gjitha funksionet e saj (Bokshi, 2010:66). Pjesëza *të*, sipas Bokshit (2010:66) nuk është e krahasueshme as për nga origjina, as për nga kuptimi me lidhëzën *sa* të rumanishtes, e cila që nga latinishtja (*si*) e kishte kuptimin e kushtores dhe vetëm pas shekullit XVI e humbi përdorimin me dëftoren dhe u bë pjesë e pandashme e lidhore, që domethënë se ishte bërë gradualisht neutral ndaj kuptimeve të lidhore. Pjesëza *të* nuk është e krahasueshme as me lidhëzën *vá* të greqishtes.

Po te Buzuku (Çabej,1986:143) e te Matrënga (Bokshi,2010:66) janë disa raste ku pjesëza *të* ende nuk përdoret, sidomos kur është pjesëza mohuese *mos*. Demiraj përmend mungesën e kësaj pjesëze edhe te Budi (2015:307). Një shembull në të cilin mungon pjesëza *të* te Buzuku:

Në do kush me ardhunë mbas meje, aj lanë vetëvetëhenë e marë kryqnë e ti muo ndjekë. Aj qi të besonjë mbë të, mos jetë trembunë (Demiraj,2015:307).

Sipas Çabejt (1986:143) lidhorja me *të* është një formim relativisht i ri. Edhe në poezinë popullore ka lidhore pa *të*, p.sh., në këngët popullore të jugut *Vijë e më vrasë mua*, në vend të *Të vijë e të më vrasë mua*.

Megenëse foljet e mënyrës lidhore janë forma analitike, Topalli (2005:180) mendon se një problem më vete përbën pozicioni i trajtave të shkurtra dhe i fjalës mohuese *mos* në raport me pjesëzën *të*. Ndërsa sa u përket trajtave të shkurtra, ato e kanë të ngulitur pozicionin e tyre gjithnjë ndërmjet pjesëzës *të* dhe të trupit të foljes (*khs. të më marrësh, t'i thuash*) dhe në asnjë të folme nuk gjendet ndonjë pozicion tjetër. Kjo renditje, ku më afër foljes qëndron trajta e shkurtër, dëshmon se kjo e fundit është e lidhur më ngushtë me foljen se pjesëza *të*, që qëndron më larg saj. Sipas Topallit (2005:180) kjo është e kuptueshme, po të merret parasysh se pjesëza *të*, megjithëse është bërë pjesë organike e formës foljore,

nuk ka qenë pjesë e saj në krye të herës; kurse trajtat e shkurtra janë përdorur gjithnjë pranë foljeve, si fjalë të patheksuara, sepse me këtë shpjegohet rrëgjimi i tyre.

Një raport i ngjashëm qëndron edhe me pjesëzën mohuese *mos*, e cila si rregull qëndron ndërmjet pjesëzës *të* dhe trupit të foljes, p.sh.: *Të mos shkosh*, te Buzuku. Por në gegërishten e sotme kjo topikë nuk është e qëndrueshme, pasi ka raste kur pjesëza e mohimit del në rend të parë (*khs. mos të shkosh atje, mot t'i thuesh gjã*); te Buzuku: *Porsi mali i Sionit mos të vëlizenë për jetë të jetësë*. Këtë ndryshim topike Topalli (2005:181) e lidh me mundësinë e ndikimit nga mënyra urdhërore, meqenëse forma e lidhore përdoret edhe me kuptim urdhëror (*khs. mos puno – mos të punosh*), ose ndikimi mund të vijë nga forma e paskajores, meqenëse kjo e fundit zëvendësohet lehtë nga forma e lidhore (*khs. mos me punue – mos të punoni*). Ka edhe raste kur pjesëza *të* vihet edhe para, edhe pas fjalës mohuese, si p.sh.: te De Rada: *Mba tutjë të mos të vras*.

Pjesëza *mos*, që është karakteristike e mënyrës lidhore, në mjaft raste është e mjaftueshme për të shënuar modalitetin e lidhore, duke bërë të panevojshëm përdorimin e pjesëzës *të*. Kjo dukuri në shqipen e sotme shfaqet më tepër në fjalitë hortotative të tipit *mos biesh, mos rrëzohesh*; por tek autorët e vjetër dukuria është mjaft e shpeshtë, me raste ku pjesëza *mos* mbetet i vetmi tregues i mënyrës lidhore; p.sh., te Buzuku: *Askana mos trazojmë, përse kamba jote mos përpiqetë mbë gūrt*; Figlia: *Mos shkonjë lopa për tēr*. Te arbëreshët e Greqisë edhe pas pjesëzës *le*: *E le jetë edhe i vogël* (Topalli,2005:181).

4. Përfundim

Në përgjithësi, kategoria gramatikore e mënyrës ka pësuar shumë ndryshime në forma dhe funksione në krahasim me gjendjen e vjetër indoevropiane. Në fazat më të hershme dalloheshin tri modalitete kryesore, të cilave u përgjigjeshin edhe mjetet formale përkatëse: modaliteti i vërtetësisë, i mundësisë dhe volitiv.

Sa i përket mënyrës lidhore, Burgmani (te Demiraj, 2015:303) dallonte tri kuptime të lidhore: kuptimin volitiv, deliberativ dhe prospektiv. Ndërsa, sipas Demirajt, kuptimet e tjera modale (mundësi, gjasë, detyrim etj.), e edhe përdorimi i lidhore me kuptimin e mënyrave dëshirore dhe urdhërore, duhet të kenë qenë diakronikisht dytësore.

Mënyra lidhore ka pësuar një evolucion të shumanshëm, dhe faktorët për këtë zhvillim kanë qenë të ndryshëm. Demirajt përmendte prirjen e gjuhëve ballkanike për ta përdorur lidhoren edhe nëpër fjali të nënrenditura, kryefjala e të cilave në shumë raste ndryshon nga ajo e fjalisë kryesore. Kështu, në shqipen e dokumentuar ajo përdoret më shpesh nëpër fjali të varura. Por, po ashtu format e lidhore, sidomos të së tashmes, përdoren edhe në fjali kryesore, apo edhe pas foljeve modale *mund* dhe *duhet*. Një përdorim i tillë ndeshet në të dyja të folmet, jugore dhe veriore, për të cilin thuhej se ishte relativisht i vjetër (Demiraj,2015:304), meqë gjendej edhe te autorët e vjetër, si Buzuku, Budi etj.

Për kuptimet e lidhore, si: deliberativ, prospektiv, polemik etj. sipas Fiedler-it, Demirajt, Topallit, duhet të jenë relativisht të vjetra, meqë për këtë dëshmojnë shkrimet e vjetra të shqipes.

Lidhorja në gjuhën shqipe, gjatë evolucionit të kësaj gjuhe, në bazë të kuptimeve modale që kishte, ka marrë edhe funksione, që në zanafillë nuk i kishte. Ky zgjerim i funksioneve i ka dhënë shkas edhe shndërrimit të shkallëshkallshëm të funksionit të saj zanafillës si një formë foljore modale në një mënyrë të foljes, ku modaliteti është gërshetuar edhe me kategorinë e kohës. Si rrjedhim, sipas Demriajt, është bërë e mundur që edhe te mënyra lidhore të zhvilloheshin kundërvënie formash kohore, siç janë ato midis së tashmes, së pakryerës, të kreyerës dhe më se të kryerës. Ky evolucion mendohet të jetë kryer qysh shumë kohë para shekullit XIV.

Për pjesëzën gramatikore *të* të mënyrës lidhore se mund të ketë qenë lidhëz që e jepte kuptimin e qëllimit sipas Sandfeldit, Bokshi e kundërshton, duke u shprehur se *të*-ja me origjinën e saj përemrore, ishte indiferente ndaj kuptimeve të trashëguara të lidhores së lashtë dhe u bë lidhëz e funksioneve të kufizuara të fjalive të varura të kësaj mënyre. Dhe vetëm për shkak të neutralitetit të tillë, ajo u bë pjesë e pandashme e mënyrës lidhore, d.m.th. u përdor edhe kur lidhorja dilte në funksion të fjalisë së pavarur. Paraqitjen e pjesëz *të*, Bokshi e përmend qysh në kapitullin Periudha deri në përfundim të shekullit V, por që nga fillimi i periudhës së shek. XIII-XV ajo do të jetë bërë pjesë e pandashme e lidhores, e përdorshme në të gjitha funksionet e saj. Ndonëse, siç shënojnë autorë si: Çabej, Demiraj, Topalli, Bokshi, ka raste kur *të*-ja mungon ndonjëherë tek autorët e vjetër.

5. Bibliografia

- Bokshi, Besim. 2010. Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes. Prishtinë.
- Bokshi, Besim. 2011. Format e futurit të shqipes në raport me gjuhët e Ballkanit. ASHAK. 29-37. Prishtinë.
- Beekes, Robert. 1995. Comparative indo-european linguistics. John Benjamins Publishing Company. Amsterdam/Philadelphia.
- Çabej, Eqrem. 1986. Studime gjuhësore (VII). Prishtinë.
- Demiraj, Shaban. 1975 Morfologjia historike e gjuhës shqipe. Tiranë.
- Demiraj, Shaban. 1988. Gramatika historike e gjuhës shqipe. Tiranë.
- Demiraj, Shaban. 2004. Gjuhësi Ballkanike. Tiranë.
- Demiraj, Shaban. 2015. Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Tiranë.
- Demiraj, Bardhyl. 2011. E ardhmja e tpit do+lidhore si dukuri mbarëgjuhësore, dialektore dhe ballkanike në shqipe. ASHAK. 37-71. Prishtinë.
- Fiedler, Wilfried. 2011. Zhvillimi i infinitivit gegë nga aspekti i ballkanologjisë. ASHAK. 27-49. Prishtinë.
- Likaj, Ethem. 2005. Fleksioni indoevropian. Tiranë.
- Mansaku, Seit. 2011. Tipologji romane dhe ballkanike në strukturën gramatikore të shqipes. ASHAK. 71-91. Prishtinë.
- Topalli, Kolec. 2010. Gramatika historike e gjuhës shqipe. Tiranë.
- Topalli, Kolec. 2010. Sistemi foljor i shqipes. Tiranë.

**TEKNIKAT DHE MJETET E KËRKIMIT TË PROVËS NË ZBULIMIN E VEPRËS
PENALE TË VRASJES
TECHNIQUES AND MEANS OF SEARCHING FOR EVIDENCE IN THE
DETECTION OF THE CRIMINAL OFFENSE OF MURDER.**

LLM Dea Toçi
Avokate Tiranë

Abstract

Criminology has proven to be a science that requires immediate response and direct action to investigate crimes and detect them in three main stages. The criminal offense of murder as an example in this paper, as a start requires a speedy ascertainment of the environment, the circumstances in which it was committed, preparatory actions related to taking measures to secure the scene, in order failure to damage traces and evidence from various factors. Of particular importance is the formation of the investigative group, speeding up the crime scene, actions at the scene and actions after the inspection.

From here, the second phase takes off, which requires an extraordinary care of the investigative groups at the scene, with the tools, methods, which will be applied in this case in order to detect as many traces and evidence as possible. , methods and manner of action of the perpetrator of the criminal offense of murder. What is important now is no longer the speed of the reaction, but the professionalism with which the actions will be performed, which will make it possible to increase the effectiveness of the results of the preliminary examination of the first phase.

Depending on what I mentioned above, the murder investigation does not end with the investigation of the scene. He only lays the foundations of a comprehensive investigation of all the circumstances related to the subjective and objective side of the crime figure for the concrete case. To make this possible, it is necessary to perform a series of procedural investigative actions, such as expertise, investigative experiments, checks, interceptions of conversations and telecommunications, questions, confrontations, presentations for recognition, seizures, arrests and other special actions. These actions constitute the third and final stage from the point of view of murder investigation investigation management.

Abstrakt

Kriminalistika është vërtetuar se është një shkencë e cila kërkon reagimin e menjëhershëm dhe marrjen e masave direkte për hetimin e krimeve dhe zbulimin e tyre në tre faza kryesore. Vepra penale e vrasjes si një shembull në këtë punim, si fillim kërkon një konstatim sa më të shpejtë të mjedisit, rrethanave në të cilën është kryer ajo, veprimeve përgatitore që kanë të bëjnë me marrjen e masave për sigurimin e vendit të ngjarjes, më qëllim mosdëmtimin e gjurmëve dhe provave nga faktorë të ndryshëm. Rëndësi të veçantë ka formimi i grupit hetimor, shkuarja me shpejtësi në vendin e krimit, veprimet në vendin e ngjarjes si dhe veprimet mbas këqyrjes.

Prej këtu merr hov dhe faza e dytë, e cila kërkon një kujdes të jashtëzakonshëm të grupeve hetimore në vendin e ngjarjes, me mjetet, metodat, që do të zbatohen në rastin konkret me qëllim që të zbulohen sa më shumë gjurmë dhe prova që vërtetojnë mjetet, metodat dhe mënyrën e veprimit të autorit të veprës penale të vrasjes. Tanimë e rëndësishme nuk është më shpejtësia e reagimit, por profesionalizmi me të cilin do të kryhen veprimet të cilat do të bëjnë të mundur rritjen e efektivitetit të rezultateve të këqyrjes paraprake të fazes së parë.

Varësisht ç'ka përmenda më lart, hetimi i krimit të vrasjes nuk mbaron me këqyrjen e vendit të ngjarjes. Ai vetëm hedh themelet e një hetimi të gjithanshëm të të gjitha rrethanave që lidhen me anën subjektive dhe objektive të figurës së krimit për rastin konkret. Për të bërë të mundur këtë është e nevojshme kryerja e një sërë veprimesh procedurale hetimore, si ekspertime, eksperimente hetimore, kontrolle, përgjime të bisedave dhe telekomunikimeve, pyetje, ballafaqime, paraqitje për njohje, sekuestrime, arrestime e veprime të tjera speciale. Këto veprime përbëjnë fazën e tretë dhe përfundimtare nga pikëpamja e menaxhimit të hetimit të krimit të vrasjes.

Fjale kyce: Kriministika, vrasja, këqyrja, prova, kryerësi, përgjime, arrestime, ADN.

1.Hyrje

Trajtimi dhe studimi kriminalistik i vrasjes bën të mundur që të kuptohet shkalla dhe gjendja e këtyre veprave penale në një territor të caktuar, mes shqyrtimit të tyre sipas viteve, strukturës, (mosha, përkatësia sociale, gjinore, qëllimeve dhe motiveve etj). Po ashtu bëhet i mundur edhe studimi i raportit ndërmjet kryerësit të veprës dhe viktimës.

“Zbulimi dhe hetimi i vrasjeve është i vështirë. Vështirësia vjen për shumë arsye, për shkak se ka disa figura krimi dhe shumë rrethana e fakte që duhen vërtetuar, për shkak se në disa raste nuk dihet fajtori, nuk dihen motivet dhe koha e vrasjes, sepse ndonjëherë nuk dihet se kush është viktimja, për shkak se nga koha e kryerjes së vrasjes dhe e zbulimit kalon një kohë e gjatë dhe humbasin gjurmët. Për kapërcimin e këtyre vështirësive, përveç përdorimit të metodave teknike dhe taktike shkencore, gjatë kryerjes së veprimeve të ndryshme hetimore, organin procedues e ndihmon edhe opinioni shoqëror ku ka ndodhur vrasja. Siç e theksuam edhe më lart, momentet kryesore për fillimin e çështjes penale në vrasje, janë kallëzimi mbi zbulimin e kufomës, njoftimet e personave të afërm familjarë, ose që e kanë parë vrasjen, njoftimet mbi shpalljen e personave si të pagjetur, dorëzimi i vetë fajtorit pas kryerjes së vrasjes etj.

Në hetimin e vrasjes, veprime të para hetimore dhe të tjera janë: këqyrja e vendit të ngjarjes dhe e kufomës, pyetja e dëshmitarëve të parë, këqyrja dhe ekspertimi mjeko-ligjor i kufomës, paraqitja për njohje e kufomës kur nuk njihet, ekspertimi kriminalistik i gjurmëve dhe i provave materiale, ndjekja e fajtorëve në bazë të gjurmëve të freskëta, përdorimi i qenit të ndjekjes në një kohë me këqyrjen e vendit të ngjarjes, mbi këqyrjen e sendeve të caktuara, mbledhjen e të dhënave që i përkasin viktimës, kërkimi i sendit të vjedhur kur ka vjedhje me dhunë me pasojë vdekje”.¹

Natyra e vrasjes, motivet dhe personat pjesëmarrës në të, përbëjnë thelbin e studimit dhe zbulimit nga ana e strukturave hetimore. Ngritja e versionit mbi natyrën e ngjarjes bëhet duke u mbështetur kryesisht në të dhënat objektive të këqyrjes së vendit të ngjarjes, në analizën e skenës së krimit, autorëve në vendin e ngjarjes, veprimeve të autorit mbas kryerjes së krimit të vrasjes, këqyrjes së kufomës dhe ekzaminimit mjeko-ligjor të kufomës.

2.Këqyrja

Këqyrja relizohet në mjedisin ku ka ndodhur vrasja si dhe në gjithë ambientet e tjera ku gjenden pasojat e krimit të vrasjes në të gjitha rastet e vdekjeve që kanë ndodhur në mënyrë të papritur dhe në rrethana të ndryshme, qofshin këto vdekje natyrale apo me dhunë. Ajo ka disa veçori nga pikëpamja procedurale dhe kriminalistike në krahasim me veprimet e tjera hetimore që kryhen në këto raste. Është veprim që kryhet me iniciativë nga përfaqësuesi i organit të procedurës, gjithmonë duke pasur parasysh se oficeri i policisë gjyqësore para se të shkojë në vendin e ngjarjes ka detyrim ligjor të njoftojë prokurorin dhe duhet të konfirmojë marrjen pjesë në këqyrjen në vendin e ngjarjes ose t'i delegojë kompetencat oficerit të policisë gjyqësore dhe si rregull është veprim i papërsëritshëm.

Megjithatë praktika ka vërtetuar edhe raste kur këqyrja mund të përsëritet, si p.sh për shkaqe objektive kur këqyrja ka filluar dhe për arsye të errësirës, kushteve atmosferike ajo nuk mund të vazhdojë por ndërpritet dhe përsëritet kur krijon kushtet normale për këqyrje; kur gjatë hetimit të çështjes konkrete mund të dalin rrethana të reja që e bëjnë të domosdoshme përsëritjen e këqyrjes së mjedisit ku është kryer vrasja; kur këqyrja e vendit të ngjarjes është kryer me cilësi të dobët, pra në procesverbalin e këqyrjes nuk janë zbatuar me korrektësi kërkesa procedurale dhe kriminalistike në lidhje me përshkrimin e mjedisit të krimit, gjurmëve dhe provave si dhe të çdo gjëje tjetër që ndodhet në vendin e ngjarjes.

¹. S.Begeja *Kriminalistika*, Tiranë, 2004, fq.539.

Këqyrja është një veprim i pazëvendësueshëm, pra nuk ka asnjë veprim procedural tjetër që mund të zëvendësojë këqyrjen e vendit të ngjarjes. Nga pikpamja procedurale me qëllim që të ruhet zinxhiri provues i gjurmëve dhe provave të fiksuar në mjedisin e vendit të ngjarjes, ka shumë rëndësi që të zbatohen në mënyrë rigorozë të gjitha rregullat e fiksimit duke filluar në përshkrimin e tyre në procesverbal, në skicë, fotografimin dhe filmimin e tyre, si dhe paketimin, sekuestrimin, administrimin dhe përgatitjen e tyre mbas këqyrjes për kryerjen e ekspertimit përkatës.

Këqyrja e kufomës bëhet duke respektuar rregullat e përgjithshme të këqyrjes së vendit të ngjarjes në raport me mjedisin ku ndodhet ajo, me gjurmët dhe provat që ndodhen rreth saj dhe këqyrja e vetë kufomës, duke pasur parasysh pozicionin e saj pas vdekjes pa e lëvizur, duke u fokusuar në pozën që ka marrë trupi, pozicionin e gjymtyrëve në raport me trupin dhe në raport me njëri-tjetrin. Më pas bëhet këqyrja dinamike e mjedisit ku gjendet kufoma dhe këqyrjen e vetë kufomës duke filluar me këqyrjen e teshave të saj me qëllim zbulimin dhe evidentimin e dëmtimeve që konstatohen në teshat e viktimës, karakteristikave të tyre, numrit të tyre, pozicionit të vendosjes së tyre në raport me njëra-tjetrën. Gjatë kësaj faze të këqyrjes së kufomës bëhet shume kujdes kur vdekja e viktimës ka ardhur si rrjedhojë e asfiksionit mekanike duke e lidhur më parë viktimën. Në këtë rast studiohet me kujdes materiali që ka përdorur për lidhje dhe në mënyrë të veçantë mënyrën e lidhjes, formën e nyjës, lakut².

Synimi kryesor i këqyrjes së brendshme është këqyrja dhe ekzaminimi i njollave kufomore. Studimi i njollave kufomore ndihmon grupin e hetimit për të ngritur versione të sakta për kohën se kur ka ndodhur vrasja, si dhe për vendin se ku mund të jete kryer krimi i vrasjes në rast se viktimë është transportuar nga një vend në një vend tjetër dhe këqyrja e brendshme e kufomës përqendrohet tek dëmtimet që konstatohen tek viktimë, numri i tyre, karakteristikat e pamjes së jashtme, duke pasur parasysh gjithmonë veçoritë e vrimës së hyrjes së shkaktuar nga mjeti dëmtues dhe karakteristikat e daljes së tij, pozicionin e vendosjes së vrimës së hyrjes dhe të daljes.

Këqyrja e kufomës përfundon me autopsinë e kufomës e cila përbën dhe fazën e fundit të veprimit të këqyrjes.

Ky ekzaminim si rregull kryhet në morg nga eksperti mjeko-ligjor, ku ndërkohë mund të marrin pjesë eksperti kriminalist për të bërë fiksime të nevojshme që mund të lindin, si dhe përfaqësuesi i organit të procedurës. Në përfundim mund të theksojmë se rezultatet e këtij veprimi hetimor shumë të rëndësishëm janë produkt i punës në ekip midis përfaqësuesit të organit të procedurës, prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore, specialistit kriminalist dhe ekspertit mjeko-ligjor.

3.Kontrolli

Kontrolli është një veprim procedural hetimor që kryhet në ambiente të ndryshme, si banesa, lokale ose tek personi me qëllimin që të kërkohet, të zbulohen, fiksohen dhe të merren gjurmë dhe prova materiale që vërtetojnë kryerjen e një veprë penale të vrasjes dhe fajësinë e autorit të saj. Si të tilla do të konsiderojmë sendet që kanë shërbyer si mjet për të kryer veprën penale, sendet që mbajnë mbi vete gjurmën e krimit, sendet që janë objekt i veprimtarisë kriminale, sendet që janë objekt i përfuturit të veprimtarisë kriminale, si dhe sende të tjera dhe dokumente që mund të shërbejnë si mjet për zbulimin e veprës penale dhe të fajësisë së fajtorëve.

“Kontrolli i personit të dyshuar ose të personave që janë të lidhur zhvillohet për të zbuluar mjetet me të cilat është kryer krimi (pistoleta, thika, helmi, etj.), objektet që mbajnë gjurmë krimi (për shembull teshat me gjurmë gjaku, objektet e vjedhura të viktimave), dokumentet dhe provat materiale (letra, ditarë, fotografi), të cilat flasin për fajtorin, për lidhjet e tij, për vendin se ku mund të ndodhet autori, apo bashkëpunëtorët etj.”³

Kontrolli në fillim kryhet në vendin ku ai ndalohej, duke e kontrolluar për sende të paligjshme që mund të ketë me vete dhe që mund t'i përdorë për të kundërvepruar ndaj forcave të policisë, më pas vazhdon në ambientet e organit procedues, duke bërë një kontroll më të imët të trupit dhe teshave të personit të ndaluar. Si veprim i domosdoshëm procedural, kërkon domosdoshmërisht nxjerrjen e vendimit të gjykatës kompetente që i dërgohet për ekzekutim policisë gjyqësore. Në rast flagrance ose në rast ndjekjeje të personit që është duke ikur, gjë që nuk lejon nxjerrjen e vendimit të kontrollit, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë me iniciativë kontrollin e personit ose të lokalit.

³ S. Begeja. Kriminalistika, Tiranë, 2004, fq. 538.

4. Sekuestrimet

Sekuestrimet janë një mjet i kërkimit të provës që ka si qëllim marrjen dhe ruajtjen nga ana e organit të procedurës, të provave dhe sendeve që kanë lidhje dhe i përkasin veprës penale të vrasjes, duke u detyruar të marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen dhe të ruhen, të pasqyrohen në procesverbal me një vendim të arsyetuar, ku mosveprimi me urgjencë mund t'i shkaktojë dëm të pariparueshëm hetimit dhe zbulimit të krimit. Objekt i sekuestrimit janë letrat, zarfet, pakot dhe mjete të tjera të korrespondencës. Rezultatet e këqyrjeve, të kontrollimeve, të përgjimeve e të bisedave ose të komunikimeve të kryera në shkelje të dispozitave që parashikon ligji nuk mund të përdoren.

5. Përgjimi i bisedave dhe telekomunikimeve

Zbatimi i përgjimit të komunikimeve apo bisedave përbën një burim shumë të rëndësishëm për të siguruar prova dhe dëshmi që vërtetojnë në mënyrë bindëse fajësinë e personave që kanë kryer vrasje. Përgjimi si veprim procedural mund të shërbejë vetë si provë ose mund të shërbejë si mjet për të shkuar tek prova të tjera. Në këtë kuptim kemi parasysh gjithmonë dy kategori të përgjimit të bisedave dhe komunikimeve, ai që kryhet në fazën e parandalimit dhe vërtetimit operativ të krimit të vrasjes, rezultatet e të cilit nuk kanë vlerën e provës, por në të njëjtën kohë ai i paraprin dokumentimit ligjor, duke shërbyer si një mjet shumë efikas për të siguruar prova dhe dëshmi të tjera dhe ai që kryhet në fazën e hetimit dhe dokumentimit ligjor të fajësisë së autorëve të krimeve kundër personit, duke respektuar të gjitha kërkesat e ligjit procedural penal.

6. Zbulimi i veprës penale të vrasjes në përshtatje me veçori specifike

6.1 -Metodat e A.D.N-së dhe fotografisë

Ku flasim për analizën e A.D.N-së kemi parasysh ekzaminimin e gjurmëve me origjinë biologjike të cilat janë me prejardhje humane, shtazore ose bimore. Si të tilla mund të përmendim gjurme gjaku, fije floku, pështyme, sperma, pjesë nga indet e ndryshme, mbetjet trunore, gjethet e pemëve, frutat e tyre, pjesët e trungut, rrënjët e pemëve, etj. Këto gjurmë kërkohen, zbulohen dhe fiksohen në vendin e ngjarjes, tek kufoma, tek personi i dëmtuar, ose në mjedise të tjera si banesë, automjete, tek mjetet që ka përdorur autori etj, të cilët bëhen objekt këqyrje në rastin e krimit të vrasjes.

“Ekzaminimi i A.D.N-së përbën një provë e cila për nga rëndësia është e njëjtë me gjurmët daktiloskopike. Bartësit e vetive trashëguese janë kromozomet apo gjenet. Çdo qelizë e ndonjë organizmi është e shënuar me kod specifik i cili quhet gen.”⁴

Megjithatë praktika hetimore dhe gjyqësore e vendit tonë dhe vendeve të tjera ka vërtetuar së vlera e provës së profilit gjenetik nuk ka të njëjtën vlerë me rezultatin e ekspertimit daktiloskopik të gjurmëve papilare, pasi është vërtetuar shkencërisht që profili ADN-së tek binjakët e vërtetë, pra që kanë lindur nga e njëjta vezë, është i njëjtë, nuk është i ndryshëm. Një përputhje e tillë nuk konstatohet asnjëherë tek gjurmët papilare të binjakëve të vërtetë që kanë dalë nga e njëjta vezë. Ajo që e bën specifike ADN-në te personat e ndryshëm është renditja specifike e nukleotideve në varg polinukleotik. Ajo është bartëse dhe përcjellëse e informacioneve trashëguese e domosdoshme për trashëgiminë e jetës nëpër gjenerata dhe për organizimin specifik të çdo qelizë. Kur bëhet analiza e strukturës së ADN-së është i sigurt identifikimi i personit që ekzaminohet me këtë metodë. Këtë metodë e zbuloi për herë të parë biologu Anglez Alec Jeffery i Universitetit të Losterit në Angli. Ai vërtetoi se testi i ADN-së bazohet në faktin se asnjë qenie njerëzore nuk ka profil të njëjtë gjenetik.

Kjo metodë është përdorur edhe nga FBI-ja. Secili organizëm posedon një sasi të caktuar të ashtuquajturave informacione gjenetike, kështu që në bazë të një elementi shumë të imët nxirret përfundimi se si është i ndërtuar i gjithë organizmi. Metoda e përcaktimit të gjurmës gjenetike nuk është tepër e komplikuar dhe nuk kërkon aparatura të shtrenjta dhe të veçanta. Metoda e ADN-së është një metodë shumë efektive jo vetëm në zbulimin e kryerësve të veprave penale, por njëkohësisht formë efektive eliminuese e personave të dyshuar si kryerës të ndonjë veprave penale konkrete.

6.2 Ekspertimi i gjurmëve biologjike

Analiza e gjurmëve dhe mikrogjurmëve me origjinë organike është objekt i shkencave ligjore si biologjia ligjore. Përcaktimi i gjurmëve gjenetike, nisur nga gjurmët biologjike si gjaku, pështyma, sperma, fije floku, inde të ndryshme etj, është tashmë njëra prej teknikave të identifikimit më efektive që zbatohet nga shkencat ligjore në vende të ndryshme të botës.

Ajo bazohet në faktin se të gjitha qelizat jetësore përmbajnë profilin e ADN-së.

⁴ V. Latifi., “ADN-ja. Analize, si mjete teknik hetimi ne luftën kundër dhunës dhe krimit,”E drejta ‘Prishtine, Nr,1-2, viti 2002,faqe 7-16.

Qelizat e bakteve mund të përmbajnë vetëm një zinxhir të ADN-së, por ky zinxhir përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për prodhimin e një qelize bijë identike. Qelizat e mamifereve përmbajnë dhjetë zinxhirë të ADN-së të grupuara në kromozome. Si përfundim, struktura e një molekule të ADN-së, ose një tërësie molekulash, përcaktojnë formën, përmbajtjen, dhe funksionin individual të qelizës bijë.

Identifikimi i personit me anë të gjurmëve biologjike kalon në dy faza, e para ka të bëjë me ekzaminimin paraprak me qëllim vlerësimin e provave biologjike (gjaku, fije floku, etj) nga pikëpamja e natyrës dhe nëse ato kanë vlera për identifikimin e personit me anë të profilit gjenetik. Në këtë fazë bëhet dhe ekzaminimi makro dhe mikroskopik për fijet e flokut, përcaktimi i grupit e nëngrupit të gjakut, me qëllim për të bërë përjashtimin kategorik të personave të dyshuar që sillen për krahasim ose identifikimin grupor të tyre me qëllim për të kaluar në fazën e dytë për të bërë identifikimin e personit me anë të profilit gjenetik. E dyta ka të bëjë me nxjerrjen e profilit gjenetik në gjurmët, objekt ekspertimi, pra që janë fiksuar në vendin e ngjarjes ose në vende dhe sende të tjera si dhe nxjerrjen e profilit gjenetik të gjurmëve model që u përkasin personave të dyshuar.

Krijimi i një databaze gjenetike kombëtare kërkon në radhë të parë krijimin e infrastrukturës së nevojshme nga pikëpamja teknike dhe së dyti duke iu referuar eksperiencës së vendeve të tjera si Italia, Anglia, kërkon edhe krijimin e bazës ligjore për marrjen e mostrave të ADN-së, e cila në vendin tonë momentalisht mungon. P.sh., në Angli, në ligjin për drejtësinë penale dhe rendin publik, janë parashikuar dispozita, të cilat autorizojnë marrjen e mostrave trupore për analiza të ADN-së dhe regjistrimin e tyre në një bazë të dhënash duke filluar nga 10 prilli 1995. Ligji i jep pushtet policisë që të marrë model në organet intime dhe në ato jo intime tek personi i dyshuar.

Në përfundim mund të themi se tre janë drejtimet kryesore që përfaqësuesi i organit proçedues, specialisti i vendit të ngjarjes, eksperti biolog, duhet të tregojnë kujdes, me qëllim që analiza e ADN-së të jetë e suksesshme. Momenti më i rëndësishëm është ai i kërkimit, zbulimit, fiksimit dhe paketimit të gjurmëve biologjike në vendin e ngjarjes duke respektuar me korrektësi të gjitha rekomandimet e metodikes përkatëse, së dyti është ai i transportit dhe mbajtjes në kushte sa më optimale me qëllim që ato të mos kontaminohen dhe të humbasin vlerat për identifikimin e autorit dhe së treti organi proçedues, në të gjitha rastet, kur si rrjedhojë e kryerjes së veprimeve hetimore dhe gjyqësore, administron gjurmë biologjike është i detyruar të vërë në lëvizje ekspertimin e tyre.

6.3 Fotografia si metodë fiksime dhe analiza e skenës së krimit ne vrasje

Në procesin e të provuarit të krimit të vrasjes një rol shumë të rëndësishëm luan fotografia kriminalistike si metodë fiksime e rezultateve të veprimeve të ndryshme hetimore që kryhen gjatë procesit të hetimit, duke filluar nga këqyrja e vendit të ngjarjes, eksperimentit hetimor, fiksimit të gjurmëve dhe provave që lidhen me autorin dhe mjetet që ka përdorur ai për të realizuar krimin e vrasjes, si dhe të rezultateve të ekzaminimeve të ndryshme kriminalistike dhe mjeko-ligjore. Fotografia kriminalistike përfshin në vetvete një sistem të tërë metodash tekniko-optike të mbështetura në parimet e fotografisë artistike dhe në arritjet e avancuara të shkencave natyrore dhe teknike. Duke shfrytëzuar këto arritje ajo ka krijuar një sërë avantazhesh në krahasim me metodat e tjera të fiksimit, siç është përshkrimi në procesverbal dhe në skicën e kryerjes së veprimit hetimor.

Kohët e fundit në Policinë Shkencore të vendeve të zhvilluar janë duke u zbatuar teknikat speciale të përpunimit dixhital, të cilat krijojnë avantazhe që të analizohen imazhet relative të vendit të krimit dhe në veçanti ato që kanë të bëjnë me viktimën, plagët, provat dhe gjurmët, mekanizimi i formimit të tyre. Më pas imazhet fotografike që individualizojnë një skenë krimi, inkludohen në programe logjike informatike, duke bërë të mundur që në bazë të krahasimeve automatike të këtyre imazheve të bëhet lidhja e rasteve të ndryshme të ndodhura në kohë dhe vende të ndryshme

Teknologjitë e avancuara si fotometria, fotografia stereoskopike dhe grafika e kompjuterizuar bëjnë të mundur rindërtimin tredimensional të dinamikës së krimit. Duke u nisur nga kryerja dhe nivelimet planimetrike, nga imazhet të fotografuara, nga ekspertimet mjeko-ligjore dhe kriminalistike, është e mundur të arrihet në një rindërtim të skenës së krimit, që lejon të seleksionosh në mënyrë progresive nga fusha e hetimeve çdo informacion të padobishëm për zbulimin e autorit të mundshëm të vrasjes.

7. Teknika special në hetimin e krimit të vrasjes

7.1 Punonjësi i policisë i infiltruar.

Krimet kundër personit krijojnë një sërë mundësish për infiltrimin e agjentëve sekret, si dhe një numër problemesh për përfaqësuesit e organit procedues që drejtojnë dhe udhëheqin hetimin. Gjithmonë çështja thelbësore dhe përgjegjësia kryesore, është ajo e sigurisë. Roli i mbikëqyrësit në këto lloje veprimesh është me rëndësi vendimtare për arsye të sigurisë së agjentit sekret dhe natyrshmërisë së veprimeve që kryen ai.

7.2 Metoda e inçizimit të dëshmisë.

Metodat e inçizimit të kësaj dëshmie më cilësi të lartë duhet të merren parasysh gjatë fazës së planifikimit të operacionit. Metoda më normale është përdorimi i pajisjeve audio të vogla për inçizim.

Për arsye sigurie këshillohet që punonjësi i policisë i infiltruar nuk duhet të mbajë paisje të inçizimit në takimin e parë të procesit të infiltrimit sepse ekziston rreziku që mund t'i nështrohet një kontrolli trupor si çështje rutinore. Kjo do t'i japë mundësi punonjësit të policisë së infiltruar që të bëjë vlerësimin paraprak për mundësinë e mbajtjes së paisjeve të tilla në takimet pasuese.

7.3 Këqyrja e personit dhe sendeve

Këqyrja e personave, e vendeve dhe sendeve vendosen nga organi proçedues kur është e nevojshme të zbulohen gjurmët dhe pasojat e tjera materiale të veprës penale. Shkencat ligjore kanë përpunuar një gamë metodash e mjetesh për zbulimin, fiksimin dhe për shfrytëzimin e gjurmëve, me qëllim që mbi bazën e tyre, të shpjegohet mekanizmi i ngjarjes, të zbulohen dhe të identifikohen autorët, ose mjetet e përdorura prej tyre në kryerjen e krimit⁵.

“Në hetimin e vrasjes, veprimet e para hetimore dhe veprime të tjera janë: këqyrja e vendit të ngjarjes dhe kufomës, pyetja e dëshmitarëve të parë, këqyrja dhe ekspertimi mjeko-ligjor, paraqitja për njohje e kufomës kur nuk njihet, ekspertimi kriminalistik i gjurmëve në bazë të gjurmëve të freskëta, përdorimi i qenit të ndjekjes në një kohë me këqyrjen e vendit të ngjarjes, mbikëqyrja në vende të caktuara si dhe e personave të ndryshëm, mbledhja e të dhënave që i përkasin viktimës etj”⁶.

7.4 Përgjimi i bisedave telefonike

Komunikimi nëpërmjet telefonit dhe mjeteve të tjera të telekomunikacionit është një e drejtë e individit për të komunikuar lirisht, me të gjitha format dhe mjetet e kësaj teknologjie, si biseda telefonike, fakse, telegrame, e-mail etj. Çdo ndërhyrje e paligjshme që cënon këtë të drejtë, nga cilido që do të bëhet është një veprim arbitrar i dënueshëm.

⁵ O. Afezulli, Revista Tribuna Juridike , Tiranw, 2002, Aplikimi i teknologjive moderne në zbulimin e gjurmëve papilare, fq.39

⁶ V.Latifi, Kriminalistika, Prishtine, 2004,fq.226

Prandaj, në shtetet me teknologji të zhvilluar në fushën e telekomunikacioneve, e cila krijon mundësi të shumta për të ndërhyrë në jetën private dhe në sekretet e shtetit si në rastin e internetit, po përmirësojnë legjislacionin me synim që të pengohet çdo ndërhyrje e paligjshme.

Vëzhgimi

Duke pasur parasysh rrezikshmërinë shoqërore shumë të lartë të krimit vrasjes, rrezikshmërinë shumë të madhe të personave që kryejnë vrasje sidomos kur kemi të bëjmë me profesionistë përsëritës në këtë veprimtari kriminale (Serial Killer), zbatimi i operacioneve vëzhguese është mëse i domosdoshëm në procesin e të provuarit të fajësisë së autorit të vrasjes. Përdorimi i teknikave të vëzhgimit duhet të kryen në pajtim me kërkesat e ligjit procedural të vendit ku ato kryhen, ndryshe ato nuk kanë vlerën e provës në gjykatë gjatë fazës së gjykimit. Qëllimi është të sigurohet vazhdimësia e identifikimit të personave, të ambienteve, mjediseve, mjeteve që ato përdorin. Kjo gjen zbatim në ato raste kur krimi i vrasjes është kryer në bashkëpunim nga një grup i organizuar dhe kur ka të dhëna dhe informata se ky grup përgatitet të kryejë vrasje të tjera në të ardhmen për qëllim dhe motive të ndryshme. Gjithashtu vëzhgimi do të synojë në identifikimin e rolit të personave që janë përfshirë në veprimtarinë kriminale të vrasjes.

Perfundimet

Nga studimi dhe analizimi i aspekteve Juridiko-Penale, Kriminologjike dhe Kriminalistike të vrasjes, mund të konstatojmë se ky lloj i kriminalitetit përfshin pjesën e veprave penale kundër jetës e trupit, si dhe manifeston disa veçori dalluese nga veprat e tjera penale.

Veprat penale kundër jetës dhe shëndetit kanë qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes së ligjvënësve e të teoricienëve, sidomos vepra penale “vrasje”, e cila konsiderohet një nga veprat më të rënda penale. Vrasja është privim kundërligjor i jetës së tjetrit, pavarësisht se a bëhet me qëllim apo pa dashje. Ato, në të kaluarën por edhe sot, me të drejtë konsiderohen si lloji më i rëndë i kriminalitetit, me të cilat asgjësohet vlera më e rëndësishme e shoqërisë dhe e individit “jeta” e njeriut. Si të tilla, ato shkaktojnë edhe një varg pasojash sociale dhe pasoja të tjera të cilat në masën më të madhe e godasin viktimën, kryesisht dhe anëtarët e familjeve të tyre.

Në aspektin kriminalistik lind i domosdoshëm aplikimi i mjeteve dhe metodave shkencore bashkëkohore në kryerjen e veprimeve duke filluar që nga konstatimi i veprës penale, këqyrjes së vendit të ngjarjes, këqyrja e kufomës, ekzaminimi i gjurmëve dhe provave, marrja e vërtetësisë së provës dhe shqyrtimi i saj, si dhe në taktikat e pyetjes së të pandehurit, dëshmitarit, eksperimenteve hetimore,

me qëllim rritjen e efektivitetit të këtyre veprimeve hetimore të cilat ndikojnë direkt në zbulimin, hetimin dhe dokumentimin me prova shkencore të fajësisë së autorit të vrasjes dhe cilësimin e drejtë juridik të veprës penale konkrete.

Në aspektin kriminologjik, prioritet i duhet dhënë faktorëve ekonomik (reformave) sociale dhe punësimit të njerëzve. Luftimi dhe parandalimi i suksesshëm i krimit të vrasjes, imponon domosdoshmërinë e studimit dhe njohjes së shkaqeve dhe kushteve me ndikim në paraqitjen e tyre. Përveç faktorëve të përgjithshëm objektiv dhe subjektiv, shtrohet nevoja e njohjes dhe e përcaktimit edhe të faktorëve të posaçëm dhe individual, të cilët ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në paraqitjen dhe ekzistimin e këtij lloj krimi. Njohja studimi dhe analizimi i këtyre faktorëve bëjnë të mundur ndërmarrjen e masave me qëllim të luftimit dhe parandalimit të suksesshëm të krimit të vrasjes.

Statistikat tregojnë se numri më i madh i vrasjeve kryhet në mjedise urbane. Situata të tilla, na bëjnë të konkludojmë se zgjidhja e disa çështjeve ekonomiko-shoqërore dhe sociale e kësaj shtrese të popullsisë, dhe ndërmarrja e masave të gjera në masë të konsiderueshme, do të kontribuonte në zvogëlimin e numrit të vrasjeve. Aplikimi i dënimit me burg, konsiderohet mjeti më efikas në luftimin dhe parandalimin e krimit të vrasjes. Policia duke qenë një institucion publik që punon për t'u shërbyer qytetarëve dhe ofruar atyre siguri e garanci në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tyre, e ka të domosdoshme të ndërtojë marrëdhënie të ngushta me komunitetin ku vepron, që në fakt paraqet konceptin e ndërgjegjësimit të komunitetit.

Lista e referencave

1. **Elezi, Dr.Ismet**, “Studimi i shkaqeve të vrasjeve dhe lufta kundër tyre,” Drejtësia popullore, Tirane 1973, faqe 13
2. Botim i Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Nr. 3, Tiranë 1996, faqe.37
3. **Elezi, Dr.Elezi**, “E drejta penale pjesa e posaçme”, Tiranë 2002
4. **Begeja, Dr.Skënder**, “Kriminalistika”, Tiranë 2004
5. **Latifi, Dr.Vesel**, “Taktika kriminalistike,” Prishtinë 2001
6. **Vladimir, Mastër Ikonomi**, “Metoda moderne në ekspertim kriminalistik”, Tiranë 2004
7. **Halili, Dr.Ragip**, “Qëllimi dhe arsyet e dënimit për krimet e vrasjes,” Përparimi, Nr.6, Prishtinë 1970. faqe,
8. **Halili, Dr.Ragip**, “Penologjia” Prishtinë, 2005
9. **Halili, Dr.Ragip**, “Kriminologjia” Prishtinë 2005.
10. **Salihu, Dr.Ismet** “Vrasjet në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës” Prishtinë, 1985
11. **Salihu, Dr.Ismet** “E drejta penale Pjesa e përgjithshme,” Prishtinë 1995.
12. **Salihu, Dr.Ismet** “Marrëdhëniet midis vrasësit dhe viktimës dhe kontributi i saj në kryerjen e veprës penale” E drejta Nr. 2, Prishtinë, 1985. faqe,
13. **Sahiti, Dr.Ejup** “E drejta e procedurës penale” Prishtinë, 1984
14. **Sahiti, Dr.Ejup**“Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurën penale” Prishtinë, 1993.
15. **Sahiti, Dr.Ejup**, “Argumentimi në procedurën penale” Prishtinë 1999
16. **Kuliqi, Mr.sc.Halim** “Viktima e delikteve të gjakut në Kosovë”, Prishtinë 2003

VETËQEVERISIA LOKALE NË KOSOVË **LOCAL SELF-GOVERNMENT IN KOSOVO**

PhD.Cand. Kastriote Vlahna

Asistente e rregullt në Universitetin i Prizrenit “Ukshin Hoti” Prizrenë.

Dafina Vlahna

kastriote.vlahna@uni-prizren.com

Nr.Kontaktues: 044/679/327

Abstract

An effective and democratic local government is absolutely essential for a stable and prosperous Kosovo. Four (4) years after the implementation of decentralization in Kosovo, we can conclude that progress has been made in the field of local government and consolidation of the country's municipalities. Also, as a result of the institutional commitment and hard work and dedication of many people, the legal framework of local government has advanced and at the same time we have a consolidation of direct democracy, which has essentially increased the democratic credentials of the country. However, the issue of institutional accountability and transparency remains a challenging issue that needs to be addressed more broadly. It seems that based on the post-war period until today, it is clear that we have an improvement in the function of local government and cooperation of local government with the central government of the country, this happens thanks to the work and maximum commitment of local and international leaders. .

Therefore, given the current state of local self-government, through this paper I have tried to briefly address the organization of local self-government in Kosovo and the activity of local self-government leaders, with the intention to continue with a more comprehensive work and current development of local self-government in Kosovo !.

Keywords: Local Self-Government in Kosovo, organization of Local Self-Government in Kosovo, function of Local Self-Government in Kosovo, supervision of work of local self-government in Kosovo, current development of local self-government in Kosovo;

Abstrakt

Një Qeveri lokale efektive dhe demokratike është absolutisht thelbësore për një Kosovë stabile dhe prosperuese. Katër (4) vjet pas zbatimit të decentralizimit në Kosovës mund të konstatojmë se është bërë progres në rrafshin e pushtetit lokal dhe konsolidimit të komunave të vendit.

Poashtu, si rrjedhojë e angazhimit institucional dhe punës së madhe dhe të përkushtuar të shumë njerëzve, korniza ligjore qeverisjes lokale ka përparuar dhe në të njëjtën kohë kemi një konsolidim të demokracisë së drejtpërdrejtë, që në esencë ka rritur kredencialet demokratike të vendit. Megjithatë, çështja e llogaridhënies dhe transparencës institucionale mbetet një çështje sfiduese e cila duhet të trajtohet më gjerësishtë. Dukue u bazuara nga periudha e pasë lufës e deri më sot, shihet qartazi se kemi një përmirësim në funksionin e qeverisies lokale si dhe bashkpunimin e qeverisies lokale me qeverisien qendrore të vendit, kjo ndodhë falë punës dhe angazhimit maksimal të udhëheqësve vendor si dhe atyre ndërkombëtarë.

Andaj, duke pasur parasysh gjendjen aktuale të vetëqeverisies lokale, perms këtijë punimi jam munduar që në pika të shkurta të bëj trajtimin e organizimit të vetëqeverisies lokale në Kosovë si dhe veprimtarin e udhëheqësve të vetëqeverisies lokale, me mendim që në të ardhmen të vashdoj me një punim më gjithëpërfshirës të punës dhe zhvillimit aktual të vetëqeverisies lokale në Kosovë!.

Fjalët kyçe: Vetëqeverisia Lokale në Kosovë, organizimi i vetëqeverisies Lokale në Kosovë, funksioni i vetëqeverisies Lokale në Kosovë, mbikqyria e punësë vetëqeverisies lokale në Kosovë, zhvillimi aktual i vetëqeverisies lokale në Kosovë;

HYRJE

Pushteti vendor siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive, respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera, zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë, ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore. Dhe në Shtetin e Republikës së Kosovës është munduar që të formohet një qeverisie sa më efikase dhe transparente për të gjithë qytetarët e Kosovë, kështu duke e ndarë atë në nivel qëndorë dhe lokal. Andaj ne si qytetarë gjat përditëshmëris hasim më shumë të kemi pun me qeverisien lokale, kështu duke shiquar punën që aktualisht bëhet në nivelin lokal në Kosofvë dhe më gjerë. Në botën bashkëkohore funksionimi normal i pushtetit lokal varet nga shumë indikatorë të cilët janë të rëndësishëm për jetën e qytetarëve dhe për mirëfunksionimin e institucioneve të pushtetit lokal të cilët duhet pasur parasysh por dy janë më të rëndësishme: funksionimi financiar dhe administrativ i organizimit të pushtetit lokal.

Në Republikën e Kosovës qeverisja lokale në aspektin financiar ka rëndësi të madhe sepse nga kjo dukuri varet mirëqenia dhe funksionimi i mirëfilltë i Komunave të Republikës së Kosovës. Me Kushtetutë të Republikës së Kosovës, Komunitat kanë këto të drejta në aspektin financiar: të drejtë të vendosin tatimet për qytetarët e komunës së tyre, të caktojnë normën e tatimeve, të mbledhin tatimet, të shpenzojnë këto të hyra dhe njëherit kanë të drejtën të marrin fonde nga qeveria qendrore. Këto janë parime të cilat duhet pasur parasysh gjithnjë nga ana e Komunave nëse ato dëshirojnë që të funksionojnë mirë në aspektin profesional dhe bashkëkohor duke zbatuar legjislacionin në fuqi gjithnjë në të mirë të qytetarëve

KREU I

KUPTIMI I ADMINISTRIMIT LOKAL NË KOSOVË

Qeverisja vendore nënkupton të drejtën e njerëzve në bashkësinë e caktuar territoriale që në mënyrë të pavarur të qeverisin punët e tyre, nëpërmjet organeve të cilat i zgjedhin vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në aspektin e përgjithshëm thekësojmë se kjo qeverisje vendore ndahet në nivelin qendrorë dhe në nivelin lokal, e meqë ne si qytetarë kemi qasje më të shpeshtë me qeverisjen lokale për atë dhe duhet të ndalemi që në fillim të kemi të qartë se çka nënkuptojmë me administrim lokal në Kosovë?, përgjigje të cilën e gjejmë në shumë libra universitar nga autorë shqiptarë e ndërkombëtarë, kështu sin ë vijim: Administrimi lokal apo qeverisja lokale paraqet një çështje mjaft të ndërlikuar, si nga aspekti i shkencës politike ashtu edhe nga aspekti i praktikës politike e kushtetuese. Për faktin se administrimi lokal qoftë si fenomen apo si praktikë mungojnë studime të plota gjithëpërfshirëse për lëndën apo objektin e administrimit lokal. Andaj në kuptim më të përgjithshëm, misioni i administrimit lokal përkatësisht qeverisjes lokale, është “Sigurimi i qeverisjes në një nivel sa më të afërt me qytetarët”. Pra, Vetëqeverisja lokale paraqet formë të udhëheqjes së bashkësive lokale ku qytetarët, direkt ose nëpërmjet përfaqësuesve që i zgjedhin vetë, vendosin për interesat dhe punët me rëndësi lokale. Përkufizim të administrimit lokal e bënë dhe Ligji i Administrimit Lokal në Kosovë në këtë mënyrë: Vetëqeverisje lokale do të thotë e drejta dhe aftësia e autoriteteve lokale, të themeluara sipas këtij Ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që rregullojnë organizojnë dhe të menaxhojnë një pjesë substanciale të çështjeve nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës vendore.

1.1. Historiku i vetëqeverisjes lokale në Kosovë

Shekulli i 20 konsiderohet si promotori i krijimit të përparësive në qeverisjen lokale në botë.

Reformat e vazhdueshme në përpjekjen e krijimit të sistemeve të përparuara të qeverisjes lokale kanë qenë kontribut i hulumtimeve të vazhdueshme gjatë shekullit të kaluar dhe në fillim të shekullit 21. Elaborimi i Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale ka qenë i lidhur ngushtë me garantimin e të drejtave të komuniteteve dhe përfaqësuesve të tyre me rastin e delegimit të autoritetit nga niveli qendror në atë lokal. Në përputhje me këto parime, filloi reforma e pushtetit lokal në Kosovë. Reforma filloi në vitin 1999/2000, pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe vendosjes së Administratës së UNMIK-ut. Fillimisht, organizimi dhe funksionimi i pushtetit lokal u rregullua me Rregullore të UNMIK – ut, që kishin fuqi ligjore dhe pastaj me ligj dhe kushtetutë në vitin 2008. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës ishte akti i parë rregullativ me fuqi ligjore që vendosi themelet e një sistemi të vetëqeverisjes lokale demokratike dhe në shërbim të qytetarëve në shtetin e Kosovës. Ndryshimet përfshijnë jo vetëm sferën e ekonomike por edhe atë shoqërore dhe politike. Me këtë rregullore themelohet baza juridike e sistemit të vetëqeverisjes lokale në përputhje me parimet dhe praktikën demokratike evropiane. Nga viti 1999 e deri në vitin 2010, janë nxjerrë shumë rregullore të UNMIK me fuqi ligjore, ligje organike, ligje sektoriale dhe udhëzime administrative, të cilat i kanë dhënë një autonomi gjithnjë e më të madhe pushtetit lokal në Kosovë. Ndërsa, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në shkurt të vitit 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës i miratoi ligjet e reja kryesore për vetëqeverisjen lokale, të cilat kanë zëvendësuar legjislacionin e deri atëherëshëm.

Zhvillimi i kornizës ligjore për vetëqeverisjen lokale në Kosovë mund të ndahet në tri periudha kohore:

1. Periudha e administrimit të komunave me Administrator komunal, sipas Rregullativave të UNMIK-ut, nga viti 2000 deri më 2002;
2. Periudha e administrimit të komunave pa administrator komunal sipas Rregulloreve të UNMIK-ut dhe akteve tjera ligjore të IPVQ, me transferim të kompetencave në organet e vetëqeverisjes lokale, gradualisht nga viti 2002 deri më 2007;
3. Periudha e vetëqeverisjes lokale sipas Kushtetutës dhe Ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nga 2008 deri sot.

1.2. Rëndësia e vetëqeverisies lokale

Punët lokale janë ato punë të cilat me Kushtetutë ose me lihje nuk janë të parapara si punë të pushtetit shtetërorë. Dhe qëllimi kryesorë i tyre është që qytetarëve tu lehtësohet mënyra e kryerjes së shërbimeve përmes parimit të ekonomizimit. Në shtetet me qetëqeverisje tradicionale kryhen punë me interes të drejtëpërdrejtë të banorëve që jetojnë në territorin e bashkësis lokale.

1.3. Burimet për studimin e qeverisies lokale në Kosovë

Burimet për studimin e qeverisjes lokale që nga koha e pasë luftës në Kosovë janë të shumta kështu duke filluar nga rregulloret e UNMIK-ut. Me kornizën ligjore janë përcaktuar shtyllat e organizimit, funksionet, të drejtat, obligimet dhe mbikëqyrja e organeve komunale. Nga viti 2008, Kushtetuta e Republikës së Kosovës përfaqëson bazën themelore ligjore për ndërtimin dhe funksionimin e VQL në Kosovë. Po ashtu në bazë të dispozitave të nenit 123 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, komuna përfaqëson nivelin e vetëm të pushtetit dhe njësinë themelore, ndërtuese dhe funksionale të vetëqeverisjes lokale me pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Përcaktimi i këtij lloji të PL ka për qëllim eliminimin e tendencave për përfaqësim të ndryshëm të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

1.4. Ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore të vetëqeverisies lokale në Kosovë

Në përputhje me parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe “Pakos së Ahtisarit”, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar LVL, si ligj organik apo themelor për organizimin dhe funksionimin e VQL në Kosovë. Ligji i cakton normat dhe standardet për një VQL e cila bazohet në 4 shtylla kryesore:

- Organizimi dhe funksionimi i SVQ
- Pushteti i autoriteteve lokale (autonomia lokale)
- Demokracia lokale (zgjedhja e organeve komunale);
- Mbikëqyrja e autoriteteve lokale;

Derisa me ligjet organike është rregulluar në parim ndërtimi dhe funksioni i sistemit të VQL, me ligjet specifike është rregulluar ndërtimi dhe funksioni i fushave të caktuara të cilat me ligj nuk janë rregulluar në mënyrë specifike. Me ligje specifike janë rregulluar disa fusha specifike të SVQL, si: zgjedhjet lokale, krijimi i komunave dhe kufijtë administrativ të tyre, menaxhimi financave lokale, bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërkufitar, shfrytëzimi i tokës dhe menaxhimi i kompanive publike rajonale. Ndërkaq ndërtimi dhe funksionimi i SVQL është rregulluar me ligje tjera organike dhe të veçanta ndërsektoriale të ministrive të linjës.

Në bazë të analizave të bëra rezulton se fushat kryesore të funksionimit të VQL janë të rregulluara me ligje dhe akte tjera nënligjore. Nga hulumtimet e bëra është konstatuar se secila kompetencë e komunave, së paku është e rregulluar nga një ligj e më shumë.

KREU II

ORGANIZIMI I VETËQEVERISIES LOKALE NË KOSOVË

Organizimi i pushtetit lokal (PL) në Kosovë ndërlidhet me konceptin e tretë të VQL apo të përfshirjes së komuniteteve dhe të ofrimit të shërbimeve cilësore. Organizimi një nivelesh i PL ka qenë edhe para vitit 1999, sipas sistemit socialist. Pas vitit 1999, si rezultat i vendosjes së Kosovës nën Protektorat Ndërkombëtar, vendosen bazat e organizimit demokratik të PL, në frymën e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Fillimisht ky proces u rregullua me Rregulloren e UNMIK Nr. 2000/45, pastaj me Rregulloren e UNMIK Nr. 2007/30 dhe aktualisht organizimi i Vetëqeverisjes Lokale rregullohet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave, Ligjin për Bashkëpunim Ndër – komunal dhe Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal. I gjithë procesi i riorganizimit të PL në Kosovë është quajtur, reformë e pushtetit lokal. Reforma e pushtetit lokal ka synuar që, nëpërmjet decentralizimit, t'i përfshijë qytetarët, bizneset dhe komunitetet në procesin e vendimmarrjes dhe krijimin e mekanizmave të brendshëm për zbatimin e politikave dhe vendimeve në shërbim të tyre. Për integrimin më të shpejtë të komuniteteve në sistemin e vetëqeverisjes lokale është ndërtuar një lloj organizimi asimetrik, ku komunitetit serb i lejohen kompetenca shtesë për dallim prej grupeve tjera etnike. Megjithatë organizimi i PL me qytetarin në qendër dhe në shërbim të qytetarit ka qenë qëllimi kryesor i reformës. Qeverisja e vendit është e organizuar në dy nivele: niveli i pushtetit qendror (NQ) dhe niveli i pushtetit lokal (PL). Qeverisja qendrore zhvillon dhe zbaton politikat shtetërore për zhvillimin dhe ruajtjen e vendit, ndërsa vetëqeverisja lokale zbaton politikat e nivelit qendror dhe ato vendore në shërbim të qytetarëve të saj. Organizimi i PL përfshinë: organizimin territorial të komunave, organizimin e PL në komunë dhe bashkëpunimin ndërkomunal, rajonal dhe ndërkufitar.

2.1. Organizimi territorial i komunave

Republika e Kosovës shtrihet në një sipërfaqe prej 10908 km², e cila është e ndarë në 38 njësi administrative apo në 38 komuna, të cilat shtrihen dhe veprojnë në kushte specifike territoriale. Komunitat, fillimisht janë të themeluara me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/43, në vitin 2000, derisa Kosova ishte nën administrimin e UNMIK. Sot, organizimi territorial dhe përcaktimi i kufijve administrativ të komunave është rregulluar me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave. Nga viti 2008 deri në vitin 2012, janë themeluar 7 komuna të reja dhe një komunë, ajo e Mitrovicës së Veriut, është në proces të themelimit.

Dy komunat e Mitrovicës, për dallim nga komunat tjera, do ta themelojnë një Bord të Përbashkët Funkcional, i përbërë prej 11 anëtarëve, 1 ndërkombëtar, që është edhe udhëheqës i bordit dhe nga 5 anëtar nga secila komunë. Organizimi territorial i komunave është i ndryshueshëm. Ligjet në fuqi krijojnë mundësinë e lëvizjes së kufijve ndërmjet komunave dhe shkëputjen apo bashkimin e pjesëve territoriale të tyre. Në këtë mënyrë, nga shkëputja e territorit të komunave ekzistuese dhe bashkimi i tyre, janë formuar komunat e reja në Republikën e Kosovës, si: Graçanica, Parteshi, Ranillugu, Klllokoti, Hani i Elezit, Mamusha dhe Juniku. Krijimi i komunave të reja është bërë në llogari të territorit të komunave: Prishtinë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë, Novobërdë, Gjilan, Viti, Kaçanik, Prizren, Suharekë, Rahovec, Suharekë, Deçan dhe Gjakovë.

Komunat e reja kanë marrë 265.4 km² territor të komunave ekzistuese apo 2% e territorit të Kosovës. Kriteret themelore për themelimin e komunave të reja apo riorganizimin e komunave ekzistuese janë: konsultimi i qytetarëve, qasja më e lehtë e qytetarëve në shërbime, qëndrueshmëria ekonomike, parimi i subsidiaritetit dhe ushtrimi i kompetencave. Kriteri i veçantë, është konsultimi i më së paku 75% të komunitetit jo shumicë, kur ky komunitet është i përqendruar në një popullsi prej së paku 5000 banorëve. E drejta për referendum, e përcaktuar me Nenin 5 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, nuk është sanksionuar si kriter në vendin tonë. Konsultimi nuk është formë e praktikueshme e vendimmarrjes për çështje madhore si ndryshimi i kufijve të komunave dhe formimi i komunave të reja. Po ashtu, parimi i efektshmërisë së entitetit të ri (komunës). Ndërkaq, parimi i qëndrueshmërisë ekonomike është përfillë pjesërisht, me rastin e themelimit të komunave të reja.

2.1.1.. Teritori i komunave

Madhësia e sipërfaqes së komunave sillet prej 633 km² (Podujevë), më e madhja e deri 23 km² (Klllokoti), më e vogla. Madhësia mesatare është 282.7 km². Komuna më e madhe përfshinë 6% të territorit të Kosovës, ndërsa komuna më e vogël përfshinë 0.23% të territorit. Kështu 57% e komunave kanë territor më të madh se mesatarja e vendit apo mbi 282.7 km², ndërsa 43% e komunave kanë territor më të vogël se mesatarja e vendit. Tetë komuna kanë më pak se 1% të territorit të Kosovës. Kjo do të thotë se në Kosovë dominojnë komunat e mëdha. Ekzistojnë 34 vendbanime (fshatra) që kanë më shumë se 3300 banor, prej tyre 8 vendbanime me mbi 5000 banorë. Në 13 komuna ka prej 1 – 3 vendbanime me mbi 3300 banor, ndërsa Ferizaj dhe Prizreni kanë 5 – 6 vendbanime me 3410 – 9398 banorë¹⁸. Në këto dy komuna ka filluar procesi i dekoncentrimit të urbanizimit.

Katër komuna kanë numër minimal të vendbanimeve: Komuna e Mamushes ka vetëm 1 vendbanim, Juniku ka 2 vendbanime, Parteshi ka 3 vendbanime dhe Klllokoti ka 4 vendbanime. Pasuria natyrore, sikur edhe numri i banorëve, nuk është e shpërndarë njësoj në tërë territorin e Kosovës, andaj disa komuna posedojnë potencial natyror ekonomik më të madh se disa të tjera.

2.1.2. Popullsia

Kriteri kryesor për themelimin e komunave është numri i banorëve. Duke u bazuar në numrin e banorëve, komunat mund grupohen në katër (4) grupe kryesore: grupi i parë, komunat me mbi 60.000 banor; grupi i dytë, komunat me mbi 30.000 banor; grupi i tretë, komunat me mbi 5000 banor dhe grupi i katërt komunat me më pak se 5000 banor.

2.2. Organizimi i komunave

Komuna, si njësi themelore apo bazike e qeverisjes lokale, përfaqëson një unitet administrativ-territorial dhe bashkësi banorësh. Ajo përbëhet prej dy organeve themelore: Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës. Mënyra e organizimit të këtyre dy organeve e mundëson funksionimin komplementar të njëra tjetrës dhe që të dy organet zgjedhen drejtpërdrejt nga vota e qytetarëve.

2.2.1.Zgjedhjet lokale

Sistemi zgjedhor udhëhiqet nga parimet demokratike, sipas të cilave qytetarë ka të drejt të zgjedhë dhe të jetë i zgjidhur, të votojë i lirë, në mënyrë të fshehtë dhe vota e tij të jetë e sigurt, e drejtpërdrejt dhe e barabartë. Subjektet politike dhe kandidatët e pavarur kanë mundësi të organizojnë fushatë parazgjedhore në një kohë optimale për të shpalosë programin e tyre. Sistemi zgjedhor është proporcional dhe i hapur çka do të thotë se anëtarët e kuvendit të komunës zgjidhen në bazë të listave të hapura, ku qytetari ka mundësi të votojë për kandidatin e tij/saj të preferuar. Që të shmanget çfarëdo parregullsie, listat duhet të jenë të certifikuara nga Komisioni qendror Zgjedhor (KQZ). Komuna përfaqëson një zonë të vetme zgjedhore. Numri i anëtarëve të kuvendit caktohet në bazë të numrit të banorëve nëpërmjet një formule standarde. Në kuvend duhet të sigurohet pjesëmarrja e gjinisë pakicë prej së paku 30% të anëtarëve të kuvendit. Sistemi zgjedhor iu mundëson të drejtën e ankesës të gjithë atyre që pretendojnë se iu është keqpërdorë vota e tyre. Kuvendi i komunës konstituohet pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga ana e KQZ.

2.2.2. Kuvendi i Komunës

Kuvendi i Komunës përbëhet nga anëtarët e tij, të zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët e komunës përkatëse, me mandat 4 vjeçar. Përfaqësimi i qytetarëve bëhet në bazë të një formule, që u siguron përfaqësim qytetarëve në vendimmarrje. Kuvendi udhëhiqet nga Kryesuesi i Kuvendit, për dallim nga rregulloret e UNMIK-ut, sipas të cilave është udhëhequr nga Kryetari i Komunës. Tani Kuvendi ka vetëm dy komitete të përhershme, ndërsa me Rregulloren 2007/30, kishte 7 komitete të përhershme. Komitetet tjera themelohen sipas nevojës dhe janë të përkohshme. Komitetet e ndihmonin Kuvendin në ngritjen e punës profesionale të tij dhe kanë funksione të njëjta në secilën komunë. Përvojat ndërkombëtare flasin për emërtime dhe numër të ndryshëm të tyre, por mesatarisht numri i tyre është pesë, ndërsa funksionet e tyre janë të ndryshme varësisht nga specifikat e komunave. Puna e kuvendit në përgjithësi është në funksion të asaj për çfarë është themeluar. Kuvendi është i ndërtuar nga përfaqësuesit e subjekteve politike ku vendos shumica.

2.2.3. Kryetari i Komunës

Sipas rregullore së mëparshme, Kuvendi Komunal ka zgjedhur një nga anëtarët e tij si kryetar të komunës në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë. Përgjegjësitë e Kryetarit të Kuvendit Komunal në atë kohë ishin të lidhura me mbikëqyrjen e përgjithshme të zbatimit të vendimeve që janë marrë nga Kuvendi Komunal dhe administrimin financiar të komunave. Kryetari ishte edhe kryetar i Komitetit për Politikë dhe Financa dhe kishte përgjegjësi të tjera që i janë dhënë atij/asaj sipas statutit. Kryetari i Komunës është mbështetur nga nënkryetarët, Kryeshafi Ekzekutiv dhe Bordi i Drejtorëve. * Me pak fjalë, në bazë të rregullore së mëparshme, kryetari i komunës nuk ka qenë në gjendje të dominojë ose ti shmanget kuvendit komunal. Por në katër vitet e fundit, vetëqeverisja lokale në Kosovë ka përjetuar disa ndryshime radikale. "Transformimi rrënjësor ka ndodhur në tri nivele, kompetencat (përgjegjësitë), riorganizimi dhe implementimi. Kryetari i komunës është autoriteti kryesor ekzekutiv në komunë. Kalimi i zgjedhjes së Kryetarit prej përfaqësuesve të qytetarëve në kuvend, në zgjedhje të drejtpërdrejt nga qytetarët e komunës përkatëse, ka shtuar kompetencat dhe përgjegjësitë e tij/saj në përfaqësimin dhe qeverisjen e komunës. Kryetari merr të gjitha kompetencat ekzekutive në komunë, emëron nënkryetarët e tij dhe drejtorët e drejtorive të administratës komunale. Kryetari krijon politika, organizon dhe udhëheq punën e komunës, menaxhon buxhetin dhe mbikëqyrë punën e komunës, por nuk ka mekanizma të qartë të llogaridhënies. Në aspektin organizativ, kryetari i komunës si organ ka strukturë të përzier organizative, të emëruarve politik dhe të shërbyesve civil.

Për ushtrimin e të gjitha këtyre kompetencave, kryetari themelon zyra të ndryshme për punë administrative. Me përshkrimin e kompetencave të zgjeruara dhe me mënyrën e zgjedhjes së kryetarit, më shumë shkohet drejt një organi autonom se sa të një organi vetëqeverisës lokal. Rrjedhimisht kryetari merr edhe rolin e mbikëqyrjes së zbatimit të vendimeve të kuvendit të komunës duke qenë përgjegjësi kryesor për punën e komunës dhe zbatimin e akteve të kuvendit. Në aspektin organizativ kryetari nuk ka konflikte funksionale me kuvendin e komunës.

2.2.4. Administrata komunale

Administrata e komunës është e ndërtuar dhe e organizuar në drejtori, të cilat udhëhiqen nga drejtorët e emëruar nga kryetari i komunës²⁰. Në secilën drejtori punojnë shërbyesit civil, të cilët zgjedhen në bazë të konkursit. Administrata e komunës përbëhet prej komponentës politike, drejtorëve, dhe nga komponenta civile. Udhëheqësi i personelit, nuk e ka të qartë pozitën e tij/saj. Drejtorët e drejtorateve më parë kanë qenë shërbyes civil dhe e tërë administrata ka qenë e udhëhequr nga Kryeshefi Ekzekutiv, po ashtu shërbyes civil, mirëpo i zgjedhur nga kuvendi komunal. Edhe pse komunat kanë të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi, ato kanë numër të ndryshëm të drejtorive. Numri i përgjithshëm i drejtorive komunale në nivel vendi është 318, ndërsa mesatarja është 9. Numrin më të madh të drejtorive e ka Mitrovica dhe Peja (14), ndërsa numrin më të vogël të drejtorive e ka Klllokoti (5) dhe Mamusha (6). Emërtimi i drejtorive është i ndryshëm nga komuna në komunë. Drejtorit të cilat në shumicën e komunave kanë organizim dhe emërtim të njëjtë janë: Drejtorati për shëndetësi dhe mirëqenie sociale (në 31 komuna), Drejtorati për arsim dhe Drejtorati për rini kulturë dhe sport (në 25 komuna), Drejtorati për inspektion dhe Drejtorati i administratës (në 20 komuna), ndërsa drejtoratet tjera kanë emërtime të ndryshme në shumicën e komunave. Emërtimi i ndryshëm i drejtorateve shpesh herë shkakton probleme në komunikim, mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen në formë standarde të të dhënave.

KREU III

MBIKQYRJA DHE KONTROLLI I QEVERISIES LOKALE

Mekanizmi i kontrollit të organeve të administratës shtetërore është pjesë e kompetencave e cila realizohet në bazë të autorizimeve ligjore. Në kuptimin përmbajtjesor, me kontroll kuptohet veprimtaria e vazhdueshme e mbikëqyrjes që subjektet juridikisht të autorizuar e bëjnë lidhur me sjelljen e organeve të administratës, mënyrën e ushtrimit të autorizimeve, mënyrën e nxjerrjes së akteve dhe shkallën e zbatimit të legjislacionit, si dhe masave të cilat i ndërmarrin në raport me ushtrimin e përgjegjësi.

Ndërkaq, qëllimi i kontrollit është “të pamundësohet nxjerrja, përkatësisht aplikimi i atij akti të përgjithshëm normativ nënligjor që do t’i kundërvihej kushtetutës apo ligjit. Për këtë shkak edhe me sanksionet, që sistemet e veçanta juridike i parashohin, tentohet që nga rendi juridik të shmangen ato akte të përgjithshme normative nënligjore dispozitat e të cilave nuk janë në pajtim me parimet e shprehura në kushtetutë, përkatësisht me ligjet”. Edhe pse termi kontroll dhe mbikëqyrje, mund të kuptohen si të njëjta, ato kanë kuptime dhe veprime të ndryshme. Sistemi i jonë i kontrollit më tepër është i orientuar në mbikëqyrje se sa në kontroll. Në Republikën e Kosovës, sistemi i mbikëqyrjes së organeve të pushtetit lokal është rregulluar me Kushtetutë, me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe me ligje të tjera sektoriale. Ky sistem është kufizuar më tepër në mundësinë e ndërhyrjes këshilluese dhe rekomanduese me rastin e ushtrimit të kompetencave nga organet e njësisë të vetëqeverisjes lokale dhe është ndërtuar si pjesë e marrëdhënieve në mes të nivelit qendror dhe atij lokal. Komunitetet gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale, inkurajojnë dhe sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

3.1. Llojet e mbikëqyrjes dhe kontrollit

Pavarësisht autonomisë së komunave në kryerjen e veprimtarive të tyre, legjislacioni ka përcaktuar një shkallë të varësisë në marrëdhënie me organet qendrore. Në këtë segment, parashikimi me ligj i funksionit me natyrë mbikëqyrëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministrive të tjera të linjës ndaj komunave, është me rëndësi të veçantë në parandalimin e shkeljes së ligjit nga ana e komunave. Kjo përkon me mbikëqyrjen e respektimit të ligjshmërisë, të parashikuar me ligj dhe të vendosur vetëm për arsye të rëndësishme publike.

Kuptimi i mbikëqyrjes dhe kontrollit të komunave në Kosovë përcaktohet në dy rrafshë:

- Kontrolli i brendshëm; dhe
- Kontrolli i jashtëm.

Në kuadër të mbikëqyrjes, duhet përmendur edhe mbikëqyrjen shoqërore, e cila realizohet përmes formave të ndryshme të demokracisë së drejtpërdrejtë.

3.2. Kontrolli i brendshëm

Mbikëqyrja dhe kontrolli i brendshëm në komunë nënkupton të drejtën e organeve të komunës të autorizuar ligjërisht, për sigurimin e respektimit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë nga organet e nivelit më të ulët përbrenda komunës. Duke marrë parasysh ndarjen strukturore Kuvend/Ekzekutiv përbrenda komunës, ekzistojnë edhe përgjegjësitë për kontrollimin e punës

së këtyre organeve, duke marrë parasysh natyrën e fushëveprimit të tyre. Korniza ligjore ka përcaktuar mundësitë e kontrollit të organeve komunale në dy mënyra:

- kontrolli që kryen Kuvendi i Komunës ndaj ekzekutivit në tërësi dhe
- kontrolli që bënë kryetari i komunës në raport me drejtoritë komunale;

PËRFUNDIMI

Katër vjet pas vendosjes së sistemit të ri të qeverisjes lokale në Kosovë, një progres i dukshëm është arritur në fushën e qeverisjes lokale sidomos në avancimin e kornizës ligjore si dhe të konsolidimit të demokracisë së drejtpërdrejtë.

Megjithatë, për shkak të apatisë qytetare dhe mungesës së angazhimit qytetarë, deficieti demokratik është i dukshëm në nivel komunal; Edhe pse kuvendet komunale janë të përbëra nga këshilltarë komunal të zgjedhur me lista të hapura të sistemit zgjedhor, roli i tyre në çështjet komunale mbetet i dobët si në aspektin e kontrollit poashtu edhe të monitorimit. Aktualisht, kryetarët emërojnë drejtorët e departamenteve, pa kritere të rrepta dhe të vendosura në mënyrë të qartë, dhe shpesh ndodh të ketë mungesë të profesionalizmit dhe ekspertizës;

Me Kryetarin e Komunës i cili ka kompetenca të tilla të koncentruara ekzekutive, qytetarët ndihen mjaft të pafuqishëm për të ndikuar në politikë-bërjen e komunës, vendim-marrjen dhe planifikimin buxhetor; Organizatat e shoqërisë civile e kanë të vështirë të funksionojnë dhe të ndikojnë në zhvillimet pa iu qasur fondeve të institucioneve komunale. Kjo varësi do të thotë se shoqëria civile është më pak e prirur që vazhdimisht të paraqes, mbroj dhe promovoj interesat publike dhe të sfidoj zhvillimet negative në nivel komunal.

Komunat me kapacitetet ekzistuese janë në gjendje të vështirë dhe e kanë të pamundur për të përballuar me kërkesat që po vijnë nga agjenda dinamike për integrim në BE.

REKOMANDIME:

1. Kryetarët e komunave duhet të krijojnë një platformë të qartë komunikimi me publikun e gjerë dhe qytetarët, në mënyrë që të sigurohet që politikë-bërja në nivel komunal të jetë e përgjegjshme, gjithëpërfshirëse dhe transparente.
2. Zyrat e informimit publik duhet të përmirësohen, dhe duhet të kenë aktivitete të shpeshta që të sigurojnë qasjes më të madhe të publikut. Këto zyra duhet të kenë staf të mjaftueshëm dhe të pajisen me resurse dhe teknologji të adekuate.
3. Përveç komiteteve të obligueshme komunale, kryetari i komunës duhet të inkurajojë krijimin dhe funksionimin e komisioneve sektoriale të kuvendit në mënyrë që të rritet veprimi ndërmjet organeve komunale legjislative dhe ekzekutive.
4. MAPL në bashkëpunim e Asociacionin e Komunave duhet të nisin iniciativën për të rritur të ardhurat e këshilltarëve komunal. Komuna duhet të sigurojë hapësira të përshtatshme pune dhe mbështetje teknike për ta; 5. Drejtorët e departamenteve duhet të zgjidhen nëpërmjet një procesi të hapur dhe konkurrues (profesional dhe akademik) të bazuar në kritere të qarta;
6. Duhet të jetë një linjë të veçantë buxhetore për organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të rritet pjesëmarrja e tyre aktive. Financimi i tyre duhet të jetë subjekt i një vendimi të paanshme jo vetëm nga zyrtarëve të komunave, por gjithashtu duhet të përfshijë njerëz nga publiku i gjerë;
7. Institucionet qendrore, në veçanti MAPL dhe Ministria e Integritimit Evropian duhet të rrisë kapacitetet e komunave, duke siguruar këshillim, udhëzim dhe monitorimin për zyrtarët komunalë. Komunat duhet të forcojnë zyrat për integrim në mënyrë që të përmbushen obligimet për integrim në BE.

LITERATURA E PUNIMIT:

- Kryeziu, Kadi. Administrimi Lokal (cikël leksionesh); Prizrenë, 2015;
- Kryeziu. Kadri. ABC-ja e së Drejtës dhe Shtetit; Prizren, 2016;
- Stavileci. Esat.// Sokoli. Agur.// Batalli. Mirlinda.// E Drejta Administrative. Prishtin 2010;
- Sokoli. Agur. E Drejta Administrative. Prishtinë 2014;
- Siljanovska-Davkova : "Komuna në mes normës dhe realitetit", Disertacion i mbrojtur në Fakultetin juridik të Ljubljanes, 1993;
- Council of Europe Publishing: "European Charter of Local Self – Government", March 2010, pg. 9;
- Tahiri Besnik, Publikimi i Raportit: Blerësi misterioz në komunë. Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale, Mars, 2012;

Ligjet dhe rregulloret e aplikueshme:

- Kushtetutën E Republikës së Kosovës; Kosovë- Prishtinë, 15 Qershorë 2008;
- Ligji Nr.003/L-189,/ për administratën shtetore të Republikës së Kosovës;
- Ligji Nr. 03/L-040; Ligji për vetqeverisje Lokale i RKS-së, Prishtinë 2008;
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë. 11 Gushtë 2000;
- Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2006/55 Për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/11 Mbi Zgjedhjet Lokale në Kosovë;
- Republika e Kosovës, MAPL: "Raport i funksionimit të komunave, janar-dhjetor 2012", Prishtinë 2013;
- ASK: "Popullsia sipas Gjinisë, Etnicitetit dhe Vendbanimit", Prishtinë, 2011;
- Rregullorja e UNMIK-ut 2007/27 Mbi Zgjedhjet Lokale në Kosovë dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30 Për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2000/45 Për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës.

Web faqet në internet:

- http://aa.mk/WBStorage/Files/poglavje09_AL.pdf;
- <http://shtetiweb.org/2012/09/25/ceshte-funksioni-administrativ/>;
- <https://juristat.files.wordpress.com/2012/02/e-drejta-administrative.pdf>;
- <https://www.ilo.org/dyn/natlex/docs/.../94365/.../ALB-94365.pdf>;
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2706>;
- <http://kfos.org/wp.../Mbi-10-vjet-Parlamentarizem-ne-Kosove-ALB.pdf>;
- <http://mls.gov.mk/images/laws/Ligji%20i%20veteqeverisjes%20lokale.pdf>;

DIFERENCAT E ZHVILLIMIT SEKTORIAL DHE RAJONAL NË MAQEDONIN E

VERIUT

DIFFERENCES OF SECTORIAL AND REGIONAL DEVELOPMENT IN THE NORTHERN MACEDONIA

Prof. Dr. Petrit Pollozhani

Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës

petrit.pollozhani@unite.edu.mk

Abstract

A country's economic structure determines long-term development trends. Propulsive sectors initiate dynamic developments in other sectors as well. Identifying and promoting sectors that will be carriers of economic development today is a challenge for any less developed country. One such country with 2 million inhabitants is Northern Macedonia. Inherited depressive structure as well as economic policies with unclear priorities in terms of economic areas, in transition did not ensure sustainable development.

The economic structure in Northern Macedonia presented through the level of employment is determined by investments in fixed assets, which confirms the high value of the correlation coefficient ($R = 0.92724$). The determinability coefficient $R^2 = 0.859775$ shows that in the analyzed period (2010/18) employment in the economy of Northern Macedonia depended 86% on investments and only 14% on other factors.

Keywords: Economic structure, GDP, investments in fixed assets, correlation and determination coefficient, innovative activities

Abstrakt

Struktura ekonomike e një vendi determinon trendet afatgjata zhvillimore. Sektorët propulzivë inicojnë zhvillime dinamike edhe në sektorët tjerë. Identifikimi dhe nxitja e sektorëve të cilët do të jenë bartës të zhvillimit ekonomik sot janë sfida për çdo shtet jo mjaft të zhvilluar. Një shtet i tillë me 2 milion banorë është edhe Maqedonia e Veriut. Struktura e trashëguar depresive si dhe politikat ekonomike me prioritete jo të qarta për sa u përket lëmive ekonomike, në tranzicion nuk siguruan zhvillim të qëndrueshëm.

Struktura ekonomike në Maqedonin e Veriut prezantuar nëpërmjet nivelit të punësimit është përcaktuar nga investimet në mjetet themelore, që vërteton vlera e lartë e koeficientit të korelacionit ($R = 0.92724$). Koeficienti i përcaktueshmërisë $R^2 = 0.859775$ tregon se në periudhën e analizuar (2010/18) punësimi në ekonomin e Maqedonis së Veriut është varur 86 % nga investimet dhe vetëm 14 % nga faktorët tjerë.

Fjalët kyçe: *Struktura ekonomike, PBB, investimet në mjetet themelore, koeficienti i korelacionit dhe determinacionit, veprimtari inovative*

Hyrje

Punimi ka për objektiv prezantimin e strukturës së formuar në ekonomin kombëtare dhe nëpër rajoneve të Maqedonis së Veriut. Struktura e formuar prezantohet nëpërmjet të kontributi të lëmive ekonomike në formimin e PBB, në nivel kombëtar dhe ate rajonal. Gjithashtu prezantohen dhe investimet në mjetet themelore të cilat janë determinues të asaj strukture ekonomike. Objektivi tjetër i punimit është prezantimi i diferencave të thella ndis rajoneve dhe vendbanimeve në kuadër të vet rajonit. Vendbanimet e banuara nga shqiptarët janë më të pa zhvilluara, prandaj kërkohet politik më aktive për një ekuilibrim rajonal.

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) nëpër sektorët ekonomik dhe rajone e Maqedonis së Veriut

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) paraqet indikatorin më të rëndësishm ekonomik (Pollozhani P. (2011), fq. 199). Ai tregon potencialin prodhues të një ekonomie kombëtare ose rajoni. Kontributi i lëmive në formimin e PBB prezanton strukturën ekonomike. Në Maqedoninë e Veriut hasim diferenca të thella sa i përket kontributit të formimit të PBB si në lëmit ekonomike ashtu dhe rajone, që mund të vërehet edhe nga prezantimi i të dhënave të mëposhtme.

Tabela 1. PBB nëpër sektorë dhe rajonet e Maqedonisë së Veriut për vitin 2016, (në 000.000 €)

	Bujqësia , pylltaria dhe peshkataria	Xehetaria, Energjetikadhe Indust. Përpunon.	Treg. me shumicë, dhe pakicë Transport	Ndërtim-taria	Veprimt. me pron. të patund Renta	Vepr.shëndetsore dhe sigur.social.arsim i	Veprim – tarit tjera	PBB
Maqedonia e Veriut	889.3	1,653.2	1,842.7	670.0	972.0	1,200.9	1,176.1	8,404.2
Rajoni i Vardarit	130.8	148.4	171.4	31.7	59.0	73.5	37.6	652.4
Rajoni lindor	72.9	207.1	119.6	49.1	90.2	87.7	37.1	663.7
Rajoni jug – perënd.	42.0	108.7	185.2	58.0	123.6	112.8	59.3	689.6

Rajoni jug-lindor	249.6	150.3	156.5	61.2	67.7	72.7	80.3	838.3
Rajoni i Pellagonis	195.7	223.3	152.9	47.9	117.0	116.0	60.2	919.2
Rajoni i Pollogut	83.7	62.6	125.6	33.8	132.8	129.0	32.8	600.3
Rajoni veri-lindor	38.1	62.2	114.8	36.7	67.0	74.2	26.0	419.0
Rajoni i Shkupit	76.6	669.6	816.6	351.4	308.6	534.8	863.7	3,621.4

Burimi: Drzaven Zavod za Statistika na Republika Severna Makedonija ,(2019) Vjetari Regional, Regionet në Maqedoninë Veriut, Shkup, fq. 34

Siç vërehet, tregtia me shumicë, ajo me pakicë dhe transporti, sektori i xehetarisë, industrisë përpunuese dhe energjetikës janë kontribuesit më të fuqishëm në formimin e PBB-së (1,842.7 respektivisht 1,653.2 miliar €) në ekonominë e Maqedonisë së Veriut. Ato në formimin e PBB-së marrin pjesë me rreth 42 %. Të dy sektorët nuk mund të jenë bartës së zhvillimit ekonomik, sepse rritja e tyre nuk intensifikon zhvillimin e lëmive tjera. Një pjesëmarrje kaq e lartë e këtyre lëmive në formimin e PBB -së tregojnë për prezencën e një strukture depressive ekonomike në Maqedoninë e Veriut. Industria e fazave të larta të përpunimit e cila mund të jetë bartëse e zhvillimit në Maqedoninë e Veriut shënon ngecje serioze teknologjike. Sektori I ndërtimtarisë është lëmia e cila më së paku merr pjesë në formimin e PBB me vetëm 670 milion €, ose një pjesëmarrje relative prej vetëm rreth 8 %

Mbas sektorit të ndërtimtarisë lëmia e cila më pak merr pjesë në formimin e PBB është bujqësia. Ajo në vitin 2016 në formimin e PBB kontribon me 10.5% ose shprehur me numra absolut dhe kap vlerën e vetëm 670 milion €. Aktualisht në lëmin e bujqësisë gati gjysma e vlerës i takon prodhimtarisë primare dhe gjysma tjetër asaj përpunuese. Vlerësoj se në bujqësi duhen lehtësime financiare për kompanitë e përpunimit, për të aplikuar teknologji më të avancuara.

Kontributi i rajoneve në formimin e PBB është treguesi më relevant për të shprehur diferencat e zhvillimit ekonomik. Vështruar nga ky aspekt në Maqedoninë e Veriut vërehen dallime të thella. Rajonet me PBB më të ulët janë ai veri – lindor (419 milion €) dhe ai i Pollogut (600.3 milion €), të cilët në PBB e ekonomis nacionale marrin pjesë me vetëm 5 % respektivisht 7 %. PBB më të lartë në vitin 2016 ka patur rajoni i Shkupit (6,621.4 milion €) i cili përfshin 43 % të PBB të ekonomis kombëtare. Pellagonia është rajoni i dytë me PBB më të lartë (912.3

milion€) ose me një pjesmarrje relative prej 11 %. Rajoni I Vardarit, ai lindor dhe jug-perendimor në vitin 2016 kanë patur PBB prej mbi 650 milion €, ndërsa ai jug-perendimor ka patur PBB e vlerë 838.8 milion

Sa i përket kontributit të lëmive ekonomike në formimin e PBB-së nëpër rajone ato kryesisht përcjellin proporcionet e ekonomisë nacionale. Struktura e tillë rezulton me nivel të caktuar të zhvillimit ekonomik. Siç e pam më sipër rajoni veri – lindor dhe ai i Pollogut ishin viset më të pa zhvilluar në Maqedonin e Veriut. Krahasuar me mesataren e vendit struktura ekonomike në këto dy rajone është më depresionuese, sepse në formimin e PBB dominon lëmia e xehetarisë, energjetikës dhe industrisë përpunuese si lëmi më propulzive në formimin e PBB marrin pjesë me shumë simbolike prej 62.2 respektivisht 62.5 milion € ndërsa sektori i tregtisë me shumicë, pakicë dhe transporti si lëmi depresionuese merin pjesë dyfish më shumë (114.8. respektivisht 125.8 milion €). Duhet theksuar se në sektorin, veprimtarit tjera në të cilat bën pjesë arti, rekreacioni, sporti viset e banuara me popullsi shqiptare në formimin e PBB marrin pjes me zero €.

Kur PBB e shpërndajmë për frym banori fitojmë prezantuesin më besnik për të vërejt nivelin e mirëqenies të popullsisë. Të mirat tregojnë nivelin e satandarit të jetesës. (John Sloman ((2006) fq 376) Në Maqedonin e Veriut PBB për frym (standard më të ulët) ka popullsia e Rajonit të Pollogut, që mund të vërehet nga të dhënat e tabelës së mëposhtme.

Tabela 2 PBB për frymë banori nëpër rajonet e Maqedonisë së Veriut për vitet 2005 dhe 2016 (në €)

	Maqedonia e Veriut	Rajoni i Vardarit	Rajoni Lindor	Rajoni jug-per.	Rajoni jug-lind.	Rajoni Pellagon	Rajoni Pollogut	Rajoni i verilind	Rajoni I Shkupit
2005	2284	2247	2618	1531	2156	2393	1105	1137	3766
Në %	100,0	98.4	114.7	67.0	94.4	104.8	48.4	49.8	164.9
2016	4677	4927	4336	3620	5572	4602	2160	2743	6709
Në %	100.0	105.4	92.8	77.4	119.1	98.4	46.2	58.7	143.4

Burimi: Enti i Statistikave na Republikën e Maqedonis së Veriut (2009), Vjetari Regjional, Regjionet e Maqedonis së Veriut, fq 77-93, dhe po aty (2019, fq. 48

Rajoni i Pollogut edhe pse me numra absolut gati ka dyfishin e PBB-së për frymë banori nga 1,105 € sa ishte në 2005 në 2,150 €, më 2016 pjesëmarrja e tij relative ndaj mesatares shtetërore shënon një rënie të lehtë prej 2.2 %. Në Rajonin jug- perëndimor në të cilin pjesëmarrja e popullsisë shqiptare është shumicë, PBB për frymë banori edhe pse u rrit për rreth 2.6 herë nga 2156 € (2005), në 5572 € (2016) dhe pjesëmarrja relative ndaj mesatares së vendit shënon rritje nga 67.0% (2005) në 77.4% (2016) ai akoma ngel ndër mesataren e ekonomisë nacionale. Popullsia në rajonin e Shkupit ka mirqenie më të mirë ekonomike se sa mesatarja e vendit dhe rajonet tjera. Ajo mund të vërehet nga PBB për frym banori. Në vitin 2005 çdo banori të këtij rajoni i ka takuar PBB me vlerë pre 3766 € ose 64.9 % mbi mesataren e vendit (koeficient 164.9) dhe në vitin 2016, gati dyfish më shumë (6709 €) ose 43.4 % mbi mesataren e vendit (koeficient (143.4)

Pas rajonit të Pollogut nivel më të ulët të PBB për frym ka patur Rajoni veri-lindor (1137 €). Rajoni i Pellagonisë dhe ai Lindor në vitin 2005 kan pat PBB për frym banori mbi mesataren e vendit dhe në vitin 2016 kan pat PBB për frym përfaqësues sa mesatarja e vendit. Rajoni i Vardarit dhe ai jug-lindor në vitin 2005 kanë pat PBB për frym gati sa mesatarja e vendit ndërsa më 2016 të dy rajonet kan patur PBB më të lart nga mesatarja e vendit.

Zhvillimi ajonal konsiderohet segment shumë i rëndësishëm. (Abdylmenaf B. (2000), fq.502) Për zbutjen e diferencave rajonale në Maqedonin e Veriut duhen mjete finansiare dhe vullnet politik, të cilat kanë munguar dhe para dhe mbas pavarimit. Maqedonia e Veriut është shtet shumë i centralizuar që pengon zhvillimin rajonal. Nga buxheti është planifikuar që për zhvillimin e barabart rajonal të ndahen mjete finansiare prej 1 % të vlersë të PBB, që asnjëherë as përfaqësues nuk është realizuar. Zakonisht janë ndarë shuma simbolike 10 fish më pak, të cilat simbolkisht janë realizuar. Nga buxheti i vitit 2020 për zhvillim të barabartë rajonal janë ndarë rreth 18 milion €, të cilat nuk mjaftojnë për zgjidhjen e problemeve të shumta, por nga përvojat e deritanishme vështir se ato do realizohen në tërësi.

Investimet në mjetet themelore nëpër sektor dhe rajonet e Maqedonisë së Veriut

Investimet tregojnë rritjen e fondeve reale të të mirave kapitale, d.m.th. Paisjeve, objekteve ndërtimore etj. (Musa L. (2002), fq. 240). Ato janë forca motorike e zhvillimit të një shteti ose rajoni, që rezultojnë me përmirësimin e kushteve jetësore (si në shëndetësi, arsim, sport, infrastrukturë, biznes, kulturë etj). Niveli i investimeve përcakton strukturën ekonomike dhe shpërndarja e tyre nëpër rajone prezanton barazinë (pabarazinë) midis etniteteve. Nga të dhënat e tabelës së mëposhtme mund të vërejmë se shpërndarja e investimeve nëpër sektorë ka rezultuar me struktur arkaike dhe diferenca të theksuara midis rajoneve.

Tabela 3. Investimet në mjetet themelore për frymë banori nëpër sektorë dhe rajonet e Maqedonisë së Veriut për vitin 2016, (në €)

	Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria	Xehetaria, energjetika industria përpunuese	Tregtia me shumicë dhe pakicë transporti	Nërtimtaria	Veprimtari shëndetësore dhe sigurimi social, arsimit	Veprimtari tjera	Gjithsej
Maqedonia e Veriut	28	242	180	423	133	156	1.162
Rajoni i Vardarit	41	382	153	521	23	8	1.128
Rajoni lindor	25	239	184	590	58	6	1.102
Rajoni jug – perënd.	6	106	91	811	47	11	1.072
Rajoni jug – lindor	86	299	119	299	46	138	987
Rajoni i Pellagonisë	92	389	69	252	38	98	938
Rajoni i Pollogut	11	34	66	164	62	5	342
Rajoni verilindor							

	9	37	42	99	12	30	229
Rajoni i Shkupit	4	336	359	509	329	414	1951

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave i Republikës së Maqedonis së Veriut, (2019) Vjetari Regjional, Regjionet e Maqedonis së Veriut, Shkup, fq. 77-93, (përpunim i të dhënave nga autori)

Siç mund të vërejmë në Maqedoninë e Veriut në vitin 2016 më shumë investime për frymë banori ka absorbuar sektori i ndërtimitarisë (423 €) dhe më pak ai i bujqësisë (28 €). Edhe pse Maqedonia e Veriut ndan shuma të konsiderueshme të subvencioneve buqësi dhe në pjesën më të madhe të territorit ka klimë të përshtatshme për prodhime bujqësore ajo nuk ka arrit ta zhvilloj këtë sektorë. Investimet në sistemin e ujitjes, rregullimi i rrjedhave të lumenjve, si dhe avancimet teknologjike në përpunimin e pemëve dhe perimeve, vlerësoj se duhet të fitojnë në peshë në strategjinë zhvillimore të vendit.

Sektori i dytë me më shumë investime në mjetet themelore (242 € për frymë banori) është ai i xehetarisë, energjetikës dhe industrisë përpunues. Në kuadër të kësaj lëmie industria përpunuese merr pjesë me afër 40 % por ajo i takon kryesisht industrisë së lehtë (përpunimi i letrës, këpucëve, pemëve, perimeve, prodhimeve buqësore, prodhimeve tekstile) e cila nuk mund të jetë bartëse e zhvillimit ekonomik aq më tepër kur ka ngecje serioze teknologjike.

Niveli i investimeve sektoriale nëpër rajonet e Maqedonisë së Veriut kryesisht përcjellin strukturën e ekonomisë kombëtare dhe shprehin shkallë të lartë pabarazie. Në vitin 2016 më pak investime për frymë banori ka pat rajoni i Pollogut (342 €), që është mbi 3 herë më i vogël nga mesatarja e vendit (1.162 €) apo afër 6 herë më pak se Rajoni i Shkupit (1.951€). Nga investimet e përgjithshme, në Rajonin e Pollogut ndërtimtaria përfshin afër gjysmën e investimeve (164 €) mandej vjen tregtia e cila përfshin 20 % të investimeve (69 € për frymë banori). Shpërndarja e tillë e investimeve nëpër lëmi shpreh strukturën ekonomike të këtij rajoni e cila është akoma më depresionuese nga ajo e rrafshit kombëtar.

Me më pak investime nga Rajoni i Pollogut ishte vetëm ai veri-lindor me 229 € për frymë banori. Strukturë depresionuese ekonomike ka dhe Rajoni jug-perëndimor në të cilin ndërtimtaria përfshin 80 % të investimeve. Investimet për frymë banori (1072 €) në këtë rajon në vitin 2016 ishin përafërsisht sa mesatarja e vendit (1.162 €). Në Maqedoninë e Veriut jo vetëm që ka diferenca të thella midis rajoneve por ato janë akoma më të theksuara midis qyteteve apo venbanimeve Brenda vet rajonit. Në rajonin jug - perëndimor vendbanimet shqiptare siç janë Struga dhe Dibra kanë pat investime shumë më të vogla krahasuar me Ohrin dhe për pasojë kanë rrjet infrastrukturor shumë më të dobët. Spitalet janë në gjendje të mjerueshme, shkollat në gjendje katastrofale, infrastruktura rrugore shumë problematike, në shumë vendbanime rurale mungon uji i pijshëm, pa kanalizime, si dhe shumë probleme tjera.

Në vitin 2016 më shumë është investuar në Rajonin e Shkupit. Në këtë rajon investimet për frym banori ishin për 1.7 herë (1.951€) më të larta nga mesatarja e vendit (1.162 €). Rreth 40 % i ka absorbu ndërtimtaria ((509 €) dhe më pak në bujqësia (4 € për frymë banori). Veprimtarit tjera (informata, komunikimi, arti, rekreacioni) janë sektori i dytë ku është investuar më shumë (414 € për frymë banori). Në rajonin e Pologut dhe at jug-perendimor dhe në gjitha vendbanimet shqiptare investimet për art, rekreacion dhe shërbime të tjera janë zero. Struktura ekonomike në Rajonin e Shkupit është më drejtpeshuese krahasuar me mesataren e vendit dhe atë të rajoneve tjera, sepse aty janë koncentruar prodhimet industrial të fazave më të lart të punimit dhe avancimet më të larta teknologjike. Një struktur e tillë ekonomike regjeneron aftësi më të qëndrueshme zhvillimore. Si në çdo venbanim tjetër ku jetojnë shqiptarët edhe në rajonin e Shkupit ato janë me më pak investime dhe për pasoj kanë kushte më të vështira për jetesë. Nëse vizitoni vendbanimet shqiptare si: Çairin, Haraçinën, Studeniçanni etj. mendoni se ndodheni në ndonjë vend të Afrikës, përkundrazi kur kaloni Vardarin në vendbanimet maqedonase mendoni se ndodheni në ndonjë vend të Europës perendimor. Viset dezinvestuese si ato shqiptare janë të pa zhvilluara dhe me varfëri të theksuar dhe për pasojë janë qendra të fuqishme migruese, Zvoglimi i vazhduar i nxënësve të shkollave fillore dhe atyre të mesme janë argument për emigrime masive të popullsisë shqiptare. Sipas Bankës Botërore 1/3 e popullsisë në Maqedonin e Veriut kanë emigruar, ku pjesa më madhe e tyre janë shqiptarë.

Punësimi dhe papunësia nëpër rajonet e Maqedonis së Veriut

Rajonet me investime të ulta nuk kanë mundësi të hapin vende të reja pune dhe për pasoj ato kanë norma të larta të papunësisë. Dy rajonet me popullsi shumicë shqiptare si ai i Pollogut dhe ai jug – perendimor së bashku me ate veri – lindor në vitin 2018 është punësuar mbi çdo i treti, ndërsa në nivel kombëtar është punësuar afër gjysma e popullsisë së moshës së punës (45.1 %). Norma më të clarta punësimi shënon rajoni jug-lindor (60.2 %).

Tabela 4 - Normat e aktivitetit të pullsisë të moshës 15 – 64 vjet, nëpër rajonet e Maqedonis së Veriut për vitin 2018

	Maqed. e Veriu	Rajoni i Vardar rit	Rajoni Lindor	Rajoni jug- per.	Rajoni jug- lind.	Rajoni Pellago n.	Rajoni Pollog ut	Rajon i veri- lin	Rajoni i Shkup it
For.pu nt.	1.608.7 02	123.2 19	146.1 64	182.4 41	140.9 25	185.77 8	264.75 2	1426 75	496.6 75
% e aktiv	56.9	60.0	60.4	55.9	67.5	64.9	50.5	50.5	52.5
Nor.pu n.	45.1	50.4	54.4	39.4	60.2	55.5	35.8	35.8	43.7
N. papun	20.7	15.9	11.5	29.5	10.9	15.3	29.0	29.0	19.3

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2009, 2012, 2016, 2019, Vjetari Regjional, Regjionet e Maqedonisë së Veriut, fq. 77-93, dhe po aty (2019, fq. 36

Ndërsa sa u përket normave të papunësisë në Maqedonin e Veriut vërehen oshilime të mëdha midis rajoneve. Në nivel kombëtar në vitin 2018 i papunë në moshën e punës ishte çdo i pesti (20.7 %) ndërsa në dy rajonet me popullsi shumicë shqiptare ai i Pollogut dhe ai jug – perendimor së bashku me ate veri – lindor të pa punë në moshën e punës ishte gati çdo i treti (29.0 respektivisht 29.5%). Norma më të ulëta ë papunësisë ka patur rajoni jug-lindor në të cilin i papunë në moshën e punës është çdo i dhjeti (10.9%).

Lidhja korelative midis investimeve të mjeteve themelore dhe punësimit në Maqedonin e Veriut

Të dhënat prezantojnë dinamikën e punësimit dhe të investimeve në mjetet themelore në ekonomin e Maqedonis së Veriut. Ato na shërbejnë për të identifikuar lidhjen egzistuese midis variablave të cekura më sipër (2010/18). Punësimi është variabël e varur (Y) nga investimet në mjetet themelore (X).

Tabela 5 – Ecuria e investimeve në mjetet themelore dhe punësimin në Maqedonin e Veriut

	Persona të punësuar (në 000)	Investimet në mjetet themelore (në 000.000 €)
2010	638.8	1,352,400
2011	645.1	1,541,000
2012	650.5	1,718,700
2013	678.5	1,913,300
2014	690.2	2,006,800
2015	706.0	2,172,000
2016	728.5	2,364,100
2017	740.6	2,205,700
2018	765.0	2.300.800


Burimi: <https://stat.gov.mk//pdf/205>, 2016, 2017, 2018, 2019,
<https://stat.gov.mk//publikime>

/209/ regjionet në Republikën e Maqedonisë.

Ekuacioni që përfshin modelin e regresionit në mënyr matematikore mund të shprehet:

$Y = a + bx + c$ Testi i hipotezës $\alpha = 0.05$, H_0 , nuk egziston lidhje midis variavblave të analizuarra nëse $p = 0$, dhe egziston lidhje midis variablave nëse $H_0 \neq 0$

Grafikoni 1 - Punësimi dhe investimet në mjete themelore në Maqedonin e Veriut (2010/18)



Burimi: Si në tabelat paraprake (përpunim i të dhënave nga autori)\

Tabela 6 - Koeficientët e korelacionit, përcaktueshmërisë, gabimi standard për punësimin dhe investimeve në ekonomin e Maqedonis së Veriut (2010/18)

	R	R ²	R ² i modifikuar.	Gabimi stand.
Modeli	0.92724	0.859775	0.836404	17.24756
Koeficientët	Koeficienti i standardizuar		Koeficienti i pa standardizuar	Signifance
Parametri konstant	̂	Gabimi standard	̂	F
IMTH	423.4548	46.0963	0.041	0.000
	0.136675	0.02253	0.000	

Burimi: Si në tabelat 5 (përpunim i të dhëave nga autori)

Nga të dhënat e prezantuara vërejmë se ekuacioni linear midis punësimit dhe investimeve në mjetet themelore është $Y = 423.45448 + 0.136675X$. Koeficienti i korelacionit ($R = 0.92724$) tregon për një lidhje të fortë korelative midis dy variablave. Koeficienti i përcaktueshmërisë ($R^2 = 0.859775$) tregon se në periudhën e analizuar (2010/18) punësimi në ekonomin e Maqedonisë së Veriut është varur 86 % nga investimet dhe vetëm 14 % nga faktorët tjerë. Vlera e sigmës është 0.000 dhe mbasi norma e lejuar është 0.05, tregon për nivel të lart besueshmërie (95 %).

Tabela 7 - Testi Anova

Modeli	Shuma e katrorëve	Df	Mesatarja e katrorëve	F	Sig.
Regresioni	10943.7	1	10943.72	36.783	0.000911
Mbetjet	1784.86	6	297.4782		
Totali	12728.5	7			

Burimi: Si në tabelën 4 (përpunim i të dhënave nga autori)

Vlera e sigmës në testin Anova prej 0.000911 tregon për një model i cili tregon për një lidhje reale midis variablave të vrojtuar.

Avantazhet e lëmive ekonomike nëpër rajonet e Maqedonis së Veriut, si mundësi për intensifikimin e zhvillimit ekonomik

Siç vërejtëm më sipër struktura ekonomike e Maqedonis së Veriut ishte arkaike. Si e tillë ajo akoma nuk ka akumulim vetanak zhvillimor për të transferu zhvillimin ektenziv në ate intenziv. (Zlatka P. (1991) fq. 191). Vështruar nëpër rajone resurset, kushtet klimatike dhe strukturat e formuar dallojnë nga njëri në rajonin tjetër. Më poshtë prezantojmë vetit e secilit rajon.

Rajoni i Vardarit përfshin pjesën qendrore në të cilin jetojnë 7.3 % e popullsisë së Maqedonis së Veriut. Resurset ujore dhe klima mediterane mundëson kultivimin e pemëve dhe hardhis së rrushit. Në këtë rajon janë koncentruar kapacitetet për prodhimin e verës. Shteti duhet të stimuloj veprimtaritë përpunuese të pemëve dhe perimeve me avancime teknologjike, si dhe disa lëmi tjera të industrisë së lehtë. Në këtë rajon eksploatohet feronikli i cili për të rrit të ardhurat duhet të punohet në faza më të larta.

Në rajonin lindor jeton 8.4 % e popullsisë së përgjithshme. Fusha e Koçanit në këtë rajon është e njohur për kultivimin e orizit. Rafshmalet e Malishevës ofrojnë kushte për zhvillimin e pemtarisë. Nga malet e këtij rajoni kryesisht eksploatohet plumbi dhe zingu. Rajoni ka traditë për industrinë e tekstile prandaj aty janë koncentruar aktivitetet e kësaj lëmie industriale. Si në gjithë vendin edhe në këtë rajon mungojnë avansimet teknologjike në industrinë e lehtë përpunuese.

Rajoni jug-lindor është kryesisht bujqësor, me më shumë ditë me diell në cilin jetojnë 8.4 % e popullsisë së përgjithshme. Kushtet e mira klimatike resurset e mëdha ujore mundësojnë kultivimin e perimeve, prodhimeve të hershme bujqësore dhe prodhimet tjera industriale. Në këtë rajon janë koncentruar kapacitetet e konzervimit. Liqeni i Dojranit mundëson zhvillimin e turizmit. Edhe në këtë rajon nevojiten stimulime monetare dhe fiskale për të avancuar lëmit përpunuese të industrisë së lehtë.

Në rajonin jug-perendimor jeton 11.6 % e popullsisë së përgjithshme. Ka potenciale të mëdha ujore (lumi Treska dhe Drini i Zi dhe liqeni i Ohrit) të cilat pjesërisht janë shfrytëzuar me instalimin e elektranave me liqenin artificial Shpile në Gllaboçicë. Është i zhvilluar turizmi veror në veçanti në qytetin e Ohrid i cili është i mbrojtur nga UNESCO. Parku nacional I Galicicës tërheq vizitor të shumtë. Dibra me ujrat e njohura termale ofrojnë kushte për turizmin e banjave. Nuk investohet ose fare pak mjete financiare derdhen në Strugë edhe pse ka pozitë të jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit verorë. Në Dibër poashtu fare nuk investohet. Sa i përket lëmive ekonomike pjesërisht janë zhvillu aktivitetet e industrisë së tekstile, furrave të bukës, e pijeve jo alkoolike, prodhimit të verës dhe disa lëmive tjera.

Në rajonin jug-lindor jetojnë 8.5 % e popullsisë së përgjithshme. Në malet e Osogovës eksploatohet xehja e plumbit dhe zingut. Në rajon ka kushte të mira për zhvillimin e blegtorisë dhe industrisë për përpunimin e prodhimeve të mishit dhe qumshtit.

Rajoni i Pellagonisë përfshin pjesën jugore të Maqedonis së Veriut, në të cilin jeton 11 % e popullsisë së përgjithshme. Rrafshnalta e Pollogut është hambari i Maqedonisë së Veriut. Kushtet e mira klimatike si dhe rrjeti i mirë i ujitjes mundëson prodhimin e duhanit, mollëve, qumshtit etj.

Në këtë rajon janë ngrit kapacitete përpunuese të qumshtiit, duhanit dhe disa lëmive të industrisë së lehtë. Liqeni i Prespës, parku nacional i Pelisteri si dhe qendra turistike e Krushevës ofrojnë kushtë për zhvillimin e turizmit veror de atij dimror.

Rajoni i Pollogut përfshin 15.5 % të popullsisë së përgjithshme. Ka pasuri të mëdha ujore të cilat pjesërisht janë shfrytëzuar nga Liqeni i Mavrovës. Rrafshnaltat e Pollogut si malet mundësojnë kushte për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Malet e larta si dhe reliefi specifik i tyre mundësojnë kushte ideale për ngritjen e qendrave turistike dimrore. Fatkeqsisht si në vendet tjera shqiptare dhe në Pollog nuk është investuar fare. Bizneset private në këtë rajon kryesisht i takojnë sferës përpunuese të industrisë së lehtë, asaj për përpunimin e qumshtiit, të dhomave të fjetjes, përpunimit të drurit etj.

Rajoni veri-lindor është i njohur për eksplatinimin e plumbit dhe zingut nga malet e Osogovës. Në rajon ka kushte të mira për zhvillimin e blegtorisë. Sa i përket lëmive ekonomike mund të zhvillohet aktivitetet për përpunimin e qumshtiit dhe prodhimeve të mishit.

Në rajoni e Shkupit jeton 30.3 % e popullsisë së përgjithshme. Në Shkup si kryeqytet i vendit janë koncentruar të gjitha kapacitetet industriale, tregtare dhe ato shërbyese. Ai është qendër ekonomike, administrative, arsimore dhe kulturore. Është rajoni me më shumë migrime të brendëshme.

Nga ajo që u cek më sipër mund të vërejmë se në Maqedonin e Veriut nevojitet politikë më aktive për zhvillimin rajonal. Ai duhet të jetë prioritet në politikat zhvillimore. Përcatimi i përparsive në zhvillimin ekonomik paraqet një problematik të ndërlikuar, që kërkon studim serioz. (Petrit P.(2008), fq. 350)

Shqyrtime përfundimtare dhe rekomandime

Nga ajo që u cek më sipër vërejtëm se Maqedonia e Veriut ka strukturë depresionuese dhe për pasoj nuk mund të realizon zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Sektorët e tregtisë me shumicë, ajo me pakicë, transporti, sektori i xehetarisë, industrisë përpunuese dhe energjetikës si kontribuesit më të mëdhenj në formimin e PBB nuk mund të jenë lëmi bartëse të zhvillimit ekonomik. Siç e pamë ato ishin të përcaktuar dhe nga volumi i investimeve në mjetet themelore.

Vërejtëm dallime të mëdha dhe sa i përket strukturës ekonomike dhe asaj investive nëpër rajone. Rajoni i Pollogut dhe ai jug-perëndimor ishin rajone me strukturë ekonomike më depresionuese dhe me investime të pakta. Ato janë dhe qendra të mëdha migruese sepse dhe papunësia ishte tejet e lartë (çdo i treti në moshën e punës ishte i pa punë). Në kuadër të vet rajonit në Maqedonin e Veriut vërejtëm se ka dallime të mëdha, në të cilat në venbanimet shqiptare fare nuk investohet dhe si të tilla ato janë më të pazhvilluara.

Në analizat empirike vërejtëm se midis Investimeve dhe punësimit kishte lidhje të forta korelative ($R = 0.92724$). Koeficienti i përcaktueshmërisë ($R^2 = 0.859775$) tregon se në periudhën e analizuar (2010/18) punësimi në ekonominë e Maqedonisë së Veriut është varur 86 % nga investimet dhe vetëm 14 % nga faktorët tjerë. Vlera e sigmës është 0.000 dhe mbasi norma e lejuar është 0.05, tregon për nivel të lart besueshmërie (95 %).

Nga prezantimet e rajoneve për mundësin e zhvillimit ekonomik vërejtëm specifikat e tyre si dhe mundësit për aktivitet ekonomike. Në vazhdim prezantojm disa rekomandime në lidhje me përmirsimin e strukturës ekonomike dhe mundësit e intesifikimit të zhvillimit ekonomik. Ato janë si më poshtë:

- Programi kombëtar i proiriteteve, në cilin vend kryesor duhet të zenë zhvillimi teknologjik;
- Identifikimi dhe stimulimi monetar dhe fiskal i lëmive ekonomike si bartëse të zhvillimit;
- Lëmit ekonomike të cilat duhet sforcuar: elektroindustria, kompleksi metalo perpunues dhe kompleksi kimik;
- Stimulimi i koperimit të firmave vendore me ato të jashtme;
- Përkrahja e firmave të vogla dhe të mesme për përvetësimin e teknologjive të avancuara në lëmin e teknologjis kompjuteristike dhe bioteknologjisë;
- Zhvillimi i sektorëve të rijë në veprimtarit innovative;
- Përkrahja e sektorëve me nivel të lartë finalizimi;
- Investimi në kapitalin human dhe arsim etj.

Referencat

- (1) Pollozhani P. (2011), *Ekonomia për jurist*, ArbëriDesign ,Tetovë,
- (2) John S. ((2006) *Economics*, sixth edition, Prentice Hill, London,
- (3) Musa L. (2002) *Bazat e modeleve makroekonomike*, Çabej, Tetovë,
- (4) Abdylmenaf B, (2000) *Zhvillimi ekonomik-shoqëror i trojeve shqiptare dhe integrimi i tyre rajonal dhe botëror*, Unioni i ekonomistëve shqiptar, Tiranë, Prishtinë, Shkup,
- (5) Zlatka P. (1991) *Tehnoloshki razvoj na Makedonija*,Makedonska kniga, Skopje,
- (6) Petrit P.(2008) *Struktura ekonomike dhe punësimi si prezantues të zhvillimit ekonomik*, ArbëriaDesign, Tetovë,
- (7) *Državen Zavod na Statistika, Regionalen Godisnik, Regionite vo Republika Makedonija (2019)*
- (8) <https://stat.gov.mk//pdf/205>, 2016, 2017, 2018, 2019

TRENSFERIMI STRUKTUROR EKSTENZIV NË ATE INTENZIVË SI FAKTOR PËRSHPEJTUES I ZHVILLIMIT NË MAQEDONINË E VERIUT EXTENSIVE STRUCTURAL TRANSFER IN THAT INTENSIVE AS A PROCESSING DEVELOPMENT FACTOR IN THE NORTHERN MACEDONIA

Prof. Dr. Seadin Xhaferi

Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës

seadin.xhaferi@unite.edu.mk

Abstract

The formed economic structure is the most relevant presenter of the level of development in a national economy. The economic structure of Northern Macedonia is unbalanced, leaving aside other limiting factors, so it does not enable sustainable economic development. Thus, that structure is archaic, with areas that do not accelerate the development of other sectors. Such a structure is a legacy inherited before the 1990s as well as an inefficient strategy.

The distribution of investments in fixed assets within the economic sectors is the determinant of such a structure. In Northern Macedonia, more investment is being made in non-productive sectors, which result in extensive development. The determination of such a structure is confirmed by the correlation coefficient which shows a strong link between GDP and investment in fixed assets ($R = 0.933422$). The coefficient of determinability is extremely high (0.87) which shows that GDP in the economy of Northern Macedonia in the analyzed period, 87% of employment depends on investment and only 13% on other factors.

Keywords: economic structure, investments in fixed assets, correlation coefficient, development strategy

Abstrakt

Struktura e formuar ekonomike është prezantuesi më relevantë i nivelit të zhvillimit në një ekonomi kombëtare. Strukturë ekonomike e Maqedonisë së Veriut është jo ekuilibruese duke mos lënë anash faktorët tjerë kufizues pra nuk mundëson zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Kështu ajo struktura është arkaike, me fusha të cilat nuk përshpejtojnë zhvillimin e sektorëve tjerë. Një strukturë e tillë është pasoj e trashëguar para viteve të 90-ta si dhe një strategji jo efikase.

Distribuími i investimeve në mjetet themelore brenda sektorëve ekonomik është përcaktues i një strukture të tillë. Në Maqedoninë e Veriut investohet më shumë në sektorët jo propulzivë, të cilët rezultojnë me zhvillim ekstenziv. Përcaktimi i një strukture të tillë vërtetohet me koeficientin e korrelacionit i cili tregon një lidhje të fuqishme midis PBB dhe investimeve në mjetet themelore ($R = 0.933422$). Koeficienti i përcaktueshmërisë është tejet i lartë (0.87) që tregon se PBB në ekonomin e Maqedonisë së Veriut në periudhën e analizuar, 87 % e punësimit varet nga investimet dhe vetëm 13 % nga faktorët tjerë.

Fjalët kyçe: *strukturë ekonomike, investimet në mjetet themelore, koeficienti i korrelacionit, strategjia zhvillimore.*

HYRJE

Struktura e formuar ekonomike determinon dinamikën e zhvillimit në një ekonomi kombëtare. Shtetet të cilat kanë arrit strukturë të drejtpeshuar ekonomike, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe anasjelltas shtet me strukturë arkaike nuk kanë mund të arrijnë këtë objektivë. Me fjalë tjera nëse bartës të zhvillimit ekonomik janë sektorët propulzivë (industri me faza të larta të përpunimit), ekonomia kombëtare rritet me norma të larta zhvillimi. Nëse bartës të zhvillimit janë sektorët depresiv (lëndë të para dhe gjysmë fabrikate si dhe sektorët e me faza të ulëta përpunimi dhe pa avancime teknologjike), kështu që ekonomia vështirë arrin zhvillim të qëndrueshëm. Një strukturë të tillë depressive ka dhe ekonomia e Maqedonisë së Veriut. Në këtë punim struktura e tillë prezantohet nëpërmjet kontributit të sektorëve në PBB si dhe distribuimi i investimeve në mjetet themelore. Pra analizohen lidhjet korelative midis PBB dhe investimeve. Në bazë të analizave prezantohen sektorët me prioritet në zhvillimin ekonomik të ardhshëm..

Kontributi i sektorëve në formimin e PBB në ekonomin e Maqedonisë së Veriut

Kontributi i sektorëve në zhvillimin ekonomik është prezantues relevant i strukturës së formuar në një ekonomi kombëtare.. Zhvillimi (rritja ekonomike) është përgjegjës për ndryshimet e mëdha (Burda & Viplosh, (200), fq. 46) Struktura ekonomike në Maqedoninë e Veriut është depressive që mund të vërehet nga kontributi i lëmive në formimin e PBB që prezantohet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1. PBB nëpër sektorë e Maqedonisë së Veriut për vitin 2010 deri më 2018, (në 000.000 €)

	Bujqësia , pylltaria dhe peshkataria	Xehetaria, Energjetika dhe Indust. përpun.	Tregtia me shumicë, dhe pakicë transporti	Ndërtimi - mtaria	Informatika dhe Komunik.	Veprimtaria publ. Mbrojtja, Sig. Oblig. arsimi	Veprimtaria tjera	PBB
2010	736.4	1.255.4	859.6	381.3	236.3	1.088.6	2,364.8	6.923.0
2011	782.9	1.340.0	933.8	466.0	192.3	1,126.4	2,487.6	7.329.0
2012	668.3	1,127.8	1,002.2	506.7	178.8	1,084.4	2,905.8	7.474.0

2013	693.4	1,084.7	1,006.7	654.8	179.1	1,066.8	3,043.6	7.729.3
2014	875.3	1,337.0	1,152.8	595.8	260.7	1,151.8	3,226.6	8.600.0
2015	886.2	1,532.6	1,202.8	646.9	268.6	1,230.8	3,343.1	9.110.1
2016	889.3	1,653.2	1,842.7	670.0	296.0	1,200.9	3,142.9	9.695.1
2017	796.0	1,796.7	2,008.7	630.0	337.3	1,220.0	3,261.3	10.050.0
2018	915.8	1,989.7	2,103.1	573.8	375.5	1,275.8	3,492.3	10.726.0

Burimi: <https://stat.gov.mk//pdf/205>, 2016, 2017, 2018, 2019, <https://stat.gov.mk//publikacii/209/regjionet> në Republikën e Maqedonisë, 2019/pdf, (përpunim i të dhënave nga autorët)

Siç mund të vërehet në periudhën e analizuar 2010/18 në Maqedonin e Veriut sektori i industrisë, energjetikës dhe industrisë përpunuese në formimin e PBB kontribuon në gamën 15 – 20 %. Kontributi i tij është rrit nga 1.255,4 miliard € sa ishte në vitin 2010 në 1,989.7 miliard € më 2018. Me përjashtim të viteve 2012 dhe 2013 ai shënon rritje të vazhduar. Sektori i dytë i cili kontribuon më shumë në PBB në Maqedoninë e Veriut në të njëjtën periudhë kohore është ai i tregtisë me shumicë, pakicë dhe transportit i cili në periudhën e analizuar në formimin e PBB merr pjesë në gamën 13 – 20 %. Ky sektor për dallim nga sektori paraprak i cili kishte oscilime, ka një rritje të vazhduar kështu nga viti 2010 (859.6 milion €) u rrit për afër 2.5 herë (2,103.0 milion €) në vitin 2018-të. Sektori i veprimtarive publike, mbrojtjes, sigurimeve të detyrueshme dhe të arsimit në të njëjtën periudhë ka kontribuar në formimin përafërsisht sa sektorët tjerë me gamën 12 – 15 %. Kontribues më i vogël është sektori i ndërtimtarisë dhe ai i bujqësisë.

Siç mund të vërehet struktura ekonomike e Maqedonisë së Veriut është depresionuese, pa zhvillim të sektorëve të cilët do përshpejtonin zhvillimin e sektorëve tjerë (industria përpunuese e fazave të larta të përpunimit). Maqedonia e Veriut ka traditë në industrinë e lehtë përpunuese siç është ajo e përpunimit të letërës, lëkurës, këpucëve, tekstile por ato kanë ngecje serioze teknologjike. Pasurit xeherore tregtohen si lëndë të para ose gjysmë fabrikantë të cilat janë shumë më të lira se sa ato të ishin në faza më të lartë përpunimi. Maqedonia e Veriut duhet të identifikoj sektorët përpunues me avantazhe komperative dhe të njëjtat ti stimuloj financiarisht me kredi të lira dhe lehtësira fiskale. Bujqësia është sektor depresionues e cila në formimin e

PBB në periudhën e analizuar merr pjesë me rreth 10 %. Edhe pse Maqedonia e Veriut ka kushte të mira klimatike dhe ndanë shuma të mëdha subvencionesh gati 1/3 e tokës nuk punohet që tregon se parat nuk shkojnë atje ku duhet por ka manipulime në shpërndarjen e subvencioneve. Një shtet në zhvillim duhet të përcaktohet që rritja e ardhshme duhet të jetë e shpejtë dhe e qëndrueshme (Rifat H. & Fatlum. G. (2013) fq. 20)

Dinamika e Investimet në mjete themelore nëpër sektorët e Maqedonisë së Veriut

Investimet janë faktori kryesor i zhvillimit ekonomik. Shtetet me nivel të lartë të investimeve zakonisht arrin ritme të qëndrueshme ekonomike dhe anasjelltas shtetet dezinvestuese nuk e arrijnë këtë objektivë.

Dinamika dhe distribuimi i investimeve në mjetet themelore pa lënë anash dhe strukturën e trashëguar nga sistemi komunist kanë determinuar strukturën ekonomike në Maqedoninë e Veriut, që mund të vërehet nga të dhënat e tabelës së mëposhtme.

Tabela 2. Investimet në mjetet themelore në sektorë e ekonomisë së Maqedonisë së Veriut, 2010/17 (në 000.000 €)

	Bujqësia , pylltaria dhe peshkataria	Xehetaria, Energjetika dhe Indust. përpun.	Treg. me shumicë, dhe pakicë transporti	Ndërtimi - mtaria	Informata. Dhe Komunik.	Vepr. Publ. Mbrojtja Sig. Oblig. arsimi	Vepri – mtarit tjera	Investimet në mjetet themelore
2010	38.4	366.3	166.4	468.8	88.8	149.5	74.2	1,352.4
2011	34.4	354.5	338.4	486.6	70.4	174.1	82.6	1,541.0
2012	41.7	430.8	258.8	565.3	96.6	158.7	166.8	1,718.7
2013	51.9	494.3	266.3	619.5	127.6	210.2	143.5	1,913.3
2014	55.8	472.1	274.0	759.3	103.2	207.0	135.4	2,006.8

2015	64.0	506.0	331.0	803.3	81.3	266.0	120.4	2,172.0
2016	55.7	493.0	366.3	860.4	100.9	253.7	234.1	2,364,1
2017	45.8	487.8	380.1	816.3	117.3	269.0	89.4	2,205.7

Burimi: <https://stat.gov.mk//pdf/205>, 2016, 2017, 2018, 2019,
[https://stat.gov.mk//publikacii/209/regjionet në Maqedonisë së Veriut, 2019/pdf](https://stat.gov.mk//publikacii/209/regjionet%20n%C3%A9%20Maqedonis%C3%AB%20s%C3%AB%20Veriut%202019/pdf), investimet Nr. 3.1.11.07, 3.1.12.07 3.1.15.05 (përpunim i të dhënave)

Siç vërejmë pjesën më të madhe të investimeve në mjetet themelore në Maqedoninë e Veriut në periudhën 2010/17 e përfshin ndërtimtaria (mbi 1/3) me gamën 34 – 37 %, dhe mandej vinë sektori i xehetarisë, energjetikës dhe industrisë përpunuese (mbi ¼) me një gamë 22 – 27 %. Sektorët e cekur më sipër nuk janë lëmi zhvillimi të cilët do të përshpejtonin zhvillimin edhe të sektorëve tjerë. Informata dhe komunikimi si një nga sektorët propulzivë përfshin vetëm mbi 6 % të investimeve në mjetet themelore. Sektori me më pak investime është ai i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë i cili në vitet e analizuara përfshin vetëm 2 deri në 3 % të investimeve. Maqedonia e Veriut krahas subvencioneve të larta, me investime simbolike nuk arrin të shfrytëzoj avantazhet në sektorin e bujqësisë.

Korrelacioni midis PBB dhe investimeve në mjetet themelore


Lidhja korrelative është prezantuar me të dhënat konkrete të ekonomisë së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2010/17. PBB është marrë variabël e varur (Y) dhe Investimet në mjete themelore janë variabël e pavarur (X).

Ekuacioni që përfshin modelin e regresionit në mënyr matematikore mund të shprehet:

$$Y = a + bx + c$$

Testi i hipotezës $\alpha = 0.05$, H_0 , nuk egziston lidhje midis variabileve të analizuara nëse $p = 0$, dhe ekziston lidhja midis variabileve nëse $H_0 \neq 0$

Grafikoni 1 - Prezantimi grafik i PBB dhe investimeve në Maqedoninë e Veriut (2010/17)



Burimi: Si në tabelat 1 dhe 2 (përpunim i të dhënave nga autorët)

Tabela 3 - Koeficientet e korrelacionit, përcaktueshmërisë, gabimi standard për PBB dhe IMTH

	R	R ²	R ² i modifikuar.	Gabimi stand.
Modeli	0.933422	0.871278	0.849824	449.9864
Koeficientët	Koeficienti i standardizuar		Koeficienti i pa standardizuar	signifance
Parametri konstant	δ	Gabimi standard	δ	F
IMTH	2437.581 3.100678	942.4758 0.486553	0.041 0.000	0.000

Burimi: Si në tabelat 1 dhe 2 (përpunim i të dhënave nga autori)

Nga të dhënat e prezantuara vërejmë se ekuacioni linear midis PBB dhe IMTH është $Y = 2437.581 + 3.100678 x$. Koeficienti i korrelacionit $R = 0.933422$ tregon për një lidhje të fortë korelative midis PBB dhe investimeve në mjetet themelore. Koeficienti i përcaktueshmërisë $R^2 = 0.871278$ tregon se në periudhën e analizuar (2010/17) PBB në ekonomin e Maqedonisë së Veriut është varur 87 % nga investimet dhe vetëm 13 % nga faktorët tjerë. Vlera e sigmës është

0.000 dhe mbasi norma e lejuar është 0.05, tregon për nivel të lart besueshmërie (95 %). Me fjalë tjera po aq ndikojnë investimet në mjetet themelore në PBB në ekonomin e vendit në periudhën 2010/17.

Tabela 4 - Testi Anova

Modeli	Shuma e katrorëve	Df	Mesatarja e katrorëve	F	Sig.
Regresioni	8223416	1	8223416	40.61191	0.0000
Mbetjet	1214927	6	202487.8		
Totali	943842	7			

Burimi: Si në tabelat 1 dhe 2 (përpunim i të dhënave nga autorët)

Vlera e sigmës në testin Anova prej 0.0000 tregon për një model i cili tregon për një lidhje reale midis PBB dhe IMTH në ekonomin e Maqedonisë së Veriut për periudhën e analizuar 2010/17.

Faktorët përkufizues dhe favorizues në procesin e ristrukturimit ekonomik

Duke identifikuar faktorët favorizues dhe ato përkufizues mund të ndërtojmë strategji për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Faktorët favorizues në Maqedoninë e Veriut janë si më poshtë:

Fuqia e lirë punëtore, pasuritë natyrore, infrastruktura gjithnjë në përmirësim, pozita gjeostrategjike, niveli i arritur i industrializmit në veçanti asaj të lehtë, pritshmërit për anëtarësim të shpejtë në Alencën Veri Atlantike (NATO), afrimi për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE, përmirësimi i marrëdhënieve me shtetet fqinje pas ndërrimit të emrit.

Faktorët përkufizues të Maqedonisë së Veriut janë: niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, mos dalja në det, ngeçjet teknologjike, struktura depresionuese ekonomike, varësia e lartë e të mirave kapitale nga importi, normat e larta të papunësisë në veçanti të atyre të moshës ë re, ekonomia jolegale, prania e theksuar e pozitave monopoliste në sektorin e përpunimit të duhanit, karburanteve, materialit ndërtimor, energjetikës, komunikacionit, telekomunikacionit etj, nepotizmi, partizmi i skajshëm, arsimi në rënie të vazhduar, shëndetësia katastrofale etj.

Strategjia e zhvillimit sektorial në Maqedoninë e Veriut

Për reforma strukturore nevojiten mjete financiare. Përveç parave duhet mbështetur dhe në faktorët favorizues dhe avantazhet tjera. Maqedonia e Veriut është shtet jo mjaft i zhvilluar dhe me një ekonomi me akumulim të kufizuar. Varësisht nga mundësit financiare, baza ekzistuese materiale, struktura ekzistuese ekonomike si dhe faktorët tjeë favorizues mund të ndërtohet strategji për zhvillimi ekonomik mbështetur në prioritetet sektoriale. Duke u nisë nga ajo që u cek më sipër, lëmit prioritare në Maqedoninë e Veriut janë:

Bujqësia mund të jetë sektor i cili mund të kontribuoj më shumë në zhvillimin ekonomik. Ushqimet bio sot janë shumë të kërkuara nga vendet e zhvilluara dhe mund të bien të ardhura nga eksporti. Sipërfaqet kodrinore - malore dhe ato të viseve kufitare janë vende për prodhime bujqësore cilësore. Sot 1/3 e tokës në Maqedoninë e Veriut nuk punohet, që sinjalizon për jo eficientë e subvencioneve. Duhet të investohet më shumë në rregullimin e sistemit të ujëtjes, të shtratit të lumenjve etj. Përveç drithërave në bujqësi duhet të rriten dhe prodhimet e pambukut, duhanit, arrave, lajthive etj. Bujqësisë i ndihmojnë edhe kapacitet ekzistues për përpunimin e pemëve dhe perimeve edhe pse ato nuk aplikojnë teknologji të avancuara. Zhvillimi i blegtorisë në kuadër të sektorit të bujqësisë duhet të stimulohet. Sipërfaqet e lira të kullosave dhe zgjerimi i tyre nga tokat e lëna djerrina mund të intensifikojnë blegtorinë. Zhvillimit të blegtorisë i ndihmojnë edhe kapacitet ekzistues të përpunimit të qumështit, leshit, lëkurës etj. (Pollozhani, P, 2008 fq. 352) Këto të fundit shënojnë ngecje teknologjike prandaj nevojitet lehtësira monetare dhe fiskale për të intensifikuar avancimin teknologjik.

Industria përpunues e fazave më të larta duhet të jetë prioritet strategjik edhe pse ajo kërkon shumë mjete financiare. Maqedonia e Veriut duhet të krijoj kushte për zhvillimin e disa lëmive të këtij sektori të cilët do jenë bartëse të zhvillimit ekonomik në të ardhmen. Sektorët e tillë mund të jenë: prodhimi dhe përpunimi i metaleve me ngjyra, prodhimi i mjeteve të komunikacionit, prodhimi i aparateve dhe makinave elektrike, prodhimi i produkteve kimike, i produkteve ushqimore, pijeve etj. (Grup autorësh, (1990), fq 114). Sektori elektronik në kompleksin metalo-përpunues ka ndikim të fuqishëm në zhvillimin e gjithë lëmit industrialë. (Zlatka Popovska, (200), fq. 394). Industria e përpunimit të drurit duke modernizuar dhe ristrukturuar kapacitet prodhues me përmirësim të dizajnit dhe kualitetit mund të fitoj në peshë në strategjinë strukturale.

Industria tekstile, e lëkurës, e mullinjve, ajo e përpunimit të qumështit për shkak të traditës, investimeve jo të mëdha dhe pozitës aktuale dhe në të ardhmen do kenë përparësi në sektorin e industrisë. Ngecjet teknologjike janë faktor kufizues por stimulimet me masa monetare dhe fiskale në këto lëmi mund të rezultojnë me avancime dhe ato të transformohen në faktor favorizues. Lëmit e tilla ekonomike mund të zhvillojnë aktivitetin e vet pa probleme sepse kanë burim të materialeve të riciklueshme në vend.

Pra sektori i tregtisë është sektor i cili kontribuon më shumë në formimin e PBB. Ai do të vijoj të ketë rrol të fuqishëm edhe më tej. Ky sektor do rrisë aktivitetin e tij dhe për punë plotësuese siç janë: paketimi, konfeksionimi, matjet etj. Ai do jetë burim i rëndësishëm i hapjes së vendeve të punës për gjininë femërore. Kështu në të ardhmen do orientohet kah integrimi dhe specializimi.

Sektori i ndërtimtarisë i cili aktualisht kontribuon me rreth 4 % të PBB duhet të forcon rrolin në ekonomin maqedonase. Ky sektor duhet të modernizohet duke aplikuar teknologji të reja si dhe të investoj në specializimin e kuadrove. Informatika dhe komunikimi edhe pse aktualisht në formimin e PBB marrin pjesë me mbi 3 %, në të ardhmen duhet të jetë sektor me përparësi zhvillimore.

Sektori i turizmit duhet të ketë prioritet zhvillimor. Zhvillimi i tij mund të realizohet pa investime të mëdha sepse ka numër të mjaftuar hotelesh, motele, banja kuruese si dhe infrastrukture relativisht të mirë. Shteti duhet të investoj në qendra dimërorë si ajo e Kodrës së Diellit në Tetovë dhe Mavrovë në Strugë qytetin e pozitës me bukurit e lumit Drin dhe banjat e Dibrës e kështu me radhë. Në këtë sektorë duhet të zgjerohen dhe modernizohen sallat universale dhe ato të kongreseve, pishina sportive, objektet aktive lundruese etj.

Përfundim

Rezultatet e hulumtimit bazuar në kontributin e sektorëve ekonomik në PBB si dhe distribuimi i investimeve nëpër lëmi ekonomike, lidhja e tyre korelative, si dhe identifikimi i sektorëve si bartës të zhvillimit ekonomik na mundëson të përpilojmë shqyrtimet përfundimtare, të cilat i prezantojmë në vijim;

Struktura aktuale ekonomike e Maqedonis së Veriut është depresionuese, sepse periudhën e analizuar 2010/18 sektori i industrisë, energjetikës dhe industrisë përpunues në formimin e PBB-së kontribuon në gamën 15 – 20 %. Përafërsisht 13 – 20 % në formimi në PBB kontribuon sektori i tregtisë me shumicë, pakicë dhe transportit dhe lëmia e veprimtarive publike, mbrojtjes, sigurimeve obligative dhe arsimit. Kontribues më modest janë sektori i ndërtimtarisë dhe ai i bujqësisë.

Në Maqedoninë e Veriut vërehet një disproporcion midis kontributit lëmive ekonomike në PBB dhe volumit të investimeve. Ashtu p.sh. sektori i xehetarisë, energjetikës dhe industrisë përpunuese në periudhën 2010/17 në formimin e PBB merr pjesë me 15 - 20% të dhe në investime ai përfshin ¼ e PBB. Sektorët e cekur më sipër nuk janë lëmi zhvillimi i të cilëve do të përshpejtonte zhvillimin dhe të sektorëve tjerë. Informata dhe komunikimi si një nga sektorët më popullarizuar përfshin vetëm mbi 6 % të investimeve në mjetet themelore. Sektori me më pak investime është ai i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë i cili në vitet e analizuara përfshin vetëm 2 deri në 3 % të investimeve.

Është vërtetuar se në mes të PBB dhe investimeve në mjetet themelore ka lidhje të forta korelative ($R = 0.933422$). Koeficienti i përcaktueshmërisë $R^2 = 0.871278$ tregon se në periudhën e analizuar (2010/17) PBB në ekonomin e Maqedonisë së Veriut është varur nga investimet 87 % dhe vetëm 13 % nga faktorët tjerë. Vlera e sigmës është 0.000 dhe mbasi norma e lejuar është 0.05, kjo tregon se niveli i besueshmërisë është 95 %.

Sektorët me prioritet në strategjinë e zhvillimit ekonomik të Maqedonisë së Veriut janë: industria përpunuese me avancime teknologjike në përpunimin e pemëve, perimeve, qumështit, lëkurës, drurit, industria tekstile etj.

Industria përpunuese e fazave më të larta prodhimi dhe përpunimi i metaleve me ngjyra, prodhimi i mjeteve të komunikacionit, prodhimi i aparateve dhe makinave elektrike, prodhimi i produkteve kimike, prodhimi i produkteve ushqimore duhet të jenë prioritet strategjik

Sektori i tregtisë, ndërtimtarisë, informatikës dhe turizmit me avancime teknologjike pritet të jenë kontribues të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Maqedonisë së Veriut.

Referncat

- (1) Burda & Viplosh, (200), Makroekonomija, Evropski tekst, Akademski pecat, Skopje
- (2) Riha H. & Fatlum G. (2013) Investimi si kusht për zhvillimin ekonomik, Igmp, Prishtinë
- (3) Pollozhani. P, (2008) fq. 352) Struktura ekonomike dhe punësimi si prezantues të zhvillimit
- (4) Grup autorësh, Ekonomski razvoj, (1990) SR Makedonija, vo periodot 1991 – 1995 (prestruktuiranje na stopanstvoto) Skopje,
- (5) Zllatka P, (200), Politika na tehnoloshki razvoj, Ekonomski Fakultet, Skopje
- (6) <https://stat.gov.mk/pdf/205>, 2016, 2017, 2018, 2019,
- (7) [https://stat.gov.mk/publikacii/209/regionite vo Republika Makedonija, 2019/pdf](https://stat.gov.mk/publikacii/209/regionite%20vo%20Republika%20Makedonija,2019/pdf),
- (8) Investicii N0 3.1.11.07, 3.1.12.07 3.1.15.05

IDENTIFIKIMI I NXËNËSVE ME VËSHIRËSI NË TË FOLUR DHE NË TË SHKRUAR NGA ANA E MËSIMDHËNËSVE KLASOR
IDENTIFICATION OF STUDENTS WITH THE OBLIGATIONS IN SPEAKING AND WRITING FROM THE CLASSICAL LESSONS

Rinë Lami Kolgeci

Mësimdhënëse klasore në shkollën fillore “Emin Duraku”, në Shtime
Class teacher at the primary school "Emin Duraku", in Shtime

ABSTRACT

The issue of identifying students with speech and writing difficulties by class teachers has been little researched in our country.

The purpose of this research was to show whether teachers are able to identify students with speech and writing difficulties.

The main research question is: How well are teachers able to identify students with speech and writing difficulties? Whereas, the basic hypothesis of this research is: Identification of students with speech and writing difficulties by class teachers is not at a satisfactory level.

In this research, mixed methods were used: the quantitative method for which the data were collected through questionnaires for teachers and principals, as well as the qualitative method which was realized through the interview and the test compiled especially for students with speech and language difficulties. written, who were identified by class teachers.

The research respondents are 20 teachers, 1 principal and 25 students from the second to the fifth grade of the primary school "Emin Duraku", in Shtime.

The results showed that teachers need professional support to be able to identify students with difficulty speaking and writing. There is cooperation with parents in identifying these cases, but there is no cooperation with professional collaborators, no teacher training has been provided to identify and treat students with difficulty speaking and writing. Based on these results, we can say that from this research we have received answers to the research questions and the hypotheses have been confirmed.

Keywords: identification, teacher, student, difficulty speaking, difficulty writin

ABSTRAKT

Çështja e identifikimit të nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar nga ana e mësimdhënësve klasor është hulumtuar fare pak në vendin tonë.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të tregohet se a janë në gjendje mësimdhënësit t'i identifikojnë nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar.

Pyetja kryesore e hulumtimit është: Sa janë në gjendje mësimdhënësit t'i identifikojnë nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar? Ndërsa, hipoteza themelore e këtij hulumtimi është: Identifikimi i nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar nga ana e mësimdhënësve klasor nuk është në nivelin e kënaqshëm.

Në këtë hulumtim janë përdorur metodat e përziera: metoda sasiore për të cilën të dhënat janë mbledhur përmes pyetësorëve për mësimdhënës dhe drejtorë, si dhe metoda cilësore e cila është realizuar përmes intervistës dhe testit të përpiluar enkas për nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar, të cilët u identifikuan nga ana e mësimdhënësve klasor.

Respondentët e hulumtimit janë 20 mësimdhënës, 1 drejtor dhe 25 nxënës nga klasa e dytë deri në të pestën, të shkollës fillore "Emin Duraku", në Shtime.

Rezultatet treguan se mësimdhënësit kanë nevojë për përkrahje profesionale që të jenë në gjendje vet t'i identifikojnë nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar. Ekziston bashkëpunimi me prindërit në identifikimin e këtyre rasteve, por nuk ka bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesional, nuk janë ofruar trajnime për mësimdhënës për të identifikuar dhe trajtuar nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar. Sipas këtyre rezultateve mund të themi se nga ky hulumtim kemi marrë përgjigje në pyejet e hulumtimit dhe janë vërtetuar hipotezat.

Fjalët kyçe: identifikim, mësimdhënës, nxënës, vështirësi në të folur, vështirësi në të shkruar.

1. HYRJE

Tek fëmijët e moshës shkollore hasim nxënës me vështirësi në të folur dhe në të shkruar, të cilat vijnë nga arsyet e ndryshme, por që kanë mjaft ndikim edhe në suksesin e tyre. Me qëllim të realizimit të këtij punimi do të merrem me hulumtimin që ka të bëjë me identifikimin e nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar nga ana e mësimdhënësve. Rëndësia e problemit është se nxënësit vinë edhe deri te automatizimi i të folurit dhe i shkrimit në përgjithësi gjatë moshës 8-9 vjeçare. Nëse këto vështirësi nuk identifikohen dhe evitohen atëherë do të zgjasin për tërë jetën. Nëse çdo mësimdhënës do të ishte në gjendje t'i identifikonte këto probleme me kohë do të ndihmonin që këto probleme të evitoheshin deri në atë masë sa të jetë e mundur dhe do të krijoheshin rrethana për t'u dalë në ndihmë kësaj kategorie të nxënësve. Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe të Kosollari me bashkëpunëtorë (1981), fjala *identifikim* do të thotë arrij të njoh një njeri në bazë të të dhënave të ndryshme ose gjurmëve që ka lënë, e zbuloj kush është ai që kërkohet; zbuloj e përcaktojë një send, një gjurmë etj., që duhet për të vërtetuar diçka. Sa i përket nocionit *mësues*, Zuna-Deva me bashkëpunëtorë (2009), është ai që jep mësim në shkollë, respektivisht mësues klase është ai që merr përgjegjësinë e mësimin klasor për klasën 1-5 të shkollës fillore, sipas përshkallëzimit të ri të sistemit edukativo-arsimor në Kosovë. Sipas fjalorit termash në edukim të Gjokutaj me bashkëpunëtorë (2016), nocioni *nxënës* është ai që ndjek një shkollë, shkollat, ithtar. Sipas Bejtullahu (2007), të *folurit* është mjet komunikimi mes njerëzve sepse me anën e të folurit arrihet deri te informimi, shprehja e mendimeve të ndryshme dhe përvojave të shumta. Sipas Woolfolk (2011) dhe Justice (2006), fëmijët që nuk arrijnë të prodhojnë tinguj të qartë konsiderohen si fëmijë me vështirësi në të folur. Sipas Rosenblum (2003, cituar në Devolli,

2008) të shkruarit është aktivitet i ndërlikuar njerëzor i cili lejon përzierjen e komponentëve kognitiv, kinetik dhe perceptuar-motorik. Kulla me bashkëpunëtorë (2006), theksojnë se *vështirësia në të shkruar* ndryshe quhet disortografi. Disortografia është vështirësia që kanë fëmijët për ta shkruar gjuhën që flasin.

1.1 Shqyrtimi i literaturës

1.1.1. Të folurit

Në moshë shumë të hershme fëmija përjeton një gamë të gjerë të aktiviteteve dhe eksperiencave për të zhvilluar të folurin, të lexuarit dhe të shkruarit. Këto veprimtari, nisur që në moshë të hershme dhe zhvillojnë aftësitë e tyre për të kënduar duke thënë vjersha, duke bërë dhe dëgjuar muzikë, ose duke dëgjuar më të rriturit, duke u bashkuar në biseda me ta, tek fillojnë e nxjerrin pretendime në lidhje me lojërat e tyre. Këto aktivitete ndihmojnë fëmijën të marrë hapat e para të rëndësishme drejt të folurit, leximit dhe shkrimit (Tahiri, 2015).

1.1.2. Vështirësitë në të folur

Sipas Justice (2006), nxënësit që nuk arrijnë të prodhojnë tingujt e përshtatshëm për të folur, konsiderohen si fëmijë me çrregullime të të folurit. Dharmo (2016), thekson se çrregullimet e të folurit komprometojnë aftësinë për të marrë, për të dërguar, pranuar dhe kuptuar informacionin verbal, joverbal, grafik dhe simbolik.

1.1.3. Të shkruarit

Garuli (2018), thekson se të shkruarit është një proces i mësuar, i qëllimshëm dhe i vetëdijshëm, i cili i drejtohet të tjerëve për t'i komunikuar diçka. Kurse sipas Rosenblum (2003), të shkruarit është aktivitet i ndërlikuar njerëzor i cili lejon përzierjen e komponentëve kognitiv, kinetik dhe perceptuar-motorik. Bejtullahu (2007), në këtë rrafsh thekson se përvetësimi i shkrim-leximit është një proces tejet i ndërlikuar psikomotorik që nuk mund të fillojë para se të pihen qendrat motorike me regjionet gjegjëse të trurit, rëndomtë menjëherë pas moshës 6 vjeçare.

1.1.4 Vështirësitë në të shkruar

Memedi (2014), disgrafia është paaftësi e qëndrueshme e fëmijës për përvetësimin e shkathtësive në të shkruar, gjë që manifestohet me gabime të shumta, të qëndrueshme dhe tipike. Nga kjo del se procesi i shkrimit të dorës për nxënësit ka një rëndësi të veçantë. Rosenblum (2004), deklaroi se akti i të shkruarit paraqet vështirësi 10 – 30% të fëmijëve të shkollave fillore.

Sipas Vio, Tressoldi, Lo Presti (2012, cituar në Garuli 2018), sa i përket moshës se kur mund të bëhet vlerësimi lidhur me vështirësitë e të shkruarit, periudha më e përshtatshme konsiderohet të jetë përfundimi i klasës së parë dhe klasës së dytë.

1.2. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të tregohet se a janë në gjendje mësuesit t'i identifikojnë nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar.

1.2.1. Pyetjet e hulumtimit

Pyetja kryesore e këtij hulumtimi është:

- Sa janë në gjendje mësimitdhënësit t'i identifikojnë nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar?

Pyetja kryesore është e shoqëruar nga nënpyetje të tjera ndihmëse të hulumtimit:

- Sa janë të përgatitur mësimitdhënësit që të identifikojnë nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar nga shkollimi paraprak i tyre?
- A ju ka ofruar shkolla trajnime të tilla?
- Në çfarë niveli është bashkëpunimi me shkollën, prindërit dhe mësimitdhënësit në identifikimin e nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar?
- Sa është numri i nxënësve të identifikuar me vështirësi në të folur dhe në të shkruar?

1.2.3. Hipotezat e hulumtimit

Hipoteza themelore e këtij hulumtimi është:

H: Identifikimi i nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar nga ana e mësimitdhënëseve klasor nuk është në nivelin e kënaqshëm.

Duke u mbështetur në hipotezën kryesore, si dhe në pyetjet ndihmëse të hulumtimit, janë përshtatur edhe këto hipoteza ndihmëse:

H₁: Mësimitdhënësit nuk janë të përgatitur nga shkollimi paraprak për të identifikuar këto probleme të nxënësve.

H₂: Shkolla nuk ju ka ofruar trajnime të tilla.

H₃: Niveli i bashkëpunimit në mes shkollës, prindërve dhe mësimitdhënëseve për të identifikuar nxënësit me vështirësi të tilla nuk është në nivelin e kënaqshëm.

H₄: Numri i nxënësve të identifikuar me vështirësi në të folur dhe në të shkruar është i lartë.

2. METODOLOGJIA

Për hulumtim janë shfrytëzuar dy lloje të instrumenteve duke realizuar metodën sasiore dhe cilësore.

2.1. Mostra e hulumtimit

Përzgjedhja e mostrës është e qëllimshme. Ky hulumtim është realizuar në shkollën fillore “Emin Duraku” të komunës së Shtimes. Respondentët e këtij hulumtimi janë 25 nxënës (7

vajza dhe 18 djem), 8 nxënës nga klasa e dytë, 6 nxënës nga klasa e tretë, 6 nxënës nga klasa e katërt dhe 5 nxënës nga klasa e pestë. Poashtu, respondent të këtij hulumtimi janë edhe 20 mësimdhënës dhe drejtoresha e shkollës.

2.2. Instrumentet

Si instrumente matëse për t'i mbledhur të dhënat janë shfrytëzuar dy lloje të instrumenteve për ta realizuar metodën sasiore: pyetësoin për mësimdhënës të përbërë nga 20 pyetje dhe pyetësoin për drejtor të përbërë nga 10 pyetje. Përveç pyetësorëve është zhvilluar testi i diktimit të fjalëve dhe intervista, e cila përbëhet nga gjithsej 10 pyetje të përgjithshme, që kanë të bëjnë me jetën sociale të nxënësve në familje dhe shkollë. Të gjitha intervistat janë incizuar me qëllim të analizimit të të folurit të tyre në tërësi.

3. Rezultatet e nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar në testet e realizuara sipas përqindjes e përgjigjeve të sakta

Përshkrimi i saktë i diktimit të 36 fjalëve nga 25 nxënësit. Rezultatet paraqiten kështu: 48% e nxënësve nuk kanë përshkruar saktë asnjë fjalë nga diktimi i fjalëve, nga 12% e nxënësve kanë përshkruar saktë diktimin e 1 fjale, nga 8% e nxënësve kanë përshkruar saktë diktimin e: 11 fjalëve, 12 fjalëve 13 fjalëve dhe 26 fjalëve, ndërsa 4% e nxënësve kanë përshkruar saktë diktimin e 24 fjalëve dhe 29 fjalëve. Përqindje e lartë e nxënësve që nuk kanë përshkruar asnjë fjalë nga diktimi i fjalëve si dhe nuk ka asnjë nxënës që ka përshkruar saktë diktimin e 36 fjalëve. Poashtu, përqindje e ulët e nxënësve që përshkruajnë saktë diktimin e deri në 29 fjalëve dhe asnjë nxënës që përshkruan diktimi e më shumë se 29 fjalëve.

3.1. Rezultatet e përgjigjeve të mësimdhënësve

Më poshtë shohim rezultatet e pyetësorit të mësimdhënësve ku gjithsej ishin 20 mësimdhënës të klasave të II-ta të III-ta, të IV-ta, dhe të V-ta, ku është realizuar pyetësoi me 20 pyetje, të ndarë sipas kategorive, PO në rastet kur pohojnë lidhur me pyetjen e parashtruar dhe JO kur mohojnë lidhur me pyetjen e parashtruar. Lidhur me pyetjen 1, - *A keni njohuri për vështirësitë në të folur dhe në të shkruar?* Nga 15 mësimdhënës kemi përgjigjen PO ndërsa nga 5 mësimdhënës kemi përgjigjen JO. Pra, janë 5 mësimdhënës që nuk kanë njohuri për vështirësitë e nxënësve në të folur dhe në të shkruar, që do të thotë se këta mësimdhënës kanë vështirësi edhe në trajtimin e këtyre rasteve. Sipas pyetjes 2, - *Gjatë shkollimit tuaj a keni pasur ndonjë lëndë lidhur me këto vështirësi?*- vetëm 5 mësimdhënës janë përgjigjur se kanë pasur lëndë të tilla, ndërsa 15 janë përgjigjur se nuk kanë pasur lëndë lidhur me këto vështirësi gjatë shkollimit. Edhe ky rezultat mund të jetë një tregues që në fakultet tona që përgatisin studentët për mësimdhënës, të ketë në programin e këtyre fakulteteve lëndë që lidhen me vështirësitë e nxënësve në të folur dhe në të shkruar, sepse praktika i ballafaqon të punojnë me nxënës të tillë dhe nuk kanë informata se si të merren me ta. Ndërsa, pyetja 3, - *A ju ka ofruar shkolla ndonjë trajnim për këto vështirësi apo diçka të ngjashme?*- vetëm 7 mësimdhënës kanë dhënë përgjigje se shkolla u ka ofruar trajnime për këto vështirësi, ndërsa 13 mësimdhënësve nuk ju ka ofruar shkolla trajnime të tilla. Duke e parë që vështirësitë e nxënësve në të folur dhe në të shkruar dita ditës po rriten, vet mësimdhënësit, shkollat duhet të kërkojnë nga DKA,

MASHT dhe nga OJQ që merren me trajnime, që të ofrojnë trajnimet e nevojshme për mësimdhënës që t'i përballojnë më lehtë vështirësitë që paraqiten me rastet e tilla në klasë. Sipas pyetjes 4, - *A jeni në gjendje t'i identifikoni vetë nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar?*- vetëm 7 mësimdhënës janë përgjigjur me PO, ndërsa 13 mësimdhënës janë përgjigjur me JO. Pra, kjo tregon që shumica e mësimdhënësve janë përgjigjur se nuk janë në gjendje vet t'i identifikojnë nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar. Bazuar në atë që mësimdhënësit realizuan hulumtimin duke i përdorur testet dhe intervistat e gatshme, mësimdhënësit vet i identifikuan nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar. Kjo tregon se nëse kanë përkrahje për të identifikuar këto raste, ata mund të arrijnë të identifikojnë rastet e nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar në klasat e tyre. Lidhur me pyetjen 5, - *A ju ofron ndihmë stafi profesional i shkollës në identifikimin e nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar?*- vetëm 8 mësimdhënës janë përgjigjur me PO dhe 12 mësimdhënës janë përgjigjur me JO. Bashkëpunëtorët profesional obligohen me Udhëzimin Administrativ 34/2014, Funksionimi i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla, që të ndihmojnë mësimdhënësit (neni 9), nxënësit (neni 10) dhe prindërit (neni 11). Pra, roli i bashkëpunëtorëve profesional në shkollë është që të ndihmojë mësimdhënësit për të identifikuar vështirësitë e nxënësve në të nxënë. Nga pyetja 6, - *A bashkëpunoni me prindër për identifikimin e nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar?*- të gjithë mësimdhënësit janë përgjigjur se bashkëpunojnë me prindërit për identifikimin e nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar. Pra, ky bashkëpunim sigurisht që i ndihmon mësimdhënësit që më lehtë të identifikojnë rastet e këtyre nxënësve. Sipas pyetjes 7, - *Gjatë përvojës suaj si mësimdhënës, a keni hulumtuar apo a jeni interesuar të mësoni më shumë rreth këtyre vështirësive?*- të gjithë mësimdhënësit janë përgjigjur se kanë hulumtuar apo janë interesuar të mësojnë më shumë rreth këtyre vështirësive. Lidhur me pyetjen 8, - *A bashkëpunoni me kolegët tuaj për t'i identifikuar nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar?*- 19 mësimdhënës janë deklaruar me PO, ndërsa vetëm 1 është deklaruar me JO. Bashkëpunimi me kolegët u ndihmon mësimdhënësve të identifikojnë më lehtë nxënësit me vështirësi. Ndërsa pyetja 9, - *Këto vështirësi a shkaktojnë vetëbesim më të ulët tek nxënësi?*- Kemi përgjigje me PO, 15 mësimdhënës dhe me JO, 5 mësimdhënës. Bazuar në literaturë, nxënësit që kanë vështirësi në të folur dhe në të shkruar mund të kenë vetëbesim më të ulët se sa ata që nuk kanë këto vështirësi. Sipas pyetjes 10, - *A ngurrojnë të flasin apo të shkruajnë nxënësit që kanë vështirësi në të folur dhe në të shkruar?*- 18 mësimdhënës janë deklaruar me PO dhe 2 mësimdhënës janë deklaruar me JO. Edhe gjatë realizimit të këtij hulumtimi kemi hasur në nxënësit që kanë vështirësi në të folur dhe në të shkruar, që kanë ngurrar të flasin apo të shkruajnë. Nga pyetja 11, - *Këto vështirësi a ndikojnë në suksesin e këtyre nxënësve?*- poashtu, 19 mësimdhënës përgjigjen me PO, dhe vetëm një mësimdhënës përgjigjet me JO. Kjo përgjigje bazohet në suksesin që kanë këta nxënës në shkollë. Lidhur me pyetjen 12, - *A është e nevojshme të hartohet Plani Individual i Edukimit për këtë kategori nxënësish?*- përsëri, kemi 19 mësimdhënës që kanë deklaruar se është e nevojshme të hartohet plani individual për këta nxënës dhe vetëm 1 mësimdhënës është deklaruar se nuk ka nevojë të hartohet plan individual për këta nxënës. Sipas pyetjes 13, - *A i lejoni nxënësve të tillë më shumë kohë për të përfunduar një test apo ndonjë aktivitet?*- 19 mësimdhënës kanë deklaruar se u lënë më shumë kohë nxënësve të tillë për të përfunduar një test apo ndonjë aktivitet, ndërsa vetëm 1 mësimdhënës është deklaruar me përgjigjen JO. Nga pyetja 14, -

A kanë vështirësi t'i kuptojnë komandat, udhëzimet, pyetjet që bëni ju?- 13 mësimdhënës kanë dhënë përgjigjen PO, dhe 7 mësimdhënës JO, d.m.th. që disa nxënës nuk kanë vështirësi t'i kuptojnë komandat, udhëzimet dhe pyetjet, kjo dëshmohet me rezultatet e intervistës së realizuar në këtë hulumtim kur 64% e nxënësve janë përgjigjur saktë në pyetjet e intervistës. Lidhur me pyetjen 15, - *Shpesh gjatë të folurit apo të shkruarit, a i zëvendësojnë shkronjat?*- 17 mësimdhënës përgjigjen me PO dhe 3 mësimdhënës përgjigjen me JO. Poashtu, kjo është vërejtur edhe gjatë realizimit të këtij hulumtimi kur nxënësit i zëvendësojnë me shkronja të tjera të folurit apo të shkruarit. Ndërsa pyetja 16, - *Dorëshkrimi i nxënësve të tillë, a është i dobët?*- 17 mësimdhënës dhanë përgjigje PO dhe 3 mësimdhënës përgjigje JO. Sipas pyetjes 17, - *A kanë pasur vështirësi ta përvetësojnë leximin nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar?*- të gjithë mësimdhënësit janë deklaruar se kanë pasur vështirësi ta përvetësojnë leximin, nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar. Nga pyetja 18, - *A bëjnë shpesh gabime gjatë shkrimit të fjalive të gjata?*- përsëri të gjithë mësimdhënësit deklarohen PO, për gabimet e këtyre nxënësve gjatë shkrimit të fjalive të gjata. Lidhur me pyetjen 19, - *Gjatë punës suaj me ta, a përdorni ndonjë teknikë apo metodë ndryshe nga nxënësit e tjerë për t'i përmirësuar shkathtësitë e këtyre nxënësve?*- të gjithë mësimdhënësit janë përgjigjur me PO. Ndërsa pyetja 20, - *Tek nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar, a është zvogëluar shkalla e vështirësive nga klasa në klasë?*- kemi 18 përgjigje PO dhe 2 përgjigje JO, dmth. shumica e fëmijëve përparojnë nga klasa në klasë dhe zvogëlohet shkalla e vështirësisë.

3.2. Rezultatet e përgjigjeve të drejtoreshës së shkollës

Bazuar në përgjigjet e marra nga drejtoresha e shkollës, mund të themi se këto të dhëna janë të ngjashme me të dhënat që kemi marrë nga mësimdhënësit. Vlen të diskutohen të dhënat që kanë të bëjnë me pyetjen kryesore të hulumtimit, ***A mendoni se mësimdhënësit në shkollën tuaj janë të përgatitur në atë masë sa të identifikojnë nxënësit më vështirësi të tilla dhe të punojnë me ta?***, përgjigja e drejtoreshës është JO. Poashtu, as drejtoresha nuk ka trajnime të tilla, nuk u ka ofruar mbështetje mësimdhënësve për t'u marrë me raste të tilla, nuk u ka ofruar trajnime mësimdhënësve për t'u marrë me këta nxënës dhe pohon se është e nevojshme të ketë Plan Individual të Edukimit për këta nxënës. Edhe këto përgjigje vërtetojnë hipotezën se mësimdhënësit kanë vështirësi në identifikimi e nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar.

4. KONKLUDIMI

Në këtë temë është hulumtuar identifikimi i nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar, në klasën e II-të, III-të, IV-të dhe V-të, nga mësimdhënësit e tyre, në shkollën „Emin Duraku”, në Shtime. Për të realizuar qëllimin e kësaj teme janë ngritur hipoteza dhe pyetjet e hulumtimit. Hipoteza kryesore e ngritur në këtë hulumtim ishte: *Identifikimi i nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar nga ana e mësimdhënësve klasor nuk është në nivelin e kënaqshëm.* Mund të konkludojmë se mësimdhënësit kishin vështirësi në identifikimin e fëmijëve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar kështu që vërtetohet hipoteza kryesore. Por, kur mësimdhënësit u treguan të gatshëm të përfshihen në këtë hulumtim dhe u pajisën me

testin e përsëritjes së tingujve dhe të fjalëve, intervistën, testin e përshkrimit të tingujve dhe të fjalëve dhe testin e diktimit të tingujve dhe të fjalëve, ata me shumë lehtësi identifikuan nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar. Pra, të gjitha rastet e përfshira në këtë hulumtim që janë 25 nxënës, janë identifikuar nga mësimdhënësit e tyre, për vështirësitë në të folur dhe në të shkruar.

Prandaj, për t'i dhënë përgjigje pyetjes kryesore të këtij hulumtimi - *Sa janë në gjendje mësimdhënësit t'i identifikojnë nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar?* - mund të nxjerrim këtë konkluzion: **Mësimdhënësit kanë nevojë për përkrahje profesionale që të jenë në gjendje vet t'i identifikojnë nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar.** Sa i përket hipotezës ndihmëse: *Mësimdhënësit nuk janë të përgatitur nga shkollimi paraparak për të identifikuar këto probleme te nxënësit*, mësimdhënësit deklaruan se nuk janë përgatitur gjatë studimeve për të identifikuar këto probleme, prandaj edhe hipoteza vërtetohet. Në bazë të hipotezës ndihmëse: *Shkolla nuk ju ka ofruar mësimdhënësve edhe trajnime të tilla*, mund të konkludojmë se mësimdhënësit dhe drejtoresha deklarohen se shkolla nuk ka ofruar trajnime që mësimdhënësit të zhvillohen profesionalisht për t'u marrë me rastet e tilla. Ndërsa, hipoteza ndihmëse: *Niveli i bashkëpunimit në mes shkollës, prindërve dhe mësimdhënësve për të identifikuar nxënësit me vështirësi të tilla nuk është në nivelin e kënaqshëm*, sipas rezultateve mund të konkludojmë se bashkëpunimi i shkollës, prindërve dhe mësimdhënësve është në nivel, por nuk kanë njohuri të mjaftueshme si të merren me këta nxënës, prandaj, derisa nuk arrihet identifikimi me kohë i këtyre rasteve mund të themi se edhe kjo hipotezë qëndron. Sipas këtyre rezultateve mund të themi se nga ky hulumtim kemi marrë përgjigje në pyetjet e hulumtimit dhe janë vërtetuar hipotezat e parashtruara.

5. REKOMANDIME

- 🔊 Të ofrohen programe trajnimi për mësimdhënësit që janë në shërbim, që të merren edhe me nxënësit me vështirësi në të folur dhe në të shkruar.
- 🔊 Fakultetet që përgatisin studentë për mësimdhënësit, të kenë në programet e tyre lëndë që ofrojnë edukimin e nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar, sepse numri i këtyre nxënësve në shkolla është i lartë (25 nxënës vetëm në shkollën ku u realizua hulumtimi).
- 🔊 Të ketë bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesional dhe me menaxhmentin brenda shkollës, që të menaxhohen më lehtë rastet e nxënësve me vështirësi në të folur dhe në të shkruar dhe të punohet profesionalisht për përmirësimin e tyre.
- 🔊 Të ofrohet mundësia që në shkollat tona të ketë logoped, për të identifikuar me kohë nxënësit me vështirësi në të folur dhe të mbështetën mësimdhënësit në punë.
- 🔊 Menaxhmenti i shkollës të vendos në planin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve, trajnimet e domosdoshme për mësimdhënësit.

- ☛ Drejtoritë komunale të Arsimit, të kenë të dhëna për numrin e fëmijëve me vështirësi të tilla dhe të kërkojnë mbështetje, nga të gjithë akterët profesional për të zvogëluar rastet e tilla.

REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE

- Bejtullahu, E. (2007). *Njohuri mbi aftësinë e kufizuar dhe rehabilitimi*. Prishtinë: OPFAKKOS.
- Dhamo, M. (2016). *Çrregullimet dhe terapitë e të folurit*. Tiranë: IDEART.
- Garuli, L. (2018). *Çrregullimet e të nxënit*. Tiranë: Mirgeeralb.
- Gjokutaj, M., Hoti, I., & Kadriu, D. (2016). *Fjalor termash në edukim-shpjegues-krahasues*. Prishtinë: Dukagjini.
- Justice, L. M. (2006). *Communication sciences and disorders: An introduction*. New Jersey: Pearson/ Merill Prentice Hall.
- Kostallari, A., Thomaj, J., Lloshi, Xh., Samara. M., Kola. J., Daka. P., Haxhillazi. P., Shehu. H., Leka. F., Lafe. E., Sima. K., Feka. Th., Keta. B., & Hidi. A. (1981). *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Prishtinë: Rilindja.
- Kulla, F., Remaçka, L., & Ndrio, M. (2014). *Jam mes jush, i ngjashëm, i ndryshëm, i barabartë*. Tiranë: World Vision.
- Tahiri, A. (2015). *Çështje gjuhësore dhe didaktike për mësimin e gjuhës shqipe në shkollë. Punim doktrate*. Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë.
- Woolfolk, A. (2011). *Psikologji edukimi*. Tiranë: CDE.
- Zuna-Deva, A. & bashkautorët. (2009). *Partneriteti shkollë - familje - komunitet - Sfidë vijanoze*. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Rosenblum, S., Weiss, P., & Parush, Sh. (2004). *Handwriting evaluation for developmental dysgraphia*. Reading and writing: An Interdisciplinary Journal 17 (5), 433 – 458. Marrë më 20 Gusht 2019, nga <https://www.researchgate.net>

PERIODIKU FETAR DHE TOLERANCA NDËRFETARE NË KOMBIN SHQIPTAR WINNING PERIODIC AND INTERNATIONAL TOLERANCE IN THE ALBANIAN NATION

Dr. Rexhep Suma

Profesor në Fakultetin e Studimeve Islame – Prishtinë

Abstract

Religious periodicals as a form of spreading the faith and strengthening the national identity were soon adopted by religious institutions. The Islamic Community of Kosovo, the Bishopric and other religious communities began their lives by giving special importance to the press as an efficient element for spreading the values of the faith and knows how to use it effectively. The transformation of religious discourse into a media discourse is realized quite efficiently in the religious press and as an example we have the monthly, religious, cultural and scientific journals "Islamic Wisdom" and "Light". Among the religious magazines published in Kosovo, they were a separate model. It is a communication that simultaneously creates itself as a communication code and the community of users of this code, believing communicators. Seen from this perspective, "Islamic Knowledge" and "Light", etc., constitute a very interesting study model.

The written and electronic religious periodical of these decades in the treated topics was used and has given a consolidated contribution to raising national awareness in maintaining and developing tolerance and strengthening the elements that stop towards disruption in various forms and ways. As their contribution is evident in the internal stability. The approaches were different but the essence or objective was the same.

Keywords: tolerance, identity, religion, periodic, religious community

Abstracti

Periodiku fetar si formë e përhapjes së besimit dhe forcimit të identitetit kombëtar janë përvetësuar shumë shpejt nga institucionet fetare. Bashkësia Islame e Kosovës, Ipeshkvia dhe bashkësitë tjera fetare, e nisën jetën e tyre duke i dhënë një rëndësi të veçantë shtypit si element efikas për përhapjen e vlerave të besimit dhe di ta përdorë atë me efikasitet. Shëndrrimi i diskursit religjioz në një diskurs mediatik realizohet në mënyrë mjaft efikase të shtypi fetar e si shembull kemi revistat mujore, fetare, kulturore e shkencore “Dituria Islame” dhe “Drita”. Mes revistave fetare të botuara në Kosovë ato përbënin një model më vete. Është një komunikim që krijon njëherësh vetveten si kod komunikimi dhe komunitetin e përdoruesve të këtij kodi, komunikuesit besimtarë. Parë nga kjo perspektivë “Dituria Islame” dhe “Drita” etj., përbëjnë një model mjaft interesant studimor.

Periodiku fetar shkruar dhe elektronike e këtyre dekadave në temat e trajtuara përdorej dhe ka dhënë kontribut të konsoliduar në ngritjen e vetëdijes kombëtare në ruajtjen dhe zhvillimin e tolerancës dhe forcimin e elementeve që ndalojnë drejt përçarjes me forma dhe mënyra të ndryshme.

Sikurse kontributi i tyre është evident edhe në stabilitetin e brendshëm. Qasjet ishin të ndryshme por esenca apo objektivi ishte i njëjtë.

Fjalë kyçe: tolerancë, identitet, fe, periodik, bashkësi fetare

Sigurisht që dialogu ndërfaqet në kohën e tanishme është më se i nevojshëm për të mbajtur kombin tonë të unifikuar, të lidhur mes vete dhe vizion të përbashkët. "Globalizmi, ndoshta është edhe arsyeja më kryesore e cila i ka orientuar fetë e ndryshme t'i bashkohen procesit të dialogut. Mirëpo, edhe të zhvillohet takime, konferenca dhe aktivitete të ndryshme të dialogut duhet theksuar fakti se ekziston një numër i konsiderueshëm studiuesish, intelektualësh e klerikësh të cilët e shohin me skepticizëm procesin në fjalë."⁷

Periodiku fetar dhe besimi në përgjithësi kanë luajtur rol në avancimin e proceseve dhe në zhvillimet kombëtare. "Si në të gjithë popujt edhe kombet e tjerë, edhe tek shqiptarët feja e besimi kanë qenë elementë të pandashëm gjatë gjithë historisë së tyre, duke luajtur një rol të rëndësishëm në jetën shoqërore."⁸

Pra, toleranca dhe respekti ndaj tjetrit është element krenarie dhe mburrje e kombit tonë, edhe pse ka pasur presione të vazhdueshme nga elementi i jashtëm që kjo harmoni të përçahet dhe të dobësohet. Periodiku fetar kanë përçuar këtë mesazh ashtu siç është më së miri duke reflektuar mendimin fetar që të forcohet identiteti ynë kombëtar dhe si qenie kombëtare të jemi më të fortë drejt synimeve dhe zhvillimeve krahas kombeve të civilizuarra dhe të përparuarra.

Në hulumtimin që e ka zhvilluar Shoqata e Sociologëve të Kosovës, financuar dhe menaxhuar nga Këshilli Britanik në Kosovë mbi hulumtimin e perceptimit të qytetarëve të Kosovës lidhur me religjionin, në pyetjen drejtuar respondentëve lidhur me mendimit e tyre për tolerancën fetare shekullore ndër shqiptarët në Ballkan, rezultoi se "59% e respondentëve shprehen se kjo është pasuri kombëtare, 14% e tyre mendojnë se është trashëgimi që na e la perandoria osmane, 12% e tyre mendojnë se është vlerë që i nevojitet Evropës, 4% është kulturë fetare që po e ushtron Evropa, 2% është pengesë serioze në proceset integruuese, 2% është begati për kombet tjera dhe 7% nuk e di ose refuzon të përgjigjet".⁹

⁷ Cakaj, Eduart. *Dialogu ndërfaqet, një qasje teorike-praktike dhe realiteti shqiptar*, Ëest Print, Tiranë, 2015, f.119.

⁸ Morina, Qemajl. *Identiteti fetar i shqiptarëve*, Stresimi i identitetit kulturor shqiptar, Zëri ynë, Prishtinë, 2003, f.26.

⁹ Raport mbi hulumtimin e perceptimit të qytetarëve të Kosovës lidhur me religjionin hulumtuar nga Shoqata e Sociologëve të Kosovës që është financuar dhe menaxhuar nga Këshilli Britanik në Kosovë, Prishtinë, 2014, f.39.

“Islami dhe Kristianizmi jetojnë në Shqipëri krah më krah si në asnjë vend tjetër. Për këtë, edhe literatura këtu është zhvilluar në një mënyrë e cila e sjell së bashku shpirtin e Lindjes dhe atë të Perëndimit.”¹⁰

Një ndër komponentët e pazëvendësueshëm të identitetit tonë kombëtar ka qenë edhe mbetet faktori fetar. Këtë fakt e kanë potencuar dhe kokat më të mëdha të kombit, rilindësit tanë, arkitektët e shtetit shqiptar, sikurse është Sami Frashëri, i cili i kushton një rëndësi të posaçme organizimit dhe sistemimit të feve në administratën shtetërore. Ai tregohet tepër i vëmendshëm kundrejt kësaj çështjeje sa që shpreh në mënyrë të detajuar përbërjen, funksionimin, arsimin, lirinë e ushtrimit të aktivitetit të të gjitha feve brenda shtetit shqiptar që ai mendonte.”¹¹

Prandaj, Periodiku fetar, duke promovuar paqe dhe tolerancë tek publiku i gjerë dhe duke ruajtur raportet mes feve në Kosovë, kanë mbetur shembull edhe për besimtarët e thjeshtë. Së këndejmi kjo ka ndikuar që të kemi një klimë bashkëpunimi, tolerance, respekti për tjetrin dhe një bashkëjetesë të frytshme duke respektuar secili të vetën por mbi të gjitha identiteti kombëtar është ai që i unifikon shqiptarët.

“Debati mbi multikulturalizmin më pak lëvizë rreth mospërfilljes së pakicave fetare se sa rreth pikave të diskutueshme si caktimi i festave kombëtare, rregullimi i gjuhëve amtare, nxitja e mësimin në gjuhën amtare për pakicat etnike apo nacionale, rreth rregullimit të kuotës për gratë, për të ngjyrosurit dhe vendasit politikë, në vendin e punës dhe në universitet. Megjithatë, në pikëpamjen e përfshirjes së barabartë të të gjithë qytetarëve, diskriminimi fetar integrohet në radhën e diskriminimit kulturor apo gjuhësor, etnik apo racist, seksual apo trupor.”¹²

Sfida të cilën po e kalon kultura shqiptare në Kosovë është trashëguar nga kriza dhe okupimi klasik i saj nga ana e Serbisë në vitet e nëntëdhjetë të shekullit të kaluar. “Në të vërtetë, kultura shqiptare në Kosovë po bën përpjekje të del nga kolapsi ku qe katandisur nga kulturocidi serb në dhjetë vitet e okupimit, por ky proces është i ngadalësuar nga letargjia që ka injektuar administrata civile ndërkombëtare në tri vitet e para të qeverisjes së vet dhe nga improvizimi i politikave kulturore vendore në këto tri vitet e fundit.”¹³

¹⁰Bartl, Peter. *Milli bağimsızlık hareketleri esnasında arnavutluk müslümanları*, çev. Ali Taner, İstanbul; Bedir Yayınları, 1998, f.220.

¹¹ Frashëri, Sami. *Shqipëria ç'ka qenë ç'është dhe ç'do të bëhet*, Reklama, Tiranë, 2010, f.65-967.

¹² Habermas, Jürgen. *Midis natyralizmit dhe religjionit*, përktheu Arbër Çeliku, Asdreni, Shkup, 2008, f.274.

¹³ Krasniqi, Milazim. *Në çfarë Kosove do të jetojmë*, Zëri ynë, Prishtinë, 2008, f.202.

Raporti i medieve me identitetin kombëtar duhet të jetë i vazhdueshëm dhe të ketë sa më shumë artikuj që vënë në pah dialogun dhe tolerancën ndërfaqetare mes nesh.

Andaj, edhe në botën e globalizuar, vërejmë se elementi fe përbën njërin ndër identitetet më të spikatura të shoqërisë njerëzore. Mu për këtë roli medieve fetare dhe feve në përgjithësi duhet të jetë edhe më i madh në promovimin e paqes dhe dialogut, bashkëpunimit, bashkëjetesës në mesin tonë, sepse rrugëdalje tjetër nuk ka. Jemi komb i vogël në krahasim me kombet e mëdha dhe çdo përçarje apo thyerje do të ndikonte direkt në qenien dhe dobësimin e identitetit tonë kombëtar.

Bazuar në metodat kuantitative (pyetësor) që kam bërë në studimin tim mendoj se mbulimi me pyetësorë këto komuna është bërë në parametra logjike, pra janë 26 komuna të Kosovës me 501 pyetësorë dhe bazuar në numrin e popullsisë kemi paraqitur edhe pyetësorët. Janë përfshirë grupmoshat 18-39 vjeçar, 40-59 dhe 60 e sipër.

Tab. 1 Numri dhe përqindja e pyetësorëve sipas rajoneve

Numri rendor	Rajoni	Numri i pyetësorëve	Përqindja %	Total
1	Prishtina	111	22.155689	22.15568862
2	Mitrovica	70	13.972056	36.12774451
3	Prizreni	70	13.972056	50.0998004
4	Ferizaj	65	12.974052	63.0738523
5	Peja	65	12.974052	76.04790419
6	Gjilani	60	11.976048	88.0239521
7	Gjakova	60	11.976048	100
	Total	501	100	


Këtu do të prezantoj vetëm disa pyetësor nga gjetja e mia në këtë hulumtim

Cilës nga këto elemente identitare i jepni më së shumti përparësi?

Tabela nr.1

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Fesë	104	20.8	20.8	20.8
Kulturës	60	12.0	12.0	32.7
Gjuhës	59	11.8	11.8	44.5
Etnicitetit	114	22.8	22.8	67.3
Shtetësisë	144	28.7	28.7	96.0
Nuk e di / refuzon të përgjigjet	20	4.0	4.0	100.0
Total	501	100.0	100.0	

2. Cilës nga këto elemente identitare i jepni më së shumti përparësi?



2. Cilës nga këto elemente identitare i jepni më së shumti përparësi?

Grafiku 1. Paraqitja e të dhënave për pyetjen nr.1

Komentimi i rezultateve

Bazuar në përgjigjet e pyetjes së dytë, rezulton se 28.74% e respondentëve shprehin bindjen e tyre se shtetësia është elementi identitar më i rëndësishëm në krahasim elementet tjera si etniciteti që renditet i dyti me 22.75%.

Edhe feja nuk mbetet larg nga përgjigjet e respondentëve ku 20.76% e tyre shfaqin opinionin se feja mbetet element shumë i fuqishëm stabil në elementin identitar të popullit tonë dhe në etnopsikologjinë tonë kombëtare. Edhe pse ky element identitar sulmohet nga qarqet politike, të cilat mundohen që elementin fetar ta zhvendosin nga identiteti ynë, respondentët nuk mendojnë kështu, por e shohin si pjesë formuese të identitetit tonë kombëtar.

Kultura dhe gjuha si elemente identitare të kombit tonë marrin 11.98%, gjegjësisht 11.78%. Nga të gjithë respondentët vetëm 3.99% e tyre kanë refuzuar apo nuk dinë apo nuk kanë dashur të japin mendim lidhur me këtë çështje.

Interesant dalin analizat se 31.5% e gjinisë femërore i japin përparësi identitetit të shtetësisë, krahasuar me gjininë mashkullore që ka vetëm 26.6%. Këtu mendoj se femra është ajo e cila ka bartur mbi supet e veta përgjegjësinë mbi shtëpinë dhe fëmijët në momentet më vendimtare kur meshkujt ishin të radhitur në luftëra për çlirimin e vendit dhe një pëlqim i tyre asocion se me identitet shtetëror do të lehtësohet barra e saj dhe shteti më do të marrë përsipër ruajtjen e rendit dhe qetësisë në vend. Në vend të dytë radhitet identiteti etnik, ku 23.8% e meshkujve dhe 21.5% të anketuarve mendojnë se ky identitet ka përparësi ndaj identitetit fetar, i cili radhitet në pozitë të tretë me 21.6%, ndjekur nga kultura dhe gjuha.

Kur jemi tek mosha rezultatet na dalin tejet interesante, ku 30.3% e moshës 40-60 mendojnë se identiteti shtetëror ka përparësi, kurse identiteti fetar pasohet me 26.2%, pasuar nga etniciteti me 23.2%, kultura me 15.3% dhe gjuha me 9.5%. Në këtë pyetje dominon identiteti shtetëror dhe sigurisht që mungesa e këtij identiteti në shoqërinë kosovare i ka rritur vlerat krahas identitetit fetar dhe atij etnik. Ndërsa kjo përparësi identitare e shtetësisë nuk ndryshon as te elementi shkollë, ku 37.4% e respondentëve me arsim të lartë (fakultet e master) mendojnë se identiteti i shtetësisë ka përparësi ndaj identitetit fetar i pëlqyer me 27.3%, kurse 26.2% e respondentëve mendojnë se elementi identitar i etnisë ka përparësi ndaj identitetit të kulturës me 13.1% e kështu me radhë.

Në fakt për të forcuar këto argumente po sjell edhe një hulumtim rreth perceptimit të qytetarëve të Kosovës lidhur me religjionin, zhvilluar nga Shoqata e Sociologëve të Kosovës (SHSK) që është financuar dhe menaxhuar nga Këshilli Britanik në Kosovë, që prof. dr. Fadil Maloku ishte koordinator dhe kryetar i SHSK-së respondentët në përgjigjen e pyetjes cilave i jepni përparësi rezulton se “Rëndësi primare është feja dhe kombi ku në këtë pyetje janë përgjigjur 55% e respondentëve,

pastaj 28% prej tyre theksojnë se është e rëndësishme liria e mendimit, 11% e tyre kryesisht të rinjtë kanë theksuar se për ta është e rëndësishme sporti dhe raportet shoqërore, apo shoqëria ndërsa 5% liria e qarkullimit dhe 1% kanë refuzuar të përgjigjen.”¹⁴

Jo vetëm kaq, por sipas kë këtij raporti del se “78% e respondentëve e konsiderojnë si shumë të rëndësishme përkatësinë fetare, ndërsa 18% deri diku, kurse 3% pak të rëndësishme dhe 1% aspak të rëndësishme”.¹⁵

Në vazhdim sa i përket pyetjes së pyetësorit se Sa pajtoheni që Periodiku fetar, vazhdojnë ta ruajnë raportin tolerant mes dy besimeve fetare (islame e të krishtera) mbi bazën e idesë kombëtare?


Tab. 2. Periodiku fetar dhe ruajtja e raporteve ndërfitare

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Plotësisht pajtohem	184	36.7	36.7	36.7
Pjesërisht pajtohem	157	31.3	31.3	68.1
Nuk pajtohem	76	15.2	15.2	83.2
Fare nuk pajtohem	47	9.4	9.4	92.6
Nuk di/refuzon të përgjigjet	37	7.4	7.4	100.0
Total	501	100.0	100.0	

¹⁴Raport mbi hulumtimin e perceptimit të qytetarëve të Kosovës lidhur me religjionin hulumtuar nga Shoqata e Sociologëve të Kosovës që është financuar dhe menaxhuar nga Këshilli Britanik në Kosovë, Prishtinë, 2014, f.17.

¹⁵ Po aty, f.18.

11. Sa pajtoheni që mediet shqipe me përmbajtje fetare, vazhdojnë ta ruajnë raportin tolerant mes dy besimeve fetare (islame e të krishtera) mbi bazën e idesë kombëtare?



Grafiku 2. Periodiku fetar dhe ruajtja e raporteve ndërfetare

Komentimi i rezultateve

Kombi shqiptar vazhdoi të ruante dhe ta kultivonte me respektin më të madh tolerancën ndërfetare mes komuniteteve në Kosovë.

Sigurisht se edhe rezultatet e analizave vërtetojnë të njëjtën gjë, pasi që edhe Periodiku fetar janë partner të idesë kombëtare dhe kombi duhet të jetë kupola e respektit të shqiptarisë. Zaten feja asnjëherë nuk i përçan pjesëtarët e një kombi, por interpretimet e gabuara të mësimave fetare, apo edhe keqpërdorimi i fesë nga individë prodhon situata të pakëndshme në mesin e kombit tonë.

Por, falë kontributit të medieeve dhe profesionalizmit të tyre është evituar edhe përçarja më e vogël e kombit tonë mbi baza fetare.

Në përgjigjet e respondentëve na del se 36.73% e tyre pajtohen plotësisht mbi këtë çështje, kundrejt 31.34% që pjesërisht pajtohen. Pra, ky rezultat vetëm vërteton edhe elaborimin tim teorik në pjesën mbi tolerancën fetare ndër shqiptar si virtyt dhe xhevahir i kulturës identitare të shqiptarisë.

Nga ana tjetër kemi 15.17% e të anketuarve nuk pajtohen me këtë gjë, kurse 9.38% fare nuk pajtohen, pra që kanë një qëndrim negativ.

Sigurisht kjo rezulton si element që nuk i njohin apo nuk i lexojnë këto medie. Në fund janë 7.39% e të anketuarve që nuk kanë mendim për këtë çështje apo kanë zgjedhur refuzimin e shfaqjes së opinionit të tyre.

Edhe te elementi gjinor na rezulton se 37.0% e të anketuarve femra pajtohen plotësisht, kundrejt 36.5% e meshkujve, pra nuk ka ndonjë ndryshim të theksuar, kurse në variabëlin pjesërisht pajtohem këtu kemi një ndryshim ku 35.5% e meshkujve pajtohen pjesërisht, përballë 26.0% e femrave.

Pjesa tjetër e meshkujve me 13.1% nuk pajtohet, kurse femrat rezultojnë me 17.8%, ndërkaq 11.0% e femrave fare nuk pajtohet kundrejt meshkujve me 8.2%. Në fund të anketuarit të cilët nuk dinë apo refuzojnë të përgjigjen mbi këtë pyetje janë 8.2% e femrave, përballë 6.7% të meshkujve.

Rezyme

Shqiptarët sot janë të lirë dhe më shumë se kurdoherë mund t'i manifestojnë të drejtat e tyre që deri dje shkeleshin e dhunoheshin. Liria kulturore, ekonomike, politike, fetare ofron mundësi të mira që ne edhe më tej ta avancojmë çështjen identitare dhe kulturore shqiptare; të forcohemi edhe më në drejtim të realizimit të dëshirave dhe synimeve kombëtare e shtetërore. Identiteti ynë kombëtar vazhdimisht ndihet i rrezikuar me faktin se kufizohemi me popujt sllavë që historikisht kanë pasur pretendime territoriale dhe kanë ndjekur politika shfarosëse ndaj kombit, kulturës, gjuhës dhe ekzistencës shqiptare. Nga ana tjetër, edhe mohimi i identitetit fetar nga vetë ne ka pasur pasoja serioze për trugun shqiptar dhe kjo praktikë është e gabuar. Është e nevojshme që sa më shpejt të thuhet gjërat ashtu siç janë, pa i tepruar e as pa i cunuar, e gjithkujt t'i jepet e drejta. Ne jemi kombi shqiptar dhe me përqindje absolute islame dhe një pakicë e vogël katolike e fe të tjera. "Dituria Islame" dhe "Drita" në koncept kanë qenë tribunë e mendimit intelektual shqiptar. Në faqet e tyre janë paraqitur artikuj që kanë reflektuar idenë e harmonisë, bashkëjetesës, respektit ndërfetar si dhe ajo që është më kulmorja, interesat dhe çështja kombëtare janë vënë në maje të politikave editoriale dhe janë lidhur ngushtë me identitetin kombëtar, duke u rreshtuar në mur mbrojtës të interesave shqiptare, qoftë brenda trojeve etnike, qoftë kudo në botë ku jetojnë shqiptarët.

FJALËSI GJUHËSOR DHE ESTETIK I VEPRËS LETRARE TË BEQIR MUSLIUT THE LINGUISTIC AND ESTETIC WORDS OF BEQIR MUSLI'S LITERARY WORK

Prof. dr. sc. Begzad Baliu

Universiteti i Prishtinës

Fakulteti i Edukimit

Phd. cann. Faton Krasniqi

Instituti Albanologjik – Prishtinë

Abstract

Having done research in the field of the history of Albanology, we have carefully followed the linguistic values and achievements of some neighboring peoples and beyond for several years. In fact, following the achievements of the national languages of neighboring and European peoples, we have noticed not without concern how much and to what extent they have researched and studied their values in time, direction and certain knowledge. Driven by the experience of other languages, we decided to enter the lexical research in some genres and types of popular literature and some of the richest creators and literary periods in the field of Albanian vocabulary and to create special corpora for them. Beqir Musliu's language of creativity in poetry and prose is rich in many aspects: in the grammatical, lexical, syntactic and stylistic and semantic context. Although collected from three literary genres: poetry, prose and drama, the language of his poetry, the lexical, grammatical, syntactic and even stylistic structure does not differ much either in morphological terms or in syntactic and stylistic terms

Keywords: Lexicon, language, speech, semantics, literature

Abstrakt

Duke bërë kërkime në fushë të historisë së albanologjisë, ka disa vjet që me kujdes i kemi përcjellë edhe vlerat dhe arritjet gjuhësore të disa popuj fqinjë dhe përtej. Në të vërtetë duke përcjellë arritjet e gjuhëve nacionale të popujve fqinjë dhe atyre evropianë, kemi vënë re jo pa shqetësim sesa shumë dhe në çfarë përmasa ata i kanë hulumtuar dhe studiuar vlerat e tyre në kohë, kahe dhe dije të caktuara. Të nxitur prej përvojës së gjuhëve të tjera vendosëm që t'i hyjmë kërkimit leksikor në disa gjini dhe lloje të letërsisë popullore dhe të disa prej krijuesve dhe periudhave letrare më të pasura në fushë të fjalësit të shqipes dhe për to të krijoj korpusë të veçanta. Gjuha e krijimtarisë së Beqir Musliut në poezi dhe në prozë është e pasur në shumë aspekt: në kontekstin gramatikor, leksikor, sintaksor dhe stilistik e semantik. Megjithatë e vjelë nga tri gjini letrare: poezia, proza dhe drama, gjuha e poezisë së tij, struktura leksikore, gramatikore, sintaksore dhe madje stilistike nuk dallon shumë as në planin morfologjik as në rrafshin sintaksor e stilistik.

Fjalët kryesore: Leksik, gjuhë, fjalës, semantikë, letërsi.

Hyrje

Leksikografia është një prej disiplinave gjuhësore e cila është zhvilluar gjerësisht dhe në ato rrjedha, tek disa shkolla nacionale, në të cilat nuk është zhvilluar edhe në gjuhësinë shqiptare. Kërkimet leksikore në letërsinë popullore dhe në letërsinë artistike të disa shkenca nacionale tashmë kanë marrë përmasën e fjalorëve të zgjedhur. Disa dije nacionale tashmë kanë fjalorët e përrallës, të letërsisë popullore, të shkrimtarëve nacionalë, të gjinive dhe llojeve të periudhave të caktuara, ndërkohë që fjalësi i përrallës shqipe, eposit, anekdotës etj., mezi shkon në nivel të një fjalorthi në fund të botimeve edhe ashtu modeste.

Gjatë shekullit XX, studiuesit e historisë së letërsisë dhe të gjuhës shqipe, në veprat e tyre, i kanë kushtuar shumë rëndësi ndihmesës së shkrimtarëve dhënë gjuhës shqipe. Kërkimet e tyre të kësaj natyre ishin rrjedhojë e rilindësve shqiptarë të fund të shekullit XIX, të cilët krijimtarisë së tyre letrare ju dhanë dimensione estetike dhe gjuhësore njëkohësisht. Fjalë, togfjalësha, neologjizma, kompozita etj., gjatë Rilindjes Kombëtare nuk patën krijuar vetëm bardët e mendimit shkencor (Sami Frashëri, Jani Vreto, Konstantin Kristoforidhi, Faik Konica, Aleksandër Xhuvani etj.), po edhe krijuesit letrar (Jeronim de Rada, Naim Frashëri, Ndre Mjeda etj). Le të kujtojmë vetëm faktin se për të gjallë dhe gjatë gjithë shekullit XX Naim Frashëri, më parë se sa Konstantin Kristoforidhi që quajtur babai i gjuhës shqipe.

Kjo traditë ka vazhduar edhe gjatë shekullit XX kur gjuha më nuk ishte vetëm objekt kujtese po edhe objekt studimi e standardizimi nga të gjithë idealistët postrilindas, nga krijuesit dhe nga studiuesit. Nuk është prandaj as e rastit që poetët si, Gjergj Fishta, Aleksandër Stavre Drenova – Asdreni, Fan Noli, Lasgush Poradeci, Millosh Gjergj Nikolla – Migjeni, Ernest Koliqi etj., u shquan për përdorimin e gjuhës popullore, për krijimin e fjalësit shumëkuptimor, për krijimin e neologjizmave dhe trajtave të reja semantike të fjalëve të moçme, për resemantizimin e togfjalëshave dhe frazeologjizmave popullore etj.

Në gjysmën e dytë të shekullit XX kur letërsia shqipe shquhet për forma të reja letrare të shkrimit, krijues të shumtë do të shquhen në mënyrë të veçantë për përdorimin e gjuhës. Në fushë të poezisë kritika letrare dhe përgjithësisht historianët e letërsisë do ta shquajnë poezinë e Martin Camajt, Azem Shkrelit, Enver Gjerçekut, Fatos Arapit, Xhevahir Spahiut etj., prozën e Jakov Xoxës, Ismail Kadaresë, Anton Pashkut, Dritëro Agollit, Jusuf Gërvallës etj., kritikën dhe publicistikën e Rexhep Qosjes, Ramiz Kelmendit etj. Por në këtë rrjedhë na ka rënë rrasa të vëmë re përjashtimin e njërit prej krijuesve më të mirë, si Beqir Musliu, me prirje tejet të veçantë për përdorimin e gjuhës në poezinë, prozën dhe dramën e tij.

Beqir Musliu (Gjilan, 1945 – 1996), i takon brezit të krijuesve të gjysmës së dytë të shekullit XX, kryesisht viteve `60-ta dhe `80-ta, i cili në letrat shqipe paraqitet me poezinë, prozën, dramën dhe kritikën letrare, përkatësisht teatrore. Shkrimtari Beqir Musliu, që në vitet `60-ta paraqitet me krijimet letrare duke botuar në fund të kësaj dekade njërin prej vëllimeve më të mira me poezi “Bukuria e zezë” (1968). Me këtë vepër dhe me veprat që do t’i pasvinë deri në fund të viteve `70 -ta (Rima të shqetësuara“ (1965); “Lulëkuqet e gjakut“ (1966); “Skënderbeu ose shqiponja e maleve“ (1968); “Sezamet“ (1972); “Parabola“ (1976); “Darka e magjisë“ (1978); “Skënderbeu“ (2004) dhe “Orfeiana“ – Shtatë Libra Anatema (2004), Beqir Musliu do të shënojë majat më të larta të poezisë moderne shqipe.

Në vitet `70-ta Beqir Musliu iu bashkohet shkrimtarëve të cilët në mënyrë të veçantë do të merren me krijimtarinë romanore, për të vazhduar edhe në vitet 80, kur krahas romanit shkruante edhe dramën. Kështu, ai gjatë këtyre viteve ka shkruar disa vëllime me tregime dhe romane, por disa nga këto i ka botuar gjatë viteve `70-ta e `80-ta, e pjesën më të madhe në vitet 2000: *Vegullia*“ (1979); *“Mbledhësit e purpurit“* (1982); *“Kori i gjelave të vdekur“* (2002); *“Makthi“* (2004); *“Amullia“* (2004), *“Krupa“* (2004), *“Skërluta“* (2004) dhe *“Ndeshtasha“* (2004). Në jetën letrare dhe kulturore Beqir Musliu do të veçohet në mënyrë të veçantë me shkrimin e dramave, një gjini letrare jo shumë e arrirë në letrat shqipe në Prishtinë dhe në Tiranë. Kjo sigurisht edhe është arsyeja pse veprat e tij dramatike do të botohen në Prishtinë dhe në Shkup.

Dramat e tij do të botohen veç e veç në revistën letrare të Prishtinës *“Jeta e re“* dhe në revistën letrare të Shkupit *“Jehona“*, do të shfaqen në teatrot e këtyre qyteteve dhe do të realizohen edhe në televizionin e atëhershëm të Prishtinës. Ato gjithashtu do të botohen edhe në dy vëllime të përbashkëta: *“Shtrigani i Gjel-Hanit“ – libër-teatër, tetralogji”* (Prishtinë, 1989), brenda të cilit ishin janë përfshirë dramat: *“Unë Halil Garria”* (1989); *“Faustiana”* (1989); *“Ora e Kukuvačkës”* (1989); *“Panairi i Gjilanit”* (1989); si dhe në vëllimin *“Rrakullima“, II (teatër - libër, tetrapтик)* (Shkup, 1990), në të cilin janë përfshirë dramat: *“Murana”* (1990), *“Kori i Korbave”* (1990), *“Familja e Shenjtë”* (1990) dhe *“Antifona”* (1990). Gjatë gjithë kësaj kohe Beqir Musliu është marrë edhe me kritikën letrare dhe sidomos me kritikën teatrore, të cilat në veprën tonë nuk kanë qenë objekt hulumtimi.

Në këtë vëllim objekt i kërkimit gjuhësor në krijimtarinë letrare të Beqir Musliut janë bërë veprat letrare të tij (poezia, proza dhe drama) dhe në këtë mënyrë ka mbetur jashtë kritika letrare, kritika teatrore dhe publicistika. Prandaj nga korpusi e veprës së tij janë bërë kërkime të përzgjedhura disa nga njësitë leksikore dhe semantike të tij, por jo edhe tërësia gjuhësore e pasurisë leksikore të tij.

E parë në tërësinë leksikore, semantike dhe kontekstuale kërkimet në veprat letrare të Beqir Musliut reflektojnë gjuhën e veçantë, madje togfjalëshin i veçantë dhe temën e poezisë së referencë më vete. Qëllimi kryesor i kërkimit leksikor në poezinë e Beqir Musliut ishte përshkrimi i sistemit fjalëformues, semantik e stilistik i leksikut të poezisë, prozës dhe dramës së tij. Në kërkimet tona gjuhësore në leksikon e Beqir Musliut, kishim parasysh tre përbërës themelorë: leksikon dhe strukturën gramatikore të tij, përbërësin semantik dhe atë funksional.

Prej kërkimeve në fushë të fjalëformimit nuk ka qenë vështirë të konstatojmë rrafshet e shumta të modeleve mbi të cilat autori ka krijuar fjalë a kuptime të reja, sikur janë fjalët me ndajshesim dhe kompozitat: *anatemë, antifonë, anipse, animirë, bashibuzuk, buzëmuzg, bjerraditësi, ditëmedrekë, degëmadh, divanhane, djerraditës, dykrenësh, flokëshprishur, fytafyfyt, haggiografi, hamadreqi, homodupleks, hastahane, hashërmeshër, havardallav, hemaglobulinë, honedon, kësobotshme, përbotshme, përvajshmëri, mirakëndëse, kapërfytur, këmbadorës, kësobotshme, kobzeza, kontrapunkt, mozomakeq, kontrapunktim, kthetërshkabë, metapsikozë, mjekërrkaltër, musteqekurleshurivetullverdhtë, njashtu, pakngapak, picigjatë, piczgjatura, qimemurrinja, qoftëlargu, sylynjari, sykapsallituri, shpërvjerrësi, teffjuqinë, theqafje, vetullverdhtë, vetullkerleshuri*¹⁶ etj.

¹⁶ **Antifonë:** Ai është në zërin tënd dhe së bashku me atë tëndin po shpërndërrohet në një *antifonë*. (*Kori i gjelave të vdekur*, 2002: 98); **Bashibuzuk:** Ashtu porsi *bashibuzuk*, merrja rrugë të gjatë. (*Krupa*, 2004: 58); **Buzëmuzg:** Edhe parandjenja që ia solli agun në këtë të perënduar të diellit, *buzëmuzg* që, se hap e mbyll sytë, prej një gjendje e kthente në një tjetër gjendje shpirtërore. (*Makthi*, 2004: 17); **Djerraditës:** Disa të tjerë sigurisht, *djerraditës* thonë në sheshin e kasabës. (*Vegullia*, 1979: 181); **Flokëshprishur:** Ishte duke e shikuar edhe më parë, atë të dehurin *flokëshprishur*. (*Kori i gjelave të vdekur*, 2002: 107); **Kësobotshme:** Mbretëria madheshështore dhe fatkeqe ilire edhe lumturia jonë e *kësobotshme* dhe e botës tjetër. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 131); **Kapërfytur:** Ashtu të *kapërfytur*. (*Familja e shenjtë, në “Rrakullima”*, 1990: 324); **Kontrapunkt:** Si *kontrapunkt* shërben shfaqja e kukudhit dhe e trupës së tij kukudh. (*Shtrigani i Gjel-Hanit*. 1989: 404); **Kthetërshkabë:** Me shputa *kthetërshkabë*. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 224); **Musteqekurleshurivetullverdhtë:** Në shkallën e gjashtë është *musteqekurleshurivetullverdhtë* duke ëndërruar të zbrësë deri në shkallën e shtatë i thashë Shuplakës së Madhe. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 90);

Për shkak se Beqir Musliu ka shkruar në një periudhë të gjatë, madje para dhe pas Konsultës së Prishtinës (1968) dhe Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972), në disa nga veprat e tij shquhen edhe njësi leksikore, togfjalësha dhe madje fjali e frazeologjizma, të formuara brenda atyre strukturave gjuhësore dhe modeleve që përdoren në poezinë e viteve '60-ta, kryesisht të katër vëllimet e para poetike: *Rima të shqetësuar* (1965), *Lulëkuqet e gjakut* (1966), *Skënderbeu ose shqiponja e maleve* - kurorë sonetesh (1968), dhe *Bukuria e zezë* (1968). Këtë të fundit madje autori e botoi edhe dy herë të tjera, por nuk i mënjanoi strukturat gjuhësore të gegnishtes, të clat Konsulta e Prishtinës dhe Kongresi i Drejtshkrimit i la jashtë standardit të shqipes. Ruajtja e këtyre strukturave sigurish nuk do parë vetëm brenda sistemit gjuhësor të gegnishtes, por brenda sistemit gjuhësor të fjalësisit të të folmes së qytetit të Gjilanit me rrethinë dhe modelit madje në përmasa varianti të formimit të tyre, si: *ditëmedrekë, divanhane, fytafyf, hamadreq, honedon*¹⁷ etj.

Po kaq të pasura janë parashtesat fjalëformuese: *akëcilës, andejmi, alkimi, askurrë, ahmarrja, anatemë, antifonë, atmot, atypari, bëzani, çoroditur, çliroj, paevitueshme, pafuqishëm, sakaq, shndritë, shpëla, pabardhuar, papamjeje, përdroth, përskithi, përçudshëm, përditshmërinë, përfytyrimet, preokupon, paartikular, padiktueshëm, paemërtuar, pafuqishëm, paepur, përditshmëri, parandierë, pararendësit, paskajshme, paturpësisht, përdëllesë, përhirë përdor, qëparë, ripërdor, rizbulojnë, rigëllim, rinjohës, rikthehem, rikrijoj, rilindja, ringjallja, ripërtëriva, ritalsfidë, stërqokëve, shpërvjerrëse, tejfuqi*¹⁸ etj. Po të shihet struktura e saj fjalëformuese, përmasa stilistike dhe mesazhi semantik i leksikut nuk është vështirë të shihet se me parashtesë fjalëformuese janë krijime kur e kur fjalët të reja, kuptime të reja dhe janë përtërirë fjalë të leksikut dialektorë duke ju dhënë vargjeve letrare apo teksteve të prozave dhe komunikimit në dramë, mesazh të ri dhe ndjejtë të sforcuar estetike. Parashtesa më prodhimtare në veprat e Beqir Musliut janë këto: për - (78), kundër - (26), para - (26), stër - (25), sipër - (10) z - (23).

Prapashtesat fjalëformuese në veprat e Beqir Musliut janë po kaq të pasura për disa arsye: për- shkak të pasurisë prapashtesore të shqipes, për shkak të ruajtjes dhe përshtatjes së prapashtesave të të folmes qytetare të Gjilanit, për shkak të krijimit të prapashtesave të reja sipas modelit të strukturës gramatikore të shqipes dhe madje për shkak të krijimit të modeleve prapashtesore jashtë modelit të saj: *agullonte, andejmi, atllarë, amnezie, argoshët, afresku, akacie, alkimi, alias, akordohej, akullemt, almiseve, berreve, balsamue, bozhurja, bëzante, bastuni, bredhëritje, brente, baritet, bartolomeut, brimajë, ceromonal, ckoptiur, cokatën, çoroditur, çuditshëm, davariste, doracku, demoniane, dregëza, ëndërrimtare, fildishta, fylltari, falas, fitilaci, liliputaësh muzgëtarja, gabzherrin, gadariste, gërgasim, gustoja, gjarpërori, haxhillëku, harrestarë, hytbeja, kabili, janxhiku, kataklizmat, kërthitje, kanapeja, intermecoja, jermëmi, lemeritshëm, mornicash, ngarendte, ofkëllonte, vajsllëku*¹⁹, etj. Prapashtesat më prodhimtare në veprat e Beqir Musliut janë këto: - tar (219), - shëm

Qimemurrja: Ajo *qimemurrja* me gojë të çaraveshur. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 224);
Vetullkërleshuri: Se si ka marrë trajtë të një *vetullkërleshuri*,. (*Murana*, në “*Rrakullima*, 1990: 52) etj.

¹⁷ **Ditëmedrekë:** Mund ti shohesh yjet *ditëmedrekë*. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 361); **Divanhane:** Rrinte në *divanhane* dhe ashtu shikonte andej nga Kardaku. (*Kori i gjelave të vdekur*, 2002:46); **Fytafyf:** Në atë fushë të shoh tërë ushtrinë se si *fytafyf* lufton. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 106); **Hamadreqi:** Xhyvenja nuk mendoj kur i përzien kapuc me shamë në mal me gjithfarë *hamadreqi*. (*Kori i gjelave të vdekur*, 2002: 27); **Honedon:** Edhe haxhillaku i botës të mos filloj aty ku *honedon* ka filluar. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 18) etj.

¹⁸**Akëcilës:** E *askëcilës* fytyrë, le të mos jetë e fytyrës sime. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 122); **Papamjeje:** Pos asaj *papamjeje* që e kisha vizavi vetes, atë imazh, edhe pse ashtu të ngushtë. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 29); **Përçudshëm:** Ç'flet ashtu *përçudshëm*. (*Familja e shenjtë, në “Rrakullima”, 1990: 328*); **Përdëllesë:** Ai zog i mallkuar të vdiq në shuplakë nga *përdëllesë*, imzot. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 15); **Rigëllim:** Mendon se kjo mund të jetë *rigëllim* shiu i portës triumfale të Orleumit. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 151); **Stërqokëve:** Në dritare e shoh një zog: e diktova përmes *Stërqokeve* që rrahën në xham: dhe asgjë tjetër. (*Krupa*, 2004: 74); **Shpërvjerrëse:** Ndoshta ky kopsht më ka pritur mua, apo krejt kjo mund të jetë një *shpërvjerrëse* që zbret e ngritet para meje, sa që unë, nuk arrij të hyj në të gjitha fshehtësitë e mundshme prej të cilave varet krejt kjo udhë. (*Ndeshtrasha*, 2004: 88) etj.

¹⁹**Agullonte:** Ai ferku i parë i mëngjesit kishte zënë të *agullonte*. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 385); **Atllarë:** Nëntë konaqe i bëra në nëntë *atllarë*, udhën fjollë erdha tjua kërkojë. (*Shtrigani i Gjel-Hanit*, 1989:

(159), - tor, - esë (134). (101), - je (62). Prapashtesa me prejardhje orientale – llëk në veprat e Beqir Musliut është e pranishme në 31 raste.

Përveç me fjalë të strukturës leksiko-semantike, vepra letrare e Beqir Musliut është e pasur edhe me fjalë të strukturave gramatikore, si ndajfoljet: *Ahere, andejmi, aqsa, askurrë, assesi, Atëbotë, Atmot, Atypari* etj²⁰. Po kaq i pasur është edhe fjalësi i mbiemrave, si: *atërore, lemeritshëm, sodisë* etj²¹. Nuk mungon as leksiku me burim a me etimologji të huaj, kryesisht orientale, si: *suhari, sureja, syreti, syrgjyn, shadërvan*²², po edhe nga gjuhë të tjera, si italishtja: *stampohen* etj²³.

Karakteristikë e leksiku të tij, sikur edhe e disa prej bashkëkohësve të tij është leksiku i funksionalizuar nga trajtat dialektore të shqipes, me theks të veçantë të folmen qytetare të Gjilanit: *anipse, animirë, ditëmedrekë, divanhane, fytafyf,*

55); **Argoshët**: Jo vetëm gjuhën, po tërë trupin ma mbulonin *argoshët*. (Krupa, 2004: 30); **Alkimia**: Për këtë kërkohet një *alkimi* tjetër për të hyrë në të. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 43); Seanca e Dytë e *Alkimiisë*. (*Shtrigani i Gjell-Hanit*, 1989: 165); Seanca e Parë e Orës së *Alkimiisë*. (*Shtrigani i Gjell-Hanit*, 1989: 7); *Alkimia* në qoftë se do të njihesh me mua ... (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 157); **Akullemt**: *Ih sa jam i akullemt*. (Murana, në “*Rrakullima*”, 1990: 104); **Almiseve**: Nxorri një kuti prej *almiseve* të veta intime, nxori pasqyrën prej asaj kutie të argjendë, filloi të shikohet në pasqyrë, u çmerit, klithi me sa zë që kishte, vallë e kujt është kjo fytyrë këtu, përnjëherë nuk iu përgjiejg askush, valët buçitën. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 138); **Balsamu**: Legjenda u *balsamue* atbotë mbi Krujë! (*Skënderbeu*, 1968: 20); **Bozhurja**: *Të është vizatuar bozhurja në trajtën e flisë sate të shenjtë*. (Murana, në “*Rrakullima*”, 1990: 97); **Bredhëritje**: E mundonin këto *bredhëritje*, por kur ishte punë detyrore e të shoqit Herman Filerit, reporter i një gazete gjermane. (*Skërluta*, 2004: 18); **Baritet**: ta shikoj prapë prej saj rojtarin tek *baritet* rreth portës dhe ta lexoj edhe njëherë shpalljen e vogël me germa të mëdha: (Krupa, 2004: 69); **Bartolomeut**: Nata e *Bartolomeut*. (*Parabola*, 1976: 31); **Brimajë**: Kjo ishte bukur moti dhe kësaj i kujtohej si në ndonjë *brimajë* Fatimes. (*Kori i gjelave të vdekur*, 2002: 23); **Davariste**: Sa nuk mund t’ia *davariste* kurrsesi atë shqetësim. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 398); **Dregëza**: Na shndrohën *dregëza* dhembjesh. (*Darka e Magjisë*, 1978: 23); **Muzgëtarja**: *Vetëm priste që të bjerë Muzgëtarja gjilanase dhe çdo gjë t’ia nënshtrijë pastaj hirit të shenjtë të shpërndërrimit*. (Kori i *Korbave*, në “*Rrakullima*”, 1990: 166); **Gabzherrin**: Do t’ia presh *gabzherrin*. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 246); **Mornicash**: Një dridhje *mornicash* ia përshkroi tërë trupin. (*Kori i gjelave të vdekur*, 2002: 114); **Ofkëllonte**: *Ofkëllonte* ngapak pastaj zgjohej ngadalë. (*Kori i gjelave të vdekur*, 2002: 85).

²⁰ **Ahere**: Nvitrina mund t’i bleni zemrat thanë *ahere*. (Nata e *Bartolomeut*, 1976: 35); **Andejmi**: Njerëzit e zij ia vinin flakën qdo pëllëme te tokes, kishin ardhur dikah nga veriu se *andejmi* edhe u dukën duke u vërsulur. (*Makthi*, 2004: 37); **Aqsa**: Nuk ka rëndësi dalja *aqsa* hyrja. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 75); **Askurrë**: Këtë nuk mundet ta mohojë *askurrë*... (*Skërluta*, 2004: 89); **Assesi**: Që *asesi* nuk mund ta dallonte në ishte vel a jo. (*Kori i gjelave të vdekur*, 2002: 113); **Atëbotë**: Dhe *atëbotë* derisa ky bisedonte me kamarierin gruaja u zgjua dhe ngriti kokën nga tavolina. (*Kori i gjelave të vdekur*, 2002: 122); Livadhi *atëbotë* çeli lulen e vjedhun në ngjyrë (*Skënderbeu*, 1968: 57); Si të ec *atëbotë*. (Murana, në “*Rrakullima*”, 1990: 60); **Atmot**: Të dy muratorët *atmot* u pikëlluan. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 377); **Atypari**: Po *atypari* diku ishte edhe varri i Habilit. (Murana, në “*Rrakullima*”, 1990: 62) etj.

²¹ **Atërore**: Prita që të më përkëdhelte ngrohtësisht, në atë mënyrën *atërore*. (*Ndeshrasha*, 2004: 177); **Lemeritshëm**: E kur e n’zirrte nëpër gishta i mbetej nje lëmashk i *lemeritshëm*: (*Makthi*, 2004: 20); **Sodisë**: Do të *sodisë* nëpër dritare. Dhe asgjë tjetër. E po qe se ky njeri i çuditshëm është im atë, atëherë çfarë do të thotë ai. (*Ndeshrasha*, 2004: 28) etj.

²² **Suhari**: Nëpër zemrën e tij tash kaluronte një *suhari* e tërë. (*Kori i gjelave të vdekur*, 2002: 130); **Sure**: Këndova edhe një *sure* nga Kurani i Ndershëm. (*Vegullia*, 1979, 5); **Syreti**: Sheh Islamit e pashë në këmishë e tëlina duke shfaqur shpirtin tim në *syretin* e tij, imzot. (*Mbledhësit e Purpurit*, 1982: 177); **Syrgjyn**: Mos vallë kjo ushtri mbretërore do të na marrë *syrgjyn* dhe do të na çojë në shkretëtirat e Arabisë. (*Vegullia*, 1979: 186); **Shadërvan**: Mu aty afër Hamamit dhe Gaz-Hanës do të ndërtohet një *Shadërvan* i ri për shpirt të njëfar hallës Sofi. (*Vegullia*, 1979: 181) etj.

²³ **Stampohen**: “Obobo, ç’janë të gjitha këto Ndeshrasha që vijnë njëra mbas tjetrës sikur unë të jem guri i parë ku duhet të *stampohen* të gjitha të papriturat e jetës! (*Ndeshrasha*, 2004: 148) etj.

*hamadreqi, honedon, këmbadorës, këtupari, mozomakeq, picigjatë, qoftëlargu, syzi, theqafje, thashetheme, zhdërvjellë, bëzani, çoroditur, brimajë, ckopiur, cokatin, çoroditur, fitilaçi, gabzherrin, haxhillëk, hytbeja, kabilit, janxhiku, jermi*²⁴, etj., po edhe frazeologjizmat: *qoftëlargu, hukubet, hundëthi*²⁵, pa përjashtuar këtu edhe togefjalëshat dhe frazeologjizmat, të cilat nuk përjashtojnë edhe të folmet e tjera të krahinave etnografike a qyteteve përreth.

Po t'i bëhet një prerje korpusit të përgjithshëm jo vetëm leksikut po edhe onomastikonit të krijimtarisë letrare të Beqir Musliut nuk është vështirë të krijojmë një hartë të gjerë përmbajtësore, tematike dhe kulturore të hapësirës shqiptare, brenda të cilave autori krijon pamje të gjera të urbanizimit tradicional (*Koleseumi Dardan, Amfiteatri i Gllamës*)²⁶, urbanizimit ballkanik (*Sahat Kulla*)²⁷ dhe urbanizimit oriental (*Sarajet e Gjinollve, Iblis Keqa, Portat e Halepit, Elvan Jusufit*)²⁸ etj.; etnonimin (*Arbëria*)²⁹; antroponiminë e patroniminë (*Abdurrahmani, Abuzemzemi, Abdyyrahimi, Atif Pasha, Hermani, Aleksandri, Hill Kodra, Rexhim Lemazi, Cam Vuthaj, Lam Terzijajn, Qazë Musajn, Cam Vuthajn, Lush Mullajn, Dush Ukajn, Malen e Hugut të Thatë, Litë Zajn, Lilën, Josif Shurdhani Fazoja Shkumbini, Mejremes, poeti Sadek Hedajati, Iblis Keqa*³⁰ etj.) dhe antroponiminë mitike (*Ademi, Molla Afërditës, Nata e Bartolomeut, Elvan Jusufit, Buda*³¹ etj.).

²⁴**Animirë:** *Animirë*. (*Murana, në "Rrakullima", 1990: 77*); **Hamadreqi:** Xhyvenja nuk mendoi kur i përzien kapuc me shami në mal me gjithfarë *hamadreqi*. (*Kori i gjelave të vdekur, 2002: 27*); **Mozomakeq:** Do të kalbet në shtrat, do të trishtojë gra e fëmijë, *mozomakeq*. (*Kori i gjelave të vdekur, 2002: 92*); **Picigjate:** Çka po bëhet me gishtërinjtë e dorës sime, asgjë më tha një hije *picigjate*. (*Mbledhësit e Purpurit, 1982: 341*); **Qoftëlargu:** Kemi shkuar në sofrën e *qoftëlargut*. (*Shtrigani i Gjel-Hanit, 1989: 530*); **Theqafje:** Çdo mësim i tij do tju shpjerë në *theqafje*. (*Mbledhësit e Purpurit, 1982: 482*); **Fitilaçi:** Fitilaçi i lodhur drithëron n'hapetesi si n'shpirit, ndërsa nëpër të njëjtën derë hyjnë.... (*Princesha Dardan, 1976: 64*); **Janxhik:** Mori një *janxhik* me vete. (*Kori i gjelave të vdekur, 2002: 91*) etj.

²⁵**Shih, Qoftëlargu:** Kemi shkuar në sofrën e *qoftëlargut*. (*Shtrigani i Gjel-Hanit, 1989: 530*); **Hukubet:** Me vete sillte nga një gjel *hukubet*. (*Kori i gjelave të vdekur, 2002: 85*); **Hundëthi:** Nuk linte asnjë vrimë pa parë, se vetëm ashtu ai *hundëthi* i marrë donte ta larë hundën nëpër atë të nuhatur. (*Mbledhësit e Purpurit, 1982: 271*) etj.

²⁶**Koleseumi Dardan:** Nje roberi me lidhet perreth qafa magji, derisa perbirohet neper *koleseumin dardan*. (*Princesha dardana, 1976: 69*); **Amfiteatri i Gllamës:** *Prej ku ti prapë më sfidove dhe më hudhe në këtë Amfiteatër të Gllamës*. (*Kori i Korbave, në "Rrakullima", 1990: 147*) etj.

²⁷**Sahat Kulla:** Do të mësyjë edhe në këto anë dhe do ta rrafshojë *Sahat- Kullën* në qendër të kasabës së Gjilanit dhe se për këtë shkak do të shëmtojë tërë vilajetin e Kosovës. (*Vegullia, 1979: 181*);

²⁸**Sarajin e Gjinollëve:** Tash je në Palestinë në *Sarajin e Gjinollëve*. (*Fshehtësia e teatrit –libër, në "Rrakullima", 1990: 18*); **Iblis Keqa:** Por përpara syve të mi në pasqyrën që e kisha kundruall pashë fytyrën e çoroditur të *Iblis Keqes*. (*Fshehtësia e teatrit – libër, në "Rrakullima", 1990: 19*); **Portat e Halepit:** Ta rropa lëkurën, mund t'i kapërcesh Dymbëdhjtë *Portat e Halepit*. (*Shtrigani i Gjel-Hanit, 1989: 468*); **Elvan Jusufi:** Në Gazi-Mestan zhvillojmë ringjalljen e Dytë të Kurmit të Issait dhe të dehemi pastaj në Dafrungën e *Elvan Jusufit* të marrë. (*Shtrigani i Gjel-Hanit, 1989: 252*) etj.

²⁹**Arbëria:** Asht i tokës sonë *Arbëri!*, (*Skënderbeu, 1968: 13*); **Arbri:** Të madhëruara me kohën e *Arbrit* mbetën historitë. (*Libri i Anatemave, 1989: 129*).

³⁰**Abdurrahmani:** Këndon *Abdurrahmani* fqiu i dytë në lebetim. (*Vegullia, 1979: 19*); **Abuzemzemi:** Tash nëpër mua qarkullon ai uji i *Abuzemzemit*. (*Vegullia, 1979: 23*); **Abdyyrahimi:** Në sy më ra së pari Hafiz-Imami, pastaj Dulani, *Abdyyrahimi*, Davudi, Kurt-*Alia* kishte ardhur dhe në sytë e tij hetova një lëngat të thellë sytë i kishin hyrë thellë në gropa dhe një lodhje të hatashme ia vëreja në sytë e tij. (*Vegullia, 1979: 80*); **Atif Pasha:** Sundimtari i Selanikut njëfarë *Atif pasha* kishte dhënë urdhër që të rrënohet kasaba e Gjilanit. (*Vegullia, 1979: 187*);

³¹**Ademi:** Gishtërinjtë do të dëshmojnë në vend teje për atë që kanë nënshkruar dhe për atë që kanë dashur të përkohjnë në kopështin e mëkatit të *Ademit*. (*Vegullia, 1979: 97*); Me që *Ademi* ra të flejë në ëndrën e parë të Haxhiut të Parë. (*Murana, në "Rrakullima", 1990: 40*); **Molla e Afërditës:** N'kokat e atyre që mbetën n'Mollën e *Afërditës*. (*Parabola, 1976: 45*); **Bartolomeu:** Nata e *Bartolomeut*. (*Parabola, 1976: 31*); **Elvan Jusufi:** Në

Vepra e tij letrare është po kaq e pasur edhe me toponime: *Arbëria, Kosova, Palestina, Gjilani, Parisi, Bombaj, Letnica*³² etj; mikrotoponime të kësaj hapësire: *Gllama e Gjilanit, Guri i Zi, Mëhallë të Balecit, Guri i Megjes, Oda e Rexhës, Portat e Halepit*, trajta sllave e mikrotoponimit *Sahat Kulla, Te lisi, Teqen e Hamdishehëve, Ura e Siratit*³³ etj.; mikrotoponime autoriale e krijuar brenda realizimeve tematike të temave letrare: *Amfiteatri i Gllamës, Biblioteka e Sarajit të Gjinollëve, Koleseumi Dardan, Pallati i Gjikaljve, Saraji i Gjinollëve*³⁴ etj.; mikrotoponimia mitike: *Gasi-Mestani, Fusha e Përhime, Fushë Kosovë, Mali i Ullinjve*³⁵ etj.

Gazi-Mestan zhvillojmë ringjalljen e Dytë të Kurmit të Issait dhe të dehemi pastaj në Dafrungën e *Elvan Jusufit* të marrë. (*Shtrigani i Gjel-Hanit*, 1989: 252); **Buda**: Tokën nën gishta si ai Kau i Zi i *Budës*. (*Parabola*, 1976: 49) etj.

³²**Kosova**: Në *Kosovë* krejt çfarë mbeti dashuri jemi Na. (*Parabola*, 1976: 45); Këtu ku kafkat këndojnë prapë mbi *Kosovën*. (*Libri i Anatemave*, 1989: 235); Bozhuret emër i dhanë kësaj fushe e *Kosovës*. (*Parabola*, 1976: 15); O që t'mund t'vdes nën qiellin azur të *Kosovës*. (*Parabola*, 1976: 51); **Palestina**: Zbrit pak më poshtë, tash je në *Palestinë* në Sarajin e Gjinollëve në Gjilan. (*Fshehtësia e teatrit – libër*, në “Rrakullima”, 1990: 18); **Gjilani**: Tri ditë më parë e bleve Hijen e Iblis Keçes në *Shitoren e Hijeve* në Gjilan. (*Murana*, në “Rrakullima”, 1990: 40); **Parisi**: Unë jam *Sadek Hedajati*, kam ardhur në Gjilan nga udha Bombaj-Paris dhe ktheva pak këtu të marr pjesë në Varieteun e Shtriganit të Gjel-Hanit. (*Shtrigani i Gjel-Hanit*. 1989: 431); **Bombaji**: Unë jam *Sadek Hedajati*, kam ardhur në Gjilan nga udha Bombaj-Paris dhe ktheva pak këtu të marr pjesë në Varieteun e Shtriganit të Gjel-Hanit. (*Shtrigani i Gjel-Hanit*. 1989: 431); **Letnica**: Obobo, mos më ke marrë gabimisht, ajo që mendon ti qëndron në kishën e *Letincës*, kam qenë disa herë atje, jam përbiruar nëpër kopshtin e fishkuar të Shën Mërisë ku më shpiente mamaja ime për të më shëruar nga pagjumësia. (*Ndeshtrasha*, 2004: 146) etj.

³³**Gllamën e Gjilanit**: Në *Gllamën e Gjilanit* të ka përgatitur edhe ca viktima. (*Shtrigani i Gjel-Hanit*, 1989: 5); *Shtrigani i Gjel-Hanit* në Tendën e Tij purpuronte në *Gllamën e Gjilanit*. (*EX Libris*, në “Rrakullima”, 1990: 11); **Guri i Zi**: *Atje ku na pret Guri i Zi dhe shkëlqimi i profecisë së shenjtë*. (*Murana*, në “Rrakullima”, 1990: 114); **Mëhallë të Balecit**: Pas tri javëve i gjetëm në *mëhallë të Balecit* dhe i sollëm në shtëpi. (*Kori i gjelave të vdekur*, 2002: 90); **Gurin e megjes**: *Duhet t'iu shpërndërrohëm në kipsin e tij dhe t'ia vëj Gurin e megjes*. (*Kori i Korbave*, në “Rrakullima”, 1990: 224); **Oda e Rexhës**: *Te Oda e Rexhës është nëna ku në atë dhomë mezi shihen fytyrat e tyre të shqetësuar*. (*Shtrigani i Gjel-Hanit*, 1989: 292); **Portat e Halepit**: *Ta rropa lëkurën, mund t'i kapërcesh Dymbëdhjet Portat e Halepit*. (*Shtrigani i Gjel-Hanit*. 1989: 468); **Sahat Kulla**: *Do të mësyjë edhe në këto anë dhe do ta rrafshojë Sahat- Kullën në qendër të kasabës së Gjilanit dhe se për këtë shkak do të shëmtojë tërë vilajetin e Kosovës*. (*Vegullia*, 1979: 181); **Te lisi**: *Po këtu te lisi i trashë*. (*Murana*, në “Rrakullima”, 1990: 43); **Teqen e Hamdishehëve**: *Ta ndeza edhe një qiri në Teqen e Hamdishehëve*. (*Kori i Korbave*, në “Rrakullima”, 1990: 196); **Urës së Siratit**: *Anën e kundërt të Urës së Siratit dhe të ferrit*. (*Kori i gjelave të vdekur*, 2002: 137) etj.

³⁴**Amfiteatri i Gllamës**: *Prej ku ti prapë më sfidove dhe më hudhe në këtë Amfiteatër të Gllamës*. (*Kori i Korbave*, në “Rrakullima”, 1990: 147); **Bibliotekën e Sarajit të Gjinollëve**: *Kërkoja nga Ai që të shfletonte nëpër Bibliotekën e Sarajit të Gjinollëve*. (*Fshehtësia e teatrit – libër*, në “Rrakullima”, 1990: 19); **Koleseumi dardan**: *Një robëri me lidhet përreth qafa magji, derisa përbirohet nëpër Koleseumin dardan*. (*Princesha dardana*, 1976: 69); **Pallati i Gjikaljve**: *Duhet që të shkosh me të në Pallatin e Gjikaljve që të merrni pjesë në Orën e Alkimisë*. (*Shtrigani i Gjel-Hanit*, 1989: 170); *Po ai mbeti në Pallatin e Gjikaljve në Bukuresht duke shfaqur Salomën*. (*Shtrigani i Gjel-Hanit*, 1989: 248); **Sarajin e Gjinollëve**: *Tash je në Palestinë në Sarajin e Gjinollëve*. (*Fshehtësia e teatrit – libër*, në “Rrakullima”, 1990: 18) etj.

³⁵**Gasi-Mestan**: *Edhe unë po tërhiqem, veç mu ftohë darka e fshehtë në Gasi-Mestan e do të më hidhërohen në Tyrben e Sulltanit*. (*Shtrigani i Gjel-Hanit*, 1989: 257); **Fusha e përhime**: *Fusha e përhime mrizon në syrin tim*. (*Karta e magjis*, 1976:15); **Fushë Kosovë**: *Mund të ëndërrojë se jam në Fushë Kosovë duke pirë çaj me sulltan Muratin e gjorë*. (*Shtrigani i Gjel-Hanit*, 1989: 257); **Mali i Ullinjve**: *Mali i Ullinjve është larg, ç'të bëjmë maestro?* (*Shtrigani i Gjel-Hanit*, 1989: 266) etj.

Në këtë rrjedhë ndryshe nga shumë autorë që leksikon e njërit dialekt a të dialektit tjetër e përdorin thjesht për pasurimin leksikor të veprës së tyre, Beqir Musliu karakteristikat e këtij leksiku i funksionalizon në përmasa jo vetëm të ngjyresave stilistike po edhe me përplotësimin kontekstual dhe të temës.

Leksiku dialektor dhe sidomos frazeologjizmat janë pjesë e strukturës së poezisë, ndërsa fjalësi dhe togfjalësi oriental dhe personazhet e proveniencës orientale janë kryesisht pjesë e prozës dhe e dramave të tij. Prandaj mund të themi se Beqir Musliu është kujdesur shumë që fjalësin e shqipes, rikrijimet të dalin nga ndërtimet gjuhësore të tij, togfjalëshat dhe frazeologjizmat e shqipes, si dhe prejardhjen orientale të tyre, etj., t'iu jap natyrën e shqipes me të gjitha dimensionet gramatikore dhe semantike të saj.

Pra, prej kërkimeve tona kemi mundur të konstatojmë rrafshet e shumta të modeleve mbi të cilat autori ka krijuar fjalë të reja, sikur janë: parashtesat dhe prapashtesat, në njërën anë dhe fjalëformat e kompozitat në anën tjetër; leksiku i funksionalizuar nga trajtat dialektore të shqipes, me theks të veçantë të folmeve qytetare të Gjilanit, dukë përfshirë këtu togfjalëshat dhe frazeologjizmat.

Në këtë mënyrë ne vërejmë një prirje të tij, që bashkë me poetin dhe prozatorin Musa Ramadani të bëhen përfaqësues të stilit gjuhësor dhe sistemit kontekstual dhe tematik të qytetit të Gjilanit, në atë përmasë që disa nga poetët dhe prozatorët, bashkëkohës të tyre, Azem Shkreli, Din Mehmeti, Rahman Dedaj ishin bërë frymë shpirtërore, me stilin gjuhësor dhe të menduarit, mbështetur në konceptet e qyteteve a krahinave etnografike të tyre: krahinës etnografike të Rugovës, Rrafshit të Dukagjinit, krahinës etnografike të Llapit etj.

Përfundim

Leksiku dialektor dhe sidomos frazeologjizmat janë pjesë e strukturës së poezisë, ndërsa fjalësi dhe togfjalësi oriental dhe personazhet e proveniencës orientale janë kryesisht pjesë e prozës dhe e dramave të tij. Prandaj mund të themi se Beqir Musliu është kujdesur shumë që fjalësin e shqipes, rikrijimet të dalin nga ndërtimet gjuhësore të tij, togfjalëshat dhe frazeologjizmat e shqipes, si dhe prejardhjen orientale të tyre, etj., t'iu jap natyrën e shqipes me të gjitha dimensionet gramatikore dhe semantike të saj.

Pra, prej kërkimeve tona kemi mundur të konstatojmë rrafshet e shumta të modeleve mbi të cilat autori ka krijuar fjalë të reja, sikur janë: parashtesat dhe prapashtesat, në njërën anë dhe fjalëformat e kompozitat në anën tjetër; leksiku i funksionalizuar nga trajtat dialektore të shqipes, me theks të veçantë të folmeve qytetare të Gjilanit, dukë përfshirë këtu togfjalëshat dhe frazeologjizmat.

Në këtë mënyrë ne vërejmë një prirje të tij, që bashkë me poetin dhe prozatorin Musa Ramadani të bëhen përfaqësues të stilit gjuhësor dhe sistemit kontekstual dhe tematik të qytetit të Gjilanit, në atë përmasë që disa nga poetët dhe prozatorët, bashkëkohës të tyre, Azem Shkreli, Din Mehmeti, Rahman Dedaj ishin bërë frymë shpirtërore, me stilin gjuhësor dhe të menduarit, mbështetur në konceptet e qyteteve a krahinave etnografike të tyre: krahinës etnografike të Rugovës, Rrafshit të Dukagjinit, krahinës etnografike të Llapit etj.

BIBLIOGRAFIA

- *Rima të shqetësuara*, “Jeta e re“, Prishtinë, 1965.
- *Lulëkuqet e gjakut*, “Rilindja“, Prishtinë, 1966.
- *Skënderbeu ose shqiponja e maleve* - kurorë sonetesh, “Jeta e re“, Prishtinë, 1968.
- *Bukuria e zezë*, “Rilindja“, Prishtinë, 1968.
- *Sezamet*, “Rilindja“, Prishtinë, 1972.
- *Parabola*, “Rilindja“, Prishtinë, 1976.
- *Darka e magjisë*, “Rilindja“, Prishtinë, 1978.
- *Vegullia*, “Rilindja“, Prishtinë, 1979.
- *Mbledhësit e purpurit*, “Rilindja“, Prishtinë, 1982.
- *Kori i gjelave të vdekur*, “Dukagjini“, Pejë, 2002.
- *Makthi*, “Faik Konica“, Prishtinë, 2004.
- *Amullia*, “Faik Konica“, Prishtinë, 2004.
- *Krupa*, “Faik Konica“, Prishtinë, 2004.
- *Skërluta*, “Faik Konica“, Prishtinë, 2004.
- *Ndeshtrasha*, “Faik Konica“, Prishtinë, 2004.
- *Skënderbeu*, “Faik Konica“, Prishtinë, 2004.
- *Orfeiana – Shtatë Libra Anatema*, “Faik Konica“, Prishtinë, 2004.
- *Shtrigani i Gjel-Hanit“ – libër-teatër, tetralogji*, “Rilindja“, Prishtinë, 1989.
- *Unë Halil Garria*, në vëllimin “Shtrigani i Gjel-Hanit“ – libër-teatër, tetralogji (“Rilindja“, Prishtinë, 1989).
- *Faustiana*, në vëllimin “Shtrigani i Gjel-Hanit“ – libër-teatër, tetralogji (“Rilindja“, Prishtinë, 1989).
- *Ora e Kukuvačkës*, në vëllimin “Shtrigani i Gjel-Hanit“ – libër-teatër, tetralogji (“Rilindja“, Prishtinë, 1989).
- *Panari i Gjilanit*, në vëllimin “Shtrigani i Gjel-Hanit“ – libër-teatër, tetralogji (“Rilindja“, Prishtinë, 1989).
- *Rrakullima II– teatër-libër, tetrapitik*, “Flaka e vëllazërimit“, Shkup, (1990).
- *Murana*, në vëllimin “Rrakullima“ II– teatër-libër, tetrapitik (“Flaka e vëllazërimit“, Shkup, 1990).
- *Kori i Korbave*, në vëllimin “Rrakullima“ II– teatër-libër, tetrapitik (“Flaka e vëllazërimit“, Shkup, 1990).
- *Familja e Shenjtë*, në vëllimin “Rrakullima“ II– teatër-libër, tetrapitik (“Flaka e vëllazërimit“, Shkup, 1990).
- *Antifona*, në vëllimin “Rrakullima“ II– teatër-libër, tetrapitik (“Flaka e vëllazërimit“, Shkup, 1990).

FORTIFIKIMI I QAFË THANËS

Fortification of Qafe Thana

Ervin Kujtila

Doktorant: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti Arkeologjik, Tiranë.

Abstract

In Albania, prehistoric fortified settlements have been known since the Bronze Age, starting from the north to the south. The Shkumbin Valley is an area that has been inhabited since early times. During the years of doctoral work, one of the interesting fortifications I visited was that of Qafë Thanë. There I gathered a lot of information, which gives us the opportunity to date the period to which the fortification belongs, but also the role it has played. The fortification of Qafë Thana has been written before, its identification has been done, but the walls have never been traced, the fortification or planimetry of the fortification has not been traced. All these new data are clearly presented in this study. Concluding that the Qafë Thana fortification is part of a very advanced fortification system of the Shkumbin valley. The study is part of the doctoral studies I am attending at the Academy of Albanological Studies, Institute of Archeology, Tirana, on "Prehistoric Fortifications along the Shkumbin Valley".

The plan of the fortification is elliptical and has similarities with other fortifications located in Albania. The prehistoric wall line follows the terrain well closing that part of the ridge where it is unprotected. The preserved wall tract is about 125 m long and over 2.20-2.40 m wide. The wall was built with large blocks of stone without mortar and apparently served to keep the route of the road that passed there in its direction to Northern Macedonia. Based on the elements we have, we think that this fortification belongs to the early Iron Age (Gajtan type). Fortification has had a protective function for the local population.

Keywords: Prehistoric Fortification, Archeology, Bronze Age, Archaeological Survey

Abstrakt

Në Shqipëri vendbanimet e fortifikuara prehistorike njihen që nga epoka e bronzit, duke filluar nga veriu deri në jug. Lugina e Shkumbinit është një zonë e cila ka qenë banuar që në periudhat e hershme. Gjatë viteve të punimit të doktoraturës një ndër fortifikimet interesante që kam vizituar ka qenë ai i Qafë Thanës. Aty kam grumbulluar një informacion të bollshëm, i cili na jep mundësi ta datojmë periudhën së cilës i përket fortifikimi, por edhe roli që ka luajtur. Për fortifikimin e Qafë Thanës është shkruar edhe më parë, është bërë identifikimi i tij, por asnjëherë nuk është bërë gjurmimi i mureve, rievimi apo planimetria e fortifikimit. Të gjitha këto të dhëna të reja janë paraqitur qartë në këtë studim. Duke arritur në përfundimin që fortifikimi i Qafë Thanës bën pjesë në një sistem shumë të avancuar fortifikues të luginës së Shkumbinit. Studimi është pjesë e studimeve doktrale që po ndjek në Akademinë e Studimeve Albanologjike, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë, me temë *"Fortifikimet Prehistorike Përgjatë Luginës së Shkumbinit"*.

Planimetria e fortifikimit është eliptike dhe ka ngjashmëri me fortifikimet e tjera që ndodhen në Shqipëri. Linja e murit prehistorik ndjek terrenin duke mbyllur mirë atë pjesë të kreshtës ku është e pambrojtur. Trakti i murit i ruajtur ka gjatësi rreth 125 m i gjatë dhe mbi 2.20-2.40 m i gjerë. Muri është ndërtuar me blloqe të mëdhej guri pa llaç dhe ka shërbyer me sa duket për të mbajtur trasenë e rrugës që ka kaluar aty në drejtimin e saj për më Maqedoninë e Veriut. Duke u mbështetur në elementët që kemi mendojmë që ky fortifikim i përket periudhës së hershme të hekurit (tipi Gajtan). Fortifikimi ka pasur funksion mbrojtës për popullsinë vendase.

Fjalë kyçe: Fortifikim prehistorik, Arkeologji, epoka e bronzit, survei arkeologjik.

Fortifikimi i Qafë Thanës

Mbi qafën e Thanës në Jug – Lindje të saj në anën e djathtë të rrugës automobilistike, mbi vargun malor të kësaj qafe me lartësi 106 metra mbi nivelin e fushës ngrihet një kodër shkëmbore me përbërje gëlqerore, e cila sipër krijon një kurorë të bukur shkëmbore.




Fig.1 Pamje e fortifikimit të Qafë Thanës

Kjo lartësi e cila ngrihet në trajtë koni banorët e fshatit të Urakës si dhe ato të fshatrave përreth e quajnë « Shkëmbi i Urakës » ose « Shkëmbi i Qafës së Thanës ». afër majës së kësaj qafe, lartësia e shkëmbit duke krijuar disa të thyera bëhet më e butë duke shtrirë nën këmbët e saj me pamje nga ana e rrugës automobilistike një shesh i cili njihet me emrin « Katund Plak ». Pranë këtij sheshi shihen trakte muri gurësh në trashësinë mbi 1 metër, këto mure që dallohen shumë lehtë mbi sipërfaqe , në disa raste kanë trajtën e katrorit dhe të katërkëndëshit këndrejtë.




Fig.2 Pamje e fortifikimit të

Qafë Thanës, muri prehistorik me ngjyrë të zezë.



Fig. 3 (Pamje lindore e linjës së murit prehistorik)

Muret janë ndërtuar prej blloqesh masive guri gëlqeror të cilët janë të vendosur njëri mbi tjetrin pa lidhje llaçi, dhe janë të pa skalitur. Duke i krahasuar me mure të tjera të njohura del se ata duhet t'i përkasin periudhës së parë të hekurit.

Në territoret përreth këtyre mureve si dhe në periferinë e shkëmbit të Urakës mbi sipërfaqe duken fragmente qeramike midis të cilave mund të gesh gryka dhe parete pitosash, të madhësive të ndryshme që disa herë kanë dhe zburime me valëzime, aty ka edhe parete, gryka e funde enësh, të tjera funde dhe vegje vorbash si dhe objekte të tjera të kësaj natyre. Nga qeramika e gjetur mbi sipërfaqe një pjesë e pakët i përket periudhës së parë të hekurit por ka edhe enë që u përkasin periudhave të tjera të mëvonshme. Fragmentet e qeramikës së gjetur kanë ngjyra të ndryshme, ato më të lashta paraqiten me ngjyrë të zezë dhë në atë të kafes së errët. Një pjesë e fragmenteve kanë ngjyrë të kuqe dhe disa në atë të rozës, nuk mungojnë gjithashtu dhe fragmente me ngjyrë gri dhe ato të periudhës helenistike. Këto të fundit janë të lyster me vernik të zi brenda dhe jashtë një pjesë e tyre janë të lyster nga jashtë me vernik të zi dhe nga brenda me vernik të kuq.

Duke i parë si tërësi fragmentet prej qeramike rezulton se në këtë vendbanim të lashtë ilir jeta ka vazhduar për një periudhë shumë të gjatë, duke filluar nga mijëvjeçari i fundit para erës sonë deri në periudhën e mesjetës.

Nga krahasimi i fragmenteve të qeramikës së gjetur në vendbanimin e Qafës së Thanës me ato të gjetura më parë në gërmimet e bëra në Lin, Kalanë e Pogradecit, dhe në Selcën e Poshtëme del se midis këtyre vendbanimeve ka ngjashmëri, goftë nga përpunimi i tyre si dhe nga zburimet dhe trajtat³⁶.

Duke përjashtuar në këtë krahasim ato që i përkasin periudhës së parë të hekurit, si dhe ato që janë të prodhimit të vendbanimit. Një gjë e tillë vërtetohet se nënshatin e sotëm të Urakës tek një vend që quhet Pacivalle, ka gjurmë të shumta të mbeturinave të qeramikës, ndoshta këtu kemi të bëjmë me një punishte të prodhimit të saj. Nga materialet arkeologjike në sipërfaqe në këto vendbanim të lashtë, një vëmendje të veçantë meritojnë dhe objektet prej hekuri, në këtë grup veç të tjerave mund të përmendim sasira të shumta të zgjyrave të hekurit, të cilat dëshmojnë për zhvillimin e përpunimit të metaleve nga të parët tanë.

Nga analiza laboratorike që ju është bërë këtyre zgjyrave ka rezultuar se ato më vete përmbajnë akoma rreth 46.73 të përbërjes së mineralit të hekurit. Banorët e këtij vendbanimi të lashtë duke qenë afër zonave të pasura me minerale përreth, si ato të maleve të Çervenakës, Radokalit, dhe të Pishkashit, ka të ngjarë që të kenë njohur dhe shkrirë këtë lloj minerali, prej të cilit mjeshtrit ilirë të përpunimit të metaleve të kenë nxjerrë nga duart e tyre armët e luftës dhe veglat e punës.

Përmbi sheshin e Katundit Plak duke ju ngjitur lartësisë së shkëmbit në lartësinë 106 m mbi nivelin e fushës, gjenden të njëjtat objekte arkeologjike që gjenden edhe poshtë sheshit; aty afër majës gjenden të tjera gjurmë të vazhdimit të vendbanimit të lashtë sheshi i sipërm e emrin lëmi i « Kaurit ».

Në afërsi të këtij sheshi duken mbi sipërfaqe traktet e mureve të ndërtesave si dhe të një muri të pjesshëm mbrojtës që kanë rrethuar dikur këtë vendbanim, i cili ka shërbyer për mbrojtjen e banorëve nga sulmet e ndryshme dhe ka pasur pozitë strategjike të mirë.

Vrojtimi nga maja e këtij shkëmbi shtrihet në grykën e maleve të Qukësit kalanë e e gurit të Pishakshit, Gradishtën e Manastirecit, dhe Gurin e Cukës së Radokalit. Meqenëse ky vendbanim ka vazhduar të ekzistojë edhe në kohën antike dhe më vonë banorët e tij ndoshta si detyrë ruajtjen dhe kontrollimin njëri nga degët e rrugës së Kandavisë ose të rrugës së Egnatias, sikur u quajt kjo rrugë në kohën e pushtimit Romak në Iliri.

³⁶ Ristani 1974, 63.



Fig. 4. (Pamje e fasadës së murit prehistorik)

Ky vendbanim duke qenë një pozicion kyç dhe strategjik, ka shërbyer edhe si stacion qëndrimi për udhëtarët të cilët duke udhëtuar nga Iliria për në Maqedoni, kanë qëndruar dhe pushuar në këmbët e këtij vendbanimi, të cilin në burimet historike të kohës antike është quajtur me emrin « Pons Servili » emër i cili identifikohet me Urakën. Që dikur pranë këtij vendbanimi ka kaluar një rrugë e lashtë e cila lidhte Ilirinë me Maqedoninë, kjo vërtetohet edhe nga një tjetër faktor. Në afërsi të uljes së Qafës së Thanës në drejtimin e veri-lindjes ruhet një trakt muri me gjatësi rreth 125 m i gjatë dhe mbi 2.20-2.40 m i gjerë. Muri është ndërtuar me blloqe të mëdhej guri pa llaç dhe ka shërbyer me sa duket për të mbajtur trasenë e rrugës që ka kaluar aty në drejtimin e saj për më Maqedoni.

Me interes për këtë vendbanim është edhe ekzistenca aty e dy shpellave të cilat shikojnë në drejtimin jugor të shkëmbit. Njëra prej tyre ajo më e madhja është shpellë eremitesh dhe banorët e Urakës e quajnë « Kisha e Urakës ». Në faqet e shkëmbore të kësaj shpelle në anën e djathtë të hyrjes në të duken akoma gjurmët e afreskeve murale të cilat mendohet se i përkasin periudhës jo më vonë se shekulli XIV³⁷.

Nga vetë pozicioni dhe natyra përreth ku është ngritur vendbanimi i lashtë duhet menduar se banorët e tij janë marrë me blegtori gjithashtu nuk përjashtohet mundësia e zhvillimit të buqësisë për shkak se aty pranë shtrihet fusha e bukur e Domosdovës. Pitosat e mëdhej që gjenden të fragmentuar në sipërfaqe kanë shërbyer si hambar të prodhimeve buqësore. Duke qenë pranë liqenit të Ohrit këta banorë të lashtë të tij kanë pasur mundësi të merren edhe me peshkim të hapur.

³⁷ Ristani 1974, 64.

Përfundime:

Vendbanimi i Qafë Thanës sipas atyre pak të dhënave që kam grumbulluar i përket periudhës së hershme të hekurit. Gjithashtu përse i përket planimetrisë së mureve rrethuese ky fortifikim ka ngjashmëri me vendbanime të tjera të këtij tipi që ndodhen në këtë zonë si ai i Bërzeshitës, Qukës Skëndërbe etj. Por për të patur një rezultat edhe më të qartë datues duhet të kryhet një sondazh brenda mureve rrethuese të fortifikimit në mënyrë që të grumbullojmë qeramikë për të na dhënë një ide më të qartë rreth kohës së ndërtimit të këtij vendbanimi prehistorik.

Bibliografia:

1. Ristani Dhimitër, Vendbanimi i lashtë ilir i Qafës së Thanës. Buletin Arkeologjik 4, Tiranë 1974. 63-65.
2. Ceka Neritan, Baçe Apollon, Vrojtime arkeologjike në rrethin e Pogradecit, luginën e Devollit dhe Shkumbinit, Monumentet, 3, 1972.
3. KOKA Aristotel – Kontribut për hartën arkeologjike të Librazhdit, “Almanak”, 1, Librazhd, 1985.
4. Ceka Neritan, Papajani Lazer, Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike, Monumentet, 1971, 1.
5. Gjipali Ilir, Vendbanime dhe materiale prehistorike nga rrethi i Librazhdit, “Iliria”, 1981, 1.
6. Ceka Neritan, Fortifikimet parahistorike ilire, Monumentet 1985, 1.

PRILOZI ZA POSTICANJE DIJALOGA O FENOMENU TURIZMA

Piše: akademik Dr. Šefket Krcić

Univerzitet u Novom Pazaru

Abstract:

Autor se

u ovom radu bavi fenomenom turizma sa kulturuloškog I sociologiskog aspekta. Prema njemu, turizam su prije svega ljudi. To znači, zajedno predstavljaju kapacitete za jačanje socijalnog I kulturnog dijaloga u sektoru turizma i uopšte društva. Cilj rada jeste da se unaprijede turistički resursi kako na primorju tako I na planinama.

Ključne riječi : Turizam , kulura, vrijednosti, dijalog , more, planine, putovanja, ljudski resursi

Uvod

Glavni ciljevi ove rasprave su :

- jačanje kapaciteta socijalnih partnera u zemljama učesnicama što doprinosi razvoju nacionalnog i evropskog socijalnog dijaloga u oblasti turizma;
- jačati pregovarače na nivou sektora o važnosti sadržaja kolektivnih ugovora (konkretnim primjerima) i jačanje njihovih trenutnih vještina pregovora sa ciljem daljeg razvoja i jačanja socijalnog dijaloga;
- istražiti mogućnosti adaptacije i implementacije *acquis communautaire* (evropskog zakonodavstva , kao i evropskih standarda);
- promovisati ideju o "evropskim pasošima vještina" , kao i mogućnost primjene u svakoj od zemalja sudionika
- povećanje svijesti i razumevanja predstavnika poslodavaca i radnika o značaju evropskog(sektorskog) socijalnog dijaloga;
- prilagoditi socijalni dijalog izazovima i promjena u zapošljavanju (modernizacija tržišta rada , fleksibilna sigurnost , vještine , kvalitetan i dostojanstven rad) .

Zatim, glavni rezultati rasprave su:

- objavljivanje rasprave o socijalnom I kulturnom dijalogu i kolektivnom pregovaranju u turizmu i ugostiteljstvu;
- održavanje niza bilateralnih sastanaka i radionica na nacionalnom nivou u cilju prepoznavanja rješenja koja su neophodna u tom sektoru;
- Panel diskusije na nacionalnom nivou;
- Studijska posjeta Bogičevići I tromedi u cilju promocije primjera dobre prakse;
- Organizovanje završne konferencije u cilju promocije rezultata projekta;
- E-letak o socijalnom dijalogu u sektoru turizma i ugostiteljstva.

Fenomen turizma danas

Ovdje cu govoriti o susretu primorskog i planinskog turizma

Kompanija planinski turizam je danas nezaobilazni činilac kada je reč o industriji putovanja i isto tako vodeći pružalac tehnoloških rešenja svim učesnicima turističke industrije i u našoj zemlji. S obzirom da ste vi pre svega tehnološka kompanija koja se prilagođava novonastalim promenama na tržištu, kakav je vaš odgovor na procese digitalne transformacije poslovanja?

Svet u kome živimo menja se gotovo svakoga dana i postaje sve više „digitalni“, a sve manje „analogni“. Brzina ovih promena takođe se povećava, tako da su za neke promene nekada bile potrebne decenije, a sada se sve to desi za godinu ili dve.

Prvi Iphone 2G sa 4GB „flesh“ memorije je izašao u junu 2007. godine i bio je dizajniran za rad na 2G mreži, dok su danas, nakon desetak godina, pripreme za potpunu industrijalizaciju 5G mreže u punom jeku, a retki su i proizvođači pametnih telefona koji nude uređaje sa manje od 64GB memorije. Godišnja stopa rasta „Internet of Things“ je preko 30% i procena je da će do 2030. godine preko 40 milijardi uređaja biti povezano na internet omogućavajući na taj način kako se uspostavljaju zdravi stilovi zivota odmora ljudi povezano sa mora i planine. Pre samo trideset godina, kada je osnovana naša kompanija, internet nije postojao, a mnoge turističke agencije su preko telefona kontaktirale avio-kompanije da za svoje putnike naprave rezervacije i izdaju avio karte. Amadeus je tada bio pionir u automatizaciji rada turističkih agencija, kao i u kreiranju elektronske distribucije u industriji putovanja, a danas je potvrđeni lider u ovom segmentu sa jasnom vizijom da tu i ostane. Ovo je bilo jedino moguće uz kontinuirani razvoj, praćenje tehnologije i postavljanje potreba putnika u centar svih naših angažovanja.

Potrebe današnjih svjetskih putnika, a naročito „millennial“, značajno se razlikuju od potreba putnika od pre samo desetak godina. Današnji putnici su u svakom trenutku na internetu („always connected passengers“), žele da imaju komunikaciju i punu kontrolu nad celokupnim putovanjem u realnom vremenu i traže efikasnost, punu transparentnost, uporedivost i personalizaciju usluge koja im je potrebna. Samo na bazi ovih potreba putnika Amadeus razvija svoje proizvode i pruža usluge svim učesnicima u industriji putovanja. Kada su u pitanju nove tehnologije, „Open Systems“, „Cloud“ i „Big Data“ su deo stvarnosti naše kompanije. Amadeus već uveliko eksperimentiše i sa VR i AR tehnologijom, a u delu elektronskog plaćanje i bezbednosti sa „blockchain“ tehnologijom.

Svedoci smo sve većeg broja turista koji u prethodnih nekoliko godina pristižu u Srbiju. Da li se taj značajan trend odražava i na poslovanje Amadeusa?

Generalno govoreći, kraći odmori i „City Break“ aranžmani su možda i najbrže rastući segment turističke ponude. Svedoci smo da više kraćih odmora u toku godine zamenjuje dugogodišnju praksu tronedeljnog odmora leti i dvonedeljnog odmora zimi. Takođe, razvoj manje konvencionalnih smeštajnih kapaciteta kao što su hosteli i apartmani, a koji su dostupni preko novih B2C „igrača“ kao što su Booking.com ili Airbnb, umnogome podstiču ovu praksu.

Naravno, ne smeju se zaboraviti niskobudžetni prevoznici koji zbog izuzetno povoljnih cena postaju najveći promoteri neke gradske destinacije ili zemlje u celini. Isti trendovi su zahvatili i Srbiju, a najviše se osećaju u Beogradu i drugim gradskim centrima, tako da ćemo, uveren sam, 2018. godinu završiti sa preko 1,2 milijarde evra prihoda od turizma. Ovaj trend izuzetno povoljno utiče i na poslovanje Amadeusa, jer što je više posla za naše partnere to je i naš poslovni rezultat bolji. Godina iza nas biće rekordna u smislu izvršenih rezervacija, prevezenih putnika i naravno u prihodima i profitu.

Samo najfleksibilniji opstaju

Šta je to novo u kompaniji Amadeus u odnosu na prethodni period čime se možete pohvaliti?

IT i industrija putovanja su verovatno dve najdinamičnije oblasti ekonomskog života u svetu. Kao i u drugim segmentima, opstaju samo oni koji se menjaju i prilagođavaju potrebama „digitalnog“ sveta.

Mi u Amadeusu imamo jasnu strategiju, širimo naš portfolio, unapređujemo i razvijamo postojeće solucije i servise i radimo na unapređenju unutrašnje organizacije i razvoju kadrova.

Početakom 2017. godine završili smo akviziciju najvećeg rezervacionog sistema za niskobudžetne aviokompanije Navitaire, dok smo u 2018. godini vlasnički preuzeli TravelClick, jednu od najbrže rastućih kompanija u hotelskom sektoru. Svakodnevno pratimo i podržavamo različite „Start-up“ projekte i time doprinosimo širenju novih ideja i poslovnih modela.

Vi ste kompanija koja veliku pažnju posvećuje segmentu istraživanja i razvoja. Da li možete da nam nagovestite neke od predikcija budućeg razvoja turističke industrije?

Od Evropske Unije Amadeus je prepoznat kao evropska kompanija broj 1 u istraživanju i razvoju u sektoru turizma i saobraćaja. Samo od 2004. godine u istraživanje i razvoj uložili smo više milijardi evra i nemamo nameru da se na tome zaustavimo. To je garant našeg opstanka u ovom poslu. Što se pak samog turizma tiče, on će nastaviti da se razvija po stopi koja je bar za dva ili tri procentna poena veća od stope rasta svetske ekonomije. Glavni motor razvoja turizma predstavljaju naravno velike azijske ekonomije predvođene Kinom i Indijom. Sve će ovo pratiti i visoka stopa rasta u avio-saobraćaju u periodu od 2018. do 2023. godine od približno 5%, dok će niskobudžetni prevoznici imati dvocifrenu stopu rasta. Ilustracije radi, u ovom trenutku niskobudžetni prevoznici čine 30% svih sedišta u avio-industriji. U budućnosti, svemirska putovanja neće biti retkost, kao ni turistički boravak u podvodnim hotelima. Hyperloop tehnologija će omogućiti suvozemne brzine nekoliko puta brže od zvuka, a putnici će sve više biti zahtevni i insistiraće na tzv. „End to End“ konceptu putovanja potpuno personalizovanim za konkretnu osobu. Koncept distribucije u industriji putovanja će sve više ličiti na poslovni model Amazona, Netflix-a ili AliExpressa.

Kakvi su planovi kompanije Amadeus za naredni period?

Kada govorimo o kratkoročnim planovima naše kompanije onda razvoj i unapređenje nove „Amadeus Travel Platform“ zauzima centralno mesto. Ova nova solucija je odgovor na drugačije potrebe avio-kompanija u distribuciji svoje ukupne ponude, novi IATA standard koji je poznat pod skraćenicom NDC – „New Distribution Capabilities“, kao i sve izraženijom fragmentacijom klasičnog GDS sadržaja. Platforma će na jednom mestu integrisati celokupan GDS sadržaj, posebni sadržaj samih avio-kompanija dobijen direktnim pristupom („Proprietary API“), ponudu niskobudžetnih prevoznika, hotelske i car-rental agregatore, železnice, kao i sve ostale sadržaje komplementarne sa putovanjem. Pristup sadržaju nove „Amadeus Travel Platforme“ biće moguć preko svih kanala, uređaja i B2B ili B2C klijentskih aplikacija. Sve ovo je deo jednog šireg koncepta transformacije kompanije Amadeus od GDS (Global Distribution System) u „Live Travel Space“, omogućavajući svim akterima u industriji putovanja da međusobno saraduju i razmenjuju relevantne informacije vezane za svoju ponudu.

Uslovi za uspeh turizma

Šta biste savetovali onima koji žele da se afirmišu i budu prepoznati kao važan akter na turističkoj mapi Srbije? Šta je recept za dugotrajan uspeh i opstanak na tržištu?

Potoje četiri privredne oblasti koje bih izdvojio kao razvojne šanse Srbije. To su: poljoprivreda, saobraćaj, turizam i informacione tehnologije. Za svaku od njih posedujemo prirodne resurse, dobar geografski položaj, kao i neophodne ljudske potencijale. Turizam u opštem smislu povezuje sve četiri oblasti i svako ko je krenuo da se bavi turizmom izabrao je privredni sektor sa dobrim potencijalom.

Završna poruka

Na koncu uz zahvalnost, ohrabrujem sudionike ovog skupa za vođenje daljeg otvorenog dijaloga koji su dragocjeni u cilju uspostavljanja društvenih vrijednosti i afirmacije kulturnih sadržaja na našim prostorima gdje se susreću svjetske ideje Istoka i Zapada u cilju stvaranja i njegovanja zdravih stilova života.

Prostora ima kako u receptivnom tako i u inicijativnom turizmu. Međutim, sve su to potrebni, ali ne i dovoljni uslovi za uspešno i održivo poslovanje. Za profitabilno i održivo poslovanje neophodno je imati viziju i strategiju artikulisanu u jasnim poslovnim planovima. Najjednostavnije rečeno, moramo uvek postavljati sebi pitanje – da li moja kompanija donosi vrednost krajnjem kupcu ili poslovnom partneru. Ako je odgovor pozitivan, uspeh je i na kraći i na duži rok zagarantovan.

DALLIMI MES KONTRATAVE DHE KONTRATAT ELEKTRONIKE

(E drejta biznesore në aspektin e ekonomisë digjitale)

DIFFERENCE BETWEEN ELECTRONIC CONTRACTS AND CONTRACTS (Business law in terms of digital economy)

Prof. Ass. Dr. Besnik HAJDARI

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike
Universiteti i Mitrovicës "ISA BOLETINI"
Besnik.hajdari@umib.net

Bashkëautor: **MSc. Edona HAJDARI**

Master e Shkencave Ekonomike

Abstracti

The contract is the most important source of obligations under the law of obligation and at the same time represents a central institution within the legal communication between the contracting parties. It follows that: a contract is a legal fact which is important in various fields (or different legal and economic branches) in international law, as well as in family law, civil law, economic law, etc. The basis for concluding a contract is the achievement of a certain result between the contracting parties which aims to establish, change or extinguish a certain legal relationship. In legal theory, a contract is defined as the consent of the will between two or more parties to which it comes in order to ascertain, change or terminate a legally binding relationship. This implies the fact that the contract is the result of the desire of the contracting parties and that they exclusively determine this desire which in legal science is called the "principle of autonomy of the will." The approval and observance of this principle has been expressed as a result of the fact that the parties regarding the regulation of their affairs could much better determine the terms and conditions in the contract than the state to intervene with legal provisions.

When certain social relations are claimed to be regulated by contract, we must state that the principle of expression of the free will of the parties in the law of obligations is considered: The freedom of the contracting parties to enter into or not to enter into the contract and that they are bound only by their will;

The freedom of the subjects of the right to choose the person with whom they will enter into a contract; The freedom of the subjects of law to determine the content, conditions and form of the contract according to their desire; The complete freedom of the contractors to change or terminate the concluded contract at their own will after concluding a contract. However, in legal theory it is accepted that the legally concluded contract must be law for the parties, and that the agreement reached by the parties must be respected.- "pacta sunt servanda" (Smaka, 2000).

If we analyze and follow the contracts carefully, taking into account their legal action, we can divide them into three groups: Contracts with which obligations are created; Contracts that change the obligatory relationship and The contract with which the obligatory relations are extinguished. In practice, in the most frequent cases we are presented with contracts with which obligations or contracts are created under point (a)

Abstracti

Kontrata është burim më i rëndësishëm i detyrimeve në kuadër të së drejtës detyimore dhe njëkohësisht paraqet një institucion qëndror në kuadër të komunikimit juridik në mes të palëve kontraktuese. Nga kjo del se: kontrata është fakt juridik i cili ka rëndësi në lëmi të ndryshme (apo degë të ndryshme juridike e ekonomike) si në të drejtën ndërkombëtare, ashtu edhe në të drejtën familjare, në të drejtën civile, ekonomike etj. Baza e lidhjes së kontratës është arritja e ndonjë rezultati të caktuar në mes të palëve kontraktuese e cila ka për qëllim të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë një marrëdhënie të caktuar juridike. Në teorinë juridike, kontrata definohet si pëlqim i vullnetit në mes të dy apo më shumë palëve deri te e cila vjen me qëllim të konstatimit, ndryshimit ose pushimit të ndonjë marrëdhënie detyimore juridike. Kjo nënkupton faktin se kontrata është rezultat i dëshirës së palëve kontraktuese dhe se ata ekskluzivisht përcaktojnë këtë dëshirë që në shkencën juridike quhet "parimi i autonomisë së vullnetit". Aprovimi dhe respektimi i këtij parimi ka ardhur në shprehje si rezultat i asaj që palët lidhur me rregullimin e çështjeve të tyre shumë më mirë do të mund ti përcaktonin kushtet dhe rethanat në kontratë sesa shteti të ndërhyjë me dispozita juridike.

Kur marrëdhëniet e caktuara shoqërore pretendohen të rregullohen me kontratë, duhet të konstatojmë se si parim i shprehjes se vullnetit të lirë të palëve në të drejtën e detyrimeve konsiderohen:

Liria e palëve kontraktuese që të lidhin apo të mos lidhin kontratën dhe se ato i detyron vetëm vullneti i tyre;

Liria e subjekteve të së drejtës që të zgjedhin personin me të cilin do të lidhin kontratë;

Liria e subjekteve të së drejtës që sipas dëshirës së tyre të përcaktojnë përmbajtjen, kushtet dhe formën e kontratës;

Liria e plotë e kontraktuesve që pasi të kenë lidhur kontratë me vullnetin e tyre ta ndryshojnë ose ta shuajnë tërësisht kontratën e lidhur. Mirëpo, në teorinë juridike është i pranuar fakti se kontrata e lidhur në mënyrë legale, duhet të jetë ligj për palët, dhe se marrëveshja që e kanë arritur palët duhet të respektohet. - “pacta sunt servanda” (Smaka, 2000).

Nëse i analizojmë dhe i përcjellim me vëmendje kontratat, duke e pasur parasysh veprimin e tyre juridik, ato mund t'i ndajmë në tri grupe:

Kontratat me të cilat krijohen detyrimet;

Kontratat me të cilat ndryshojnë marrëdhëniet detyrimore dhe

Kontrata me të cilat shuhet marrëdhëniet detyrimore.

Në praktikë në raste më të shpeshta na paraqiten kontratat me të cilat krijohen detyrimet apo kontratat nën piken (a) (Krasniqi, 2014).

Klasifikimi i kontratave

Kontratat në të drejtën detyrimore janë të shumëllojshme qoftë për nga natyra, përmbajtja e tyre si dhe për nga të drejtat dhe detyrimet që dalin nga ato. Më poshtë kemi klasifikimin e rëndomtë i cili është i pranueshëm nga shumica e shkencëtarëve të njohur dhe e cila në praktikën juridike ka më së shumti arsyetim.

Kontratat e njëanshme dhe të dy anshme. Kjo ndarje e kontratave bëhet duke u mbështetur në përmbajtjen e kontratës.

Kontrata e njëanshme - konsiderohet ajo kontratë ku vetëm njëra palë kontraktuese është e detyruar të përmbushë ndonjë prestim (kusht) që do të thotë se njëra palë ka vetëm të drejta ndërsa pala tjetër vetëm detyrime. P.sh. kontrata lidhur me faljen, ose kontrata mbi qiranë, ku qiramarrësi e ka për obligim ta kthej sendin në afatin e caktuar dhe në gjendje të njëjtë siç ka qenë në momentin kur e ka pranuar. Ndërsa huadhënësi ka të drejtë të kërkojë kthimin e pronës pa asnjë veprim kushtëzues nga qiramarrësi. Nuk duhet harruar se të gjitha kontratat janë dypalëshe, por te kontratat njëpalëshe e kemi fjalën vetëm për detyrimin, për të cilin njëra palë është e detyruar ta përmbushë atë.

Kontratat dypalëshe. - Me këto kontrata krijohen ato marrëdhënie detyrimore në të cilat dy palët kontraktuese fitojnë ndaj njëra tjetrës të drejta dhe obligime. Te këto kontrata të drejtat e njëres palë kontraktuese i përgjigjen detyrimit të palës së kundërt dhe anasjelltas. Në praktikë këto kontrata i hasim në formën e kontratave të shitjes, kontratat mbi veprën, kontrata mbi organizimin e udhëtimit etj.

Kontratat me ngarkesë dhe kontratat bamirëse. - Kjo ndarje në kontrata me ngarkesë (oneroze) dhe kontrata bamirëse zakonisht bazohet në faktin se pala kontraktuese, që ka ndonjë dobi nga kontrata, i jep palës tjetër ndonjë kompensim në vlerë të caktuar ose nuk i jap. E para quhet kontratë me kundërvlerë kurse të dytat pa kurrfarë kundërvlerë (për këtë arsye edhe quhen kontrata mbi bamirësi. Kontratat me ngarkesë apo kompensim të kundërvlerës janë ato kontrata ku njëra palë fiton ndonjë dobi, pasi ekuivalencë të sajë duhet t'ia kthejë palës tjetër kompensimin e caktuar, që do të thotë se këtu deri diku duhet të ekzistojë një baraspeshë në mes të palëve kontraktuese në aspektin e përfitimit nga kjo kontratë. Kurse kontratat bamirëse siç quhen edhe **“lucrative”** – janë ato kontrata të cilat nuk e obligojnë palën e cila ka pasur përfitime apo dobi, që ta kthejë kundërvlerën. Këto kontrata janë më të rralla në krahasim me kontratat me ngarkesë në praktikë. Si kontrata bamirëse numërohen: kontrata mbi faljen, kontrata mbi huapërdorjen, kontrata mbi huan pa kamatë etj.

Kontratat aleatore dhe komutative. Ky lloj klasifikimi i kontratave është bërë varësisht nga fakti se në rastin e lidhjes, a kanë njohuri palët lidhur me të drejtat dhe detyrat e tyre.

Kontrata aleatore (apo siç quhen ndryshe edhe kontrata në fat), janë ato kontrata në të cilat palët në momentin e lidhjes nuk kanë njohuri për të drejtat dhe detyrat e tyre, por që kjo njohuri do të arrihet nga rrethanat e ardhshme të cilat janë të pasigurta. Në kuadër të kontratave aleatore hyjnë: kontrata mbi sigurimin, kontrata mbi lojërat me fat, kontrata mbi kushtin, shitjen e shpresës etj.

Kontrata komutative janë ato kontrata në të cilat palët kontraktuese që nga momenti i lidhjes së tyre kanë njohuri të mjaftueshme për të drejtat dhe detyrimet e tyre. Emërtimi komutativ rrjedh prej fjalës latine commutatio, që ka përmbajtjen e ndërrimit, këmbimit. Pra, këto kontrata nuk gjenden nën hijen e pasigurisë, paqartësisë, por këto kontrata hyjnë në grupin e kontratave me ngarkesë dhe në teori quhen edhe kontrata ekuivalente. Kjo ndarje është me interes, në rast të ekzistimit të dëmtimit mbi gjysmën (laesio anormis) sepse nëse kjo ndodhë kontrata komutative mund të anulohet me kërkesën e palës së dëmtuar, e cila ka marrë më pak se gjysmën e vlerës për atë që i ka dhënë palës tjetër në emër të detyrimit. Përderisa kontratat aleatore nuk i njohin këto institucione të dëmtimit mbi gjysmën, duke e ditur natyrën e tyre. Tek këto të fundit kontrata nuk mund të anulohet vetëm për atë se pala ka marrë më pak se gjysmën e vlerës apo nuk ka marrë asgjë nga ajo çka ka dhënë, prandaj edhe quhen kontrata të fatit. Kontratat e sipërhënuara janë shumë të rëndësishme dhe masovike në lëmin e qarkullimit të mallrave dhe të shërbimeve posaçërisht në krahasim me ato aleatore. Në kuadër të këtyre kontratave hyjnë: kontrata mbi shitjen, kontrata këmbimin, kontrata mbi sigurimin, qiranë etj.

Kontratat sensuale, reale dhe formale. - Kontrata sensuale janë ato kontrata për lidhjen e të cilave nuk nevojitet asnjë formë e veçantë përveç harmonizimit të dëshirës së palëve kontraktuese.

Kontratrat reale janë një lloj i kontratave formale, sepse për ekzistimin e kontratës nuk mjafton vetëm arritja e pëlqimit, por është e nevojshme edhe dorëzimi i sendit apo objektit mbi të cilën edhe bëhet kontrata. Pasi të dorëzohet ai, dhe pasi të jetë arritur pëlqimi i palëve kontraktuese, konsiderohet se kjo kontratë është lidhur. Këto kontrata i ka njohur edhe e drejta e vjetër romake. Mirëpo e drejta bashkëkohore duket se gjithnjë e më shumë po e lëshon mendimin lidhur me kontratat reale. Thuhet se nuk ka nevojë që kontratat reale të ndahen nga kontratat konsensuale. Mirëpo në anën tjetër mund të konstatojmë se vetëdija juridike është ende e fortë që të kuptohet se te disa marrëdhënie mund të kuptohet se ekziston kontrata pa u dorëzuar sendi. Andaj, nuk ka efekt që në mënyrë artificiale të ndërpritet forma e kontratave reale.

Kontratrat formale, janë ato kontrata për ekzistimin e të cilave kërkohet respektimi i ndonjë forme të caktuar (p.sh. të jenë të lidhura me shkrim apo të vërtetohen në organet gjegjëse si gjykatat). Ekzistimi i tyre nuk supozohet por kjo duhet të ceket shprehimisht se kontrata e tillë është kontratë formale (p.sh. kontrata mbi botimin e veprës, kontrata mbi shitblerjen e pajimeve, investimeve etj.) kjo do të thotë se te këto kontrata nuk mjafton arritja e akordimit të vullnetit (mutum consensus), por kjo dëshirë apo vullnet i akorduar duhet të shprehet në formë të veçantë siç e parasheh ligji. Respektimi i kësaj forme të paraparë me ligj është kusht thelbësor për ekzistimin e kontratës dhe bile kontrata mund të shpallet inekzistuese ose nule. Edhe ligji në mënyrë urdhëruese shpesh e cekë se “kontrata duhet të jetë e përpiluar me shkrim”, ose “nëse kontrata nuk është e përpiluar me shkrim nuk prodhon efekt juridik”. Këto janë vërejtje me rëndësi që palët kontraktuese doemos duhet ti respektojnë, sepse janë të natyrës imperative (ius cogens).

Kontratrat me emër dhe pa emër. Kontrata me emër janë ato kontrata që janë të parapara dhe që janë të rregulluara shprehimisht me dispozita ligjore. Në kuadër të këtyre kontratave bëjnë pjesë: kontrata e shitjes, e dhuratës, e veprës, e qirasë etj. Numri i këtyre kontratave në sferën e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve është i madh. Kontrata pa emër janë ato kontrata që nuk e kanë emrin e tyre dhe të cilat nuk janë të rregulluara me ligj të cilat lidhen nga palët duke u bazuar në rregullat e përgjithshme të së drejtës kontraktore. Në kuadër të kësaj kontrate bëjnë pjesë: kontrata për sefin, për ekspozimin, botimin dhe kontrata mbi angazhimin e kapaciteteve hoteliere.

Kontrata sipas aderimit (formale, tipe të standardizuara). Në kontratën e rëndomtë ekziston vullneti i të dy palëve për të lidhur një kontratë. Kurse tek kontrata e aderimit kjo bëhet në mënyrë të veçantë duke e bërë pranimin e kushteve (en blanc) të cilat i cakton njëra palë. Kontratë sipas aderimit i pari i ka përkufizuar juristi Francez Salesi (Saleilles) në fillim të shekullit të kaluar apo saktësisht më 1901. Te kontratat e atëhëzimit (sipas aderimit) janë prezent këto karakteristika: ekzistimi i njërës palë kontraktuese superiore (në aspektin e forcës ekonomike që në treg mund të paraqitet në pozitë monopoliste);

në formë të ofertës së përgjithshme i propozon lidhjen e kontratave një numri të pacaktuar dhe të pakufizuar të personave; klauzolat kontraktuese janë pjesë përbërëse dhe të formuluar njëanësisht (nga pala në pozitë më të fortë ekonomike) që pala tjetër t'i pranojë ashtu siç janë (en blanc) në tërësi apo ti refuzojë tërësisht.

Kontratrat formulare. Janë lloj i kontratave të cilat zakonisht i lëshojnë organizatat e ndërmarrjet e ndryshme ekonomike dhe financiare të cilat kanë një numër të madh të klientëve. Kontratrat formulare janë të përpiluara në mënyrë mjaft koncize dhe racionale në bazë të përvojës së gjatë të punës së tyre, që afarizmi të kryhet më shpejt dhe është me rëndësi se këta formularë i parashohin situatat e shumta të cilat mund të paraqiten nga marrëdhënia juridike me klientët e tyre në përgjithësi. Sipas rregullit nuk lejohet që të bëhen përjashtime nga këta formularë (me çka nënkuptohet se vërejtjet dhe rezervat e klientëve nuk pranohen). Ka raste të formularëve të caktuar ku është e mundur që klientëve t'u jepet mundësia e orientimit të zgjedhjes së disa varianteve që gjithashtu të gjitha dobitë shkojnë në favor të palës së fortë ekonomike. Këto kontrata zakonisht i përdorin bankat, ndërmarrjet hoteliere dhe të udhëtareve, të transportit etj.

Kontratrat tipe. Janë kontrata të cilat i rregullojnë marrëdhëniet e ndryshme biznesore në mënyrë "uniforme" të njëjta në ndonjë veprimtari ekonomike, si kontrata tipe për dërgimin e drithërave, pambukut, drunjëve të prerë etj.

Kontratrat e standardizuara. Janë kontrata të cilat për dallim nga dy llojet e kontratave të lartpërmendura lënë mundësi të konkretizimit të disa kushteve (zakonisht ato duhet të plotësohen në formulare). Mirëpo, duhet pasur kujdes sepse janë të formuluar nga ekspertët janë të njëanshme do të thotë në dobi të formuluesit.

Duhet përmend se të gjitha format e kontratave të cilat i kemi cekur (tipe, formulare dhe të standardizuara) janë rezultat i zhvillimit ekonomik dhe i qarkullimit të të mirave materiale me një shpejtësi dhe racionalitet dukshëm më të madh se sa në kohërat e kaluara. Ndërhyrja e institucioneve shtetërore që të kontribuojnë rreth sajimit të paqartësive, parregullsive, klauzolave kushtëzuese etj, është pothuajse e logjikshme dhe e domosdoshme sepse në këtë mënyrë mbrohet interesi i konsumatorit dhe i personave të tjerë fizik dhe juridik që punojnë në suaza të korrektesisë profesionale.

Kontratrat elektrone (Kuptimet themelore)

Pasi që shumë njerëz këtyre ditëve bëjnë biznese në internet, kontratat elektronike janë shumë të rëndësishme, sidomos për ata që punojnë në mënyrë të pavarur. Nëse ne do të punonim si të pavarur, atëherë do të duhej të dimë se çfarë janë kontratat elektronike dhe si ti përdorim ato. Pa marrë parasysh se a jemi dizejner web-faqesh, shkrimtar, apo diç tjetër, është me rëndësi të mbajmë azhurnimet me të gjitha aspektet e biznesit tonë të pavarur.




Figura 1. Shemmbull i kontratës elektronike.

Ja disa informata të rëndësishme në lidhje me kontratat elektronike dhe me atë se çfarë me të vërtet duhet të dimë për to. Kontratat elektronike në parim janë të njëjta me kontratat e rregullta. Në fakt ne nuk i nënshkruajmë ato, por përderisa ne shtypim emrin tonë, do të thotë se kemi për synim të nënshkruajmë dokumentin, e që është e njëjta gjë sikur të nënshkruajmë. Ato kanë domethënie të njëjtë si kontratat e rregullta dhe detaizojnë specifikat e biznesit apo provave në mes të dy kompanive apo njerëzve. Përmes kontratës elektronike ne jemi në gjendje të detaizojmë specifikat e çmimeve, produkteve, datave si dhe informatave tjera, në të njëjtën mënyrë sikurse tek kontratat e zakonshme. Kontratat elektronike janë po aq legale sa janë edhe kontratat e rregullta, dhe vetëm për shkak se nuk i nënshkruajmë ato, nuk do të thotë se nuk janë reale dhe se nuk kemi nevojë ti përmbahemi termeve në kontratë. Normalisht, format e kontratave mund të gjinden edhe në internet, dhe ato mund ti përdorim duke i shtuar informatat e rëndësishme të kompanisë. Aty kemi mundësi ti ndryshojmë gjërat deri sa kontrata nuk bëhet sipas dëshirës sonë.

Të gjitha kontratat elektronike duhet të shtypen apo printohen të paktën nga një herë, pastaj duhet të ruajmë një kopje të kontratës elektronike në kompjuterin tonë, në një fajll të specifikuar për të gjitha kontratat. Të drejtat të cilat janë përfshirë në kontratën elektronike kanë domethënien e njëjtë sikurse kontratat tipike. Shumë njerëz mendojnë se nëse bëjnë biznese online apo përmes internetit si të pavarur, ata nuk kanë nevojë për kontrata. Kjo thjesht nuk është e vërtetë. Kontratat janë shumë të rëndësishme në çdo biznes, dhe ne duhet ti përfshijmë në çdo punë që bëjmë. Në këtë mënyrë ne mund të mbrojmë vetën dhe klientët nga mosmarrëveshjet që mund të shfaqen më vonë.

Terms of Use

No warranty, explicit or implied, is made with respect to the completeness or accuracy of the data contained in this site, and FreePatentsOnline.com will not accept responsibility for any actual or consequential damages that may arise from the use of this site. Access of the FreePatentsOnline.com database in an automated manner is not permitted, and may result in banning from the site, as well as legal action. Data from this site may not be resold or redistributed. FreePatentsOnline.com reserves the right to ban users from this site, whether using automated means or not, if, in our sole opinion, they are abusing our data or database.

Një nga kontratat tipike elektronike që ata të cilët punojnë si të pavarur, nënshkruajnë është një kontratë për mos-zbulim

Account Sign up

Sign up for your free account, and get an opportunity to save searches, save documents into portfolios, make notes on your portfolios, set up alerts to be notified of new documents of interest, batch export data to excel and share your portfolios with other users and much more...

The fields marked * are mandatory.

Name: *

Password: * [Minimum 6 characters] ?

Retype Password: *

Occupation: *

Email: * [Use an existing email address]

Email: *

Company Name:

Address 1:

Address 2:

City:

State:

Zip code:

Country:

Phone number:

Fax number:

I have read and understood the [Terms of Use](#) *

apo NDA. Kjo thjesht e potencon se ne nuk do ti tregojmë askujt për informatat mbi klientin që i mësojmë deri sa jemi duke punuar për të. Ja një shembull, nëse jemi duke i dizajnuar klientit një webfaqe apo logo, brenda saj ne do ti kemi informatat në lidhje me kompaninë që ai apo ajo do të fillojë. Ne vetëm pajtohemi ti mbajmë këto informata konfidente. Kontratat elektronike janë pjesë e rëndësishme e botës biznese të pavarur, por rëndësi të njëjtë ka të dihet se çka janë ato

(http://www.snapcontract.com/article/E_Contracts_101_Understanding_the_Basics)

Principet e Pranuara të Marrëveshjeve Elektronike

Ky paragrafë përshkruan pesë principet të cilat janë esenciale për përmbushjen e kërkesave të domosdoshme dhe të pranuar, siç kërkohet nga legjislati i nënshkrimit elektronik dhe standardeve të themeluara legale. Këto principe janë të zbatueshme në gjashtëmbëdhjetë kritere të matjeve të cilat mund të përdoren për të bërë vlerësimin se dizajni për procesin e formimit të kontratës elektronike do të nxjerrë kontratat elektronike legalisht të pranuar.

Principet e pranueshmërisë së kontratave elektronike janë:

Principi i 1: Siguria e Nënshkrimit Elektronik në lidhje me sigurinë teknike të vetë nënshkrimit elektronik.

Principi i 2: Kontrolli i Vetëm mbi Aktin e Nënshkrimit në lidhje me atë se a ka qenë nënshkrimi i përdorur i aplikuar nga vetë nënshkruesi.

Principi i 3: Konstatimi i Pëlqyer i Informimit në Aktin e Nënshkrimit ka të bëjë me gjendjen mendore të nënshkruarit në kohën kur nënshkrimi është aplikuar.

Principi i 4: Zinxhiri Digjital i Pranueshmërisë ndërlidhet me atë se a ka qenë shkalla e besueshmërisë e procesit të përpunimit të kontratës e mjaftueshme për qëllimet e kontratës.

Principi i 5: Besueshmëria e Kontratës Elektronike i referohet kapitullit dhe konservimit ligjorë të të dhënave elektronike të procesit krijues të kontratës.

Formimi i kontratave elektronike

Kontratat mund të formohen me pajtim oral ose në të shkruar. Ato mund të nënkuptohen edhe nga sjellja e palëve. Dhe, me arritjen e komunikimeve online, ato mund të formohen në mënyrë elektronike. Një llojllojshmëri e procedurave janë në disponim për formimin e kontratave elektronike:

E-maili – me shkëmbimin e e-mail komunikimeve, palët mund të krijojnë kontrata të vlefshme. Oferta dhe pranimi mund të shkëmbehen plotësisht përmes e-mailit, ose mund të kombinohen me dokumente në letër, faks dhe diskutime orale. Forumet e ueb faqeve – në shumë raste operatori i ueb faqes do të ofrojë të mira ose shërbime për shitje, të cilat konsumatorët i porosisin me mbushjen dhe transmetimin e formës së porosisë në ekranin e kompjuterit. Pasi që prodhuesi të pranojë porosinë, formohet kontrata. Pastaj të mirat ose shërbimet mund të dorëzohen fizikisht tek konsumatori. Marrëveshjet në tregjet online, ku kontratat elektronike gjithashtu mund të formohen me ndonjë proces online. Për shembull, një prodhues mund të ofroj softuer ose ndonjë përmbajtje tjetër digjitale online, që i nënshtrohet një pajtueshmërie përmes ndonjë forme. Shfrytëzuesi për të shkarkuar mund të ketë nevojë të pranojë formën e pajtueshmërisë.

Shkëmbimi elektronik i të dhënave – përfshin shkëmbimin e drejtpërdrejtë elektronik të informatave në mes të kompjuterëve, pra, shënimet formatizohen duke përdorur protokollet standarde ashtu që të mund të implementohen drejtpërdrejtë nga kompjuteri pranues. Shkëmbimi elektronik i të dhënave shpesh përdoret për transmetimin e porosive, pranimeve, faturave dhe shënimeve tjera standarde, duke zvogëluar kështu punën me letra dhe mundësinë për gabime njerëzore. Këto shkëmbime mund të krijojnë kontrata të detyrueshme.

Agjentët elektronik – kontratat gjithashtu mund të krijohen me përdorimin e ndonjë agjenti elektronik nga njëra ose të dyja palët. Agjent elektronik është softueri i cili përdoret në mënyrë të pavarur për të nisur një aksion ose për tu përgjigjur në një porosi elektronike pa intervenim të ndonjë individi në kohën e aksionit, përgjigjes ose ekzekutimit. Akti uniform i transaksioneve të informatave kompjuterike, pranon se kontrata mund të formohet në mes të një individi dhe një agjenti elektronik, ose në mes të dy agjentëve elektronik, edhe nëse asnjë individ nga cilado palë nuk është i njoftuar për veprimet e agjentit. Për aq kohë për sa agjentët angazhohen në veprimet që bëjnë të ditur për pajtim, ose ndonjë individ në bashkëveprim me një agjent elektronik personi duhet të dijë se kjo në mënyrë të qartë cakton pajtueshmëri, dhe formon kontratë.

Ofertat dhe pranimet online

Kontrata elektronike mund të krijohet në cilëndo mënyrë të mjaftueshme për të shfaqur pajtueshmëri, duke përfshirë ofertë dhe pranim, ose sjellje që miraton ekzistencën e kontratës. Njëllë, parimet ligjore tradicionale mbi formimin e kontratës vlejné edhe për ambientet e kontraktimit elektronik. Ato pa dyshim pranojnë kontratat elektronike me ripohimin e rregullit të përgjithshëm se kontrata mund të formohet në cilëndo mënyrë që është e mjaftueshme për të treguar pajtueshmëri. Në mënyrë tipike, kontrata formohet kur njëra palë bën ofertë, e cila pranohet nga pala tjetër.

Ofertat

Ofertat e kontratave mund të bëhen në mënyrë orale, me shkrim ose me sjellje. Nuk ka ndonjë arsye përse një ofertë e transferuar në mënyrë elektronike do të ishte më pak e vlefshme se ajo e bërë me gojë ose shkrim. Që të jetë e vlefshme, oferta duhet t'ia komunikojë personit që e pranon atë se në momentin kur pranohet oferta, krijohet kontrata.

Pranimet – E-mail, klikimi dhe metodat tjera

Oferta mund të pranohet “në cilëndo mënyrë dhe me cilindo medium të arsyeshme për rrethanat”. Pranimet tipike off-line përfshijnë komunikimet orale dhe të shkruara, si dhe pranimi me sjellje. Homologët e tyre online përfshijnë pranimin me e-mail ose formate tjera të porosive elektronike, dhe pastaj me sjellje si për shembull klikimi i butonit ose shkarkimi i përmbajtjes.

Gjykatat duhet të konsiderojnë pranimin me e-mail si një praktikë të arsyeshme, ngase nëse oferta bëhet përmes e-mailit, pala duhet të jetë në gjendje ta bëjë pranimin me të njëjtin mjet. Por çfarë mund të ndodhë nëse oferta është bërë përmes ndonjë metode tjetër, siç është letra ose faksi? Pranimi nuk ka nevojë që doemos të dërgohet në mënyrë të njëjtë si oferta. Sidoqoftë, për shkak tëtributeve speciale të e-mailit, gjykatat me gjasë do të vendosin për secilin rast duke u bazuar në rrethanat. Për tu bindur, është mirë të konfirmojmë praktikën e preferuar të personit para se të supozojmë se përgjigja me e-mail do të jetë e përshtatshme.

Më pastaj një sjellje siç është përdorimi i miut për të klikuar një buton, vendosja e ndonjë simboli ose kodi, ose shkarkimi i materialit, gjithashtu mund të konsiderohen si mënyra të rregullta për pranimin e ofertës online. Sipas rregullit të përgjithshëm, kontratat mund të formohen dhe pranohen me sjellje, nëse është e arsyeshme për rrethanat e krijuara. Kontratat mund të pranohen me lëvizje të kokës ose me tundje (shtrëngim) të duarve, dërgimin ose depozitim të çekut, dërgimin e porosisë së blerjes, dërgimin e të mirave, ose me aktin e marrjes së produktit nga rafti. Njëri mund të pranojë licencën edhe me hapjen e pakos, natyrisht në disa rrethana të caktuara. Heshtja e paprerë vet nuk do të krijojë kontratë.

Sidoqoftë, llojet e veprimeve që janë zakonisht të përfshira në transaksionet online – klikimi, shkarkimi – janë më të paramenduara se sa vetë heshtja, dhe duhet të trajtohen si forma të rregullta të pranim, varësisht prej situatës.

një blerje elektronike nga prodhuesi. A duhet porosia e tillë të trajtohet si e detyrueshme? Përderisa në të vërtetë nuk mund të diskutojmë për ndonjë rast konkret, një rast i ngjashëm ka mbështetur vlefshmërinë e përtëritjes së kompjuterizuar të policës së sigurimit. Gjykata, duke argumentuar se kompjuteri vepron vetëm në përputhshmëri me informatat dhe drejtimit e dhëna nga programorët, e ka gjetur kompaninë e sigurimeve të detyrueshme për përmbushjen e lajmërimeve mbi ripërtëritjen e sigurimeve të gjeneruara nga kompjuteri.

Kompjuterët gjithashtu mund të gjenerojnë pranime. Sidoqoftë, ato do të analizohen njëllor sikurse edhe plotësuesit e tyre të gjeneruar nga njeriu – nëse është porosia një pranim ose thjesht dëftesë e pranim. Në shumicën e rasteve do të varet nga natyra e përgjigjes. Për shembull, në një rast të porosisë kompjuterike, porositë bëhen përmes telefonit, dhe sistemi në mënyrë automatike gjeneron një numër përcjellës për porosinë. Kur shitësi refuzon të plotësojë porosinë e blerësit, blerësi ankohet. Gjykata vendosi se kontrata nuk ishte krijuar, për shkak se numri përcjellës ishte vetëm për lehtësime administrative, dhe jo një pranim i qartë.

Kjo çështje me siguri se do të ngritet edhe gjatë EDI transaksioneve, ku kompjuteri mund të gjenerojë vetvetiu dëftesë të pranim të porosisë së blerjes elektronike. Sidoqoftë, ky lloj i pranim zakonisht vetëm do të thotë se kompjuteri ka pranuar porosinë në formën në të cilën mund ta kuptojë. Ajo nuk do të thotë medoemos që porosia është pranuar. Sidoqoftë, llojet tjera të EDI mesazheve, siç është pranimi i porosisë, do të ishin pranime të pranueshme.

Ngjashëm, UCITA pranon se kontratat mund të formohet në mes të një individi dhe një agjenti elektronik, edhe nëse asnjë individ në përfaqësim të palës tjetër nuk është në njohuri të veprimit të agjentit ose që është duke rishikuar rezultatet.

Minutazhi i pranim – rregulla e kutisë postare

Minutazhi i pranimeve mund të jetë i rëndësishëm gjatë përcaktimit nëse kontrata e bërë është detyruese. Kjo për shkak se oferta në përgjithësi mund të anulohet, nëse ende nuk është pranuar. Por çfarë ndodh nëse personi që ka bërë ofertën e anulon atë, por pranimi i palës tjetër është tashmë në kutinë postare? Nën të ashtuquajturin “rregull të kutisë postare”, kontrata është detyruese. Pranimi do të ketë efekt që në momentin që është jashtë kontrollit të dërguesit, nëse ai është dërguar në mënyrë dhe medium të pranuar nga ofertuesi.

A do aplikohet rregulli i kutisë postare për të gjitha pranimet elektronike? Me sa duket ka pak gjasa të jetë kështu, edhe pse për momentin nuk ka raste për të cilat do të mund të kishim diskutuar. Rregulli i kutisë postare aplikohet tek posta dhe telegrafi, por jo edhe për komunikimet të cilat janë në thelb të menjëhershme, siç është telefoni ose faxi.

UCITA gjithashtu adreson edhe minutazhin e krijimit të kontratës si dhe efektshmërinë e mesazhit. Në pranim të natyrës gati të menjëhershme të komunikimeve elektronike, ajo ndryshon rregullën e kutisë postare dhe siguron se nëse një mesazh elektronik tregon tendencën të jetë detyrues, kontrata ekziston kur përgjigjaqë bën të ditur pranimin pranohet nga dërguesi. Ajo gjithashtu siguron se një mesazh elektronik është efektiv në momentin që pranohet, edhe nëse asnjë individ nuk është një njohuri mbi pranimin e tij, sikurse edhe rregulli me postën e bazuar në letër, e cila nuk kërkon hapjen e letres.

Minutazhi mund të jetë i rëndësishëm edhe në rastin kur kontrata cakton një afat për pranimin e saj. Për shembull, në një rast, një transmetim faksi nuk ishte njoftim efektiv, sepse ishte nisur para skadimit të afatit, por nuk kishte përfunduar deri pas skadimit të tij. Transmetimet elektronike mund të pozojnë probleme të ngjashme, veçanërisht për shkak se mund të ketë vonesa në mes të dërgimit dhe pranim.

Shërbimi i Përgjigjes së Regjistruar

Shërbimi i Përgjigjes së Regjistruar është një mënyrë, vegël apo opsion i cili mund të përdoret gjatë procesit të negociimit dhe transaksionit. Ky shërbimi krijon një “Shtrëngim-Duarsh Digjital”™ duke incizuar një regjistër autentik të transaksionit apo negociimit.

Regjistron marrëveshjen në mes të dy palëve përmes e-mailit, plotësisht në mënyrë elektronike. Për më tepër, dërguesi mund ti mundësojë ÇDO pranuesi (marrësi) të përgjigjet përmes E-mailit të Regjistruar® pa ndonjë softuer të posaçëm, procedurë, apo orvatje gjatë gjenerimit të Pranimit të Regjistruar™ për marrësin.

NUK kërkon asnjë angazhim shtesë gjatë gjenerimit nga marrësi;

Ofron të dyja palëve zbuluesin e zbrazëtirave apo gabimeve në regjistrin elektronik gjatë gjithë negociimit, marrëveshjes, dialogut;

Marrësi (pranuesi) nuk duhet të jetë i ndërlidhur me shërbimin RPost™.

Shërbimi i Përgjigjes së Regjistruar™ mund të eliminojë procesin e printimit -> nënshkrimit -> dërgimit me fax -> dhe thirrjes për konfirmim të marrjes së faxit – në çdo kohë kur dërguesi ka nevojë të “dokumentoj” një marrëveshje shtrëngim-duarsh apo mirëkuptim në mes të dy palëve.

Me Shërbimin e Përgjigjes së Regjistruar™, dërguesi i mundëson marrësit të përgjigjet në një e-mail specifik përmes E-mailit të Regjistruar® në atë mënyrë që të dyja palët do të marrin një “Pranim të Regjistruar™” i cili dokumenton transaksionin e plot.

Një shembull gjuhësor që mund të përdoret për të kryer një kontratë apo për blerje duke përdorur Shërbimin e Përgjigjes së Regjistruar si në shembullin në vijim:

I nderuari XXXX,

Faleminderit për porosinë tuaj.

Nëse pajtoheni dhe e pranoni kontratën/porosinë për blerje të përfshirë në fajllin e bashkangjitur dhe në lidhje me këtë e-mail, ju lutem përgjigjuni këtij e-maili;

Shtypni “Nëpërmjet kësaj, pajtohem dhe miratoj të gjitha kushtet dhe rrethanat siç janë paraqitur në këtë e-mail, e-mailat e ndërlidhur si dhe attachmentet (të bashkangjiturat) vijuese për E-SIGN (nënshkrimin elektronik) dhe statutet e UETA*”. Pastaj shtypni emrin tuaj, i përcjell me, “pranon për dhe në emër të” dhe vazhdon me emrin tuaj të plotë.

Send (Dërgo)

E kam dërguar këtë e-mail elektronik të nënshkruar dhe “Regjistruar” me Shërbimin e Përgjigjes së Regjistruar. Pasi të përgjigjeni siç ceket më lartë, ju do të merrni një Dëshmi të Regjistruar të cilën mund ta ruani në formatin elektronik si një zbulues i zbrazëtirave apo gabimeve, vulosën kohore, regjistruesin elektronik të kësaj marrëveshje.

Nënshkruar, XXXX

*([Uniform Electronic Transactions Act](#) - Akti Unik i Transaksioneve Elektronike)

Ky shërbim i së ardhmes është plotësisht unik në treg dhe funksionon pa marrë parasysh sistemin e e-mailit të pranuesit apo ISP. Mund të përdoret për çdo marrës (pranues) dhe çdo e-mail adresë.


Është një RPost i ndërtuar në atë mënyrë që nuk kërkon ndonjë softuer special apo password (fjalëkalim) dhe pranuesi apo marrësi nuk ka nevojë për asgjë tjetër

9.16.5. Shtrëngimi-Duarsh Digjital

Për të krijuar një “Shtrëngim-Duarsh Digjital”™ me marrësin, vetëm duhet shtypur (R+)™ në fillim të hapësirës për temën apo subjektin të çdo e-maili (instalohet në server), ose klikohet në Send (R)egistered™ butonin (tastierën) në programin e e-mailit (instaluar në desktop) dhe pastaj zgjedhim shërbimin e “përgjigjes së Regjistruar™” (origj. "Register Reply™" service).

Hapi 1:

Hartoje mesazhin, shtyp “Send (R)egistered” (dërgo regjistrimin) dhe kliko në “Register Reply™” katrorin kontrollues




Hapi 2:

E-maili i marrësit është identik me mesazhin në E-mailin e Regjistruar® përveç fjalisë, “Përgjigja e juaj këtij mesazhi do të regjistrohet” në pjesën e lartë.



Hapi 3:

Dërguesi ka para autorizuar marrësin (pranuesin) e mesazhit të E-mailit të Regjistruar® ti përgjigjet dërguesit original me mesazh të E-mailit të Regjistruar® edhe pse marrësi nuk e ka RPost® në sistemin e tyre. Marrësi thjeshtë shtyp “Reply” shtypë përgjigjen dhe shtypë emrin e tyre, dhe në fund shtypë dërgo.



Hapi i Hapi i 4

RPost® i dërgon të dyja palëve e-mailin me Vërtetim të Regjistruar™ duke incizuar një regjistër autentik të transaksionit apo negociimit.



Vlefshmëria e kontratave elektronike

Kontratat elektronike dhe nënshkrimet elektronike janë legale dhe të detyrueshme po aq sa edhe kontratat tradicionale në letër të nënshkruara me ngjyrë shkrimi. Në shumë vende, ligje të tëra janë shkruar dhe aprovuar për të larguar mëdyshjen që qëndronte mbi kontratat elektronike²⁷.

Shumica e këtyre ligjeve të aprovuara në fillim të mileniumit të ri bënë kontratat elektronike ligjërish të vlefshme sikurse edhe kontratat në letër, gjë që ishte lajm i madh për kompanitë që bënin biznes online, veçanërisht për kompanitë që kryenin shërbime financiare, të sigurimit, dhe shtëpiake për konsumatorë. Ligji ishte i mirëseardhur për ueb faqet biznes-biznes të cilat kishin nevojë për marrëveshje të detyrueshme për porositjen e furnizimeve dhe shërbimeve. Për të gjitha kompanitë tjera, ligjet mundësuan kryerjen e biznesit tërësisht përmes internetit. Kjo kishte si rezultat kursime të konsiderueshme për bizneset, të cilat mund të kalohen edhe tek konsumatorët. Për shembull, një kompani online llogariti se eliminimi i tarifave të punës me shkresa zvogëloi koston e përpunimit të kredisë për shtëpi për rreth 750 dollarë.

Kontrata elektronike është një marrëveshje e krijuar dhe “nënshkruar” në formë elektronike – me fjalë të tjera, nuk përdoret asnjë letër ose ndonjë kopje në letër. Për shembull, e shkruajmë një kontratë në kompjuter dhe ia dërgojmë me postë elektronike ndonjë bashkëpunëtori në biznes, dhe i njëjti e dërgon prapë tek ju pas një nënshkrimi elektronik i cili tregon pranimin e saj. Një kontratë elektronike gjithashtu mund të jetë edhe në formë të butonit të ashtuquajtur “Click to Agree” (kliko për tu pajtuar), që shpesh përdoret gjatë shkarkimeve në internet, ku shfrytëzuesi duhet të klikojë butonin “I Agree” (pajtohem) në faqen e cila ofron kushtet e licencës softuerike para se të përfundohet transaksioni.

Për shkak se nënshkrimi tradicional me ngjyrë nuk është i mundur në kontratë elektronike, njerëzit përdorin mënyra të ndryshme për të dëshmuar nënshkrimet e tyre elektronike, duke përfshirë shkrimin e emrit të nënshkruesit në pjesën për nënshkrim, vendosjen e një imazhi të nënshkrimit të skanuar, klikimit të butonit “I Accept”, ose përdorimit të teknologjive të ndryshme kriptografie.

Nënshkrimi i kontratave elektronike

Biznesi elektronik përballet me problemin e nënshkrimit të kontratave elektronike. Tri qasjet kryesore në udhëheqjen me kontratat elektronike përfshijnë:

Mos përdorimin e protokolleve të besueshme nga pala e tretë Përdorimin e protokolleve shumë të besueshme të palës së tretë Përdorimin e protokolleve pak të besueshëm

Një problem tjetër që shfaqet te biznesi elektronik është dizajni vetë- implementues i kontratave.

Kontratat janë vitale për biznesin. Çdo marrëveshje në mes të dy ose më shumë njerëzve duhet të përfshijë kontratën. Gjërat e thjeshta, siç është pritja e shoqes të vjen në klasë, janë shembuj të kontratës së implikuar. Kontratat tjera janë më formale dhe të nënshkruara nga të dyja palët që marrin pjesë. Pas pajtimit me kontratë, secila palë mund të sillet në pajtueshmëri që pala tjetër të përmbushë pjesën e vet.

Kontratat e shkruara krijojnë mekanizma të cilat lejojnë palët të tejkalojnë mosbesimin në njëri tjetrin, pasi që sjellja jo e rregullt e tyre do të kuptohej. Pasi të jenë shkruar njëherë, kushtet e marrëveshjes nuk mund të harrohen.

Në rastet e mashtrimit ose polemikës, “kontrata” në të vërtetë i referohet asaj pjese të letrës të cilën të gjithë e kanë nënshkruar. Letra është certifikatë bindëse për një vështrues të paanshëm, sikurse që është gjykatësi, se marrëveshja në vërtetë kishte ndodhur.

Me kalimin e numrit gjithnjë e më të madh të bizneseve online, edhe kontratat do të lëvizin gjithashtu në përcjellje të trendit në rritje. Çdo herë që ndonjëri bën porosi nga ndonjë shitës online, krijohet kontrata e cila premtos shkëmbimin e parave për ndonjë të mirë ose shërbim. Këto lloje të kontratave elektronike bëjnë të mundshëm biznesin elektronik.

Kontratave elektronike parashtojnë vështirësi speciale. Offline, shumë kontrata nënshkruhen fytyrë-me-fytyrë. Të gjitha palët që nënshkruajnë kontratën mund të jenë relativisht të sigurt se pala tjetër është ajo që pretendon se është, dhe se formulimi i kontratës në të vërtetë ishte i pajtuar nga të dyja palët, dhe se përfundimisht, të gjithë kanë nënshkruar kontratën. Asnjë nga këto të thëna më lartë nuk vlen kur kalojmë online (në internet).

Kjo është ndoshta problemi më i rëndë: si mund të dinë palët kontraktuese se secila ka nënshkruar kontratën e njëjtë? Trajtimi i qartë do të ishte të bëjmë po të njëjtën gjë që e bëjmë edhe offline. Kjo do të jetë në fokus pra në vazhdim të këtij punimi.

Dështimi i kontratës së “nënkuptuar”

Një formë e “nënkuptuar” e kontratës online do të pasqyroste mënyrën e bërjes së kontratës në jetën fizike. Të supozojmë se dy palë Trimi dhe Shpresa, dëshirojnë të krijojnë kontratë. Së pari Trimi dhe Shpresa së bashku shkruajnë kontratën, ose i angazhojnë avokatët ta bëjnë atë punë. Tani të dy e kanë nga një kopje të pa nënshkruar të kontratës. Pastaj, Shpresa nënshkruan kopjen e saj të kontratës dhe e dërgon atë te Trimi. Kur ai pranon kontratën e nënshkruar, nënshkruan kopjen e tij dhe ia dërgon atë Laurës. Pastaj Shpresa kontrollon kontratën e nënshkruar për tu bindur se është ajo kontratë të cilën ajo dëshironte që Trimi ta nënshkruaj. Trimi kontrollon kontratën e marrë nga Shpresa për të vërtetuar nëse ajo është kontrata e dëshiruar. Shpresa pastaj nënshkruan kontratën që ka nënshkruar Trimi dhe ai nënshkruan kontratën që ka nënshkruar Shpresa dhe i shkëmbejnë kopjet e nënshkruara.

Tani të dy, Shpresa dhe Trimi kanë nga një kopje të kontratës të cilat të dy i kanë nënshkruar. Mirëpo ky protokoll nuk funksionon gjithnjë. Ja një shembull pse nuk do të funksiononte:

Një ditë Shpresa dhe Trimi dëshironin të nënshkruajnë kontratë. Shpresa i dërgoi një email Trimit dhe thoshte se po vë bast se një ekip futbollit do të fitojë në një garë. Trimi mendoi për pak kohë dhe pranoi me kusht që nëse humbas Shpresa duhet të ia dhuronte tërë koleksionin e librave që kishte. Pas ca mendimesh ata u pajtuan të formojnë kontratë të vërtetë, në rast se ndonjëri nga ta “ftohën” nga marrëveshja.

Shpresa dhe Trimi formuan kontratën. Shpresa e nënshkroi kopjen e saj dhe ia dërgoi Trimit. Pastaj ai filloi të presë përgjigje nga Trimi, por përgjigja nga Trimi nuk erdhi.

Të supozojmë se të nesërmen, ekipi i Laurës mundi ekipin e Trimit dhe Shpresa ia dërgon një email Trimin me kopjen e kontratës të bashkangjitur. Sipas frikës që kishte i erdhi edhe përgjigja në emailin e dërguar. “Oh kjo na qenka kontrata, ..., unë kam menduar se ke ndërruar mendjen, në të vërtetë nuk ka marrë asgjë nga ti”.

Ose mund të ndodhe edhe që ekipi i Trimit të fitojë, dhe që Shpresa të merr email me përmbajtje “Do të vijë pasdite të mbledh koleksionin tuaj të librave”. Dhe me siguri se Shpresa do të ishte shumë e hutuar në të dyja rastet e përmendura.

Moskuptimet e mundshme

Kur Trimi nuk u përgjigj, Shpresa supozoi se ai nuk e kishte pranuar kopjen e kontratës. Në të vërtetë, Trimi priste që të shohë se a do të i pëlqente rezultati për të cilin bënte fjalë kontrata. Vetëm pasi u sigurua se rezultati ishte ai që kishte pritur ai vendosi të respektojë kontratën. Ai mund ta bënte këtë vetëm sepse Shpresa ishte e obliguar ndaj kontratës para Trimit. Vëreni se Shpresa nuk kishte mënyrë si të përcaktonte nëse dështimi i Trimit ti përgjigjet ishte qëllim-keq. Për më shumë, ajo nuk ka mjete ti bindë të tjerët mbi veprimet keqdashëse të tij. Kjo paraqet problemin e nënshkrimit të kontratës.

Problemi i nënshkrimit të kontratës

Mungesa e atomecitetit është shkak i problemit të nënshkrimit të kontratës. Të themi se vargu i veprimeve është atomik do të thotë se ose të gjithë nga këta ndodhin ose të mos ndodh asnjëri nga ata. Kur dy palë janë të lidhur njëri me tjetrin përmes një rrjete mundësisht jo të sigurt, duke siguruar se atomeciteti të bëhet problem serioz.

Në problemin e nënshkrimit të kontratës, janë dy ose më shumë palë të cilat mundohen të pajtohen mbi një kontratë. Secila palë do të nënshkruajë në mënyrë digjitale kontratën për të sinjalizuar pajtimin e tyre me kontratën.

Një variant e problemit të nënshkrimit të kontratës është problemi i recetës së kthyer ose problemi i postës së certifikuar. Këtu, Shpresa i dërgon email Trimit, dhe ajo dëshiron të marrë një dëshmi se Trimi ka pranuar porosinë e saj. Kjo është vendimtare për aplikacionet e tilla si thirrjet ose biznesi i porosive me postë elektronike. Protokollin e recetës së kthimit mundohet të na sigurojë se Trimi merr postën vetëm nëse Shpresa e merr recetën e cila do të bind të gjithë se Trimi në të vërtetë ka marrë emailin.

Të dy këto raste mund të mendohen si raste speciale të problemit të shkëmbimit të ndershëm: Shpresa dhe Trimi të dy pra kanë diçka që tjetri dëshiron. Ata dëshirojnë të shkëmbejnë artikujt e tyre ashtu që Shpresa të marr artikullin e Trimit nëse dhe vetëm nëse Trimi merr artikullin e Laurës. Në rastet e kontratës, artikulli është nënshkrimi në kontratën e ndarë. Të gjitha këto kanë problemin e njëjtë në marrëdhënie me mungesën e atomecitetit që përmendëm më sipër.

Korrigjimi i problemit

Në këtë pikë, vërejmë se problemi është i pavarur nga mjetet e ndryshme kriptografie që përdoren për nënshkrimin e kontratave. Ai është i pavarur nga cilido lloj i parasë që përdoret për përmbushjen e kontratës.

Nuk ka rëndësi nëse nënshkrimi është krejtësisht i paharrueshëm, ose nëse paratë janë kundër- falsifikatore. Detajet e sakta të kryerjes së nënshkrimeve digjitale do të konsiderojmë si të pavenda. Vetë kriptografia nuk do të zgjidh problemin e kontratave.

Në vend të kësaj, afrimi më i mirë është të përdoren mjete kriptografie për të ndërtuar protokolle: proceset e specifikuar në mënyrë eksplicite për zgjidhjen e problemeve.

Ky problem nuk është i ri për biznesin elektronik. Problemi i njëjtë i atomitetit ekziston edhe me kontratat që bëhen përmes faks makinave ose telefonave. Në këto raste, sidoqoftë, shpesh dy palët kontraktuese njohin njëra tjetrën dhe kanë bërë biznes më herët. Nëse faks makina e Trimit dështon, Shpresa mund ta thërras atë në telefon dhe të pyes se çfarë ka ndodhur. Nëse Trimi refuzon të përgjigjet, Shpresa fillon të dyshojë. Ngase të dyja palët njohin njëra tjetrën, ato kanë një varg më të gjerë të aktiviteteve që mund të ndërmarrin.

Në ligjin e SHBA-ve, ky problem është i njohur nga kodi uniform i biznesit. Kontratat që kalojnë vlerën prej 500 dollarëve që kryhen përmes kabllave kërkojnë kontratë të ndarë të shkruar. Kontratat elektronike biznes-biznes manovrohen nënshkrimin e kontratave të tilla të cilat specifikojnë llojin e sistemeve elektronike të shkëmbimit të të dhënave dhe të provizioneve në rast të dështimit të sistemit. Kjo jo vetëm që i bën kontratat të detyrueshme nga aspekti ligjorë, por kjo gjithashtu i jap palëve siguri se çdo gjë do të punojë sipas pritjeve.

Kjo situatë nuk qëndron zakonisht, për shkak se Shpresa dhe Trimi mund të mos njohin njëri tjetrin. Në veçanti, konsideroni rastin e tregtarit i cili dëshiron të kujdeset për shumë konsumatorë të ndryshëm online. Është jo-praktike për tregtarët të krijojnë kontrata të ndara të shkuara për secilin konsumatorë. Në të njëjtën kohë, tregtari dhe konsumatori kanë nevojë të jenë të sigurt se mund të krijojnë ndonjë lloj kontrate. Kjo është ku protokollet për nënshkrimin e kontratave janë të dobishme.

Nënshkrimet elektronike dhe ato digjitale

Nënshkrimi - është një shkrim i stilizuar i lidhur me personin. Është i krahasueshëm me një vulë apo ngjitëse vulë. Në tregti dhe në drejtësi, nënshkrimi në dokument është indikacion që personi pajtohet me qëllimet e paraqitura në dokument. Nënshkrimi Elektronik

Nënshkrim elektronik është çdo mjet elektronik i pranuar me ligj që tregon se personi miraton përmbajtjen e mesazhit elektronik. Nënshkrimi elektronik përfshin të gjitha llojet e nënshkrimeve elektronike si: emri i shtypur, e-mail adresa, nënshkrimi digjital apo nënshkrimi i skanuar.

Termi nënshkrim elektronik ka disa kuptime. Sipas ligjit të SHBA-ve nënshkrimi elektronik nënkupton “një tingull elektronik, simbol ose proces, i ngjitur ose i bashkangjitur në mënyrë logjike me një shënim dhe i ekzekutuar ose i adaptuar nga një person me qëllim të nënshkrimit të shënit.” Ky definicion vjen nga Akti Uniform i Transaksioneve Elektronike ose UETA (ang. Uniform Electronic Transactions Act) dhe për herë të parë u përdor në vitin 1999.

Vet koncepti nuk është edhe aq i ri. Shumë ligje në Evropë dhe botë përmbajnë referenca për nënshkrime telegrafi ose nënshkrime të faksuar, disa bile edhe në mesin e shekullit të 19-të. Për më shumë, në SHBA ka propozime që shënimet dhe nënshkrimet elektronike të jenë të pranueshme edhe në gjykatë.

Në drejtësi, nëse kontestohet nënshkrimi në kontratë ose ndonjë dokument tjetër, nënshkrimi duhet të përmbush disa teste të caktuara para se gjykata të bazohet në to. Këto kërkesa dallojnë varësisht nga juridiksioni, por llojet e ndryshme të nënshkrimeve, disa edhe plotësisht elektronike, telegrame, dhe faksimile të dokumenteve, bile edhe në disa raste të pa nënshkuara nga dërguesi.

Pyetje qendrore në këto raste është falsifikimi dhe aprovimi i rremë, dhe në këto vendime, gjykatat kanë vendosur se falsifikimi dhe aprovimi i rremë mund të përjashtohen nga praktika. Për më shumë, është shumë lehtë e mundshme, për shumë mënyra elektronike të nënshkrimit, ose për nënshkrimet e ngjitura, të falsifikojnë ose mashtrojnë aprovimin. Problemi gjithnjë e në rritje i vjedhjes së identitetit ilustron shumë nga këto falsifikime. Shpesh, bizneset mbështeten në mjetet tjera për të provuar të sigurojnë se një nënshkrim elektronik është i rregullt, duke përfshirë edhe bisedën e drejtpërdrejtë me personin para se të bëhet nënshkrimi elektronik, sidomos në rastet e vazhdimësisë së biznesit, dhe të pranimit të pagesave ose të indikacioneve tjera të qëllimit të bërjes së biznesit që nuk varen vetëm nga një dokument i nënshkuar.

Nënshkrimet digjitale

Nënshkrimi Digjital është një vlerë numerike dhe unike e bazuar në gjithë dokumentin e shtypur që është nënshkuar. Për shkak të ligjeve të BE dhe Britanisë së madhe, vetëm nënshkrimet digjitale janë të pranueshme si fakte në gjykata. 30

Nënshkrimet digjitale marrin konceptin e nënshkrimit tradicional në letër dhe e shndërrojnë atë në “gjurmë elektronike të gishtërinjve”. Nënshkrimet digjitale mundësojnë migrimin e lehtë prej proceseve të pavalitshme të bazuara në letër drejt një ambienti të sigurt dhe efikas pa-letër.

“Gjurmët e gishtërinjve” ose mesazhi i koduar është unik për nënshkruesin dhe për dokumentin. Kjo siguron se personi i cili ka nënshkuar, është në vërtetë origjinatori i porosisë. Gjurmët e gishtërinjve nuk mund të ri-përdoren ose ti ri- caktohen ndokujt tjetër në cilëndo kohë tjetër. Nënshkrimi digjital autentikon origjinatorin e porosisë dhe përcakton se porosia nuk ishte e ndryshuar pas dërgimit.

Nëse çfarëdo ndryshimi ishte bërë pasi të është nënshkuar dokumenti, ai në mënyrë automatike ka bërë jo të vlefshëm dokumentin dhe në këtë mënyrë do ta mbroj atë nga falsifikimi.

Një dallim i qartë qëndron në mes të nënshkrimeve elektronike dhe atyre digjitale, edhe pse këto dy terme shpesh përdoren në shkëmbim të njëri tjetrit:

Nënshkrimet digjitale (nganjëherë të referuara edhe si nënshkrime elektronike të avancuara ose të sigurta) janë rezultat i një veprimi kriptografik. Teknologjia që qëndron prapa nënshkrimeve digjitale është një standard i industrisë që njihet si Infrastruktura e Çelësit Publik ose PKI (ang. Public Key Infrastructure), e cila garanton integritetin e shënimeve dhe mospranimin e transaksioneve. Nënshkrimi digjital nuk mund të kopjohet, ngatërrohet ose ndryshohet.

Në anën tjetër, nënshkrimet elektronike janë imazhe elektronike që në mënyrë fizike ose logjike i ngjiten të dhënave të nënshkruara. Duke shtuar fjalinë “Unë, Sylë Sylja, nënshkruaj këtë dokument” mjafton që të konsiderohet si nënshkrim elektronik, është e qartë pra se nënshkrimet elektronike janë të lehta për tu falsifikuar, për ndryshim nga nënshkrimet digjitale.

Përmes nënshkrimeve digjitale në mënyrë të lehtë mund të nënshkruajmë në mënyrë digjitale dokumentet, fajllat format dhe transaksionet derisa në të njëjtën kohë jemi të mbrojtur nga falsifikimi i nënshkrimit. Përmes implementimeve të ndryshme të nënshkrimeve digjitale organizatat e ndryshme mund të vendosin nënshkrime në një numër të aplikacioneve siç janë Microsoft Word, Adobe Acrobat etj. Nënshkrimet digjitale “vulosin” dokumentet elektronike, duke siguruar autenticitetin, integritetin dhe besueshmërinë e transaksioneve elektronike.

Përgjegjësia etike në Sistemet e informacionit të Menaxhmentit

Mungesa e vetëdijes për implikimet etike të kohës së informacionit është ajo që do të mund të quhet “mit i kompjuterizmit dhe teknologjisë informative amorale”. Sipas këtij miti kompjuterët nuk janë as të mirë e as të keq dhe kur kompjuteri prishet ose kur softveri ka ndonjë virus nuk duhet fajësuar askënd dhe se çdo gjë që ka të bëjë me teknologjinë informative dhe kompjuterët nuk duhet vlerësuar në aspektin moral.

Miti mund të jetë i kuptueshëm pasi që shumë pak njerëz në biznes ose jashtë tij e kuptojnë kompjuterizmin dhe teknologjinë informative. Ato thjeshtë janë vegla që neve na pëlqen t’i kemi dhe t’i përdorim. Por për përdorimin e tyre nuk marrim kurrfarë përgjegjësie etike.

Kompjuteri aq i përdorur dhe i dobishëm në kohën e informacionit ka kapacitetin që të ndryshoj konceptin tonë për veten dhe të tjerët – konceptin e asaj çka është njerëzore. Si vegla që janë, kompjuterët mund të bëjnë që qeniet njerëzore të jenë plotësisht njerëzore. Por, nëse kompjuterët bëhen modele me të cilin ne masim humanitetin, ata mund të dominojnë mënyrën tonë të menduarit dhe të na bëjnë që të shohim veten si kompjuterë: si ruajtës dhe manipulues të informacioneve, si makina që mendojnë ose robot, të zhveshur tërësisht nga dinjiteti dhe liria.

Informacionet rreth individëve qartazi ngrisin çështjen e intimitetit, informacionet rreth korporatave shpiejnë në problemet që kanë të bëjnë me besueshmërinë e tregtisë dhe spiunimit. Meqë informacioni po bëhet vegël qendrore për marketing, ne jemi të detyruar të ballafaqohemi me dëmet që mund t’i shkaktojmë vetes, shoqërisë dhe marrëdhënieve shoqërore përmes abuzimeve që mundëson teknologjia. Dhe sa më shumë që ngritet rëndësia e informacionit, ne do të kuptojmë sa lehtë mund të rrezikohen këto virtyte.

Fatkeqësisht sabotimi i një korporate ose rrjetit kombëtar të informacionit mund të bëhet më lehtë se sa sabotimi i rrjetit industrial. Lidhjet janë më të dobëta dhe kanë më shumë varësi nga njëra tjetra. Dhe të përmenden ose të ngriten këto çështje nuk do të thotë edhe të zgjidhen ato. Por mund të bëhen analiza dhe të fillohet të kuptohet më lehtë natyra e kohës së informacionit dhe çka ajo sjell si dhe mund të kuptohen të metat e saj për individët dhe për shoqërinë.

9.24.1. Siguria e përdorimit të Sistemeve të informacionit në biznes

Është vështirë për të besuar se jo më larg se para një dekade, shumica e kompanive në mbarë botën ju ofronin punëtorëve të tyre shumë pak ose nuk u ofronin fare qasje në Internet. Në të vërtetë, Interneti ishte duke u bërë një medium i popullarizuar dhe shumë pak veta kanë mundur të parashikojnë se ai aq shpejtë do të ishte i pranishëm kudo, në punët personale dhe biznesore. Ndërmarrjet menaxhojnë qasjen në Internet përmes ‘proxy serverëve’ të instaluar në serverët e përgjithshëm. Edhe sot një përqindje e madhe e kompanive bazohen në këto lidhje.

Kur kompanitë filluan me të madhe të futen në Internet në mes të viteve 1990-ta, ato u mbështeten në teknologjinë ekzistuese. Administratorët u detyruan që të shtonin aplikime të tjera për të përmirësuar sigurinë, për tu mbrojtur nga virusët apo për të filtruar përmbajtjen. Integrimi i këtyre aplikimeve nuk ishte i lehtë dhe në përgjithësi zvogëlonte besueshmërinë në sistemin e tërësisht. Ato sisteme ishin të parapara që të përdoren nga një numër i kufizuar i shfrytëzuesëve dhe kur ai numër u tejkalua, kompanitë u detyruan që të shtonin më shumë sisteme.

Kur kompanitë ndërtojnë sistemet e tyre të qasjes në Internet në këtë mënyrë, dmth duke shtuar numrin e serverëve për qëllime të përgjithshme me softverë të serverëve proxy, ato rrisin shpenzimet hardverike, softverike dhe administrative. Thënë shkurt, më shumë kuti kërkojnë më shumë administratorë për të punuar me to. Pastaj sa më shumë kuti që instalojnë administratorët aq më e komplikuar bëhet infrastruktura e TI-së së kompanisë, dhe kjo në përgjithësi rezulton rënie të besueshmërisë dhe ngritje të shpenzimeve.

Fatmirësisht, punëdhënësit nuk kanë më nevojë të bazohen në serverët proxy tradicional për t’i bërë vend zhvillimit dhe shtimit të shfrytëzuesëve të Internetit. Tani ekzistojnë sisteme të menaxhimit të qasjes në Internet duke bazuar në pajisje të cilat janë shumë më të shkallëzueshme dhe që kombinojnë funksionalitetin e serverit proxy me një varg mundësish tjera përfshirë këtu edhe filtrimin përmbajtjes, dyfishimin e të dhënave, aplikimet e sigurisë, e kështu me radhë.

Zgjidhjet e bazuara në pajisje janë më të besueshme, menaxhohen më lehtë dhe funksionojnë më mirë se serverët me qëllim të përgjithshëm. Dhe çka është më me rëndësi shkallëzueshmëria iu lejon kompanive që të konsolidojnë ngarkesën e shumë serverëve në vetëm një numër të vogël të pajisjeve. Si rrjedhojë ka më pak sisteme për t'u mirëmbajtur, më pak gjëra mund të shkojnë gabim, ka më pak nevojë për mirëmbajtje dhe riparime dhe kohë shumë më të shkurtër të mosfunksionimit të sistemit.

Shumë punëdhënës janë të mendimit se politikat më efektive të qasjes në Internet lejojnë një sasi të kërkimit dhe kërkimit në Internet që nuk ka të bëjë me biznesin. Një arsye për këtë është thjeshtë morali: punëtorët e kënaqur kanë nevojë për llojshmëri dhe pushim, dhe atyre mund t'u duket Interneti shumë më interesant se bisedat në korridore apo vende ku bëhen pauzat gjatë ditës. Përveç punës, punëtorëve u duhet të mendojnë edhe për jetën e tyre të përditshme, e cila shpesh kërkon edhe kryerjen e punëve të ndryshme private gjatë orarit të punës. Nganjëherë ata mund t'i kryejnë ato shumë më shpejt dhe në mënyrë më efektive duke shfrytëzuar Internetin sesa duke u larguar nga zyra ose edhe duke përdorur telefonin e kompanisë.

Filtrimi i përmbajtjes dhe monitorimi i shfrytëzimit poashtu e përmirësojnë produktivitetin e punëtorëve duke zvogëluar kufizimin në kapacitetin e komunikimit. Pasiqë teknologjia e shkurton kohën humbur në kërkimin e Internetit për çështje që nuk kanë të bëjnë me biznesin, ajo ndihmon që të lehtësohet rruga për aktivitet më të shpejt dhe më efikas të biznesit. Por kjo nuk është e vetmja mënyrë me të cilën sistemet e reja të menaxhimit të qasjes në Internet përmirësojnë punën. Disa nga këto sisteme kombinojnë filtrimin me teknologjinë shumë efektive të dyfishimit e cila e shpejton edhe më shumë qasjen dhe navigimin në internet.

Kur klientët hapin ndonjë llogari, kur regjistrohen për të marrë informacione ose për blerë ndonjë produkt nga biznesi juaj, ka shumë mundësi që si pjesë të procesit ata t'u besojnë juve informacione personale. Nëse informacionet e tyre dalin në shesh, pasojat mund të jenë të shumta: klientët mund të jenë në rrezik që t'u vjedhet identiteti i tyre ose atyre mund tu humb vullneti që të vazhdojnë të bëjnë biznes me ju.

Kërcënimet për sigurinë e informacionit janë të ndryshme – hakerët e kompjuterëve, punëtorët e pakënaqur, pakujdesia, etj. Ndonëse mbrojtja e sistemeve të kompjuterëve është një aspekt i rëndësishëm i sigurisë së informacionit, ajo është vetëm pjesë e procesit. Siguria e mirë për bizneset nënkupton vlerësim të rregullt të rrezikut, koordinim dhe mbikqyrje efektive dhe reagim përkatës ndaj zhvillimeve të reja. Hapat themelor në planifikimin e sigurisë së informacionit përfshijnë: Identifikimin e rrezeve të brendshme dhe të jashtme të sigurisë, besueshmërisë dhe integritetit të informacioneve personale të klientëve;

Përgatitja dhe zbatimi i masave mbrojtëse për të kontrolluar rreziqet;

Monitorimi dhe testimi periodik i masave mbrojtëse për tu siguruar që ato janë duke funksionuar në mënyrë efektive; dhe Mbiqyrja e praktikave të përdorimit të informacioneve të provajderëve të shërbimeve dhe partnerëve biznesorë të cilët kanë qasje në informacione personale, kjo do të thotë se nëse i lejon qasje ndonjë organizate në të dhënat tuaja ose në rrjetin tënd kompjuterik, duhet siguruar që ata të kanë edhe programe të mira të sigurisë.

Me rastin e krijimit të programit të sigurisë, biznesi duhet të shqyrtojë të gjitha fushat e rëndësishme të veprimtarisë përfshirë menaxhimin dhe trajnimin e punëtorëve; sistemet informative përfshirë dizajnin e rrjetit dhe softverit dhe procesimin, ruajtjen dhe fshirjen dhe veprimet që përfshijnë parandalimin, zbulimin dhe reagimin në rast të rënies së sistemit.

Ekzistojnë kërcënime serioze për sigurimin e tregtisë në Internet si pasojë e synimit të hakerëve të kompjuterëve që të hyjnë në sistemet kompjuterike. Hakerët janë të shumtë, duke filluar nga gjurmuesit kureshtarë deri te grupet e organizuara mirë dhe të përgatitura teknikisht qëllimi i të cilave është që të kenë qasje në informacionet private në uebfaqen tuaj ose tu pengojnë ju ose klientët tuaj të shfrytëzoni Internetin. Me shtrirjen gjithnjë e më të madhe të Internetit, janë shpeshuar edhe këto lloj sulmesh në informacionet private dhe tregtinë në Internet. Por edhe përpjekjet e qeverive, kompanive të mëdha dhe këshilltarëve të sigurisë janë poashtu intenzive në luftimin e këtij kërcënimi.

Disa pyetjet që mund të shtrohen janë:

Çfarë mund të bëjë një kompani që të mbrohet?

Ekzistojnë një varg hapash që kompania juaj mund t'i marrë por së pari duhet të bëjë vlerësimin e natyrës së biznesit dhe të shikoj se sa janë gjasat e kërcënimit dhe çfarë ndikimi do të kishte ndonjë hyrje e hakerëve në kompjuterët e kompanisë.

Disa pyetje që mund të shtrohen janë:

A është kompania e profilit të lartë?

Kompani të profilit të lartë janë kompanitë me produkt të dalluara ose me identifikim të tipit të kompjuterëve Dell, pastaj Wal-Mart dhe Southwest Airlines.

A bën kompania tregti përmes Internetit?

Nëse kompania varet nga Interneti për të kontaktuar dhe për t'u shitur shitur klientëve, atëherë duhet të planifikohen me kujdes kontrollimet e brendshme për të siguruar që këto transaksione të jenë të sigurta. Hakerët mund të ndërpresin transaksionet në Internet derisa këto janë duke u transmetuar, duke kapur informacione mbi kartelën e kreditit të klientit ose informacione mbi pronarin e ndërmarrjes.

A ka ndonjë nxitës financiar që do shtyente një haker të futet në sistemin e informacionit?

Këtu hyjnë institucionet financiare siç janë bankat, firmat brokere, unionet kreditore, bankat e kursimeve dhe kreditë, ose kompanitë që lëshojnë kartela të kreditit.

Kompanitë që veprojnë në industrinë financiare janë në mesin e atyre kompanive të cilat duhet ta marrin sigurinë e Internetit me shumë seriozitet, sepse ato ua tërheqin vëmendjen njerëzve që mendojnë të shfrytëzojnë njohuritë e tyre për të kryer vepra penale dhe krime. Këtu hyjnë grupet e organizuara të hakerëve që kanë një sasi të konsiderueshme të mjeteve për të sulmuar sistemin tuaj kompjuterik.

Kompania mund të dëshirojë të shqyrtojë mundësinë për softver për të krijuar një "Firewall" në mes të atyre që kanë qasje nga jashtë në sistemin tuaj kompjuterik dhe individëve brenda kompanisë suaj ose klientëve. Këto vegla dallojnë në kompleksitetin e tyre varësisht prej natyrës së informacionit që duhet të mbrohet.

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Krahasimi me rajonin

Evidenca nga literatura tregoi se financimi i siguruar nga tregu bankar paraqet burimin kryesor për ekonominë në tërësi, e posaçërisht për NVM-të të cilat kanë burime të pamjaftueshme në fazat e para të krijimit të tyre, por edhe gjatë stadeve të mëtuqshme të rritjes dhe zhvillimit të tyre. Në bazë të rezultateve të pyetësorëve lidhur me kreditë për sektorin privat dhe publik, është evidentuar fakti se pothuajse 100 % e kredive të dhëna janë të drejtuara tek sektori privat, përderisa në vendet e rajonit, përveç kredive në sektorin privat, bankat gjithashtu bëjnë dhënien e kredive edhe për sektorin publik.

Zgjerimi i kredive për sektorin privat që nga fillimi i funksionimit të industrisë bankare nga viti 2000 kishte një ngritje të jashtëzakonshme deri në vitin 2008, duke vazhduar me një rënie të lehtë pas këtij viti. Ndërsa, nga viti 2011 niveli i kredive konsumuese dhe kredive të ndërmarrjeve ka mbetur pothuajse i pandryshueshëm. Këto rezultate janë të ngjashme me gjetjet në rajonin e EQL-së, sepse me paraqitjen e krizës financiare industria bankare ka ulur nivelin e kredive të dhëna për ndërmarrjet, sepse është llogaritur si sektor më riskor.

Gjithashtu, ka një përputhje të literaturës me vendet e EQL-së dhe gjetjeve në Kosovë se kreditë e ndërmarrjeve e ndihmojnë zhvillimin ekonomik, ndërsa ndikimi i kredive për ekonominë familjare në rritjen ekonomike është i paqartë, mirëpo sipas literaturës empirike këto kredi nuk e ndihmojnë zhvillim ekonomik.

Për shkak të rolit të kredive në ndërmarrje nevojiten masa lehtësuese ndaj këtij sektori. Me rëndësi është edhe pjesëmarrja e NVM-ve në aspektin e marrjes së shërbimeve të konsulencës, e cila në Kosovë është deri në 49për qind dhe përdorimi i konsulencës profesionale rritet me rritjen e madhësisë së firmës (Kosme, SME, 2014). NVM-të që janë anëtare të Aleancës Kosovare të Biznesit kanë qasje më të lehtë në financa. Gjithashtu, nevojitet një bashkëpunim më i ngushtë i Bankës Qendrore, Aleancës Kosovare të Biznesit dhe bankave të nivelit të dytë, me qëllim të marrjes së informacioneve për biznese dhe transmetimin e informacioneve tek bankat, në mënyrë që bankat t'i përdorin këto informacione për të siguruar kredinë e dhënë.

Gjithashtu, nevojitet krijimi i një fondi të veçantë nga ana e qeverisë, me qëllim të garantimit të bankave për kreditë e dhëna në sektorin e NVM-ve, posaçërisht në sektorin e bujqësisë. Shoqata e bizneseve duhet ofrojë këshilla dhe konsulencë lidhur me bashkimin e sektorit të NVM-ve, për të krijuar një fond, me qëllim që ky fond të jetë një lloj garantuesi për NVM-të që aplikojnë për kredi.

Gjetjet në Kosovë janë të njëjta si në vendet e EQL-së, se në periudhën kur ekonomia ishte në rritje (deri në vitin 2008) ndikimi i kredive në zhvillimin ekonomik ishte më i lartë sesa kur ekonomia kishte rënie (nga viti 2009 -2013). Gjithashtu, sa i përket thellimit financiar, gjetjet janë të njëjta me ato të EQL-së, se në këto vende zgjerimi i kredive dhe ndikimi i tyre në rritjen ekonomike është në nivel shumë më të ulët sesa në vendet e zhvilluara.

Niveli i lartë i kredive joperformuese në të gjitha vendet e rajonit ka bërë që organet rregullatore të ndërmarrin masa për ngadalësimin e zgjerimit të tyre nëpërmjet ngritjes së kërkesave për rikapitalizimin e bankave dhe gjithashtu bankave iu është kërkuar që të zvogëlojnë borxhet në bilancet e tyre. Mirëpo, në krahasim me vendet e rajonit, kreditë joperformuese në Kosovë janë në nivel më të ulët.

Ka një ngjashmëri ndërmjet Kosovës dhe vendeve të rajonit sa i përket kërkesave të kolateralit, të cilat konsiderohen se janë shumë të larta. Kërkesat e larta për kolateral janë pikërisht për shkak se bankat kanë mungesë të informacioneve për klientët. Kjo mungesë e informacioneve për bankat do të shoqërohet me rritjen e kostos, për shkak të monitorimit të klientëve derisa kredia të kthehet. Mirëpo, që bankat të kenë të gjitha informacionet, autori sugjeron që bankat të ofrojnë produkte dhe shërbime të cilat do të jenë të pranueshme më lehtë për ndërmarrjet dhe, gjithashtu, të ofrojnë një transparencë më të lartë lidhur me produktet dhe shërbimet e ofruara. Gjithashtu, çmimet e ofrimit të shërbimeve të jenë të arsyeshme, sepse, nëse çmimet janë më të ulëta, atëherë edhe NVM-të do të rrisin numrin e shërbimeve të marra nga bankat. Bankat duhet të përmirësojnë politikat e menaxhimit të dhënies së kredive dhe të ulin kërkesat për kolateral, sepse kjo paraqet një barrierë shumë të lartë për NVM-të e sapoformuara. Mirëpo, sipas literaturës, kërkesat e larta për kolateral ndikojnë në uljen e kërkesave për kredi. Por, një element tjetër i ngjashëm midis vendeve të EQL-së dhe Kosovës është edhe funksionimi joefikas dhe joefektiv i sistemit juridik, ku si rezultat bankat arrijnë të bëjnë restriktionin e kredive për ndërmarrjet. Politikat qeveritare në këtë drejtim në të ardhmen duhet të luajnë një rol të rëndësishëm, duke e bërë trajtimin e lëndëve financiare një prioritet, me qëllim që zgjidhja e tyre të bëhet për një periudhë më të shkurtër kohore.

Literatura

- Adam Engst, Glenn Fleishman, "The wireless Networking Starter", second edition, Peachpit Press, 2004;
- Alex Rousskov, Matthew Weaver, Duane Wessels – "The fourth Cache-Off – The official Report" – <http://www.measurement-factory.com/results/public/cacheoff/N04/report.by-alph.html#Sect:1>;
- Alex Russkov – "On Performance of Caching Proxies" (<http://www.cs.ndsu.nodak.edu/~rousskov/research/cache/squid/profiling/papers/on.performance.html>);
- Andre de Jong, Ton Verschuren, Henny Bekker, Ingrid melve, "Report on the costs and benefits of operating caching service" <http://www.surfnet.nl/projecten/surf-ace/caching/deliver/>;
- Ari Luotonen, Kevin Altis – "World Wide Web Proxies" – Document for WWW94 Conference (<http://www.w3.org/History/1994/WWW/Proxies/Overview.html>).
- Bradley Huffaker, Jaeyeon Jung, Duane Wessels, K Claffy – "Visualization of the Growth and Topology of the NLANR Caching Hierarchy" - <http://www.caida.org/tools/visualization/plankton/>
- Brian D. Davison - A Survey of Proxy Cache Evaluation Techniques – (<http://workshop99.ircache.net/Papers/davison2.html>);
- Dr. Muhamed Mustafa, "Kibernetikë dhe hyrje në informatikë", Prishtinë, 1995;
- Dr.sc. Edmond Beqiri, „Bazat e informatikës, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2006;
- Dr.sc. Edmond Beqiri, „Interneti-komunikimet kompjuterike, IOM, Prishtinë, 2000;
- Fluhrer, S., I. Mantin, and A. Shamir, "Weaknesses in the Key Scheduling Algorithm of RC4" 2001-
http://www.drizzle.com/~aboba/IEEE/rc4_ksaproc.pdf;

Msc. Besim Tahiri

Master i Shkencave Juridike

FORMATION MANAGEMENT FORMS HUMAN RESOURCES

ABSTRACT

Rewards are operational control tools used to link employee goals. To be able to touch employees who use rewards, the reward must be perceived as meaningful and meaningful. Rewards are described in two different ways, it can be in the form of incentive (internal) motivation or personal growth motivation (external). External or additional rewards can be monetary, usually a variable compensation, divided by salary or non-monetary. Employees may find it difficult to see how their efforts translate into results and may be demotivated if they see a team member being rewarded for not contributing enough to the end result. It argues a reward based on equality in a given team and not on a balance-based basis, where everyone gets the same. That's why team-based reward design is vital if you need to avoid the negative effects on motivation that will eventually lead to bigger problems for your organization if allowed to spur. The data of the paper are primary, with a sample of 53 employees of 4 commercial banks in Peja, where the econometric results of the paper show that external, internal rewards and other factors have an impact on the performance of employees in the banking sector.

ABSTRAKT

Shpërblimet janë mjete të kontrollit operativ që përdoren për të lidhur qëllimet e punonjësit. Për të qenë në gjendje të prekë punonjësit që përdorin shpërblime, shpërblimi duhet të perceptohet si kuptimplotë dhe domethënës. Shpërblimet janë përshkruar në dy lloje të ndryshme, ajo mund të jetë në formë të motivimit nxitës (të brendshëm) ose të motivimit personal të rritjes (jashtme). Shpërblimet e jashtme apo shtesë mund të jenë monetare, zakonisht një kompensim i ndryshueshëm, i ndarë nga paga ose jo monetare. Punonjësit mund të kenë vështirësi të shohin se si përpjekjet e tyre përkthehen në rezultate dhe mund të demotivohen nëse ata shohin një anëtar të ekipit të shpërblehet për mos kontribut të mjaftueshëm për rezultatin përfundimtar. Ajo argumenton një shpërblim të bazuar në barazi në një skuadër të caktuar dhe jo në një bazë të bazuar në ekuilibër, ku të gjithë marrin të njëjtën. Prandaj dizajni i shpërblimeve të bazuara në ekip është jetësor në qoftë se ju duhet të shmangni efektet negative mbi motivimin që përfundimisht do të çojë në probleme më të mëdha për organizatën tuaj nëse lejohet të nxisë. Të dhënat e punimit janë parësore, me mostër prej 53 punonjës të 4 bankave tregtare në Pejë, ku rezultatet ekonometrike të punimit tregojnë që shpërblimet e jashtme, të brendshme dhe faktorët e tjerë kanë ndikim në performancën e punonjësve në sektorin bankar.

Hyrje

Po fillojme me pyetjen, përse janë shpërblimet dhe mënyra në të cilën menaxhohen dhe përjetojnë ato në punë, një pjesë kaq e rëndësishme e menaxhimit të burimeve njerëzore? Një pikënisje e dobishme është të pranosh se shpërblimet janë element bazë i marrëdhënies së punësimit dhe kanë ndikim vendimtar te kënaqësia dhe përkushtimi i punonjësve. Organizatat që nuk arrijnë të kuptojnë këtë marrëdhënie themelore ka të ngjarë të jenë më pak konkurruese dhe më pak të suksesshme sesa ato që e kuptojnë këtë dhe japin politika dhe praktika shpërblimi vazhdimisht efektive. Mjaft e thjeshtë, punonjësit që janë të ndrydhur dhe të pakënaqur me shpërblimet që marrin do ta shprehin këtë me anë të mënyrës si sillen dhe si performojnë në punë, në mënyra që nuk ka të ngjarë të jenë në interes të organizatës. Organizatat që gabojnë në mënyrën si menaxhojnë shpërblimet pothuaj me siguri do të përjetojnë pasoja dëmtuese në format e produktivitetit të ulët, qarkullim më të madh të punonjësve dhe mungesë të përgjithshme të angazhimit të punonjësve. Sa më i madh të jetë gabimi, aq më e lartë është kostoja që do të përjetojë organizata.

Është njësoj e rëndësishme të pranojmë se mënyra në të cilën menaxhohen shpërblimet do të ndikojë gjithashtu, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në aspekte të tjera të BNJ-së.

Për shembull, ndjenja e padrejtësisë dhe pakënaqësisë me pagesën me shumë mundësi do të ketë efekt te forma dhe niveli i konfliktit industrial dhe në gatishmërinë e punonjësve për të marrë pjesë me menaxhim me një qasje më bashkëpunuese ndaj marrëdhënieve të punës. Sikurse vëzhgoi Paul Bissell-i (në Arkin, 2005):

Organizatat po e kuptojnë çfarë leve e fuqishme është shpërblimi dhe si nevojitet ai për të plotësuar strategjitë e tjera të biznesit, ndërsa historikisht njerëzit janë prirur ta shohin atë në izolim të shkëlqyer.

Kjo do të thotë se menaxhimi i shpërblimeve nuk ka të bëjë thjesht me çështjet bazë të pagesës së njerëzve në mënyrë të drejtë në marrëdhënie me normat e tregut, punën që bëjnë dhe sa mirë performojnë në punë, por shtrihet tek impakti i vendimeve të shpërblimit te zgjedhja, mbajtja, trajnimi, fleksibiliteti dhe performanca, përveç efektit të tyre te morali dhe përkushtimi. Është e dukshme se pa shpërblime të kënaqshme, organizata nuk do të jetë në gjendje as të tërheqë e as të mbajë kalibrin e punonjësve që kërkon, me aftësitë dhe kompetencat e duhura për të dhënë kontributet që ka nevojë organizata për të qenë e suksesshme dhe konkurruese. Në fakt, nuk do të ishte e ekzagjeruar të sugjeronim se shpërblimet kanë një domethënie që përshkruan pothuajse çdo aspekt të punësimit dhe punës. Ndaj, nuk është e çuditshme që interesi në menaxhimin e shpërblimeve po rritet.

Por ndërkohë që çështja e pagesës dhe e shpërblimit është themelore për sjelljen dhe performancën e punonjësit, në mënyrë të diskutueshme ajo është një nga fushat më të diskutueshme dhe më të vështira të BNJ-së për t'u menaxhuar. Ndoshta kjo është arsyeja që paketat e pagesës për specialistët e shpërblimeve prirën të jenë shumë më të mëdha sesa ato të gëzuara nga shumica e gjeneralistëve të BNJ-së (CIPD, 2005). Niveli i njohjes së rolit dhe kontributit të rëndësishëm, të luajtur nga specialistët e shpërblimeve është pjesërisht falë shkallës dhe gamës së çështjeve të shpërblimit. Nga menaxhimi i listëpagesave, i pensioneve dhe i përfitimeve të tjera kontraktuale, njerëzit e përfshirë marrin edhe vendime kritike mbi nivelet e pagave dhe të rrogave, mbi rritjen e pagës dhe zgjidhin diskutimet dhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme për pagesat e bonuseve. Kostot e pagesës dhe paketat totale të shpërblimeve përbëjnë për shumicën e organizatave një pjesë të rëndësishme të buxhetit total dhe

këto kosto duhet të menaxhohen efektivisht për të garantuar se mbeten brenda kufijve të pranueshëm.

Specialistët e shpërblimeve jo vetëm që duhet të sigurohen se punonjësit paguhen drejt dhe në mënyrë të përshtatshme (të dyja shumë subjektive), por duhet edhe të shmangin mbipagesat e mëdha, në kontekstin e asaj që mund të përballojë të paguajë organizata për të mbetur konkurruese dhe në biznes.³⁸

Të menaxhosh shpërblimet mund të përfshijë edhe projekte në masë, bazuar në sektor, të modernizimit të pagesës, që kërkojnë të zëvendësojnë politikat moshore dhe të pagesës joefektive me struktura të zakonshme pagese, bazuar në kuadrin kombëtar të vlerësimit të punës dhe me kushtet e harmonizuara të punësimit, Projekti i Agjendës së NHS-së për Ndryshim është shembull i mirë i një nisme madhore të menaxhimit të shpërblimeve dhe në këtë rast lidh zhvillimin e një kuadri të ri kombëtar kompetencash me një strukturë të thjeshtëzuar punësh dhe nivelesh pagesash (Departamenti i Shëndetit, 2004).

Për më tepër, sistemet e shpërblimit integrohen me fusha të tjera të BNJ-së dhe duhet t'i përgjigjen presioneve të jashtme dhe ndryshimeve legislative, behët gjithnjë e më e vështirë të konceptosh një situatë ku menaxherët kanë "zgjidhur problemin" në kuptimin përfundimtar. Është më logjike të konceptosh menaxhimin e shpërblimeve si angazhim i vazhdueshëm - një përpjekje për të pajtuar interesat dhe pritshmëritë e stakeholders-ave të ndryshëm të organizatës - që ndërmerret me dijen se këto interesa dhe pritshmëri të ndryshme nuk mund të përmbushen ose të pajtohen kurrë tërësisht. Sikurse deklaroi Daniels-i (2000):

Pak organizata janë të kënaqura me sistemet e tyre të shpërblimit dhe të njohjes. Për më tepër, çdo ndryshim në këto sisteme rezultojnë në dikë tjetër që mbetet i pakënaqur. Shumë shpesh, menaxhimi bëhet cinik, pasi pavarësisht se çfarë provojnë, askush nuk është i kënaqur.

Dallimet mbi ato që përbëjnë sisteme "të drejta" dhe "efektive" shpërblimi dhe pasiguritë për impaktin e shpërblimeve dhe të praktikave të veçanta të shpërblimit mbi sjelljen, e bëjnë punën e praktikuesit të BNJ-së që punon në këtë fushë veçanërisht problematike dhe sfidante. Nuk ka përgjigje dhe receta të thjeshta ose universale që janë të garantuara se funksionojnë. Ajo që del nga kontributet e ndryshme akademike, gjetjet e studimeve dhe përvoja individuale është se nuk ka konsensus mbi mënyrën sesi organizatat duhet t'i shpërblejnë punonjësit, as nuk ka siguri se përdorimi i shpërblimeve të caktuara do të garantojë në fakt sjelljet dhe rezultatet e dëshiruara nga menaxherët. Për më tepër, jo të gjithë komentuesit kanë të njëjtin këndvështrim për efektin e tipave të caktuara të shpërblimit në sjellje.³⁹

KONCEPTI I SHPËRBLIMIT

Nuk duhet ta marrim për të mirëqenë se të gjithë stakeholder-sat kryesorë të organizatës ndajnë të njëjtin këndvështrim për atë çfarë përbën një shpërblim dhe për vlerën që çdo shpërblim i veçantë përfaqëson. Për shumë gjatë, shpërblimet janë barazuar vetëm me pagën dhe ky perceptim duhet sfiduar. Sikurse thotë Thompson-i (2002)

³⁸ Puwaneethiren, P. (2011). Reward System and its impact on Employee Motivation in Commercial Bank of Sri Lanka Plc, In Jaffna District. *Global Journal of Management and Business Research*, 11(4), 84-92.

³⁹ Fetije Xhaku Murturi, "Menaxhimi I burimeve njerezore", Prishtine, 2010

... duhet ta mendojmë sërish çfarë është dhe çfarë nuk është një shpërblim.

Në një kuptim, shpërblimet mund të përfaqësojnë instrumente për kontrollin e sjelljes. Konsideroni përdorimin e tyre, pikësëpari, në një kontekst jopunësimi. Të gjithë ata që kanë vizituar parqet me temë nga bota ujore e Disney SeaWorld-it pothuajse me siguri do të kenë vëzhguar përdorimin e shpërblimeve për të përforcuar sjelljen e dëshiruar te kafshët,

Kur një fokë, delfin ose balenë vrasëse performon një veprim saktësisht, trajneri e përkëdhel, e lavdëron dhe e ushqen me peshq si shpërblim që bëri gjënë e duhur. Kjo është ajo çfarë njihet si “kushtëzim instrumental”, nën të cilin sjelljet e dëshiruara pasohen menjëherë nga shpërblimi. Shpejt kafsha fillon të shoqërojë sjellje të caktuara me pasoja të caktuara, le të themi shpërblimin dhe për shkak se shpërblimi është i dëshirueshëm, shpejt ai mëson ta shoqërojë njërin me tjetrin.

Në mënyrë të ngjashme fëmijët mësojnë përmes përdorimit të llojeve të ndryshme të shpërblimeve. Të sillësh mirë mund të shoqërohet me ëmbëlsira dhe me çokollata, me kohë shtesë për televizion dhe të drejta të veçanta. Megjithatë, në mënyrë interesante, ndërsa përdorimi i shpërblimeve për të trajnuar kafshët duket se funksionon gjatë shumicës së kohës, e njëjta gjë nuk mund të thuhet për fëmijët, të cilët duket se nuk luajnë të njëjtin grup rregullash si kafshët.⁴⁰

Po nëse shpërblimet tërhiqen? A përbën kjo një formë ndëshkimi? Është e rëndësishme të mbajmë mend se sikurse shpërblimet kanë potencialin që të japin kënaqësi dhe të kënaqin një nevojë themelore nëse jepen, t'i mbash ose t'i tërheqësh shpërblimet ka potencialin që të lëndojë. Nga këndvështrimi i sjelljes, menaxherët duhet të përpiqen të parashikojnë reagimet që pasojnë nga përdorimi i shpërblimeve në mënyra të ndryshme.

Kohn-i (1993a) argumenton se shpërblimet dhe ndëshkimi nuk janë në të vërtetë të kundërta, por anë të ndryshme të së njëjtës monedhë. Ai sugjeron se dhënia dhe tërheqja e shpërblimit, secila përbën strategji që synojnë të manipulojnë sjelljen e kafshës, të fëmijës ose të punonjësit. Në këtë kuptim, shpërblimi përbën një burim jokarakteristik - që gjendet jashtë - motivimi që sipas Kohn-it nuk e alternon përkushtimin emocional ose njohës të personit, që janë çelësat për të kuptuar dhe influencuar sjelljen. Por menaxherët nuk kanë të bëjnë me kafshë ose me fëmijë dhe pyetjet për të cilat ata janë veçanërisht të interesuar janë:

- ✓ a mund të përdoren shpërblimet për të kushtëzuar sjelljen e punonjësve dhe nëse po, në çfarë rrethanash?
- ✓ cilat tipa shpërblimesh kanë impaktin më të madh te sjellja e punonjësit?
- ✓ a është dallimi midis shpërblimeve të jashtme dhe të brendshme i dobishëm dhe nëse po, përse?
- ✓ e a ka probleme dhe kosto të shoqëruara me përdorimin e papërshtatshëm të

⁴⁰ Armstrong Michael (2003). *Employee Reward*, CIPD House, London, 3rd edition

✓ shpërblimeve?

✓

1.1 Sistemet e Shpërblimit të Ekipit

Në mjedisin modern të biznesit, performanca e ekipit po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për suksesin organizativ. Një nga pyetjet e para të pyetura në shumicën e intervistave sot është 'a mund të punoni si pjesë e një ekipi?' Sigurimi i punonjësve që punojnë në mënyrë produktive dhe bashkëpunuese si pjesë e një ekipi mund të jenë të vështira dhe sipas Torrington et al. (2011) nëse aktiviteti i menaxhimit të performancës nuk është përcaktuar saktë,

qëllimet individuale të punonjësve mund të dëmtojnë punën e ekipit dhe anasjelltas. Çmimet e bazuara në grup duket se janë komplimente logjike të matjes së performancës që fokusohet në ekipet dhe cilësinë / sasinë e punës që ata prodhojnë dhe (Dematteo et al., 1998, fq.144) zbuluan se aplikimi i shpërblimeve për ekipet në tërësi bazohet në supozimi se shpërblimet e ekipit do të bëjnë diçka cilësisht të ndryshme nga shpërblimet individuale.

Gjithashtu nga pikëpamja e vlerësimit të performancës, mund të jetë më e lehtë dhe më pak e ndërlikuar për një menaxher të vlerësojë ecurinë e një ekipi në krahasim me performancën individuale. Kështu mund të argumentohet se menaxhimi i performancës dhe përfitimet që janë në dispozicion për arritjen e nivelit të performancës së dëshiruar mund të jenë kompliment dhe më pak kohë duke marrë parasysh një pikë monitorimi dhe matjeje në një strukturë të bazuar në ekip. Megjithatë, sipas (Armstrong, 2012, fq. 294) mund të duhet kohë që një anëtar i ekipit të përshtatet me një pjesë të shpërblimit të tyre të përcaktuar nga përpjekjet e grupit dhe sa kohë do të zgjidhet nga pjekuria e anëtarëve të ekipit dhe sa të përdorura ata duhet të punojnë së bashku. Megjithëse ideja e një ekipi me performancë të lartë që punon ngushtë dhe bashkëpunues së bashku është tërheqës, rreziku i detyron njerëzit të bëjnë një marrëveshje të re shpërblimi, të cilët tashmë mund të përdoren për një mënyrë të re pune.

Në disa organizata mund të jetë më e leverdishme që të mos zbatohen objektiva individuale të performancës dhe të fokusohen vetëm në planet e shpërblimit kolektiv dhe të performancës. Kramar dhe Syed (2012) kanë identifikuar se shpërblimet ose stimujt e grupeve kanë më shumë gjasa të japin një qasje bashkëpunuese ndaj performancës dhe në këtë mënyrë të jenë më efektive në arritjen e qëllimeve tuaja të përbashkëta. Ata gjithashtu argumentojnë se skemat e nxitjes kolektive mund të inkurajojnë më shumë blerje organizative nga punonjësit në krahasim me ato skema të një natyre individuale. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që shpërblimet e bazuara në ekip nuk janë në përputhje me skemat e pagesave individuale të performancës, pasi të dyja mund të kombinohen me vëmendje të kujdesshme. Siç komenton Kerrin dhe Oliver (2002) në hulumtimin e tyre mbi aktivitetet e përmirësimit kolektiv dhe individual, efektiviteti i shpërblimeve kolektive ose ekipore mund të lidhet drejtpërdrejt me kulturën e organizatës. Pasi paga bazë nga pikëpamja individualiste është parë gjithmonë si shtylla kurrizore e kompensimit, kur dizajni organizativ shkon në ekipet mbështetëse për produktivitet, atëherë shpërblimet kolektive të aplikueshme duhet të përshtaten për të mbështetur këtë. Ata gjetën se kompanitë ballafaqohen me sfida në lëvizjen nga një sistem tradicional shpërblimi i bazuar tek individi në një strukturë shpërblimi më të bazuar në ekip, por që ata të mund të veprojnë në të njëjtën kohë me suksesin.

Ata gjithashtu theksojnë se sfidat gjithashtu lindin kur proceset e prodhimit mund të ndërtohen rreth konceptit të ekipeve, ndërsa shpërblimet për aktivitetet e përmirësimit të vazhdueshëm mbeten ende të lidhura me shpërblime individuale.

Një studim i Michael D. Johnson (2009) argumenton efektivitetin e një sistemi shpërblimi të bazuar në ekip në kuptimin bazë. Dinamika e ekipit luan një rol të madh në "ndërvarësinë e shpërblimit", pra se si shpërblimi i një individi bazohet në punën e një anëtari tjetër të ekipit. Ky studim argumenton nevojën për të futur më shumë stimuj individualë brenda strukturës së shpërblimit të bazuar në ekip. "Alokimet e barabarta" bëhen të rëndësishme kur shpërblimi nuk varet vetëm nga performanca e përgjithshme e ekipit, por ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet të gjithë anëtarëve të ekipit (Johnson, 2009, fq.4). Ai sugjeron se anëtarët e ekipit duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin për të arritur rezultatin e tyre përfundimtar, por ata shpërblehen ndryshe bazuar në atë që kanë kontribuar në performancën e ekipit.

Ai gjithashtu gjeti se ku është e dukshme transparenca e kontributeve të anëtarit të ekipit, atëherë ai mund ta bëjë anëtarin e ekipit më të vetëdijshëm për atë kontribut, duke rritur kështu tendencën për të vepruar në favor të ekipit.

Hulumtimi në marrëdhënien ndërmjet fuqizimit dhe shpërblimeve nga Born dhe Molleman (1996) zbuloi se sistemi i saktë i shpërblimit, i orientuar në mënyrë të drejtë, mund të mbështesë fuqizimin e punonjësit. Kjo ishte në kontekstin e grupeve të punës autonome ku trajnimi kryq ishte mbizotërues. Megjithëse shpërblimet e rastësishme konsideroheshin të jenë efektive, aplikimi i tyre për të shpërbluar sjelljen e grupit konsiderohej të jetë më efektiv dhe inkurajoi një ndjenjë të përgjithshme të fuqizimit.

Në mënyrë të ngjashme, në një sondazh të kryer mbi shpërblime të bazuara në ekip në grupet kompjuterike të ndërmjetësuar (Rock et al., 2011, f.431), u gjetën një rezultat më të ulët për një "strategji të kapitalit" ku të gjithë kanë të njëjtën. Në këtë shpërblim të bazuar në ekipin e studimit nuk ka treguar korrelacion me performancën më të lartë. Megjithatë, ajo tregoi se një sistem shpërblimesh me bazë ekipi mund të çojë në një bashkëpunim më të mirë dhe komunikim ndërmjet anëtarëve të ekipit. Në studimin e procesit të shpërblimit dhe njohjes së punonjësve në një organizatë australiane Londër dhe Higgot (1997) konstatoi se duke theksuar njohjen si pjesë e procesit të shpërblimit, përfshirja e punonjësve dhe njohja e suksesit në ekip në mbledhjet e kompanisë ku të gjithë punonjësit ishin ftuar, rezultuan në rezultate pozitive. Ata gjithashtu sugjerojnë që çdo shpërblim ose proces njohjeje duhet të jetë formale dhe të largohet nga shumë ndikime të drejtpërdrejta menaxheriale. Ajo duhet të shihet të jetë e paanshme dhe e drejtë.

Me rritjen e përdorimit të strukturave të punës në ekip, është e rëndësishme të zgjedhësh shpërblimet e duhura për të arritur performancën më të lartë. Por sjelljet konstruktive mes anëtarëve të ekipit janë gjithashtu të rëndësishme. Argumenti për shpërblimet e ekipit bazuar në 'barazinë' ku të gjithë anëtarët shpërblehen në mënyrë identike në krahasim me një sistem 'barazie' ku anëtarët shpërblehen bazuar në performancën e tyre individuale në ekip, është hulumtuar më tej në një studim të (Bamberger dhe Levi, 2009, fq. 301). Ata gjetën "struktura të pagave të orientuara drejt barazisë" brenda një skuadre të caktuar që çoi në sjellje më të mira të sjelljes për ekipin, si një bashkëpunim më pozitiv midis anëtarëve dhe shkëmbim më të mirë të kompetencave individuale. Pra, në vend që të fokusohen në qëllimet specifike të performancës së ekipit, ata shikojnë

"përgjigjet e sjelljes" që një strukturë shpërblimi e bazuar në ekip mund të sjellë kur shokët e ekipit duhet të përgjigjen për të ndihmuar kërkesat e shokëve të tjerë. Shpërblimi i sjelljeve të lidhura me skuadrën, të tilla si ndihmimi i shokëve të skuadrës tuaj, rriten efektivitetin e të gjithë ekipit. Ai zbuloi gjithashtu se individët në nivelin më të lartë të zhvillimit brenda organizatës ishin më të prirur për të ndihmuar në vendosjen e ekipit edhe kur nuk bënin kështu që të mos ishte avantazhi i tyre i dukshëm. Kuptimi i sjelljes është i rëndësishëm në këtë kontekst. Weightman (2004) përshkruan ndikimin e sjelljes së punonjësve nëpërmjet udhëzimit dhe shpërblimit si 'modifikim sjelljesh'. Kjo është e rëndësishme për menaxhimin e njerëzve, sepse nëse personaliteti mësohet dhe mbështetet në përforsim, atëherë lloji i duhur i shpërblimeve të aplikuara për një ekip duhet të sjellë sjellje pozitive që mund të rrisin motivimin dhe performancën. Në mënyrë të ngjashme, King (2007) argumenton se nisja e punës së ekipit në një shkallë të vogël në të gjithë organizatën dhe përqendrimi në detyrat thelbësore që i ndihmojnë njerëzit të rriten përgjatë gjithë zinxhirit të karrierës, do të kontribuojnë pozitivisht në 'motivimin e karrierës'. Ndërsa bota e korporatave sheh një qarkullim të tillë të lartë të stafit dhe kështu ka më pak nxitje për të shpenzuar burime për motivimin e stafit, kjo ide e 'motivimit të karrierës', dmth. Marrja e angazhimit më të mirë nga stafi juaj, mund të shtojë vlerë reale për organizatën tuaj. Ekzistojnë lidhje të qarta ndërmjet përkushtimit, produktivitetit dhe cilësisë së balancës së punës / jetës.

Vlefshmëria e sistemeve të shpërblimit në bazë të ekipeve mund të varet edhe nga industria specifike në të cilën i zbatoni. Ndonjëherë kombinimi i stimuljeve individuale dhe grupe financiare si dhe një përzierje e skemave të shpërblimeve formale dhe joformale mund të inkurajojnë punonjësit që të angazhohen në të dyja 'roli "dhe" jashtë-rolit "në të njëjtën kohë (Yap et al., 2009, fq. 280). Në këtë studim të veçantë për industrinë e shitjes me pakicë, ai gjeti një përzierje të shpërblimeve individuale dhe grupe të inkurajuara për sjellje ose detyra roli në "në" dhe "ekstra", specifike për përshkrimin e punës dhe detyrat që janë më shumë diskrecionale dhe shkojnë më lart se çfarë ju pritët të bëni. Ajo gjithashtu tregoi 'shpërblime joformale', të përcaktuara si shpërblime më spontane të paraqitura nga menaxherët e dyqaneve individuale për të qenë më efektiv në rritjen e performancës dhe motivimit të anëtarëve të ekipit. Siç komenton DeMatteo et al. (1998) në shqyrtimin e tyre të gjerë mbi shpërblimet e bazuara në ekip, një pyetje kyçe është se si mund të zbatohen praktika të ndryshme shpërblimi për të mbështetur dhe nxitur nivele të larta të performancës individuale, duke inkurajuar ende punën e ekipit brenda organizatës suaj? Shumica e kërkuesve duket se sugjerojnë një kombinim të dy llojeve të shpërblimeve, të zbatuara në kombinimin e duhur dhe në mjedisin e duhur mund të jenë më të favorshme për përmirësimin e performancës.

Ka dëshmi për të sugjeruar që stimujt individualë monetarë brenda një skuadre të caktuar, të përafuara me llojin e duhur të shpërblimeve në grup, mund të ndikojnë pozitivisht në sjelljet, dinamikën e ekipit dhe produktivitetin. Sidoqoftë shumë organizata janë të ngadalta për të zbatuar pagat e ekipit ose shpërblime të tjera ekstra të ekipit, sepse ato janë mjaft të kënaqur me skemat e tyre individuale të performancës (Armstrong, 2007, fq 352). Janë këto kompani që duhet të marrin parasysh shpërblimet e bazuara në ekip si një mjet për të përmirësuar performancën më shumë dhe nëse dëshirojnë të përfshijnë punën në ekip si një kompetencë për t'u matur dhe shpërblehet si pjesë e një sistemi të menaxhimit të performancës. Në mënyrë të ngjashme, në studimin e saj mbi programet e shpërblimit dhe njohjes në mjedisin e bazuar në njohuri, Milne (2007) zbuloi mangësi të mëdha se si shpërblimet e bazuara në ekip ishin parë në aspektin e motivimit. Punonjësit mund të kenë vështirësi të shohin se si përpjekjet e tyre përkthehen në rezultate dhe mund të demotivohen nëse ata shohin një anëtar të ekipit të shpërblehet për mos kontribut të mjaftueshëm për rezultatin përfundimtar. Ajo argumenton një shpërblim të

bazuar në barazi në një skuadër të caktuar dhe jo në një bazë të bazuar në ekuilibër, ku të gjithë marrin të njëjtën. Prandaj dizajni i shpërblimeve të bazuara në ekip është jetësor në qoftë se ju duhet të shmangni efektet negative mbi motivimin, që përfundimisht do të çojë në probleme më të mëdha për organizatën tuaj nëse lejohet të nxisë.

Pra, megjithëse elementet themelore të punës së ekipit duhet të jenë në vend për të arritur nivelin e dëshiruar të performancës, Cacioppe (1999, fq.325) në studimin e tij se si shpërblimet e ekipit shpjen në suksesin organizativ, sugjeron "kjo veçanërisht përfshin ndërvarësinë pozitive, llogaridhënien personale, ndërveprimet dhe përdorimit të duhur të aftësive sociale dhe përpunimit të grupeve. Kjo sugjeron që sistemet e shpërblimit dhe njohjes, janë një nga mënyrat më të rëndësishme për të nxitur ndërvarësinë pozitive dhe llogaridhënien personale ". Pra, identifikimi i shpërblimeve të sakta për ekipin tuaj duhet të ndiqet nga dizajni i duhur i asaj strategjie. Ky hulumtim i bazuar në prova gjithashtu zbuloi se si organizatat vazhdojnë të rrafshojnë hierarkitë dhe të zhvillojnë modele të bazuara në ekip për të përmirësuar performancën; praktikatat e shpërblimit dhe njohjes të cilat përputhen me këto ndryshime do të japin rezultatet më të mira. Përshtatja e qëllimeve organizative me zhvillimin e shpërblimeve të bazuara në ekip dhe duke përfshirë kulturën dhe vlerën e organizatës në këtë zhvillim, është qasja e sugjeruar.

Një qasje me rrezik të ulët për këtë do të ishte futja e një strategjie të njohjes të bazuar në ekip, e cila duhet të synojë të përforcojë aftësinë e ekipit. Kjo do të lejojë që organizatat të përfitojnë nga marrëdhëniet më të afërta të punës me ekipin dhe të vlerësojnë nëse përfitime edhe më të mëdha do të lindin më vonë nga paga specifike në bazë ekipi (Thorpe & Homan, 2000).

Në hulumtimin e bazuar në dëshmi duke përfshirë një studim mbi 173 shpërblime dhe praktikues të HR, (Armstrong et al., 2011, fq 114) ⁴¹tregojnë se ndërsa shumë organizata ende nuk e vlerësojnë efektivitetin e sistemeve të tyre shpërblim, disa janë duke përdorur disa kriteret.

Kjo ngurrim lidhet me shpërblimet e ekipit ashtu si edhe tek strukturat individuale të shpërblimit. Studiuesit tregojnë se ndonëse vlerësimi i sistemeve të shpërblimit në fjalë shfaq një nivel më të lartë të angazhimit të punonjësve pas një ndryshimi në atë sistem, nuk mund të lidhet përfundimisht me performancën e përmirësuar. Nuk ishte e mundur të zhvillohej një sistem shpërblimi me një sistem të hapave logjik që përfundoi me një sistem shpërblimi të zhvilluar mirë dhe operacional.

1.2 Paga lidhur me performancën (PRP)

Në vitet e fundit, shumë organizata kanë lëvizur drejt shpërblimit të punonjësve për performancën si një mjet për të arritur qëllimet organizative (Mullins, 2005). Në thelb ata kanë lidhur kompensim për performancën. Debati mbi efektivitetin e shpërblimit financiar mbi performancën vazhdon ndërsa studiuesit përpiqen të krijojnë përshtatshmërinë organizative dhe kulturore për një praktikë të tillë. Rayner dhe Adam-Smith (2005, fq. 101) thonë "pasi që të dy performancat dhe motivimi ndikohen nga shumë faktorë, paga lidhur me performancën (PRP) (ose ndonjë ndërhyrje tjetër) nuk mund të lidhet në mënyrë rastësore". Ata argumentojnë se edhe pse mund të jetë relativisht e lehtë për të dhënë përgjigje ndaj aspekteve individuale të efektivitetit të PRP kur merren në

⁴¹ Armstrong et al., 2011, fq 114

konsideratë të gjitha variablat që lidhen me këtë koncept siç aplikohet lidhja e PRP me nivelet e performancës bëhet më e vështirë.

Vlerësimet e performancës janë një aspekt kyç i menaxhimit të çdo pagese për modelin e performancës. Smith dhe William (2003) në hulumtimin e tyre duke eksploruar lidhjen mes vlerësimit të performancës dhe ndikimeve motivuese, vështronin rreziqet e marrjes së rritjes së gabuar të meritave, ku aplikohen modelet e performancës së pagave dhe efektet që kjo mund të ketë në motivim. Në një anketë të administruar për 5 kompani të ndryshme, duke filluar nga mbështetja administrative tek mbikëqyrësit dhe menaxherët, ata zbuluan se 58% e të anketuarve morën një rritje të meritës që nuk korrespondonin me vlerësimin e tyre aktual të performancës. Ai konstatoi se koncepti "de-coupling" midis vlerësimit të performancës dhe shpërblimit ishte një praktikë e zakonshme në mesin e kompanive të anketuara. Kjo nënvizon rëndësinë e çdo modeli të bazuar në merita për të qenë i drejtë dhe transparent në mënyrë që ajo të jetë e suksesshme në afat të gjatë në rritjen e motivimit dhe të performancës. Shumica e të anketuarve nuk e ndjenin shpërblimin e tyre në rritje u bazua në performancën e tyre por më tepër të ndikuar nga kufizimet e buxhetit organizativ. Në mënyrë të ngjashme, St-Onge et al. (2009), theksojnë përhapjen e shtrembërimit të vlerësimit të performancës dhe efektet e tij në performancën dhe motivimin. Edhe pse ky shtrembërim është i pashmangshëm në shumicën e organizatave, menaxherët gjithashtu duhet të shikojnë shqyrtimin e vlerësimeve dhe mënyrën se si ne e komunikojmë suksesin ose dështimin si dhe shpërblimin e bashkangjitur.

Armstrong (2009, fq 254) pretendon se është më mirë të ndajmë menaxhimin e performancës dhe të paguajnë, "çvendosje" të dyja, në mënyrë që të bëjnë një dallim midis potencialit zhvillimor dhe ndikimit të performancës suaj në rritjet e pagave në rritje. Ai e përshkruan vështirësinë në pagimin e performancës, ku duhet të matet në nivele të ndryshëm, kështu që bazohet në dëshmi dhe kjo dëshmi duhet të shihet si e drejtë dhe transparente dhe nuk kryhet pas dyerve të mbyllura.

Në një intervistë me Juliet Norton (2010, fq. 41-43), Michael Armstrong vazhdon të argumentojë se departamentet e BNJ për njëfarë kohe nuk i kanë vlerësuar politikat e tyre të shpërblimit për të vërtetuar rëndësinë e tyre. Në një studim të Institutit të Çertifikuar të Zhvillimit të Personelit (CIPD) në vitin 2009, ata zbuluan se "përqindja e jashtëzakonisht e ulët prej 12 përqind e të anketuarve kishte vlerësuar skemat e pagave të lidhura me performancën".

Kjo indiferencë ndaj rëndësisë aktuale të sistemeve të tyre të shpërblimit ka qenë në kontrast me vëmendjen dhe financimin që u është dhënë skemave të trajnimit për punonjësit dhe duke konsideruar se sa shpenzohen për paga dhe shpërblime, më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet kësaj, sesa programeve të trajnimit, duke marrë parasysh pasojat e atyre të varfërve sistemet e shpërblimeve mund të kenë në një organizatë.

Duke pasur llojin e duhur të programit të shpërblimeve, do të ndihmojë punëtorët të rriten, të pjekin dhe në fund të shtojnë vlerën e organizatës suaj. Paguani, si 'variable dhe bazë', është çelësi për të siguruar që ju të merrni më shumë vlerë nga punonjësit tuaj, veçanërisht nga interpretuesit e lartë sipas një raporti mbi anketat e pagave (Zingheim, 2010, fq.9). Organizatat që përhapen paguajnë më shumë në mënyrë të barabartë largojnë artistët e lartë dhe inkurajojnë të njëjtin lloj të performancës mesatare në të gjithë organizatën. Ky raport argumenton se shpërblimi financiar duhet të bazohet në vlerën që shtoni në organizatën tuaj. Por sa e rëndësishme

është pagimi i suksesit të një kompanie për një periudhë më të gjatë kohore? Në studimin e tyre mbi rolin e sistemeve të shpërblimit në organizatën me performancë të lartë, de Waal dhe Jansen (2011, fq.9) gjetën shpërblime të lidhura me pagën për të qenë as efektive dhe as joefektive për performancën e organizatave. Përderisa ka prova të mjaftueshme për të sugjeruar lloje të caktuara të rritjes së pagës që lidhet me performancën, kjo nuk ishte përfundimi i studimit. Nga karakteristikat e 12 'HPO' (organizimi me performancë të lartë) të diskutuara në këtë studim, paga ishte më dominuesja. Megjithatë, ajo arriti në përfundimin se gjatë një periudhe më të gjatë, kjo nuk ka efekt pozitiv ose negativ në performancën organizative. Gilmore dhe Smith (2005) i referohen kësaj organizate me performancë të lartë si jo-hierarkike dhe largohen nga kontrolli i menaxhimit qendror në një formë më të bazuar në ekip, duke punuar me përgjegjësitë e përhapur më në mënyrë të barabartë dhe bazuar në nivele të larta besimi dhe komunikimi. Kjo ngre disa pika interesante se si t'i shpërblejë këto ekipe, qoftë kolektivisht ose individualisht, dhe se si funksionojnë sistemet e shpërblimit në mjedisin e bazuar në ekip. Kjo do të diskutohet më vonë në kapitullin. Për të rritur këtë pikë, motivimi i punonjësve mund të nxitet më shumë nga shpërblimet e brendshme (p.sh. duke bërë punën që gëzon) sesa me shpërblime të jashtme (pagë, shpërblime). Në studimin e tyre mbi nismat e punonjësve dhe ndryshimeve, Stumpf et al. (2013, fq.10) u përqendrua në dy shpërblime të brendshme - kuptimplotë dhe zgjedhje. Ata argumentojnë se këto janë thelbësore për kënaqësinë e punonjësve dhe mbajtjen e punonjësve në kohë të paqartësisë dhe ndryshimit organizativ. Pra, në këtë rast, shpërblimet e brendshme ishin më efektive sesa shpërblimet monetare. Kjo është në kontekstin e ndryshimeve organizative, prandaj është interesante të vërehet se kënaqësia në punë dhe qëllimi për të qëndruar brenda rolit tuaj gjatë kohës së ndryshimeve organizative mbështeten në përzierjen korrekte të shpërblimeve jofinanciare. Kënaqësia e punës është një faktor i rëndësishëm në punën e një punonjësi dhe shpërblimet e brendshme luajnë një rol të rëndësishëm në këtë.

Në mënyrë të ngjashme, në studimin e tyre për efektin e shpërblimeve të parave në performancën e punonjësve në kompaninë Kenia Power and Lighting Company Ltd, Njanja et al. (2013) konstatoi se megjithëse shumica e stafit të anketuar kishin një perceptim se shpërblimet e parave të gatshme motivojnë performancën, studimi arriti në përfundimin se këto shpërblime të parave të gatshme nuk kishin efekt në performancën e punonjësve.

Ata që kishin marrë një bonus dhe ata që nuk kishin, e perceptonin atë të ndikonte në punën e tyre të njëjtë; prandaj ajo nuk kishte një efekt të rëndësishëm në performancën. Megjithatë, anasjelltas, në studimin e tyre të strukturave të shpërblimit në industrinë e ndërtimit britanik (Drunker and White, 1996, fq.142) tregoi se për shkak të natyrës së projektit të asaj industrie dhe dallimit të qartë në forcën e punës midis manualit dhe fuqisë punëtore të jakës së bardhë, Sistemet PRP mund të japin rezultate në mes të menaxherëve profesionistë dhe të lartë në atë industri. Ai sugjeron që ky model PRP mund të zhvillohet në kontekst të përmirësimit të performancës në ekipin e projektit, dhe rreth një sistemi të pagave të kompetencës ose aftësisë.

Në mënyrë të ngjashme, Bart et al. (2008, fq.9), në studimin e tyre të gjerë për atë se kush paguan për performancën dhe bazuar në sondazhet e themelimit norvegjez nga 1997 në 2003, zbuloi se sukcesi apo dështimi i pagës që lidhet me performancën do të varet shumë nga vendosja që ajo është futur në dhe "parashikimi është se skemat e shpërblimeve të bazuara në prodhim kanë më shumë gjasa të respektohen kur ka diskrecionin e konsiderueshëm të punonjësve mbi detyrat e punës". Pra, ata gjetën që pagesa lidhur me performancën është më

e përhapur në organizatat më të mëdha dhe më pak të zakonshme në organizatat më të organizuara. Ata gjetën një lidhje midis kualifikimit arsimor të punonjësve dhe përdorimit të pagave të performancës me bazë individuale dhe gjithashtu një lidhje të qartë midis performancës është prekur pozitivisht nga PRP dhe niveli i autonomisë që ka puna. Në këtë kuptim më shumë liri veprimi një punëtor ka për detyra të tij / saj, PRP më i suksesshëm do të jetë.⁴²

Megjithëse ka shumë dëshmi për të sugjeruar se të dyja llojet e shpërblimeve ndikojnë në performancën organizative, këtu studiuesit sugjerojnë se përqendrimi në shpërblimet e brendshme tregon se vetë roli është i mjaftueshëm për të nxitur brenda punonjësit, një ndjenjë të vlefshme, kënaqësi dhe fuqizim. Këto shpërblime të brendshme mund të jenë veçanërisht efektive në kohën e ndryshimit brenda një strukture organizative. Megjithatë, shpërndarja e këtyre shpërblimeve në një mënyrë sistematike dhe të drejtë është thelbësore për suksesin e tyre. Dhe sigurisht, çështja e nevojës individualiste mund të ndikojë drejtpërdrejt në rezultatin pozitiv të performancës së PRP. Në studimin e tyre mbi shpërblimet organizative: duke pasur parasysh nevojat e punonjësve në alokim, Webb Day et al. (2014) diskutojnë se si përdorimi i një modeli pay-for-performance në një organizatë perëndimore mund të ketë rezultate pozitive në performancën. Duke u fokusuar jo vetëm në pagën, por edhe në nevojat specifike të individit për këtë pagë, ai gjeti se jo vetëm që mund të arrini rezultate pozitive të performancës, por ndihmon organizatën që t'i përgjigjet më mirë pritjeve të punonjësve. Ai gjithashtu gjeti se nëpërmjet komunikimit të nevojës për menaxherin tuaj, punonjësit me nevoja më të larta kanë më shumë gjasa të marrin shpërblime më të mëdha.

Në mënyrë të ngjashme, kur shpërblimi i punonjësve të njohurisë ose atyre që merren me inovacion si pjesë e rolit të tyre, një punonjës i motivuar është më produktiv dhe në këtë mënyrë një performues më i lartë. Motivimi i brendshëm është më i rëndësishëm për produktivitetin dhe performancën kur lidhet me punëtorët kreativë ose inovatorë (Markova dhe Ford, 2011). Ky studim u përqëndrua tek punonjësit në mbi 30 kompani të mëdha dhe përmes një sistemi të shkallëzuar të vlerësuar nga mbikëqyrsit, konstatoi se as shpërblimet monetare as jo monetare kishin ndonjë efekt të drejtpërdrejtë në performancën. Megjithatë, ata kishin një efekt në motivimin dhe sa më të motivuar ishin të punësuarit, aq më shumë kohë kaluan në punë dhe prandaj ndikojnë pozitivisht në performancën në afat të gjatë.

Kjo, nga ana tjetër, është e rëndësishme për konkurrencën organizative. Ajo gjithashtu tregon se si shpërblimet dhe performanca dhe inovacioni që nuk paguajnë mund të ndërthuren me rezultate pozitive. Pra, në fakt, paraja nuk është ilaç dhe nuk çon në një kohë më të gjatë pune ose në përmirësimin e bashkëpunimit dhe sjelljeve midis punonjësve. Shpërblimet e brendshme mund të jenë po aq efektive, por më pak të kushtueshme.

1.3 Karakteristikat e shpërblimeve

Do të diskutojmë se, pavarësisht formës që merr, shpërblimi duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme.

- ✓ Duhet të ketë vlerë në vetvete ose për shkak të asaj që përfaqëson. Me fjalë të tjera, vlera e tij lidhet me përmbushjen e nevojave njerëzore bazë ose një nevojë që përfitohet në aspektin social. Duhet të jetë domethënëse dhe i rëndësishëm për individin. Një makinë kompanie për shembull nuk është e rëndësishme

⁴² Armstrong Michael (2003). *Employee Reward*, CIPD House, London, 3rd edition

XII INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE | KONFERENCA E XII-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE XII-ta NAUČNA MEDJUNARODNA KONFERENCIJA

për punonjësin që ose nuk di të ngasë makinën ose ajo nuk i nevojitet dhe anëtarësimi falas në palestër nuk ka të ngjarë të jetë tërheqëse për dikë që nuk është i interesuar në aktivitetin fizik.

- ✓ Duhet të shoqërohet me ose t'i shërbejë një qëllimi. Shpërblimi është diçka që mund të përdoret për të arritur një rezultat që dëshirohet nga njëra palë ose tjetra.
- ✓ Shpërblimi duhet të ketë efekt të sjellja e personit që e merr shpërblimin, edhe pse efekti aktual mund të mos jetë ai që synohet,
- ✓ Duhet të ketë njohje të ndërgjegjshme nga ana e marrësit dhe dhënësit se ka ndodhur një akt shpërblimi.

Kushdo qoftë qëllimi i “dhënësit”, është marrësi ai që efektivisht jep kuptim shkëmbimit ose transaksionit dhe menaxherët duhet të jenë të paktën të vetëdijshëm për mundësinë se motivimi dhe qëllimet e tyre mund të keqinterpretohen ose keqshpjegohen nga marrësi. Edhe pse natyra e një shpërblimi shpesh shihet si jo problematike, kjo është larg realitetit dhe kjo nuk është vetëm çështje e qartësisë konceptuale. Strategjitë e shpërblimit të menaxherëve bazohen, pjesërisht, te këndvështrimet e tyre për vlerën e punonjësve, Supozimet që ata bëjnë për impaktin të sjellja, që mund të vijojë nga përdorimi i llojeve të caktuara të shpërblimeve, dhe funksionimi i sistemit të shpërblimit dhe pagesave që përdorin. Nëse supozimet e tyre kanë të meta, ka të ngjarë që objektivat e shoqëruara me një skemë të caktuar shpërblimi të mos arrihen.

1.4 Kategoritë e shpërblimeve

Shpërblimet vendosen zakonisht në kategoritë e mëposhtme.

Shpërblimet monetare

- ✓ Pagesa bazë
- ✓ Bonuset
- ✓ Pages komisioni
- ✓ Mbikohë/Orët jashtë orarit
- ✓ Pagesa me kusht

Përfitime të shoqëruara nëse punon për organizatën

- ✓ Pensionet
- ✓ Kujdesi shëndetësor
- ✓ Ushqime, kredi të subvencionuara, etj.
- ✓ Anëtarësim në klube shëndeti dhe palestra
- ✓ Makinë pune ose tollon karburanti
- ✓ Marrëveshje elastike pune

Burimi i këtyre është i rrënjësor në punën që bëjnë njerëzit dhe në mjedisin në të cilin punojnë.

- ✓ Njohja - lavdërimi
- ✓ Të qenit i vlerësuar
- ✓ Të qenit pjesë e një komuniteti social
- ✓ Arritje
- ✓ Të pranosh se puna është e rëndësishme dhe ka vlerë të brendshme
- ✓ Argëtim dhe kënaqësi

Shpërblime personale

- ✓ Promovim
- ✓ Avancim dhe zhvillim
- ✓ Përfitimi i kompetencave të reja
- ✓ Punësim i rritur

Perfundimet

Shpërblimet janë një nga elementët e rëndësishëm për të motivuar punonjësit për të kontribuar në përpjekjet e tyre më të mira për të gjeneruar ide inovative që çojnë në funksionalitet më të mirë të biznesit dhe për të improvizuar më tej performancën e kompanisë si financiare ashtu edhe jofinanciare. Disa nga këto përfshijnë vlerësimin se punonjësit janë në gjendje të marrin nga menaxherët e tyre, mundësinë për të marrë projekte apo detyra të rëndësishme dhe madje edhe vëmendjen e drejtuesve. Shumë hulumtime mbi fuqinë udhëheqëse kanë gjetur se fuqia e shpërblimit të mbikëqyrësit do të shoqërohet pozitivisht me performancën e detyrave të

punonjësve, produktivitetin, kënaqësinë, qarkullimin dhe sjelljet organizative të qytetarisë. Punonjësi do të japë maksimumin kur ata kanë një ndjenjë ose besim se përpjekjet e tyre do të shpërblehen nga menaxhmenti. Ekzistojnë shumë faktorë që ndikojnë në performancën e punonjësve si kushtet e punës, marrëdhëniet e punëtorëve dhe punëdhënësve, mundësitë e trajnimit dhe zhvillimit, siguria e punës dhe politikat dhe procedurat e përgjithshme të kompanisë për shpërblimin e të punësuarve etj.

Bankat i ofrojnë punonjësve të bankës rivale, pagesën e bukur dhe përfitimet shtesë, duke mbajtur parasysh tendencat konkurruese. Në skenarin e tanishëm, kjo është kërkesa e kohës, për bankat për mbijetesën e tyre, për të mbajtur punonjësit e tyre të aftë të paprekur përmes shpërblimeve.

Për të rritur performancën individuale, sistemi i shpërblimeve luan një rol kryesor. Shkathtësia e një punonjësi mund të rritet nëse një organizatë pune i zbaton punonjësit e saj me shpërblime. Menaxhmenti pret nga punonjësit e saj që ata duhet të respektojnë rregullat dhe të sjellin ndryshime dhe përmirësime revolucionare në mënyrë që të shtojnë aftësi të reja në punën e tyre.

REFERENCAT

- [1] Bratton and Gold, *Human Resource Management Theory and Practice*, 4th edition chapter 10, Palgrave Macmillan, 2007
- [2] Hope and Fraser, *Beyond Budgeting*, Harvard Business School Press, 2003
- [3] Val, M & Fuentes, CM 2003, „Resistance to change: a literature review and empirical study“, *Management Decision*, vol. 41, no. 2, pp. 148-155.
- [4] Puwaneethiren, P. (2011). Reward System and its impact on Employee Motivation in Commercial Bank of Sri Lanka Plc, In Jaffna District. *Global Journal of Management and Business Research*, 11(4), 84-92.
- [5] Ivancevich, J., Olelans, M., Matterson, M. (1997). *Organizational behavior and management*, Sydney: Irwin.
- [6] Dewhurst, M., Guthridge, M., Mohr, E. (2010). Motivation people: getting beyond money. *McK-insey quarterly*, 1, 12-15.
- [7] Samuelson, Lars A. (2001). *Controller Handbook*, London: McGraw Hill, cop.
- [8] Armstrong Michael (2003). *Employee Reward*, CIPD House, London, 3rd edition
- [9] Armstrong, M. (1993). *Managing Reward System*. Buckingham: Open University Pres.
- [10] Torrington, D., Hall, L., Taylor, S. and Atkinson, C. (2011) *Human Resource Management*. 8th edn. Edinburgh: Pearson Education.
- [11] Dematteo, J.S., Eby, L.T and Sundstrum, E. (1998) ‘Team-Based Rewards: current empirical evidence and directions for further research’, *Research in organisational behaviour*, 20, pp. 141-183. Academic Search Complete, EBSCOhost [Online]. (Accessed: 16 February 2014).
- [12] Armstrong, Michael. (2007) *Employee Reward*. 3rd edn. London: Chartered Institute of Personnel Development.
- [13] Armstrong, Michael. (2012) *Armstrong’s Handbook of Reward Management Practice*. 4th edn. London: Kogan Page.

RËNDËSIA TURIZMIT KULTUROR NË QYTETIN E PRIZRENIT

THE IMPORTANCE OF CULTURAL TOURISM IN THE CITY OF PRIZREN

NEVRUZ ORUQI, PhD¹.

*St. Clement of Ohrid University of Bitola,
Faculty of Tourism and Hospitality, Ohrid*

XHELIL BEKTESHI, PhD².

*St. Clement of Ohrid University of Bitola,
Faculty of Tourism and Hospitality, Ohrid*

Abstract

Prizren as a city thinks that there is no need for many major interventions from abroad, or new industries for development, but a rational approach to the existing potential of the city is needed to enliven the cultural life. Cultural tourism in this region is the most efficient enterprise and the fastest way to the local economic development of Prizren. With this approach, Prizren can be transformed into the capital of tourist culture, not through platforms and ideas written on paper, but through the practical development of a rich cultural life. Prizren can be transformed into a regional capital of culture, this level the city will achieve through cooperation with summer festivals in the region, thus proving in practice that it is one of the most important cities in the entire Balkan region. The local government of Prizren must urgently establish a tourism office and include cultural and natural tourism in the development priorities of the municipality, for the remaining historical cultural values of the city, and more qualitative strategies for tourism development in the city of Prizren.

Keywords: Prizren, cultural heritage, historical values, strategy, tourist potential

Abstrakt

Prizreni si qytet mendojë që nuk ka nevojë për shumë intervenime të mëdha nga jashtë, ose industri të reja për zhvillim, por nevojitet një qasje racionale të potencialit ekzistues të qytetit për të gjallëruar jetën kulturore. Turizmi kulturor në këtë rajon përbën ndërmarrjen më efikase dhe rrugën më të shpejtë drejt zhvillimit lokal ekonomik të Prizrenit. Me këtë qasje, Prizreni mund të shndërrohet në kryeqytet të kulturës turistike, jo përmes platformave dhe ideve të shkruara në letër, por përmes zhvillimit në praktikë të një jete të pasur kulturore. Prizreni mund të shndërrohet në kryeqytet rajonal të kulturës, këtë nivel qyteti do ta arrijë edhe përmes bashkëpunimit me festivalet verore në rajon duke u dëshmuar kështu edhe në praktikë se është njëri ndër qytetet më të rëndësishme të gjithë rajonit të Ballkanit. Qeveria lokale e Prizrenit duhet urgjentisht të themelojë zyrën e turizmit dhe të inkuadrojë

turizmin kulturor dhe natyror në prioritetet zhvillimore të komunës, për vlerat kulturore historike të mbetura të qytetit, dhe strategji më cilësore për zhvillimin e turizmit në qytetin e Prizrenit.

Fjal kyqe: Prizreni, trashëgimia kulturore, vlerat historike, strategji, potencial turistik

HYRJE

Industria e turizmit është industria me rritjen më të shpejtë ekonomike në botë. Kontributi total i udhëtimit dhe turizmit në ekonominë globale për vitin 2017 ishte 8.27 trilion dollarë amerikanë.⁴³

Turizmi në Kosovë është një sektor në rritje me shumë turistë që vizitojnë vendin çdo vit. Kosova ka vende turistike që mund të shfrytëzohen nga popullsia e vet për ekskursionet, për sport, rekreacion, pushim, kulturë, për arsim e edukim. Turizmi në Kosovë është i karakterizuar nga trashëgimet arkeologjike nga kohët e Ilirëve, Dardanëve, Romakëve, Bizantinëve, Serbëve dhe Osmanëve, kuzhina tradicionale Shqipëtare dhe Serbe, arkitektura, traditat, dhe peisazhet natyrore⁴⁴.

Prizreni në vitet 1999 po përjetonte tmerrin luftës ku po shkatroheshin monumentet dhe vlerat e ralla të së kaluarës si Lidhja e Prizrenit, shtëpitë të vjetra, mirpo pas përfundimit të luftës gjithnjë e më shumë është folur për potencialin turistik që posedon Prizreni duke ofruar mundësitë për zhvillim më të mirë ekonomik.

Në këtë kontekst do flasim për rëndësinë e turizmit kulturor në regjionin e Prizrenit si potencial kryesor turistik në Kosovë, njohës të fushës së turizmit e konsiderojnë Prizrenin si qytet i cili ka pasuri më të madhe të trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturo-historike.

Prizreni njihet për monumente të shumta të trashëgimisë në rajonin e ballkanit, duke e përfshirë Hamamin, Xhaminë e Sinan Pashës, Kalanë mandej ka edhe objekte të dy besimeve të tjera atij katolik dhe ortodoks.

Prizreni përveç që e ka të zhvilluar turizmin kulturor, ka potencial për zhvillim të turizmit malor dhe dimëror, prizreni si qytet historik në Kosovë është i rethuar me malet ku këtë qytet e bëjnë si potencial kryesor për turizëm dimëror, në këtë rajon gjindet Prevala e cila ndodhet në brendë Parkut nacional e cila jep një mundësi të mirë për vizitorët si në aspektin veror po ashtu edhe dimëror, ndërsa si mundësi tjetër turizmit malor në Prizren janë Malet e Sharrit dhe të Pashtrikut.

Lokacionet turistike më të rëndësishme në qytetin Prizrenit

Prizreni padyshim mundë të themi se është një prej vendbanimeve më të rëndësishme të Kosovës.

Prizreni si njëri prej qyteteve më të bukura në Kosovë ka shumë objekte historike dhe ato fetare, por ky vend është i njohur edhe me mikpritjen e tursiteve të cilët e vizitojnë Prizrenin brenda vitit.

Prizreni ka një të kaluar të bujshme që ka zgjuar kureshtjen e udhëpërshkruesve, historianëve, gjeografëve e shkencëtarëve të ndryshëm, të cilët botuan shumë vepra për këtë trevë të njohur administrative kulturore, historike,

¹<https://www.wttc.org/-/media/files/reports/economic-impact-research/regions-2018/world2018.pdf>

⁴⁴https://sq.wikipedia.org/wiki/Turizmi_n%C3%AB_Kosov%C3%AB

politike. Të dhënat arkeologjike dëshmojnë se ky territor ishte i banuar që nga antika, kur njihej me emrin Theranda në shek. II PES, ku në këtë trevë banonte një popullsi Dardane⁴⁵

Prandaj mund të themi se historikisht, Prizreni ka qenë një vend takim i kulturave dhe i tolerancës fetare, nga e kaluara e bujshme historike, qyteti I Prizrenit ka trashëguar një numër të madh objektesh kulturo-historike.

Më të rëndësishme për ata që dëshirojnë ta vizitojnë Prizrenin janë : Lidhja e Prizrenit, Xhamia e Sinan Pashës, Xhamia e Bajraklisë, Teqeja Halveti, Teqeja Rufa'i, Kompleksi I Shatërvanit, Marashi, Kalaja, Kisha Shën Premtja, Hamamet, Ura e Gurit, këto janë disa vende ku patjetër duhet ti vizitohet po pse jo edhe të kalojmë atje një pjesë të kohës tuaj me miqtë apo familjen.

Muzeu dhe Kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Kompleksi i Lidhjes së Prizrenit vazhdon në mbetet një nga vendet që të gjithë duan ta vizitojnë, Lidhja e Prizrenit ishte një organizim politik I parisë së katër vilajeteve shqiptare në Perandorinë Osmane.

Përveç vlerave të kulturës që posedon ky qytet, Lidhja e Prizrenit ka një rëndësi të madhe historike pasi që në objektin e Medreses dhe Xhaminë e Mehmed Pashës (Xhamia e Bajraklisë) u mbajt kuvendi themelues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, më 10 qershor 1878. prandaj themi se historikisht, Prizreni ka qenë një vend takim i kulturave dhe i tolerancës fetare. Lokacioni është shumë lehtë për tu gjetur pasi që ndodhet në distancë ecje nga sheshi Shadërvan.

Xhamia e Sinan Pashës

Xhamia e Sinan Pashës u ndërtua më 1615 nga Sofi Sinan Pasha. Xhamia e Sinan Pashës konsiderohet si njëra ndër xhamit më të vjetra në Kosovë mbasë Xhamisë së Sulltan Mehmet Fatihut II e cila është ndërtuar më 1461 e cila ndodhet në qytetin e Prishtinës, karakteristik që dallon xhamin e Sinan Pashës, është për shkak të arkitekturës së saj unike që e bën të dallojë nga xhamitë e tjera. Xhamia e Sinan Pashës u ndërtua në qendër të qytetit të Prizrenit në anën e majt të Lumbardhit, ndërsa me bukurinë e saj arkitektonike, ky objekt i kultit islam llogaritet si njëri ndër objektet më të rëndësishmit në Gadishullin Ballkanik.

Kalaja e Prizrenit

Kalaja e Prizrenit shtrihet në një sipërfaqe diku reth një hektar e gjysmë, nga Kalaja mund të shihet i tërë Prizreni bashkë me fushat e tij. Sa I përket ndërtimit të Kalas koha e sajë e saktë e ndërtimit nuk dihet, arkeologët thonë se ato u përkasin periudhave të ndryshme historike, nga ajo antike dhe bizantine.

Bazamenti i Kalasë përmban një rrjet tunelesh, njëri prej të cilit pas vitit 1938 u përdor si rezervuar uji, si pjesë e sistemit hidro-elektrik dhe atij të furnizimit me ujë të Prizrenit⁴⁶.

Muret e Kalasë shtrihen në drejtimin veri dhe jug, ndërsa nëse I shikojme muret e Kalasë në brendinë e saj vërejm se ata janë të ndërtuara në hapsira të ndryshme dhe korridore nën tokësore.

Teqeja Halveti

⁴⁵https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/PRIZRENI-VENDTAKIM_I_CIVILIZIMEVE_shq.pdf

⁴⁶https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/PRIZRENI-VENDTAKIM_I_CIVILIZIMEVE_shq.pdf

Teqeja Halveti është themeluar më 1605 në Lagjën e Saraçve nga ana e Sheh Osman Babës nga Luma, që njëherit është edhe teqja qendrore e këtij tarikati në Prizren. Prizrenasit e njohin si teqja e Sheh Hasanit. Degët e veta i ka edhe në Rahovec, Mitrovicë dhe Shqipëri⁴⁷.

Trashëgimia Kulturore-Historike

Qyteti i Prizrenit është i njohur si një vend për vlerat e trashëgimisë kulturore, dhe religjioneve të ndryshme. Paturia më e madhe e Prizrenit themi se janë vlerat e trashëguara nga nga kohët e lashta.

Turistët e zgjedhin Prizrenin si destinacion kryesor për vizitë në Kosovë, për shkak se Prizreni njihet si ndër qytet më të vjetra në Kosovë dhe trashigimisë kulturore që ka qyteti.

Prej trashigimesë kulturore që posedon Prizreni, vizitorët shprehin interesim qdo ditë e më shumë dhe janë të kënaqur me mirëpritjen që e ka Prizreni ndaj turistëve të huaj, ndërsa tursitët e përforojnë më së shumti qytetin e Prizrenit për shkak të trashigimsë së lashtë që e ka ai.

Vendet që turistët shpesh i vizitojnë në Prizren janë Trashigimia Kulturore që ka ky qytet si : Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Ura e Gurit, Hamami i Gazi Mehmed Pashës, Shtëpitë e Vjetra Tradicionale të Prizrenit, Muzeu Arkeologjik i Prizrenit.

Lidhja shqiptare e Prizrenit është objekt më i vizituar në Kosovë, mbas kompleksit Adem Jasharit.

Ura e Gurit burimet historike nuk ofrojnë ndonjë të dhënë për kohën e saktë të ndërtimit të saj, mirpo nga materiali, stili, teknika e ndërtimit arkeologët supozojnë se ura është ndërtuar në fundë të shekullit XV apo në fillim të shekullit XVI , ndërsa më 1948 kjo urë është marrë nën mbrojtjen e shtetit, në rrjedhat e histories, me kalimin e kohës ura ka pasur ndryshime.

Hamami i Prizrenit gjendet në qendër të Prizrenit, është ndërtuar në vitet 1563-74 nga Gazi Mehmet Pasha, nëse shikohet nga lartë pullazi o objektit ka dy kupola mbi tabure dhe nëntë kupola të vogla që janë mbi pjesën e ngrohtë⁴⁸. Ndërsa nga viti 2000 një pjesë e Hamamit shfrytëzohet si galeri për aktivitet të ndryshme kulturore dhe edukative. Hamami paraqet një rëndësi prej objekteve më të rëndësishme të periudhës Osmane në Prizren.

Shtëpitë e Vjetra Tradicionale të Prizrenit në Prizren si vlerë historike dhe arkitektonike janë Shtëpitë e Vjetra Tradicionale të cilët u ndërtuan gjatë shekullit XIX dhe XX disa prej shtëpive Tradicionale në Prizren janë : Shtëpia e muze e Musa Shehzades, Shtëpia e familjes Arapi, Shtëpia e Ymer Prizrenit, Shtëpia e Zija Beut, Në këto shtëpi karakteristik është se dritaret, tavanet,dollapet janë nga druri i përpunuar me shumë mjeshtri.

⁴⁷https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/PRIZRENI-VENDTAKIM_I_CIVILIZIMEVE_shq.pdf

⁴⁸<http://prizrenpress.com/hamami-i-prizrenit-historia-dhe-monumenti-qe-nuk-duhet-mbyllur-me-celes/>

Muzeu Arkeologjik i Prizrenit apo Hamami i Shemsedin Ahmet Beut dhe Sahat Kulla gjenden në pjesën perëndimore të qytetit të vjetër. Hamami është ndërtuar në shekullin XV, përkatësisht në vitin 1498.

Objekti i Hamamit ka formë drejtkëndëshe dhe është ndërtuar me gurë të ndryshëm dhe tulla të lidhura me llaç gëlqeror. Kulmi ka shtatë kupola dhe tri qemerë, dhe të gjitha janë të mbuluara me plumb. Dyshemeja e objektit është shtruar me pllaka guri të vendosura në vitet 1972/75 të shekullit XX kur objekti shndërrohet në muze arkeologjik⁴⁹.

Shatërvani i Prizrenit

Të gjithë ata që vizitojnë qytetin e Prizrenit shatërvani është vendi më i rëndësishëm për shëtitje në Prizren. Krojet në Shatërvan janë një prej simboleve të qytetit të Prizrenit. Në afërsi gjendet edhe xhamia e Sinan Pashës ku

vizitorët që kalojnë aty mund të ndalen për të pirë ujë nga kroji i famshëm i shatërvanit apo për të pirë çaj apo kafe në lokalet që gjenden aty përreth.

SWOT Përparësitë në Prizren

- 🚩 Trashëgimi kulturore
- 🚩 Klimë të ndryshueshme
- 🚩 Kulturat bujqësore (hardhit e rrushit, frutave dhe perimeve)
- 🚩 Kuzhina tradicionale
- 🚩 Qasje rrugore me Maqedonin dhe Shqipërin.
- 🚩 Natyrë të pasur me Malet e Sharrit
- 🚩 Traditë mikëpritëse (Njerëz mikëpritës)
- 🚩 Ciceroni i certifikuar nga

Kompleksi Marash

Kompleksi Marash gjendet në dalje të Prizrenit rrugës për Prevall, gjendet në anën e majtë të lumit të Lumebardhit, apo në pjesën lindore të Prizrenit. Ky vend brenda vitit vizitohet nga vizitorë të shumtë ku këta vizitorë e shfrytëzojnë hapësirën e Marashit për të pushuar, argëtuar, ecurë dhe për aktivitete sportive.

SWOT ANALIZA

Në këtë punim kam analizuar Analizan SWOT për Sektorin e turizmit në rajonin e Prizrenit. Analiza SWOT na jep një pasqyrë e cila na tregon përparësitë dhe dobësitë të sektorit të turizmit në Prizren, dhe na tregon mundësitë përkatësisht kërcënimet kryesore që ballafaqohet sektori i turizmit

⁴⁹<https://prizrenpost.com/al/muzeu-arkeologjik-i-prizrenit-hamami-i-shemsedin-ahmet-beut-dhe-sahat-kulla/>

në Prizren. Analiza SWOT njihet ndryshe si analiza e Përparësive, Dobësive, Mundësive dhe Rreziqeve (SWOT) dhe mund të themi se është një mjet më i preferuar, dhe shpesh përdoret për planifikimim, kjo analiz bazohet në inpute dhe në njohuritë e situates prezente të ofruar nga personat tjerë.

Analiza (SWOT)⁵⁰

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Prizreni themi se është një nga qytetet më të rëndësishme sa i përket ekonomisë, turizmit, trashigimisë kulturore - historike në rajonin e Dukagjinit.

Një ndër qëllimet më të rëndësishme të këtij punim po synohet mundësija për zhvillimin të turizmit në rajonin e Prizrenit, nëpërmjet promovimit të trashigimis kulturore dhe historike, si pasuri që ka Prizreni.

Trashigimia kulturore luan një rol shumë të rëndësishëm në rritjen e numrit të turistëve dhe në zhvillimi e vendit në aspektin ekonomik.

Në Prizren zhvillim të madh ka turizmi kulturor, për shkak të numrit të madh të elementeve të trashëgimisë historike, mirpo krahas turizmit kulturor në Prizren mund të zhvillohet turizmi sportive.

Sa i takon numrit të turistëve në rajonin e dukagjinit, turistët e preferojnë stinën e dimrit për shkak të rreshjeve të borës dhe mundësive për zhvillimin e sportive dimërore. Në Prizren vërehet një fluks i madhë i turistëve në periudhën e dimrit. Dimri i jep qytetit të Prizrenit një mundësi reale për të tërhequr turistë vendas dhe të huaj, mirpo duhet ti kushtohemi rëndësi infrastrukturës rrugore, duhet ti mbështesim produktet artizanale që ka ky qytet, duhet të krijohet në komision i cili i mbykqyrë dhe bën ruajtjen e arkitekturës së qytetit nga ndërtimet e reja, me qëllim që të rrisim numrin të turistëve.

SWOT Dobësitë në Prizren







- ✚ Mungesa e infrastrukturës adekuate
- ✚ Mungesa e produkteve turistike
- ✚ Mungesa e parkimit për automjete;
- ✚ Marketing i pamjaftueshëm për turizm
- ✚ Mungesa e depozitimeve të ujërave të zeza dhe menaxhimin e tyre;
- ✚ Mungesa e standardeve të përparuara në shërbimet e turizmit,
- ✚ Strategji jo adekuate të stimulimit për të tërhequr investime nga jashtë

SWOT Rreziqet/Kërcënimet në Prizren

- ✚ Pamjaftueshmëria e fondeve buxhetore
- ✚ Munges e Investimeve nga shteti i Kosovës
- ✚ Krizat ekonomike dhe rrijta e numrit të papunësis
- ✚ Migrimi i të rinjeve për një jetë më të mirë
- ✚ Munges e energjisë elektrike
- ✚ Mos kujdesja ndaj objekteve kulturore dhe ndotja e lumenjeve
- ✚ Konkurenca nga vendet e tjera të rajonit

⁵⁰<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/20220224.pdf>

SWOT Mundësitë në Prizren

-  Zgjerimi i turizmit ndertimi i bujtinave
-  zhvillimit i mundesive per nje ambient rekrativ
-  Investimet nga Qeveria për Prizrenin si destinacion turistik
-  Pëmirësimi i infrastrukturës
-  Përfshirja e Mërgatës për zhvillimin e turizmit në qytetin e Prizrenit
-  Partneritet mes sektorit publik

Literatura

- <https://www.wttc.org/-/media/files/reports/economic-impact-research/regions-2018/world2018.pdf>
- https://sq.wikipedia.org/wiki/Turizmi_n%C3%AB_Kosov%C3%AB
- https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/PRIZRENI-VENDTAKIM_I_CIVILIZIMEVE_shq.pdf
- <http://prizrenpress.com/hamami-i-prizrenit-historia-dhe-monumenti-qe-nuk-duhet-mbyllur-me-celes/>
- <https://prizrenpost.com/al/muzeu-arkeologjik-i-prizrenit-hamami-i-shemsedin-ahmet-beut-dhe-sahat-kulla/>
- <https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/20220224.pdf>

NDIKIMI I FAKTORËVE TË RISKUT NË PERFORMANCËN FINANCIARE TË NDËRMARRJËVE

THE INFLUENCE OF RISK FACTORS ON THE FINANCIAL PERFORMANCE OF ENTERPRISES

Vait Nikaj

vaitnikaj@hotmail.com

Abstract

Risk management is a very important component in financial management, so risk management refers to the ways in which activity risk can be avoided. Risk management is aimed at avoiding obstacles, unexpected situations and the effects of the external and internal environment.

Financial risks arise through countless transactions of a financial nature, including sales and purchases, investments and loans, and changes in business activities. It is well known that modern corporations face a wide range of risks that follow the business. The risk, which we define as any source of uncertainty, affects business operations, comes in different forms

Risk management today plays a vital role in business. Every firm, whether large or small, makes an effort to manage risk more efficiently. Risk management is very important in the financial system. The purpose of this paper is to provide a clear overview of the financial risks that can be faced.

The paper focuses on financial risk analysis in commercial enterprises. The risk was first analyzed and how it should be managed, then a greater focus is on the financial risk of how these risks affect the enterprise how to manage them, as well as through questionnaires to recognize the real situation of commercial enterprises in Kosovo than they cost importance of this type of risk.

Keywords: financial risk, financial institutions, credit risk, interest rate risk and insolvency, liquidity risk, strategy, financial derivatives and regulations.

Abstrakt

Menaxhimi i riskut është komponentë shumë e rëndësishëm në menaxhmin financiar prandaj menaxhimi i riskut i referohet rrugëve përmes të cilave mund të evitohet risku i aktivitetit. Menaxhimi i risku është i drejtur në evitimin e pengesave, situatave të papritura dhe efekteve të rrethines së jashtme dhe të brendshme.

Rreziqet financiare lindin nëpërmjet transaksioneve të panumërta të një natyre financiare, duke përfshirë shitjet dhe blerjet, investimet dhe kreditë, dhe ndryshimet në aktivitetet e biznesit. Dihet mirë se korporatat moderne përballen me një gamë të gjerë të rreziqeve që e ndjekin biznesin. Rreziku, që ne e definojmë si çdo burim pasigurie, ndikon në operacionet e biznesit, vjen në forma të ndryshme

Menaxhimi i riskut sot luan një rol jetësor në biznes. Çdo firmë, qoftë e madhe apo e vogël, bën një përpjekje për të menaxhuar rrezikun në mënyrë më efektive. Menaxhimi i rrezikut është shumë e rëndësishëm në sistemin financiar. Qëllimi i këtij punimi është që të ofrojë një pasqyrë të qartë të rreziqeve financiare me të cilat mund të ballafaqohen ndërmarrjet.

Punimi është fokusuar në analizen e rrezikut financiar në ndërmarrjet tregtare. Fllimisht është analizuar risku dhe si duhet të menaxhohet ai, pastaj një fokus më të madh ka rreziku financiar se si këto rreziqe ndikojnë në ndërmarrje si duhet menaxhuar ato, po ashtu nëpërmjet pyetësorëve të njihet gjendja reale e ndërmarrjeve tregtare në Kosovë se sa ato i kushtojnë rëndësi këtij lloji rreziku.

Fjalët kyçe: rreziku financiar, institucionet financiare, rreziku i kredisë, rreziku i normës së interesit dhe paqftësia paguese, rreziku i likuiditetit, strategjia, derivatet financiare dhe rregulloret.

1. Hyrje

Menaxhimi i rreziku është një disiplinë shumë e rëndësishme për të menaxhuar një organizatë, ajo është një metodë që në mënyrë sistematike bënë indentifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve që përballen ndërmarrja si dhe mer masa për të redukuar ose eliminuar ekzpozimin ndaj humbjeve që mund të kërcënojnë një organizatë.

Manaxhimi i Rrezikut Financiar është një proces që merret me pasiguritë që rezultojnë nga tregjet financiare. Kjo përfshin vlerësimin e rreziqeve financiare me të cilat përballen një organizatë dhe zhvillimin e

strategjive të menaxhimit në përputhje me prioritetet dhe politikat e brendshme. Menaxhimi e riskut financiar kërkon marrjen e vendimeve organizative në lidhje me rreziqet që janë të pranueshme kundrejt atyre që nuk janë.

Organizatave menaxhojnë rrezikun financiar duke përdorur një shumëllojshmëri të strategjive. Ekspozimi ndaj tregjeve financiare ndikon në shumicën e organizatave, drejtpërdrejt ose tërthorazi. Kuptimi i parë i riskut lidhet me faktin se çdo mjet, veçanërisht mjetet financiare, gjatë porçesit të përdorimit të tyre sigurojnë fitim. Rreziku është definuar si një ngjarje e mundshme që ndodh dhe ka implikime negative në ndërmarrje.

Organizatave përballen me një spektër të gjerë të rreziqeve që ndikojnë në rezultatin e operacioneve të tyre. Menaxhimi i riskut ofron një qasje të integruar për vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e llojeve të rrezikut.

2. Përkufizimi dhe kalsifikimi i riskut

Risku përcaktohet si mundësi për të humbur ose si frikë se nuk do të realizohet niveli i parashikuar i fitimit apo, më keq akoma, se mund të pësojmë humbje. Mjetet që kanë mundësi më të mëdha për të pësuar humbje quhen më risikoze.⁵¹ Sipas fjalorit të Oxfordit risku definohet si “shanse apo mundësi e riskut, humbje, lëndim apo ndonjë ndikim i pafavorshëm”⁵² Sipas këtij definicioni risku definohet si diçka negative, por një vlerësim i tillë nuk do të duhej të merrej vetëm nga kjo qasje sepse risqet kanë edhe ndikim pozitiv.

Ka përkufizime të shumta të rrezikut. Gjithkush ka një përkufizim të asaj se çka është rreziku, dhe të gjithë e njohin një gamë të gjerë të rreziqeve. Disa nga përkufizimet më gjerësisht të diskutuara të rrezikut përfshijnë si në vijim:⁵³

- Gjasat që një ngjarje e padëshirueshme do të ndodhë
- Madhësia e humbjes nga një ngjarje e papritur
- Probabiliteti se "gjërat nuk do të shkojnë mirë"
- Efektet e një rezultati të kundërt

Rreziku është një ngjarje e ardhshme e pasigurtë (ose thënë ndryshe e mundshme), e cila nuk është e lidhur me objektivin, por një ngjarje e tillë nëse ndodh atëherë mund të ketë ndikime të mëdha apo të vogla apo të dëmtojë shëndetin, sigurinë, reputacionin dhe pasurinë tonë. Me konkretisht me termin rrezik nënkuptojmë çdo ngjarje të mundshme në të ardhmen që ka një ndikim negativ në jetën tonë.

2.1. Llojet themelore dhe karakteristikat e rrezikut

Ekzistojnë ndarje të ndryshme të risqeve me të cilat përballen ndërmarrjet. Sipas Orfea Dhucit klasifikimi i riskut bëhet nga tri këndvështrime: nga këndvështrimi i ngjarjeve të riskut, nga këndvështrimi i mundsisë së ndryshimit (diversifikimit) të tij, dhe nga këndvështrimi i dallimit të risqeve në risqe të veprimtarisë ekonomike dhe risqet financiare. Bizneset varen nga faktorë të brendshëm organizativë dhe nga rrethanat e jashtme të cilat në shumicën e rasteve janë jashtë ndikimit dhe kontrollit të kompanisë, duke u nisur nga kjo risqet mund të klasifikohen në:⁵⁴

Risku i biznesit dhe risku financier - Risqet financiare kryesisht lidhen me parametrat makroekonomik. Këto ndikojnë në aftësinë financuese të firmës dhe në të ardhurën/humbjen e saj. Jo të gjitha firmat preken në të njëjtën mënyrë. Risku financiar është njeri ndër risqet që ka marrë vëmendje më të madhe kohët e fundit pasi që është një proces dinamik i cili përfshin dhe ndikon në shumë pjesë të kompanisë si thesarin, shitjet, marketingun, aspektet ligjore, produktet, financimin e kompanisë etj, dhe ndikimi i tij është afatgjatë.

- **Risku sistematik dhe risku josistematik** - Risku sistematik ose “risku i tregut” është i paparashikueshmë dhe është e pamundur krejtësisht për t’u shmangur. Rreziku përdoret kryesisht në financa. Rreziku sistematik përdoret për etiketimin e rrezikut që ndikon në të gjitha llojet e financave (asetet) me të cilat tregtohet në tregun e kapitalit. Risku sistematik i referohet riskut që ndikohet nga faktorët e jashtëm, pra risku i tregut. Dhe kryesisht lidhet me: Lulatjen e çmimeve të letrave me vlerë, lulatjen e normave të interesit, humbjen e fuqisë blerëse nga inflacioni, riskun e kurseve të këmbimit, ndryshimet në pritjen e investitorëve të lidhura me performancat e përgjithshme të ekonomisë. Ndërsa, risku jo sistematik përfshin të gjitha lulatjet e performancës që rezultojnë nga funksionimi i faktorëve që lidhen me entitetin e veçantë ekonomik. Ky lloj rreziku mund të eliminohet me strategjitë e diversifikimit. Rreziqet jo sistematike përfshijnë rreziqet strategjike të cilat zakonisht janë të vështira për t’u matur. Rreziqet strategjike lindin nga një mjedis i jashtëm në ndryshim, i turbullt, që i referohen konkurrentëve, klientëve,

⁵¹ Sherif Bundo, *Financë*, Tiranë 2007 faqe 68

⁵² Oxford dictionaries, <https://en.oxforddictionaries.com/definition/us/risk>

⁵³ Richard Apostolik & Christopher Donohue, *Themelet e riskut financiar*, në shqip Hashim Rexhepi Prishtinë 2016 faqe 19

⁵⁴ Mustafa Isa, “Menaxhmenti financiar”, botimi i dytë, Riinvest, 2007, Prishtinë, faqe 189

zinxhirit të furnizimit etj. Këto rreziqe janë shumë delikate, sepse ato përfshijnë një shkallë të lartë të pasigurisë që e ndërlikon identifikimin dhe parashikimin e tyre.

- **Risku i një mjeti dhe risku i portfolios** - Në pjesën më të madhe të studimeve në fushën e financës, analizohen normat e kthimit në vend të çmimeve të asetëve. Arsyet kryesore janë dy: në radhë të parë, për shumë investitorë, rendimenti i një asemi është një informacion i plotë mbi mundësitë për investim.
- Në radhë të dytë, seritë e rendimenteve (normave të kthimit) janë më të lehta për t'u menaxhuar se seritë e çmimeve, për shkak të vetive të tyre interesante statistikore.
- Objektivi i menaxherit të portofolit është gjenerimi i flukseve monetare të përafërt me pritjet e çdo klienti. Kjo do të thotë se objektivi i menaxherit nuk është me domosdoshmëri maksimizimi i rendimenteve të asetëve, siç mund të mendojnë shumica e individëve. Objektivi është më i komplikuar dhe ka të bëjë me lidhjen ndërmjet riskut dhe rendimentit në një periudhë të caktuar kohore. Zakonisht, menaxherët përqendrohen në një pjesë të veçantë të universit të investimeve dhe më pas, mundohen të zgjedhin tituj 'fitues', të cilët performojnë mirë në periudhën afatmesme dhe afatshkurtër.

3. Performanca financiare dhe risqet

Performanca financiare është një perspektivë më e ngushtë e performancës dhe përgjithësisht lidhet me cilësinë e aktivitetit financiar të ndërmarrjes, dhe më konkretisht mund të përkufizohet si masa në të cilën janë realizuar ose arritur objektivat financiare të firmës.

Pikërisht në këtë këndvështrim mund të themi se përmes matjes së performancës financiare firma mund të masi rezultatet e politikave, strategjive dhe operacioneve të saj në terma numerike monetare. Matja e performancës për më tepër asaj financiare do t'i mundësojë firmës të masi dhe të analizoj shëndetin financiar të saj gjatë një periudhe kohe si dhe të mund të krahasoj performancën e saj me firmat e ngjashme ose konkurrencte.

Gjithashtu duke ditur se investitorëve, aksionerëve, ose stakeholders-ave iu duhet vazhdimisht të njohin performancën e firmës, ndaj informacioni financiar (si psh. kthimi nga investimet, kthimi ndaj kapitalit, rritja e shitjeve, apo dhe përfitueshmëria) është informacioni më eksplisit dhe më i vlefshëm në raport me treguesit e tjerë të vlerësimit të performancës.

Njëkohësisht informacioni financiar duhet të jetë të paktën i vlefshëm për qëllime rregullatore dhe raportuese sidomos për çështje fiskale. Raportimi i informacionit financiar është edhe një çështje që lidhet me karakteristikat e firmës (publike apo private), madhësinë e saj etj. Performanca financiare mund të matet përmes treguesve të dy grupeve kryesore. Këto dy tipe treguesish përfshijnë:⁵⁵

- "Treguesit tradicionale të bazuar në të dhënat kontabile dhe financiare (psh. ndikimet mbi fitimin vjetor, kthimi nga shitjet, kthimi nga aktivet, etj.)."
- "Si dhe treguesit e bazuar në treg, të derivuar prej vlerave të tregut të aksioneve të cilat janë bazuar mbi parimet e vlerësimit".

Pra performanca financiare e firmës konsiderohet se është funksion i disa treguesve financiar si kthimi nga shitjet (ROS), kthimi nga aktivet (ROA), rritja e shitjeve, raporti kosto/të ardhura etj.

Treguesit e performancës financiare të firmës

Treguesit ose matësit e performancës financiare zakonisht shprehen ose artikuloohen si raporte financiare. Raportet financiare klasifikohen në:⁵⁶

- Raportet e aktivitetit, të cilat tregojnë sesa në mënyrë eficiente një firmë i përdor aktivitetet e saj ditore si mbledhja e llogarive të arkëtueshme, menaxhimi i inventarit etj.
- Raportet e likuiditetit, të cilat masin aftësinë e firmës për të përballuar detyrimet e saj afat-shkurtra.
- Raportet e afësisë paguese (që njihen ndryshe dhe me termin raportet e levës, ose të borxhit afat-gjatë), masin aftësinë e firmës për të përballuar detyrimet e saj afat-gjata.
- Raportet e përfitueshmërisë masin aftësinë e firmës për të gjeneruar fitim ose të ardhura rentabile nga shitjet prej burimeve ose aktiveve të veta.
- Raportet e vlerës ose të tregut masin madhësinë e një treguesi si psh. fitimet që i atribuohet çdo fraksioni kapitali si psh. çdo aksioni të zakonshëm.

4. Risqet që ndikojnë në aktivitetin e ndërmarrjeve

Ndërmarrjet ndeshen me shumë faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Aktiviteti i tyre influencohet nga risku politik (ndryshimet në jetën politike të vendit, akte të reja ligjore), risku kriminalistik (raste të situatave

⁵⁵ Aktan, B., & Bulut, Ç. (2008). Financial Performance Impacts of Corporate Entrepreneurship in Emerging Markets: A Case of Turkey, European Journal of Economics, Finance and Administrative Sciences, 12: faqe 69-79.

⁵⁶ Po aty

kriminalistike të ndërlikuara apo korrupsioni, të cilat nuk zgjidhen nga institucionet ligjore), risku financiar (ndryshime në tregjet financiare) dhe risku tregtar (ndryshimet në import-eksportin e mallrave, një sistem taksash jo perfekt, logjistikë e keqe, etj.). Prandaj, drejtuesit e ndërmarrjeve duhet të vlerësojnë të gjithë këto faktorë në mënyrë objektive në mënyrë që të arrijnë objektivat e dëshiruara.⁵⁷

Epstein & Rejc në një guidë kontabiliteti drejtimi sugjerojnë që organizatat duhet të identifikojnë risqet me të cilat përballen. Disa risqe potenciale sipas tyre janë:⁵⁸

- *Risqet strategjike* - përfshijnë riskun ekonomik, riskun e industrisë, riskun e transaksioneve strategjike, riskun social, riskun teknologjik, riskun politik dhe riskun e organizimit të sistemeve.
- *Risqet operacionale* - përfshijnë riskun e ambientit, riskun financiar, riskun e vazhdimësisë së biznesit, riskun e inovacionit, riskun tregtar, riskun e projektit, riskun e burimeve njerëzore, riskun shëndetësor dhe të sigurisë, riskun e pronësisë dhe riskun e reputacionit.
- *Risqet e raportimit* - përfshijnë riskun e informimit dhe riskun e raportimit.
- *Risqet e pajtueshmërisë* - përfshijnë riskun ligjor dhe rregullator, riskun e kontrollit, dhe riskun profesional.

5. Menaxhimi me rreziqet financiare

Menaxhim i riskut është një nga konceptet më të reja, por që ka një rëndësi shumë të madhe në fushën e menaxhimit të bizneseve e që ka të bëjë me identifikimin, analizimin, vlerësimin dhe trajtimin e risqeve. Menaxhimi i rrezikut financiar kërkon marrjen e vendimeve organizative për rreziqet që janë të pranueshme kundrejt atyre që nuk janë. Organizatat menaxhojnë rrezikun financiar duke përdorur një sërë strategjish dhe produkte. Është e rëndësishme të kuptojmë se si këto produkte dhe strategji punojnë për të zvogëluar rrezikun brenda kontekstit të tolerancës dhe objektivave të rrezikut të organizatës.

Ndërmarrjet si subjekte të pavarura ekonomike në realizimin e politikës së tyre afariste, realizojnë politikën e tyre financiare dhe strategjinë financiare. Me realizimin e politikës së tyre financiare dhe strategjisë në esencë realizojnë menaxhmenin financiar të cilin do e ndanim në:⁵⁹

- a) Realizimin e menaxhmentit financiar të rrezikut në lëmin e punës me valutë komëtare**, të cilat mund të shfaqen mbrenda ndërmarrjes si dhe në mardhënjet me subjektet tjera ekonomike financiare. Vlenë të cekem: *Planifikimi jo adekuat* i vëllimit të përgjithshëm të mjeteve financiare, së strukturës së këtyre mjeteve, shkallës së likuiditetit, shkallës së solventit të ndërmarrjes, *Sistemi i sigurimit me rastin e ruajtjes* apo bartjes së mjeteve financiare, shkalla e të hyrave, në shfrytëzimin e mjeteve nga aspekti i shkallës së humbjes së fuqisë blerëse dhe vlerës intervalutore në njësinë e vendit, *si dhe shkalla e aftësisë profesionale* dhe aplikative të personave të cilët punojnë dhe menaxhojnë me mjetet financiare.
- b) Menaxhmenti financiar në punën me letra me vlerë**. Mundësitë për rreziqe financiare egzistojnë që nga momenti i marrjes së vendimit për emitimin e letrave me vlerë, shitjen apo stërshitjen e tyre e deri te shuarja, përkatësisht shlyerja e letrave me vlerë.
- c) Menaxhmenti financiar në lëmin e punës devizore**. Këtu bëhet fjalë për rrezikun devizorë deri te i cili vihet si rrezulltat i ndryshimit të menjëherëshëm dhe të papritur të lartësisë së kursit devizorë të valutave të një apo më shumë partnerëve afarist.
- d) Realizimi i menaxhmentit financiar në lëmin e punës së ndërmarrjeve në tregun financiarë** (tregu i parave, tregu i kapitalit, tregu i letrave me vlerë, tregu devizorë). Rreziqet më të shpeshta që hasen në këto tregje janë:⁶⁰ *Rreziku financiarë, Rreziku i likuiditetit të tregut, Rreziku i fuqisë blerëse, Rreziku i çmimit* ose në ndryshimet në lartësinë e kursit devizorë.

6. Strategjitë e trajtimit të riskut

Ka mjaftë rëndësi fakti se si implementohen strategjitë e zgjedhura. Ato duhet të jenë lehtësisht të aplikueshme, nuk duhet të kenë kosto të lartë dhe të garantojnë zgjidhjen e problemeve të mbrojtjes së riskut. Pra, instalimi i teknikave duhet të bëjë që mekanizmi të funksionojë si duhet.

Ka katër karakteristika për të reduktuar riskun. Ato janë:⁶¹

⁵⁷ Valkauskas, R. (2013). Assessment of the financial position of a company: theoretical aspect. *Ekonomika*, 92 (3), 166-180.

⁵⁸ Epstein, M. J., & Rejc, A. (2005). *Identifying, Measuring and Managing Organizational Risks for Improved Performance. Management Accounting Guideline*. Hamilton: The Society of Management Accounting of Canada, New York: AICPA.

⁵⁹ Bakrač Xhevat, *Menaxhmenti i rrezikut dhe sigurimet*, UP, Prishtinë, 2007 faqe 175

⁶⁰ Po aty

⁶¹ National Consumer Commission, *Risk Management Strategy and Methodology*, National Consumer The NCC 4, fq, 23

- **Evitimi i riskut:** mund të arrihet duke vendosur me dëshirë që të marrim përsipër një risk të caktuar. Një person mund të zgjedh që të vendosë vetë që të mos punojë në një zanafillë të caktuar, në një profesion të caktuar. Po kështu një ndërmarrje mund të evitojë disa tregje të cilat ajo i vlerëson me risk të lartë. Por nuk mund që gjithnjë të evitohet risqet. Kështu për shembull, të gjithë jemi të ekspozuar para risqeve të sëmundjeve, për shkak të qenit qenije të gjalla. Nuk mundemi aspak ta evitohet këto lloj risku.⁶²
- **Parandalimi i riskut:** kjo përmbledh veprimet për të reduktuar probabilitetin ose shumën e humbjes. Mund të vepohet para se të ndodhin humbjet, mund të vepohet edhe gjatë momentit që ndodhin humbjet dhe së fundit mund të vepohet edhe pasi kanë ndodhur humbjet.
- **Thithja ose pranimi i riskut:** kjo do të thotë që ta pranosh rrisun dhe të paguash humbjet nga burimet e tua financiare. Kjo ndodh për shkak të defekteve apo të ngjarjeve të papritura. Kështu për shembull kur nuk jemi të mirë informuar për riskun ose kur e kemi injoruar shkallen e riskut.
- **Transferimi i riskut:** konsiston në qëndrimin për ta larguar riskun dhe në transferimin e tij te personat e tjerë. Mundet shumë mirë të shesim një aktiv të riskuar dikujt tjetër. Kjo realizohet nëpërmjet firmosjes së një kontrate sigurimi me një kompani sigurimi. Transferimi i riskut konsiderohet edhe kur disa nuk bëjnë përpjekje të reduktojnë riskun duke i llogaritur mbi të tjerët humbjet e shkaktuara nga risku i vërtetuar.

Arsyja që shumë drejtues mendojnë së niveli i një risku të caktuar është i ulët, është që ata besojnë së kanë pika kontrolli të forta që sigurojnë menaxhimin efektiv të tij.

Çdo organizatë biznesi duhet të studjojë me kujdes mjedisin ku ajo vepron për të përcaktuar sa më mirë mikromjedisin e saj konkret. Po ashtu rëndësi të veçantë kanë edhe punonjësit pasi që në bazë të aftësive të tyre të prodhojnë produkte e shërbime cilësore e kompetitive. Një faktorë i rëndësishëm për mjedisin e brendshëm kanë edhe konkurrentët ngase konkurrenca i shtyen firmat që të bëjnë ndryshimet e nevojshme në teknologji, organizim dhe në përgatitjen e marketingun e produkteve. Po ashtu edhe partnerët dhe furnitorët kanë impakt të rëndësishëm në ndërmarrje.

Tabela. 1. Matrica e korrelacionit ndërmjet faktorëve të riskut financiar

		Correlations					
		jetegjatesia e ndermarrjes	madhesia	mjedisi i jashtem	orientimi kah inovacionet	aksesi ne kapital	rreziku financiar
jetegjatesia e ndermarrjes	Pearson Correlation	1	.053	-.018	.100	-.106	-.098
	Sig. (2-tailed)		.613	.863	.335	.308	.344
	N	95	95	95	95	95	95
madhesia	Pearson Correlation	.053	1	-.037	.240*	.030	-.016
	Sig. (2-tailed)	.613		.720	.019	.772	.877
	N	95	95	95	95	95	95
mjedisi i jashtem	Pearson Correlation	-.018	-.037	1	.020	.144	-.052
	Sig. (2-tailed)	.863	.720		.845	.163	.619
	N	95	95	95	95	95	95
orientimi kah inovacionet	Pearson Correlation	.100	.240*	.020	1	-.014	-.095
	Sig. (2-tailed)	.335	.019	.845		.890	.358
	N	95	95	95	95	95	95
aksesi ne kapital	Pearson Correlation	-.106	.030	.144	-.014	1	-.149
	Sig. (2-tailed)	.308	.772	.163	.890		.151
	N	95	95	95	95	95	95
rreziku financiar	Pearson Correlation	-.098	-.016	-.052	-.095	-.149	1

⁶² Farid, J. A. (2014). *Models at work: A practitioner's guide to risk management*. London: Palgrave Macmillan.

Sig. (2-tailed)	.344	.877	.619	.358	.151	
N	95	95	95	95	95	95

*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

Nëse do t'i referoheshim tabelës me sipër (tabela 8), do të shohim se lidhja ose korelacioni mes orientimit sipërmarrës kah inovacionet (si një strukturë një-dimensionale) dhe rrezikut financiar të ndërmarrjes (është rreth $Sig=0.358$ pra është një lidhje jo shumë e fortë (megjithëse e rëndësishme) çka do të thotë se firmat me orientim kah inovacionet më një shkallë më të lartë do të kenë edhe riskun financiar më të lartë.

Pikërisht nisur prej këtij treguesi do të pranohet se: Në lidhjen mes orientimit kah inovacionet të ndërmarrjes dhe rrezikut financiare ndikon edhe aksesimi në burime financiare.

Tabela. 2. Regresioni linear ndermjet madhesis se ndermarrjes, jetegjatesiss e ndermarrjes, ndikimi i mjedisit, orientimi kah investimet dhe aksesi kapital

		Coefficients ^a				
		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients		
Model		B	Std. Error	Beta	t	Sig.
1	(Constant)	1.663	.328		5.067	.000
	jetegjatesia e ndermarrjes	-.005	.006	-.088	-.831	.408
	madhesia e ndermarrjes	-.068	.091	-.079	-.754	.453
	ndikimi i mjedisit	-.040	.090	-.047	-.451	.653
	orientimi kah investimet	-.068	.086	-.082	-.786	.434
	aksesi kapital	.034	.054	.066	.630	.530

a. Dependent Variable: rreziku financiar

7. Konkluzione

Bazuar në të gjeturat, rezultatet e fituara nga anketimi por edhe nga literatura e shqyrtuar kemi arritur në përfundim që përmes procesit të menaxhimit të riskut financiar, drejtuesit e subjekteve afariste arrijnë t'i identifikojnë me kohë rreziqet që u kanosën në rrethinë dhe t'i krijojnë alternativat e duhura strategjike për zvogëlimin e ndikimit të tij në realizimin e objektivave afariste. Nga hulumtimi i realizuar rezultoi se:

- Menaxhimi i riskut financiar është proces që u mundëson ndërmarrjeve që të përballen me pasigurinë që vin nga tregjet financiare. Kjo përfshin vlerësimin e risqeve financiare me të cilat përballen një ndërmarrje dhe zhvillimin e strategjive për menaxhimin e riskut në përputhje me projektet dhe politikat e brendshme të saj. Dhe kryesisht lidhet me luhatjen e çmimeve të letrave me vlerë, luhatjen e normave të interesit, humbjen e fuqisë blerëse nga inflacioni, riskun e kurseve të këmbimit.
- Moshja e ndërmarrjes dhe madhësia e ndërmarrjes ndikonin në rrezikun financiar. Pra sa më e madhe jetëgjatësia dhe mosha aq më i madhe është mundësia e menaxhimit të rrezikut financiar të ndërmarrjes.
- Në lidhjen mes orientimit kah inovacionet të firmës dhe rrezikut financiar ndikon edhe aksesi në burime financiare.
- Nga ana tjetër, në lidhjen dhe marrëdhënien mes rrezikut financiar dhe menaxhimit të tij ndikon edhe mjedisi i jashtëm.
- Sistemi i informacionit, të dhëna dhe raporte të marra në kohë reale janë padyshim një ndihmesë në menaxhim për të marrë vendime më të drejta. Këtu përfshihen sistemet e informatikës, sistemet financiare dhe kontabile apo sistemet logjistike, e që mund të kenë probleme ose të mos funksionojnë siç duhet.
- Zhvillimi i teknologjisë ka sjellë zhvillimin e një sërë sistemesh informacioni si sistemet e kontabilitetit, sistemet e planifikimit të prodhimit, sistemet e burimeve njerëzore, sistemet e shpërndarjes, etj.

8. Referencat

1. Aktan, B., & Bulut, Ç. (2008). Financial Performance Impacts of Corporate Entrepreneurship in Emerging Markets: A Case of Turkey, *European Journal of Economics, Finance and Administrative Sciences*,
2. Bakraçi Xhevat, *Menaxhmenti i rrezikut dhe sigurimet*, UP, Prishtinë, 2007
3. Epstein, M. J., & Rejc, A. (2005). *Identifying, Measuring and Managing Organizational Risks for Improved Performance. Management Accounting Guideline*. Hamilton: The Society of Management Accounting of Canada, New York: AICPA.
4. Farid, J. A. (2014). *Models at work: A practitioner's guide to risk management*. London: Palgrave Macmillan.
5. Mustafa Isa, "Menaxhmenti financiar", botimi i dytë, Riinvest, 2007, Prishtinë,
6. National Consumer Commission, *Risk Management Strategy and Methodology*, National Consumer The NCC 4,
7. Oxford dictionaries, <https://en.oxforddictionaries.com/definition/us/risk>

8. Richard Apostolik & Christopher Donohue, *Themelet e riskut financiar*, në shqip Hashim Rexhepi Prishtinë 2016
9. Valkauskas, R. (2013). Assessment of the financial position of a company: theoretical aspect. *Ekonomika*, 92 (3),

Cultural Heritage and Identity as Favorable Development Potentials

KOSOVO RADIOFONIAL AND TELEVISION MEDIA

PUBLIC INFORMATION

Dr.Sc.Shqipe Kastrati

eagle59-1@live.com

Director of LSSchool "Besim Nrecaj"- Prizren,Kosova

ABSTRACT

Abstract

Kosovo, after a century of rule by the Serbian regime and the communist father, and a hard-fought war with full of contradictions, came out of a closed circle of foreign violence and ideology.

A society that experienced the horrors of a genocide that emerged from the post-communist system faced many difficulties.

Thanks to the involvement of political parties and the considerable support of the international community of democratic countries, we are heading for another path, leaving much pain and destruction but with a sound goal and a clear vision for the future.

On this journey, we need fair information and guidance to take the lead in transforming new institutions based on pluralistic and meaningful politics.

But for this to happen, the radio and television media in Kosovo itself as the most powerful media had to be transformed.

Keywords: genocide; the post-communist system; the international community; the media...

HYRJE

Kosova pas një periudhe një shekullore të regjimit serb dhe ati komunist dhe një lufte të vështirë me përplot kundërthenje doli nga rrethi i mbyllur i dhunës dhe ideologjisë së huaj.

Një shoqëri që përjetoi tmerret e një gjenocidi, e dalë nga sistemi postkomunist u ballafaqua me vështërsi të shumta.

Falë anagzhimit të subjekteve politike dhe përkrahjës së konsiderueshme të bashkësisë ndërkombëtare të vendeve demokratike ecëm drejtë një rruge tjetër duke lënë pas shumë dhëmbje e shkatrrime por më një synim të shëndosh dhe vizion të qartë drejtë së ardhmës.

Në këtë rrugëtim na është nevojitur një informim i drejtë dhe një udhërrëfyes për të marrë drejtimin e ndërtimit të institucioneve të reja të mbështetura në politikën pluraliste dhe kuptimplotë .

Informimi apo komunikimi është shtylla e shoqërisë sonë, duke na mundësuar krijimin e marrëdhënieve me persona të tjerë dhe sjelljen e ndryshimit në shoqëri.

Pa informacion, zotësia për të përparuar në botën profesionale dhe në vetë jetën tonë, do të ishte e pamundur. Por që kjo të ndodh , vetë mediat radiofonike dhe televizive në Kosovë si medime më të fuqishme duheshin të transformoheshin.

Për ta paraqitur në rrafshin real atë që sot quhet sistem i informimit publik në Kosovë, do të duhej veçuar aspekte të ndryshme dhe më saktësisht do të duhej përcaktuar se çka në fakt nënkupton ky sistem?

Realisht shikuar sistemi i ri i informimit në Kosovë është krijuar mbi bazën e një vullneti të përzier ndërkombëtar dhe vendor dhe mbi të gjitha mbi një sistem, rrënjët e të cilit kanë kohë që kanë kaluar.

Mediat e sotme në Kosovë megjithatë ende ndodhen ndërmjet asaj që quhet tradicionalizëm dhe koncept modern i gazetarisë, ndërmjet vazhdimësisë dhe shkëputjes e rinisjes së një modeli tjetër gazetar dhe në luftën që dikur është quajtur luftë brezash ose gjeneratash.

STACIONET E MEDIAS RADIOFONIKE DHE TELEVIZIVE NË KOSOVË

Roli i mediave në Kosovë është vital ndoshta më shumë tani sesa ndonjëherë më parë.

Mediat duhet të jenë forum për shkëmbime dhe shprehje të mendimit të përgjegjshëm dhe mjet për arsimimin e popullatës për dobitë dhe vlerat e demokracisë dhe shoqërisë civile.

Derisa ndërtohen muret e shoqërisë , mediat luajnë një rol me rëndësi vitale në themelimin e institucioneve të mira dhe me përgjegjësi, të vetëqeverisjes në Kosovë.

Stacionet e e medias radiofonike dhe televizive mund të jetë një faktor vendimarrës në marrëveshjet e punës, ngritjet e biznesit ose kompanisë suaj, por edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Se sa është i rëndësishëm komunikimi dhe informimi i mediave në publik, vërtetojnë edhe shembujt e disa momenteve në historinë e njerzimit, si ajo e Marthin Luther King me fjalimin e tij " I have a dream " në të cilin fjalim frymëzoi një popull të tërë duke prishur barrierat e racizmit. Pa udhëheqjen dhe fjalimin e tij do të nevojiteshin edhe 10 vite të tjera për të sjellë barazi mes racave, apo Deklarimin e të Drejtave të Njeriut nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të cilin mjaft kontribuoi fjalimi i Eleanor Roosvelt ,kemi edhe rastin e Nelson Mandela me fjalimin e tij " An idea for which I am prepared to die " ndihmoi në nxitjen e opinionit kundrejt padrejtësive të aparteidit etj.

Historia ka treguar që rëndësia e mediave dhe Komunikimi në Publik ka bashkuar njerëz dhe ka sjellë ndryshime të mëdha. Në Kosovën e pasluftës sektori mediatik filloi punën në vitin 2000. Gjer në vitin 2006 ishte i

XII INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE | KONFERENCA E XII-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
XII-ta NAUČNA MEDJUNARODNA KONFERENCIJA
administruar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, e pas 2006 themelohet Komisioni i Pavarur për Media (KPM), ku nga 2009 KPM nis procesin e licencimit.

Në formulimin e politikave dhe procedurave të licencimit KPM zbaton standard europiane. Rregullat e licencimit janë bërë për të siguruar që secili subjekt transmetues i shërben interesit të gjërë public, zbaton disa kërkesa të profesionalizimit dhe nuk ndërhyjnë në transmetimin e subjekteve tjera transmetuese.

KPM-ja licencon mediat elektronike. Sipas Ligjit të KPM-së⁶³, përkatësisht neni 11.2 ajo ka autoritet për të filluar rregullimin e operatorëve Kabllorë dhe Digjital.

Licenca transmetuese ipepërkohësisht për të përdorur frekuencën sipas kushteve të caktuara. Kushtet e caktuara janë tri llojesh:

1. Rregullat e përgjithshme të operimit që aplikohen për të gjitha subjektet transmetues.
2. Kushtet teknike të veqanta për secilin subjekt transmetues, siq janë frekuencat për të përdorur, niveli i fuqisë dhe lokacioni.
3. Format i programit për secilin subjekt transmetues.

Nëse një subjekt transmetues shkel Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, kushtet e licences së vetë, apo cilëndo Rregullore të KPM-së, atëherë KPM-ja ka autoritetin që të ndërmarrë masa disiplinore, që nga vërejtjet formale, gjer ke sanksionet finansiare.

Në Kosovë egzistojnë 110 subjekte transmetuese të licencuara përkohësisht, të cilat janë në process të licencimit afatgjatë. Prej tyre është një transmetues publik, që ka një kanal televiziv dhe dy radiostacione, dy televizione private komerciale me transmetim nacional si dhe dy radiostacione me mbulesë nacionale. Poashtu egzistojnë edhe subjekte transmetuese të kategorizuara si subjekte me fuqi të ulët, të destinuara për nevojat e populates minoritare dhe mbulojnë disa lokacione të vogla gjeografike. Realisht shikuar sistemi i ri i informimit në Kosovë është krijuar mbi bazën e një vullneti të përzier ndërkombëtar dhe vendor dhe mbi të gjitha mbi një sistem, rrënjët e të cilit kanë kohë që kanë kaluar.

Sot në Kosovë vazhdojnë të dalin gazeta dhe të lulëzojnë dhjetëra televizione e radiostacione, disa me frekuenca kombëtare dhe të tjerat me ato vendore, shtrihet për diskutim një tjetër çështje, sa në të vërtetë ato janë të afta të kryejnë misionin primar të tyre, atë informimit. Nga transmetuesit, 66 janë në gjuhën shqipe, 32 në gjuhën serbe, boshnjake, turke dhe romë. Si trashëgim nga e kaluara, Kosova është e ndarë në pesë regjione transmetuese.⁶⁴

Ne kemi nevojë akute për një gazetari profesionale, për një gazetari që të sigurojë një informacion me cilësi të lartë. Mediat, megjithatë, kontribuojnë si ndryshues të qëndrimeve dhe opinioneve, të cilat, tashmë ekzistojnë. Por këtu bëhet fjalë për ndryshime të vogla.

⁶³ <http://www.kpm-ks.org/>

⁶⁴ <http://www.kpm-ks.org/>

Pra, mediat mund të ndryshojnë qëndrimet. Mirëpo, nëse vjen deri tek ndryshimi i qëndrimeve, mendimeve, atëherë këtu mund të flitet se këto qëndrime, nuk “funksionojnë” sa duhet.

Zbulimi i një të fshehure apo kryerja me sukses e ndonjë tregimi të panjohur për lexuesin, e bënë atë më të përshtatshëm për ndryshime në shoqëri. “Derisa këto sekrete të mos jenë të zbuluara, lexuesit apo shiquesit, do ta kenë më të vështirë për të ndryshuar”, - pohon Rayan George, gazetar amerikan shumëvjeçar i gazetarisë hulumtuese.⁶⁵

Mediat konsiderohen të jenë shumë efektive në ndërtimin e qëndrimeve, opinioneve të reja. Dhe kjo për faktin pasi që shoqëria paraprakisht nuk ka ndonjë mendim apo qëndrim. Aty ku më parë nuk ka ndonjë qëndrim, opinion për një zgjidhje politike, ekonomike.etj., mediat janë shumë efektive në "vaksinimin" e mëvonshëm të qëndrimeve, mendimeve.

Mungesa e qëndrimeve, ideve sjell që mediat të jenë efektive në strukturimin e ndodhive. Mediave shqiptare, si në të kaluarën, u imponohet "detyrimi dhe obligimi" ndaj politikave ditore. Edhe sot, si më parë, idetë liberale të lirisë dhe pavarësisë së shtypit refuzohen, dhunohen e ndalohen. Edhe sot kërkohet të drejtohet dhe të kontrollohet forma dhe përmbajtja e informimit dhe lajmit...!? Rast konkret kemi pozitën mediale në Kosovë. Pa dyshim, mediat tona kanë edhe mëkatet e tyre.Ky fenomen, ka me vite të tëra që, nëpërmjet analizave mbi mediat, është kritikuar dhe gjykuar. Të tjerët janë radiotelevizione në nivel lokal.Mediat lokale zhvillimin më të hovshëm e kanë marrë që nga paslufta në Kosovë. Dikur para lufte secila qendër ka pasur nga një radio lokale, mirëpo tani mediat lokale nga paslufta kanë marrë hov të zhvillimit.

Perspektivat e mediave lokale,menjëherë pas luftë, radiot, kanë pasur një përsepektivë të sukseshme.Kurse me kalimin e kohës dhe me digjitalizmin e teknikës,perspektiva ka kaluar tek televizionet. Mirëpo,krizat e fundit që kanë përfshirë botën domosdoshmërisht se kanë përfshirë edhe Kosovën.Në këtë drejtim më së shumti e kanë pësuar pikërisht mediat lokale. Ngase shumica për të mos thënë ekskluzivisht të gjithë mbijetojnë nga reklamat, krizat ekonomike dëmtojnë shumë të ardhmen medaive. Roli i mediave domosdo se është i madh.

Nëse është thënë dikur se mediat konsiderohen “forca e shtatë”, tani më ato nuk janë forca e shtatë po forca e tretë menjëherë pas pushtetit dhe pas ligjëshmërisë.

Perspektiva pritet që të shtohet për mediat për dy arsye kryesore.

E para sepse bota gjithnjë e më shumë po lidhet me teknologjinë më të re ;

derisa e dyta, refleksioni i botës moderne po lidhet me informimin.

Mediat lokale padyshim se tek ne pas lufte kanë marrë vendin e rëndësishëm dhe si duhet.

Kjo u pa edhe gjatë fushateve zgjedhore, kur mediat kanë pasur rëndësi gadi primare në orjentimet e simpative deri në simpatitë votuese.

⁶⁵ Ryan, George. “Investigative reporting take time and tell the secrets”. Quill. June 2001. f 42

Nuk duhet harruar se vetë media dhe industrializimi i saj lindi si një fenomen i mirëfilltë urban.

Është qyteti ai që e ka të pamundur të bazohet më në një komunikim sy më sy, sikur ka qenë karakteristikë e zonave rurale tradicionale. Qyteti është një hapësirë që mbledhë çdo ditë e më shumë individë dhe grupe që nuk kanë asnjë njohje me njëri-tjetrin.

Në këtë drejtim mediat lokale po fuqizohen tëthuash ditëpër ditë. Roli në jetën politike dhe shoqërore i mediave po bëhet gjithnjë e ma i pranishëm sidomos në Kosovë, pasi që tradita e fjalës publike po merrë përmasat origjinale. Kurse profesionalizmi i mediave lokale ende është larg standardeve evropiane, por me një insunatë për të shkuar kah profesionalizimi i këtyre mediave.

Zbulimi i një të fshehure apo kryerja me sukses e ndonjë tregimi të panjohur për lexuesin, e bënë atë më të përshtatshëm për ndryshime në shoqëri. Mediat duhet poashtu të përkrahin vizionin demokratik të shoqërisë dhe të mbështesin përpjekjet për themelimin e sundimit të ligjit dhe shoqërisë civile nëpër gjithë Kosovën. Me fjalë tjera, zgjedhur të mbahen përgjegjës ndaj njerzve që i kanë vendosur ata në detyra. Mediat duhet të jenë roje jo vetëm i qeverisë por edhe i atyre elementeve të shoqërisë të cilët mundohen të nënvlerësojnë vlerat demokratike për themelimin e të cilave po punojnë kosovarët. Edhe në demokracitë Shoqëria ka nevojë për media e cila veprimtarinë e bazon në përgjegjësi.

Për përgjegjësi, nuk duhet rregull shoqërore e as ligj. "Principet duhet të vijnë në shprehje para rregullave dhe ligjit"⁶⁶ Por, principet mund të jenë edhe të orientuara gabimisht.

Në mungesë të një qeverie e një rregulli medial dhe si pasojë e situatës aktuale, nuk vepron as gjykata e cila do të merrte në shqyrtim ankesat nga publikimet e ndryshme.

Në Kosovë, roli i mediave si "roje e qeverisë" është më i rëndësishëm së kurrë më parë. Posa të shprehin njerëzit vullnetin e tyre demokratik në zgjedhje, është punë e mediave dhe organizatave civile që të punojnë çdo ditë të sigurohen se zëri i popullit vazhdon të dëgjohet. .

Kjo e arsyeton formimin e një organi me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shumicës së medimeve dhe aty të promovohet nevoja e ndërtimit të medias objektive dhe të mos lejohet publikimi i spekulimeve dhe informative të pabazuara. Ky do të ishte një hap i parë, për të vazhduar më tutje me miratimin e rregullave apo ligjeve të cilat do të sanksiononin informimin joobjektiv ose nxitës. Tani është përgjegjësi e medias për t'i matur pasojat e mbështetjes që do t'i jep një lideri politik.

"Me qëllim që të bëjnë zhurmë, liderët kanë nevojë për fjalën e zëshme të mediave," thekson Charles Poncet.⁶⁷ Thelbi i sistemit demokratik nuk është pushteti, as monologu, por qytetari dhe dialogu i qytetarit me të

⁶⁶ Poncet, Charles. Seminar "Gazetaria dhe Demokracia". 9 qershor 2000. Gjenevë.

⁶⁷ Ryan, George. "Investigative reporting take time and tell the secrets". Quill. June 2001. f 42

ngjashmit e tij. Pushteti në demokraci ka një status të veçantë, është i definuar qartë, dhe sa më i kufizuar që është ai probabiliteti për të abuzuar me të është ma i vogël.

Dialogu është thelbi ekspozues i demokracisë, përkatësisht përmes tij konvertohet pushteti në autoritet dialogues, ku qytetarët realizojnë vetveten e tyre dhe të tjerët në komunitet. Derisa dialogu është pjesa thelbësore, jo çdo dialog dhe komunikim shtrohet si duhet. Reklama politike është njëra prej formave komunikuese dhe, në të njëjtën kohë, manipuluese masive e qytetarëve.

Në mes të shumë gjërave të reja që liria solli në Kosovë, u mundësua gjithashtu që të hapen një numër i konsiderueshëm i televizioneve, gazetave dhe sidomos radiove. Në fillim ato paraqiteshin si të balancuara politikisht. Por më vonë ato morën orientime politike, ku promovonin liderë dhe parti politike.

Aktualisht në Kosovë veprimtarinë e tyre e zhvillojnë vetëm tri televizione kombëtare. Pavarësia e tyre redaktuese shpesh vihet në pikëpyetje dhe këtë për një numër arsyesh. Televizioni Publik (RTK) ka një numër të konsiderueshëm të burimeve financiare. Mbase kjo vlerësohet të jetë arsyeja pse shpesh ata duket të mbajnë anën e palëve të caktuara politike.

Një vështirësi tjetër me të cilën ky medium përballët është edhe monitrimi i pandërprerë nga ana e UNMIK-ut. Së fundi, mund të vërehet që ky është mediumi më i përkdhelur nga ana e Qeverisë së vendit, p.sh. Qendra Informativ e Kosovës⁶⁸ është burim i informacioneve për Kosovën dhe Europën Juglindore, dhe e afert me LDK-në.

Përveq ngjarjeve ditore, në këtë website ekziston edhe arkivi i lajmeve që daton nga viti 1997.

Agjencia e Lajmeve „Kosova Live”⁶⁹ është agjenci e pavarur lajmesh në Kosovë që sjell më të reja nga Kosova dhe në lidhje me Kosovën. Kjo agjenci mbështetet nga kontributet e fondacioneve nga Zvicra, Gjermania e Austria.

Mund të gjejmë edhe lajme të shkruara dhe disa emisione në arkivë. Shumëkush beson se televizioni KTV (Kohavision) është medium që udhëhiqet nga fryma politike e partisë ORA. Por, në fakt edhe pa ekzistimin e këtij subjekti politik ky medium është vërejtur të orientohet që të shërbejë si opozitë konstruktive e secilit pushtet. Kronikat televizive mundohen të kapin pikat e dobëta të qeverive, me shpresën se ato do të sjellin ndryshime në rrjedhat politike.

Radiotelevizioni 21 jep një pasqyrë krejt tjetër. Ashiqare, ky television në mënyrë perfekte i përshtatet secilit pushtet, pavarësisht se kush është në të. Kjo mund të vërehet sidomos pas zgjedhjeve të fundit. Edhe aktivitetet më të parëndësishme të kryeministrit Thaqi përbëjnë lajmin kryesor për këtë medium. Megjithatë, të trija televizionet mundohen të fshehin mirë orientimet e tyre, por që shpesh dalin haptas në shesh.

Ekzistojnë rreth 100 radio-stacione në Kosovë. Shumica prej tyre janë lokale. Vetëm Radio Kosova dhe Radio Dukagjini mbulojnë tërë territorin e Kosovës. Kjo e fundit udhëhiqet nga një biznesmen i fuqishëm, i cili ka lidhje të caktuara me një parti politike prej nga edhe rrjedh ai. Lokalizmat në këtë rast luajnë rol mjaft të rëndësishëm. Ekstrem në rastin e mediave paraqet radio „Kosova e lire”.

⁶⁸ © KPM 2000-2010

⁶⁹ www.kosovalive.com

Në të mund të dëgjohen etiketime, fyerje dhe linçime për njëren anë, dhe himne e lavde për një krah tjetër politik. Ndryshe nga radiot tjera, kjo radio i jep shumë hapësirë komenteve politike të përpiluara vet. Madje, aty u censurohet kënga edhe atyre artistëve që pretendohet se i takojnë një krahu të caktuar politik.

Të tjera radio udhëhiqen nga biznesmenë lokalë që udhëhiqen nga preferencat e tyre partiake, sepse edhe varen nga sponsorimet e ndryshme. Gazetat, defitivnivisht, janë mjeti më i fortë politik që përdorin politikanët në Kosovë.

Radiotelevizioni 21 dikur ka qenë radioja e parë shqipëtare në internet, tani ofron edhe programin e vet televiziv në website⁷⁰. Në faqet e gazetave shpesh herë hasim ideologji, polemika, fyerje të individëve, fyerje të institucioneve, të liderëve të tyre, dhe skandale të llojeve të ndryshme. Për ta paraqitur në rrafshin real atë që sot quhet sistem i informimit publik në Kosovë, do të duhej vecuar aspekte të ndryshme dhe më saktësisht do të duhej përcaktuar se cka në fakt nënkupton ky sistem? Realisht shikuar sistemi i ri i informimit në Kosovë është krijuar mbi bazën e një vullneti të përzier ndërkombëtar dhe vendor dhe mbi të gjitha mbi një sistem, rrënjët e të cilit kanë kohë që kanë kaluar.

MEDIAT DHE POLITIKA

Politika dhe mediat nuk mund të ekzistojnë pa njëra-tjetrën. Politikanët kanë nevojë që të promovojnë ideologjitë e tyre dhe i shfrytëzojnë mediat për të arritur këtë qëllim. Ndërkohë, mediat duhet të ekzistojnë disi. Ato financohen dhe sponsorizohen në shumë raste nga partitë. Por nuk mund të themi gjithmonë që politika përfiton më shumë nga mediumet, përderisa edhe këto të fundit nuk do të kishin ndonjë kuptim pa pasur informacione nga jeta politike, ngase njerëzve u interesojnë zhvillimet në këtë fushë shumë të rëndësishme për rregullimin e jetës së tyre. Pra me një fjalë mediat shikohen si një derë e madhe për promovim politikash. Mediat e sotme në Kosovë megjithatë ende ndodhen ndërmjet asaj që quhet tradicionalizëm dhe koncept modern i gazetarisë, ndërmjet vazhdimësisë dhe shkëputjes e rinisjes së një modeli tjetër gazetar dhe në luftën që dikur është quajtur luftë brezash ose gjeneratash.

Sot në Kosovë vazhdojnë të dalin gazeta dhe të lulëzojnë dhjetëra televizione e radiostacione, disa me frekuenca kombëtare dhe të tjerat me ato vendore, shtrohet për diskutim një tjetër çështje, sa në të vërtetë ato janë të afta të kryejnë misionin primar të tyre, atë informimit. Mirëpo mediat kosovare, të tilla si janë sot, gjenden ndërmjet një gjysmëprofesionalizmi dhe amatorizmi të plotë. Pra, sot, ne mund të jemi edhe gazetar dhe redaktor të vetvetes; gazetarë të çkyçyr nga kërkesat tradicionale të mediave dhe gazetarisë profesionale. Vazhdimisht është duke u eksperimentuar me mediat e reja ku shfrytëzuesit dërgojnë përmbajtjen, dhe ku lexuesit janë vetë gazetarët. Ne kemi nevojë akute për një gazetari profesionale, për një gazetari që të sigurojë një informacion me cilësi të lartë. Mediat, megjithatë, kontribuojnë si ndryshues të qëndrimeve dhe opinionëve të cilat tashmë ekzistojnë. Por

⁷⁰ www.radio21.com

këtu bëhet fjalë për ndryshime të vogla. Pra, mediat mund të ndryshojnë qëndrimet. Mirëpo, nëse vjen deri tek ndryshimi i qëndrimeve, mendimeve, atëherë këtu mund të flitet se këto qëndrime, nuk “funksionojnë” sa duhet.

Mediat konsiderohen të jenë shumë efektive në ndërtimin qëndrimeve, opinioneve të reja. Dhe kjo për faktin pasi që shoqëria paraprkisht nuk ka ndonjë mendim apo qëndrim.

Ndërtimi dhe forcimi Televizionit Publik dhe Televizioneve kombëtare,si dhe i atyre lokale, i japin impulse të reja demokracisë në të gjitha fushat e jetës.

Cilët jemi ne dhe çfarë bëjmë? Cilët janë aspiratat tona? Si duhet të përshtatemi me botën që na rrethon, me qëllim që të vazhdojmë të përmbushim rolin tonë, duke u bërë njëkohësisht edhe kompetitivë? Cilat janë pasojat e zgjedhjeve tona, për shoqërinë, qytetarët dhe publikun?

Për ta kuptuar më mirë këtë, duhet ta ndërtojmë diskutimin tonë në mënyrë të atillë që ky i fundit, të jetë i kuptueshëm për të gjithë. “Vlerat e së shkuarës na mësojnë se çfarë ka të drejtë të ketë çdo qytetar, cilido qoftë vendi i tij në shoqërinë apo vendin ku banon”⁷¹.

Radio Televizioni Publik është një instrument që i drejtohet çdo njërit qytetar.

Ai nxit pjesëmarrjen në jetën publike, zhvillon dijet, zgjeron horizontet dhe i lejon secilit të kuptojë më mirë vetveten, duke kuptuar botën dhe të tjerët. Në këtë vend takim, të gjithë qytetarët ftohen dhe trajtohen si të barabartë, pavarësisht nga statusi social apo ekonomik . Misioni dhe detyrimet e tij, nuk vijnë si rezultat i besnikërisë apo ekzistencës së statutit.

Qëllimi vlerave demokratike dhe Televizioni

Ai ka të bëjë me luftën për mbrojtjen e disa vlerave të domosdoshme për shoqërinë, individët dhe demokracinë, duke iu drejtuar jo vetëm teleshikuesve, por gjithë qytetarëve, duke nxitur dinamizmin intelektual të shoqërisë. Por detyra e tij nuk kufizohet vetëm tek informimi dhe zhvillimi kulturor. Ai duhet gjithashtu të zhvillojë imagjinatën dhe të zbavitë, duke pasur kujdes cilësinë, e cila duhet ta dallojë atë nga transmetuesit komercialë. Televizioni Publik duhet të japë shembull guximi dhe risish, bile edhe duke rrezikuar.

E, nëse arrin të zhvillojë gjini apo ide që mbajnë vulën e tij, ai mund t’u imponojë standarde të larta edhe kanaleve të tjerë. Në shoqërinë tonë në transformim, liberalizimi i hapësirës së komunikimit, ka lejuar shtimin e transmetuesve audiovizualë, por jo gjithnjë atë të mesazheve të duhur. Kanalit të vetëm publik, i duhet të përballojë konkurrencën e kanaleve privatë, të cilat kujdesen më shumë për përfitime, sesa për kulturë. Ne që prej vitesh punojmë dhe japim kontributin tonë aty, e ndjejmë se teleshikuesi po afrohet gjithnjë e më shumë tek ne, por mendoj se strukturës aktuale të programeve, përqendruar rreth evenimenteve më të rëndësishme që pasqyrojnë imagjinatën kolektive dhe rrezatojnë kulturën e vendit tonë dhe vendeve të ndryshëm, dokumentarëve, momenteve të mëdha sportivë si: kampionatet botërorë, lojërat olimpike dhe konceptimit të ri të informacionit, nga njëra anë,

⁷¹ Larry King Geleceğe Dair Konuşmalar (Günümüzün En Provakatif Kişilikleriyle Söyleşiler) Borusan 1999 faqe 3

XII INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE | KONFERENCA E XII-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE XII-ta NAUČNA MEDJUNARODNA KONFERENCIJA

duhet t'i shtohen edhe emisionet më të thelluar dhe debatet. Europa është e rëndësishme, dhe për të ardhmen e të gjithë evropianëve, është i nevojshëm të ngjallet një debat rreth identitetit tonë, ndryshimeve që ne kemi me njeri-tjetrin, pikëpamjeve të përbashkëta dhe aspiratave tona. Çfarë shoqërie kemi vendosur ne të ndërtojmë për fëmijët tanë? Çfarë vlerash duhet t'ju transmetojmë atyre? Çfarë premtimesh kemi bërë e duhet t'i mbajmë? Mediat e shërbimit publik, duke qenë një mjet komunikimi social, kanë një ndikim të fuqishëm mbi cilësinë e jetës që kemi vendosur t'u trashëgojmë fëmijëve tanë.

Le ta vazhdojmë pra, rrugën e mirë që kemi nisur, ta perceptojmë realitetin ashtu siç është, të kuptojmë se si mund të ofrojmë shërbim më të mirë dhe të kapërcejmë vështirësitë që kemi përpara. Të kombinojmë zhvillimin me vazhdimësinë, duke bërë të hyjë në lojë dija individuale dhe ndërveprimi shoqëror, konfrontimi i ideve dhe bashkëpunimi. Cilat janë disa nga strategjitë për të arritur qëllimin tonë: Rritja e efikasitetit, lehtësimi i strukturave, riorganizimi i personelit, formimi i punonjësve, politikat e inkurajimit dhe motivimit për punonjësit e kualifikuar, ekuilibri buxhetor. Publiku paguan gjithnjë, drejtpërdrejt apo në mënyrë indirekte, shërbimet që merr. .

REZYME

Roli i mediave duhet të jetë kritik dhe ato nuk duhet të jenë të subordinuara nga pushteti. Pengesat të cilat e vështirësojnë zhvillimin normal të mediave në Kosovë janë mungesa e infrastrukturës ligjore për media, nënshtrimi i mediave nga qarqe të ndryshme të pushtetit, prezenca e tregut medial të çrregulluar, profesionalizmi i ulët i disa mediave dhe mungesa e gazetarisë hulumtuese. Profesionalizmi i ulët madje ndikon edhe në tirazhin e vogël të gazetave si dhe në besimin e qytetarëve ndaj këtyre gazetave.

Për tju shmangur kësaj ndoshta do të ishte mirë që të bëhej liberalizimi i tregut medial në Kosovë. Me këtë nënkuptohet që mediat në Kosovë të mos bëhen pre e ndonjë grupi të veçantë politik, por të krijojnë veprimtari të pavarur.

Epoka numerike na vë përpara sfidave të reja, hap mundësi të reja, por do të sjellë edhe probleme të reja. Televizioni numerik, satelitor apo kabllor, do të na lejojë të shohim më shumë programe, me cilësi më të mirë teknike. Ai nuk duhet parë si një media e re, por si një mjet i ri transmetimi që do të zëvendësojë televizionin analog.

Kosova po përballet me probleme të shumta, janë ato duke filluar nga papunësia, korrupsioni, varfëria e tejskajshme, zhvillimin ekonomik, problemet me infrastrukturë, mungesa e ligjeve përkatëse etj, janë këto çështje që mediat sadopak mundohen t'i reflektojnë në opinion publik për përmirësim të gjendjes. Faktorë shumë i rëndësishëm për zbutjen e papunësisë është zhvillimi ekonomik dhe çrrënjësja e korrupsionit, e cila është prezente edhe në institucione tona. Roli i sektorit civil në luftë kundër korrupsionit mund të jetë i rëndësishëm.

Një numër shumë i vogël i OJQ-ve kanë marrur përkrahje nga format dhe mundësitë e ndryshme për veprim anti-korrupsion.

Jo kot MEDIA AUDIOVIZIVE u quajt „SUPERFUQI E II-të”, sepse duke iu falemnderu këtyre mediave, faktorit ndërkombëtar, djemve trima të UQK-së Kosova po perjeton lirinë.

BIBLIOGRAFIA

1. *Prof. Dr. Franc Vreg, Drustveni Komuniciraje-Zagreb, 1975*
2. *Prof. Dr. Ibrahim Berisha, Media*
3. *Dushan Sllavkovič, Bazat e gazetarisë dhe informimit-Prishtinë- 1978*
4. *Vlladisl Jisel, Informisanje u praksi-Nr. 10/ 1971*
5. *Danillo Zhlander. Zanrovi u nasoj stampi-Revista nr. 10 /1967*
6. *Bashkim Ramadani, Gazetaria Radio-Televizive" Dispenz 2203*
7. *Larry King Geleceğe Dair Konuşmalar (Günümüzün En Provakatif Kişilikleriyle Söyleşiler) Borusan 1999*
8. *Bülent Çaplı -Fili Tarif Etmek: Özel Televizyona Beş Kala- İmge Kitabevi*
9. *Jane Chapman-Comparative Media History: An Introduction - 1789 to the Present -Polity Press 2005*
10. ¹ <http://www.kpm-ks.org/>

STRUKTURA LIGJORE E "SHPËRLARJES SË PARAVE DHE KONTRIBUTEVE TJERA NGA VEPRA PENALE E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT" E PRODUKTEVE TË VEPRËS PENALE SI VEPËR PENALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË VERIORE

LEGAL STRUCTURE OF "DISTRIBUTION OF OTHERS AND OTHER CONTRIBUTIONS FROM CRIMINAL OFFENSES OF TERRORISM FINANCING" OF THE PRODUCTS OF THE CRIMINAL OFFENSE OF THE CRIMINAL OFFENSE AS ACTION

Dr. sc. Mitasin Beqiri

Ligjërues në Universitetin FON Shkup

Abstract

The paper legal structure of Money Laundering and other contributions from the criminal offense of financing terrorism and its products as a criminal offense in the Republic of Northern Macedonia, presents a study in the legal-criminal aspect of the phenomenon or phenomenon of money laundering and crime products criminal or criminal activity from a comparative point of view rather in legal terms. The paper begins with a look at the Legal Regulation on the Prevention of Money Laundering and Terrorist Financing

Money laundering, posing a problem for international security and the tendency to infiltrate all spheres of society, has forced international organizations and states to establish legal norms with obligations to take immediate measures to criminalize, prevent and suppress money laundering.

The same interest protected by laws in a special way and the actions as an element of the objective side described in their definitions are similar. The criminalization and punishment of the criminal offense of money laundering is also done to protect states from organized crime and the activity of criminal organizations, which undermine legitimate economies and threaten the stability, security and sovereignty of states. Illegality in money laundering has an additional element that transcends previous crime, a profit motive designed to ensure the survival of the criminal organization, which is not always present in the previous act.

Abstrakt

Punimi struktura ligjore e Shpërlarjes së Parave dhe kontributeve tjera nga vepra penale e financimit të terrorizmit dhe produkteve të saj si vepër penale në Republikën e Maqedonisë Veriore, paraqet një studim në aspektin juridiko-penal të dukurisë apo fenomenit të shpërlarjes së parave dhe produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale në një këndvështrim krahasues më tepër në aspektin ligjor. Punimi fillon me një vështrim me Rregullativën ligjore të parandalimit të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit

Shpërlarja e parave duke përbërë një problem për sigurinë ndërkombëtare dhe tendenca për të depërtuar në të gjitha sferat e shoqërisë i ka detyruar, organizatat ndërkombëtare dhe shtetet të krijojnë norma ligjore më detyrime për të ndërmarre masa të menjëhershme për kriminalizimin, parandalimin dhe shtypjen e shpërlarjes së parave.

Të njëjtin interes të mbrojtur më ligje në mënyre të posaçme edhe veprimet si element të anës objektive të përshkruara në përkufizimet e tyre janë të ngjashme. Kriminalizimi dhe dënimi i veprës penale të shpërlarjes së parave behet edhe për të mbrojtur shtetet nga krimi i organizuar dhe veprimtaria e organizatave kriminale, të cilët minojnë ekonomitë legjitime dhe kërcënojnë stabilitetin, sigurinë dhe sovraniteti i shteteve. Paliqshmëria në kryerjen e shpërlarjes së parave ka një element shtese që tejkalon krimin e mëparshëm, një motiv fitimi i projektuar për të siguruar mbijetesën e organizatës kriminale, e cila nuk është gjithmonë i pranishëm në aktin paraprak.

Rregullativa ligjore e parandalimit të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit

Ligji i parandalimit të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Parandalimi i shpërlarjes së parave si problem juridik për herë të parë në Republikën e Maqedonisë Veriore është rregulluar me Ligjin për parandalimin e shpërlarjes së parave⁷². Me këtë ligj konstruktohet baza juridike e materies shpërlarjes së parave, jipen udhëzimet e para për njerëzit dhe institucionet që janë të obliguara të njëjtat t'i zbatojnë. Gjatë zbatimit të saj gjatë dy viteve të para dolën në pah disa dobësi, njëra ndër dobësitë e mëdha ishte mos harmonizimi me rregullativën ndërkombëtare. Me 20 korrik 2004 është miratuar Ligji i shpërlarjes së parave dhe kontributeve tjera si vepër penale⁷³ i cili erdhi si rezultat i harmonizimit me rregullativën ndërkombëtare (Konventa e Vienës, Konventa e Strasburgut dhe Konventa e Palermos, udhëzimet e FATF-së dhe Urdhëresat e UE-së). Me këtë ligj përveç që u verifikuan masat dhe ndikimi i parandalimit dhe zbulimit të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit si novitet u inkorporuan dispozita të mbikqyrjes së zbatimit të këtyre masave dhe veprimeve. Konform këtij ligji janë miratuar edhe akte nënligjore si Rregullore për përmbajtjen dhe raportet e transaksioneve.

Nga 10 janari i vitit 2001 ne fuqi ishte Ligji për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe kontributeve si vepër penale dhe financimin e terrorizmit⁷⁴. Siç mund të shihet edhe nga titulli i tij është përfshirë edhe financimi i terrorizmit. Ky ligj është ndryshuar dhe plotësuar disa herë me më shumë akte nënligjore. Nga periudha

⁷² Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 70/01

⁷³ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 46/04

⁷⁴ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 04/08

që pason pas miratimit të këtij ligji deri në vitin 2014 janë miratuar edhe katër ligje për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Një ndër ata ishte Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit mbi shpërlarjen e parave⁷⁵, i cili u miratua dhe hyri në fuqi me vitin 2010. Me këto ndryshime u precizuan disa obligime të institucioneve financiare dhe u formuan kushtet për miratimin e më shumë rregulloreve për formëen dhe përmbajtjen e të dhënave të cilë subjektet do të duhet t'i përcjellin deri te Drejtoria për zbulim financiar. Ndryshimet e ligjit të vitit 2008 janë sjellur edhe me vitet 2011, 2012 dhe 2014.

Sot në fuqi është Ligji mbi parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit⁷⁶ nga 03 shtator 2014. Shkaqet e miratimit të këtij ligji respektivisht për plotësimin e kësaj rregullative ligjore imponohet nevoja e harmonizimit me standardet ndërkombëtare- udhëzimet e parandalimit të shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit të vërtetuara nga ana e FATF-së me vitin 2012 dhe për tejkalimin e dobësive të vërtetuara në kornizën e rrethit të katërt të evaluimit nga ana e MONEYVAL-it, komitetit të Këshillit të Europës. Obligimet e parashtruara me këtë ligj subjektet i zbatojnë për qëllime të parandalimit të shpërlarjes së parave të ndërlidhura me indikacione të veprave penale dhe financimit të terrorizmit. Ligji i definon kuptimin dhe nocionet e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit, ndërsa “ nocionin e ndërlidh me veprën penale” është definuar si vepër penale që gjeneron të ardhura të cilat janë object i trajtimit të veprës penale e shpërlarjes së parave. Konform këtij ligji janë miratuar me shume akte nënligjore ndër ta edhe:

1. Rregullorja për përmbajtjen e raporteve që dorëzohen deri te Drejtoria për parandalimin dhe larjen e parave dhe financimin e terrorizmit⁷⁷.
2. Rregullorja për përmbajtjen dhe formën e të dhënave të cilat subjektet i dorëzojnë deri te Drejtoria për parandalimin dhe larjen e parave dhe financimin e terrorizmit dhe dorëzimin e tyre në formë elektronike⁷⁸.
3. Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e regjistrit numëruar të cilën e udhëheqin subjektet të cilët organizojnë punë këmbimi⁷⁹.
4. Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e regjistrit numëruar të cilën e udhëheqin subjektet të cilët organizojnë lojrat e fatit nëpër kazino⁸⁰.

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë Veriore (neni 273). Me nenin 273 të Kodit

Penal të Republikës së Maqedonisë Veriore⁸¹, inkriminohet shpërlarja e parave dhe veprimet tjera si vepra penale. Shpërlarja e parave në legjislativën e RMV-së është e rregulluar në Ligjin Penal të vitit 1996, ndërsa në Kodin penal të vitit 2004 ka pësuar ndryshime rrënjësore. Inkriminimi tërësisht është harmonizuar me rregullativën ndërkombëtare në vitin 2009 në drejtim të implementimit të Konventës së Vienës dhe Konventës së Palermos ku përfshihen të gjitha veprimet e lëshimit në qarkullim pranimin, ndërrimin, konverzimin, përcjelljen e të hollave si dhe shitjen, dhurimin, blerjen, pranimin e pengut ose lëshimin në qarkullim në forma të pronës ose lëndëve me qëllim që të fshihet burimi i vertete i tyre, lokacioni, lëvizja dhe pronësia.

Gjithashtu, ndryshimet e Kodit penal ridefinohen dhe caktohen nocionet të lidhura me këtë vepër penale. Me nocionin e të hollave nënkuptohen mjetet pagesore të gatshme në moneta ose të holla elektronike të cilat conform ligjit janë në qarkullim në R.M.V. dhe në disaporë. Nën nocionin e të hyrave nga veprat penale nënkuptohet çdo pasuri ose interes i fituar me ndërmjetësim ose drejtpërsëdrejti në ekzekutimin e veprës penale. Gjithashtu nën këtë nocion si të hyra nënkuptohet të hyrat si vepra penale të kryera në diasporë, me një kusht që të jetë inkriminim i dyfishtë (të jetë e paraparë në vend dhe jashtë si vepër penale në momentin e kryerjes si vepër penale). Nocioni i pronës përfshinë të hollat ose mjetet tjera të pagesës, letrat me vlerë, depozitin, pronësinë tjetër materiale ose jomateriale, sende të luajtshme ose të paluajtshme, të drejta të tjera ndaj lëndëve, ofertave si dhe dokumenteve publike dhe dokumenteve legale të pronësisë dhe aktivave në forma të shkruara ose elektronike ose instrumente me të cilat dëshmohet prona ose interesi i pronës si e tillë.

Ligji mbi policinë financiare. Neni 5 i Ligjit mbi policinë bashkëkohore⁸² rregullon obligimet e policisë financiare si institucion që të mbledh informacione dhe të dhëna në bashkëpunim me organet tjera të ndjekjes me qëllim që të zbulohen shkelësit e ligjit që kanë qenë të kyçur në aktivitetet e shpërlarjes së parave, si dhe të zbatojnë hetuesinë për të cilat ekziston dyshimi i bazuar se është kryer një lloj i këtillë i veprës penale nga personi i caktuar.

⁷⁵ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 57/10

⁷⁶ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 130/14

⁷⁷ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 38/09

⁷⁸ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 140/10

⁷⁹ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 02/11

⁸⁰ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 02/11

⁸¹ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 37/96

⁸² Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 12/14

Ligji mbi Bankat. Sipas nenit 171 të Ligjit mbi Bankat⁸³ çdo bankë është e obliguar të veprë konform rregullativës së parandalimit të shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Si supervisor në sistemin e parandalimit të shpërlarjes së parave paraqitet Banka Popullore e Maqedonisë Veriore.

Ligji i Procedurës Penale. Sipas nenit 142-b të Ligjit të Procedurës Penale⁸⁴ mund të zbatohen masa të veçanta të hetuesisë gjatë hetuesisë së veprave penale të kriminalitetit financiar siç është shpërlarja e parave. Gjithashtu sipas nenit 203-a mund të caktohet masa e sigurimit të përkohshëm të pronës ose mjeteve që kanë lidhje me veprën penale. Nën masa të sigurimit të përkohshëm të pronës ose mjeteve që kanë lidhje me veprën penale nënkuptohet ngirirja e përkohshme, konfiskimi, mbajtja e fondeve, llogaritë bankare dhe transaksionet financiare ose të hyrat e veprave penale që janë masa të zbatuara në raste të shpërlarjes së parave. Procedura që zhvillohet ndaj personave juridik është e përfshirë në këtë ligj dhe kanë pika të përbashkëta me veprat penale të shpërlarjes së parave kur si ekzekutues të tyre lajmërohen personat juridik.

Ligji i Prokurorisë publike. Neni 22 i Ligjit të prokurorisë publike⁸⁵ rregullon punët inter-personale në mes prokurorisë publike si organ i ndjekes dhe institucionet tjera ndër ta edhe Policia financiare me qëllim të funksionimit të ndjekjes së veprave penale. Ndjekja e këtyre veprave penale të shpërlarjes së parave conform këtij ligji është nën kompetencën e Prokurorisë Themelore për ndjekjen e kryerësve nga sfera e kriminalitetit të organizuar dhe korrupsioni.

Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë Veriore, Konform nenit 32 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë Veriore⁸⁶, Banka Popullore e RMV-së zbaton supervizionin dhe kontrollin e punës së bankave dhe kursimoreve. Në raport me masat për rregullimin e kontrollit ndaj veprave penale të shpërlarjes së parave ky ligj nuk e ka atë rëndësi dhe peshë që e kishte ligji i mëhershëm.

Ligji i zbatimit të shërbimeve të shpejta në transferin e të hollave. Zhvillimet teknologjike kanë bërë revolucion edhe në sferën e transferimit të parave si mjete pagesore, prandaj sot në formë elektronike nëpërmjet transferit të shpejtë në afat prej një ore mund të dërgohen shumë e caktuar e parave nga një vend në vendin tjetër. Pavarësisht nga transferimi nga Republika e Maqedonisë Veriore ose nga jashtë hyrja dhe dalja e mjeteve behet nëpërmjet bankës Ligji i zbatimit të shërbimeve të shpejta në transferin e të hollave⁸⁷ rregullon mënyrën, licencimin, mbikqyrjen dhe sanksionimin e subjekteve të cilët kryejnë transferim të shpejt të parave. Këto subjekte janë të detyruara të përgatitin program për parandalimin e shpërlarjes së parave, të përgatitin raporte mujore për transaksionet e kryera deri te Banka Popullore të cilat e kryejnë revizionin dhe të respektohen të gjitha aktet që e rregullojnë parandalimin e shpërlarjes së parave, prandaj nëse nuk ndërmirren këto aktivitete mund të ndeshen me dënime me të holla.

Ky ligj është si rezultat i afrimit të rregullativës evropiane, rregullimi i kontrolleve adekuate ndaj subjekteve që vite me radhë miren me keto aktivitete financiare të transferit të shpejtë të parave si dhe përforcimi i konkurrencës jo lojale.

Ligji mbi punët devizore. Me këtë ligj rregullohet qarkullimi pagesor me vendet tjera, puna devizore e bankave, disponimi i devizave nga ana e qytetareve si dhe nxjerrja dhe futja Brenda e denarit, letra me vlerë devizore⁸⁸. Me vendim të Këshillit të Bankës Popullore të RMV-së⁸⁹ janë përshkruar kushtet nën të cilën pagesa devizore dhe llogaritë e personave të huaj mund të kryhen me të holla efektive të huaja, si dhe obligimi që të paraqiten në BP të RMV-së për çdo pagesë jorezidente në bankë, kërkesa, deklarata për prejardhjen e mjeteve të personit të huaj, nëse bëhet fjalë për pagesa individuale me shumë më të larta se 10000 euro në kesh, si dhe mundësinë e kërimit të lejes nga BP të RMV-së për pagesa individuale për të hollat e huaja efektive me vlerë më shumë se 50000 euro.

Duke u bazuar në dispozitat e këtij ligji nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë Veriore është sjellur Vendim për kushtet lartësinë e vlerës së të hollave të huaja efektive dhe çeqe që mund të futen dhe nxjerren nga vendi⁹⁰.

Përfundimi

Duke u bazuar në analizën e këtij punimi sa i përket aspektit krahasues të posedimit të infrastrukturës ligjore të dukurisë së shpërlarjes së parave, mundë të vijmë në përfundim se Republika e Kosovës ka arritur kënaqshëm të nxjerrë ligje të cilat dukurinë e shpërlarjes së parave e trajtojnë pothuajse njëjtë sikurse vendet

⁸³ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 67/07 dhe 90/09

⁸⁴ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 150/10

⁸⁵ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 150/07

⁸⁶ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 158/10

⁸⁷ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 77/03

⁸⁸ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 34/01

⁸⁹ Gazeta Zyrtare e RM –se nr.42/11

⁹⁰ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 128/14

e rajonit sa i përket mënyrës se kryerjes se kësaj veprë penale e cila është e sanksionuar edhe në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë se Veriut he në ligjin e posaçëm për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizimit. Ligjvënësi më rastin e aprovimit të Ligjit më për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizimit ka paraparë disa detaje të cilat i tejkalojnë edhe kërkesat e konventës së Vjenës dhe asaj të Palermos ku vepra penale e shpërlarjes së parave shtrihet edhe tek personat fizik të cilët me vetëdije angazhohen në veprimtari të shpërlarjes së parave dhe madje shkon përtej këtij kufiri. Elementi i dijes sipas nenit 273 i Kodit Penal është njohuria e kryerësit ("*kushdo që e ka ditur*") ose ka pasur bazë të arsyeshme për të ditur ("*ka pasur arsye për të ditur*") që pasuria që i nënshtrohet shpërlarjes përbën pasuri të fituar nga të ardhurat e krimit- dhe i vetmi detaj në rastin konkret që mendoj se duhet të rregullohet me rastin e amendamentimit të ligjeve të cilat e sanksionojnë këtë dukuri është koncepti terminologjik gjithnjë duke pas parasysh parimin e legalitetit në sistemin e drejtësisë penale. Në këtë këndvështrim krahasues Republika e Maqedonisë se Veriut ka arritur të krijoj mekanizma të rregullativës ligjore për parandalimin dhe luftimin e dukurisë së shpërlarës së parave. Por mjaftë sfidues mbetet bashkëpunimi i brendshëm i të gjithë këtyre mekanizmave dhe institucioneve të tjera sepse e gjithë aktiviteti i shpërlarës së parave në vendin tonë nuk mundë të identifikohet në bazë të memorandumeve të brendshme të disa institucioneve kompetente të cilat në radhë të parë kanë qasje indirekte në të dhënat e institucioneve kompetente, një gjë e tillë pra identifikimi më i lehtë i transaksionit të dyshimtë mundë të behët vetëm më aplikimin unik të sistemit të bazës së të dhënave në të gjitha institucionet relevante i cili sistem mendoj që duhet të jetë në gjuhën angleze edhe pse ky veprim kërkon amendamentim të Kushtetutës dhe Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare të Republikës së Republikës se Maqedonisë Veriore por më të vetmin qëllim rreth mundësisë më të shpejtë të ngrirjes së fondeve të cilat janë të dyshimta.

Literatura

- V. Kambovski, "Kazнено pravo – opsht del" 2-ri avgust, Shtip;
S. Buxhakoski. " E drejta penale- pjesa e pergjithshme", Kosta Abrash, Oher;
S. Buxhakoski. " E drejta e procedures penale- pjesa e pergjithshme"⁹ ligjerata te autorizuara FON Univerzitet. Shkup.
N. Matovski, 2003, "kazнено procesno pravo", 2- ri avgust, Shtip;
S. Taseva, "Perenje Pari", Data pons, 2003
G. Trajkovski, "Sprecuvanje na perenje pari kaj finansiskite institucii", Akademska pecat, Skopje,2003

Dokumentet:

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë nr 52/ 1991, Shkup;
2. Kodi Penal Gazeta zyrtare e R.M –se nr. 37, Shkup
3. Ligji i procedurës penale gazeta zyrtare e R.M-ss nr. 150/2010, Shkup
4. Ligji për parandalimin e shpërlarjes së parave, Gazeta zyrtare 70/2001, Shkup;
5. Ligji për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe të hyrave tjera nga veprat penale, gazeta zyrtare nr. 46/2004, Shkup.
6. Ligji për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe kontributeve tjera dhe financimi i terrorizmit gazeta zyrtare nr. 130/2014, Shkup.
7. Ligji për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimi i terrorizmit. Gazeta zyrtare nr. 130/20, Shkup.
8. Ligji për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe kontributeve tjera dhe financimi i terrorizmit, Gazeta zyrtare nr. 04/2008, Shkup.
9. Ligji mbi Policinë financiare, Gazeta zyrtare e R.M-së, nr.12/2014;
10. Ligji mbi Prokurorinë publike, Gazeta zyrtare e R.M-së nr. 150/2007;
11. Ligji mbi Bankat, gazeta zyrtare e R.M-se nr. 67/2007 dhe 90/2009
12. Ligji mbi Bankën Popullore të RMV-së, gazeta zyrtare e R.M-së nr.158/2010;
13. Ligji mbi kryerjen e shërbimeve të shpejta transfer të parave, Gazeta zyrtare e R.M-së nr.77/2003;

NDIKIMI I POLITIKAVE FISKALE NE ZHVILLIMIN E BIZNESIT NE KOSOVE **THE IMPACT OF FISCAL POLICIES ON BUSINESS DEVELOPMENT IN KOSOVO**

Abstract

To achieve prosperity and political stability, national governments aim to achieve economic balance. The government uses various instruments to stimulate economic growth, reduce unemployment and achieve macroeconomic objectives. In the context of the slow economic growth of recent years and fiscal pressures, Kosovo faces the complex challenge of economic development. Unemployment continues to be high. This is best shown by the large application for work visas in Western countries, especially in Germany and Croatia.

The demand for labor is still very low and the creation of an environment that will favor the formation of stable jobs is a challenging task that requires multidimensional reforms in the economy. However, this paper addresses the issue of the impact of fiscal policy on debt forgiveness to businesses, the impact of changing the VAT rate, the eventual increase in the minimum wage and its impact on businesses, the tax imposed on Serbian products and its impact on our products.

The purpose of this paper is to show that fiscal policies play a key role in the development of a business as the eventual change of fiscal policies: profit tax, value added tax, taxes, wages or debt forgiveness directly affects the business activity.

Keywords: fiscal policy, debt forgiveness, VAT change, minimum wage, taxes on Serbian products

Abstrakti

Për të arritur mirëqenie dhe stabilitet politik, qeveritë kombëtare synojnë arritjen e ekuilibrit ekonomik. Qeveria përdor instrumente të ndryshme për të stimuluar rritjen e ekonomisë, për të ulur papunësinë dhe për të arritur objektivat makroekonomike. Në kontekst të rritjes së ngadalshme ekonomike të viteve të fundit dhe të presioneve fiskale, Kosova ballafaqohet me sfidën komplekse të zhvillimit ekonomik. Papunësia vazhdon të jetë në një shkallë të lartë. Këtë e tregon më së miri edhe aplikimi i madh për viza pune në shtetet e perëndimit sidomos në Gjermani dhe Kroaci.

Kërkesa për fuqi punëtore është ende shumë e ulët dhe krijimi i një ambienti që do të favorizojë formimin e vendeve të qëndrueshme të punës është një detyrë sfiduese që kërkon reforma shumëdimensionale në ekonomi. Mirëpo ky punim adreson çështjen e impaktit të politikës fiskale në faljen e borxheve ndaj bizneseve, ndikimi i ndryshimit të normës së TVSh-se, rritja eventuale e pagës minimale dhe ndikimi i saj te bizneset, taksa e vendosur ndaj produkteve serbe dhe ndikimi i saj te produktet tona.

Qëllimi i këtij punimi është të tregojmë se politikat fiskale kanë rol kyç në zhvillimin e një biznesi pasi ndërrimi eventual i politikave fiskale pra: tatimit në fitim, tatimit mbi vlerën e shtuar, taksave, pagave apo falja e borxheve ndikon drejtpërdrejtë në veprimtarinë e biznesit.

Fjalët kyçe: politika fiskale, falja e borxheve, ndryshimi i TVSh-së, paga minimale, taksa ndaj produkteve serbe.

Hyrje

Politika fiskale konsiston në përdorimin e taksave dhe shpenzimeve qeveritare si mjete për të ndikuar në treguesit makroekonomik të një vendi. Shpenzimet qeveritare ndikojnë në nivelin e përgjithshëm të shpenzimeve të ekonomi, pra edhe në nivelin e GDP e për rrjedhojë edhe në nivelin e pune zënies, inflacionit etj. Politika fiskale ndikon drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë në ekonominë e vendit.

Kosova është njëra ndër vendet e fundit në Evropë që ka kaluar në ekonominë e tregut. Procesi i tranzicionit ka filluar nga një pikë startuese shumë të vështirë. Kosova ka një histori të gjatë të dominimit shtetëror të sistemeve ekonomike dhe financiare, gjë që solli deri tek një shkallë, vëllim dhe përvojë e kufizuar të ekonomisë private. Faza e tranzicionit e cila është tej zgjatur në Kosovë ka ndikuar shumë në gjendjen ekonomike dhe sociale të qytetarëve të Kosovës. Vetëm një politikë e përshtatshme fiskale do të mund që gradualisht të sjellë vendin në një nivel më të kënaqshëm të rritjes ekonomike. Gjatë viteve të pas luftës është shënuar një rritje ekonomike e karakterit simbolik, e cila iu është atribuuar kryesisht të hyrave (remitencave) nga vendet e perëndimit apo Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kosova që prej formimit të qeverisë së përkohshme nga viti 2002 që ishte në mbikëqyrje të UNMIK-ut deri në vitin 2008 kur u shpall pavarësia ka arritur të shënojë një progres në rritjen e buxhetit ndër vite. Fillimisht buxheti i Kosovës në vitet e pasluftës kishte arritur vlerën afër 500 milion euro kurse sot në vitin 2019 buxheti i Kosovës sille mbi 2 miliardë euro, e gjithë kjo falë të hyrave nga Dogana dhe Administrata Tatimore e Kosovës të cilat përmes mbledhjes së tatimit mbi vlerën e shtuar, tatimin në fitim kanë arritur të krijojnë rritje të buxhetit ndër vite që automatikisht krijojnë edhe rritje ekonomike.

Ndikim tjetër në rritje të buxhetit ka pasur edhe pagesa e taksave të ndryshme si: Taksa Komunale, taksa administrative, taksa rrugore, taksa ekologjike, taksa gjyqësore etj.

Hipotezat

2. **Ndryshimi i normave të TVSh-se nga TVSh fikse 16% në variabile 18% dhe 8% ka ulur çmimin për produktet bazë.**
3. **Rritja eventuale e pagës minimale do të ndikonte pozitivisht te bizneset.**
4. **Taksa 100% e vendosur ndaj produkteve serbe ka rritur kërkesën për produkte vendore.**

Politikat fiskale

Politika fiskale konsiston në përdorimin e taksave dhe shpenzimeve qeveritare si mjete për të ndikuar në treguesit makroekonomik të një vendi. Shpenzimet qeveritare ndikojnë në nivelin e përgjithshëm të shpenzimeve të ekonomi, pra edhe në nivelin e GDP e për rrjedhojë edhe në nivelin e pune zënies, inflacionit etj. Politika fiskale ndikon drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë në ekonominë e vendit. Vendimet e marra në politikën fiskale nuk janë të lehta për shkak se ndryshimi i një variabli mund të shkaktoj ndryshim të variablave të tjerë dhe të merr kahjen e gabuar, prandaj politika fiskale konsiderohet si një fushë komplekse e cila është e nevojshme të analizohet detajisht. Sistemi fiskal në Kosovë ballafaqohet me ide e sfida nga më të ndryshmet. Pa qëllim të theksimit të ndonjë problemi specifik brenda këtij sistemi, disa nga të metat janë mjaft evidente dhe nuk kërkojnë angazhim të theksuar për tu zgjidhur. Të tjerat kërkojnë reforma radikale në përmasa gjenerale. Ulja e normave tatimore e bërë nga Qeveria ka qenë hapi më i qëlluar në Kosovën e pasluftës. Vendimi i tillë ka ndihmuar zhvillimin e bizneseve dhe shpërndarjen e barrës tatimore tek të gjithë pjesëmarrësit. Pozitiviteti më i lartë vjen nga ulja e tatimit në korporatë nga 20 në 10%. Kjo e bëri Kosovën shumë më atraktive në tregun global. Megjithatë, në valën e optimizmit mbet i harruar rritja e TVSH-së nga 15% në 16%. Ndonëse u proklamua si rritje prej “vetëm 1 %” e vërteta është se TVSH është rritur për 1 pikë të përqindjes dhe kjo është e barabartë me 6.6%.

Ndikimi i politikës fiskale në mjedisin e biznesit në Kosovë

Politika fiskale në vendin tonë ka pësuar shpesh herë ndryshime ndër vite kur dihet se jemi një shtet i ri dhe me ndërrimin e qeverive njëkohësisht është ndërruar edhe politika fiskale e vendit. Fillimisht tatimi në të ardhura të

XII INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE | KONFERENCA E XII-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE XII-ta NAUČNA MEDJUNARODNA KONFERENCIJA

korporatave prej themelimit të ATK (Administratës Tatimore të Kosovës) ishte 20% deri në fund të vitit 2009 dhe me fillimin e vitit 2010 kjo tarife ka ndryshuar dhe është zbritur në 10%.

Kjo ka ndikuar pozitivisht te bizneset që veprojnë si korporata në Kosovë si (Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, shoqëritë aksionare etj.) që këtë diferencë prej 10% ta shndërrojnë në fitim apo në investime për kompaninë. Kjo politikë ka ndikuar pozitivisht edhe te buxheti i shtetit pasi në njërin anë janë zvogëluar të hyrat nga tatimi në korporata mirëpo në anën tjetër është zvogëluar evazioni fiskal dhe është krijuar një baraspeshe në buxhetin e Kosovës.

Tatimi për bizneset që merren me veprimtari tregtare është 3% dhe nuk ka ndryshuar mirëpo te veprimtaritë shërbyese tatimi ka qenë 5% deri në vitin 2013 dhe më pas është ndryshuar dhe është rritur në 9%. Kjo ka ndikuar negativisht te shumë biznese të cilat edhe janë detyruar ta ndërrojnë formën e tatimit dhe të kalojnë në tatimin e të ardhurave reale. Bizneset kanë vlerësuar se kjo është një zgjidhje më e mirë kur dihet se tatimin e të ardhurave reale pranohen shpenzimet kurse në tatimin e paragjykuar nuk pranohen.

Një ndikim tjetër ka qenë edhe rregullorja për tatimin në qira ku norma prej 9% nuk ka ndryshuar mirëpo ka ndryshuar forma e pagesës. Tani me ligjin e ri prej vitit 2015 të gjitha bizneset janë të obliguara të paguajnë tatimin në qira për objektin që e zotërojnë dhe këtë vlerë të ja ndalin pronarit të objektit pra të ja paguajnë qiranë bruto (minus tatimin në qira) = Qiraja neto. E njëjta ka ndodhur edhe me bizneset që kanë produkte të mishit dhe qumështit të cilat kanë blerë nga fermerët janë detyruar të paguajnë 3% të asaj vlere që kanë blerë nga ata dhe të ja ndalin këtë vlerë në burim.

Në të dyja rastet kjo ka qenë favorizuese për shtetin pasi ka arritur ti kontrollojë më mirë objektet me qira dhe fermerët mirëpo ka krijuar një "konflikt" mes palëve të lartpërmendura se kush duhet të paguajë atë pjesë të tatimit.

Tjetër ndikim i politikës fiskale është edhe tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSh). Ky tatim ndryshe njihet edhe lloj tatimi që paguhet nga konsumatori. Mirëpo në Kosovë shteti fillimisht obligon bizneset që të paguajnë TVSh-në në doganë me rastin e importimit të mallit dhe më pastaj atë vlerë ta marr si të zbritshëm (kreditojë) dhe momentin e shitjes së mallit konsumatori i fundit paguan gjithë vlerën e TVSh-së. Kjo është një barrë për bizneset pasi një pjesë të madhe të parave të tyre duhet ta ndajnë për pagesën e TVSh-së në doganë.

TVSh fillimisht deri vitin 2008 ka qenë 15% për të gjitha produktet mirëpo nga fillimi i vitit 2009 norma e TVSh-së është rritur në 16%. Kjo politikë i ka detyruar bizneset të rrisin çmimet e tyre mirëpo jo edhe fitimin pasi në këtë rast janë rritur të hyrat e shtetit e jo edhe të biznesit. Mirëpo në Shtator 2015 shteti vendosi për herë të parë një normë variabile të TVSh-së ku vendosi që produktet elementare të ngarkojë me 8% TVSh ndërsa produktet e luksit me 18% TVSh. Kjo rezultojë me mundësinë që bizneset të zvogëlojnë çmimet për produktet elementare dhe kërkesa për këto produkte të jetë edhe më e madhe.

E kundërta ka ndodhur me produktet e luksit ku me rritjen e TVSh-së janë rritur automatikisht të gjitha çmimet e produkteve që ka rezultuar me rënien e kërkesës së produkteve.

Po ashtu ka ndodhur edhe një ndryshim tjetër në vitin 2015 ku pragu për regjistrim në TVSh ka zbritur nga 50,000 sa ka qenë në 30,000 euro dhe kjo ka ndikuar negativisht te ndërmarrjet e vogla dhe të mesme pasi bizneset janë të obliguara të marrin fatura që janë me TVSh për të krijuar balancë kreditore në blerje dhe për të pasur atë rezervë në momentin që shiten mallrat. Po ashtu kanë ndikuar edhe normat e larta të interesit në banka ku fillimisht kanë qenë norma deri në 20% në kreditë për bizneset e dihet se shumë biznese punojnë me marzhë më të vogël se 20% dhe kjo i ka dërguar automatikisht bizneset në falimentim. Ndikim tjetër ka qenë edhe ligji për faljen e borxheve që ka ndikuar mjaft shumë te bizneset sidomos ato me qarkullim të madh. Hulumtimet e ndryshme tregojnë se shumë biznese kanë përfituar nga falja e borxheve që kanë pas ndaj ndërmarrjeve publike dhe ndaj Administratës Tatimore të Kosovës.

Arkat fiskale po ashtu kanë qenë një barrë për bizneset pasi fillimisht është krijuar një monopol i tyre dhe arkat në fillim janë shitur me një çmim mjaft të lartë që nuk korrespondojnë me çmimin real të tyre dhe kjo ka qenë një

XII INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE | KONFERENCA E XII-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE XII-ta NAUČNA MEDJUNARODNA KONFERENCIJA

barrë e madhe të cilën e kanë paguar bizneset. Kur i shtojmë kësaj edhe mirëmbajtjen vjetore të arkës si sigurimin në rast defekti atëherë kjo mjaft e dëmshme sidomos për bizneset e vogla dhe të mesme që kanë qarkullim dhe fitim me të vogël. Mirëpo çmimi i arkave ka filluar të bie në momentin kur është pajisur pjesa dërrmuese e bizneseve dhe kërkesa për to ka rënë.

Nga 01.09.2015 Qeveria e Kosovës respektivisht Ministria e Financave ka vendosur të ndryshojë ligjin e TVSh-së duke krijuar për herë të parë TVSh-në e ndryshueshme apo variabile. Fillimisht tvsh-ja deri në vitin 2008 ka qenë 15% pastaj nga 2009 deri në Shtator 2015 tvsh-ja ka qenë 16%. Me ndryshimin e ligjit të tvsh-së është shëndrruar tvsh-ja nga tvsh fikse në tvsh variabile ku janë aplikuar 2 norma të tvsh-se 18% dhe 8%.

Aplikimi i normës prej 8% është aplikuar te produktet elementare si (Barnat, Mielli, Vaji, Qumështi etj.) kurse produktet tjera të cilat cilësohen si produkte të luksit si janë rradhitur te norma prej 18%.

Të anketuarit të cilët janë pyetur në lidhje me pyetjen se si ka ndikuar ky ndryshim i normës së tvsh-së kanë dhënë përgjigjet e tyre ku 42.40% mendojnë se ky ndryshim ka ndikuar negativisht te bizneset, 39.40% mendojnë se kjo ka ndikuar pozitivisht te bizneset ndërsa 18.20% mendojnë nuk ka pasur kurrfarë ndikimi.

Siç mund ta shohim nga të dhënat e të anketuarëve kemi një përafrim të atyre që mendojnë se ky ndryshim ka pasur ndikim pozitiv dhe të atyre që mendojnë se ka pasur ndikim negativ. Nga 01.09.2015 Qeveria e Kosovës respektivisht Ministria e Financave ka vendosur të ndryshojë ligjin e TVSh-së duke krijuar për herë të parë TVSh-në e ndryshueshme apo variabile. Fillimisht tvsh-ja deri në vitin 2008 ka qenë 15% pastaj nga 2009 deri në Shtator 2015 tvsh-ja ka qenë 16%. Me ndryshimin e ligjit të tvsh-së është shëndrruar tvsh-ja nga tvsh fikse në tvsh variabile ku janë aplikuar 2 norma të tvsh-se 18% dhe 8%.

Aplikimi i normës prej 8% është aplikuar te produktet elementare si (Barnat, Mielli, Vaji, Qumështi etj.) kurse produktet tjera të cilat cilësohen si produkte të luksit si janë rradhitur te norma prej 18%.


Të anketuarit të cilët janë pyetur në lidhje me pyetjen se si ka ndikuar ky ndryshim i normës së tvsh-së kanë dhënë përgjigjet e tyre ku 42.40% mendojnë se ky ndryshim ka ndikuar negativisht te bizneset, 39.40% mendojnë se kjo ka ndikuar pozitivisht te bizneset ndërsa 18.20% mendojnë nuk ka pasur kurrfarë ndikimi.

Siç mund ta shohim nga të dhënat e të anketuarëve kemi një përafrim të atyre që mendojnë se ky ndryshim ka pasur ndikim pozitiv dhe të atyre që mendojnë se ka pasur ndikim negativ.

Ndryshimi i normave të TVSh-se nga TVSh fikse 16% në variabile 18% dhe 8% ka ulur çmimin për produktet bazë.

1. Si ka ndikuar ndryshimi i normës së TVSh-së nga 16% në 18% dhe 8% ?

33 responses



Nga 01.09.2015 Qeveria e Kosovës respektivisht Ministria e Financave ka vendosur të ndryshojë ligjin e TVSh-së duke krijuar për herë të parë TVSh-në e ndryshueshme apo variabile. Fillimisht tvsh-ja deri në vitin 2008 ka qenë 15% pastaj nga 2009 deri në Shtator 2015 tvsh-ja ka qenë 16%. Me ndryshimin e ligjit të tvsh-së është shëndërruar tvsh-ja nga tvsh fikse në tvsh variabile ku janë aplikuar 2 norma të tvsh-se 18% dhe 8%.


Aplikimi i normës prej 8% është aplikuar te produktet elementare si (Barnat, Mielli, Vaji, Qumështi etj.) kurse produktet tjera të cilat cilësohen si produkte të luksit si janë rradhitur te norma prej 18%.

Të anketuarit të cilët janë pyetur në lidhje me pyetjen se si ka ndikuar ky ndryshim i normës së tvsh-së kanë dhënë përgjigjet e tyre ku 42.40% mendojnë se ky ndryshim ka ndikuar negativisht te bizneset, 39.40% mendojnë se kjo ka ndikuar pozitivisht te bizneset ndërsa 18.20% mendojnë nuk ka pasur kurrfarë ndikimi.

Siç mund ta shohim nga të dhënat e të anketuarëve kemi një përaftrim të atyre që mendojnë se ky ndryshim ka pasur ndikim pozitiv dhe të atyre që mendojnë se ka pasur ndikim negativ.

2. Zvogëlimi i TVSh-së për produktet bazë ne 8% a ka zvogëluar çmimet ?

33 responses



Siç jemi në dijëni tatimi mbi vlerën e shtuar është tatim i cili paguhet nga konsumatori dhe për këtë ju jemi drejtuar të anketuarve se si mendojnë se ka ndikuar në praktikë ky ndryshim ku kemi një zvogëlim të tvsh-së të produktet elementare nga 16% në 8%, pra një zbritje prej 100% të normës së tvsh-së.


39.40% nga të anketuarit mendojnë se kjo nuk ka ndikuar në zvogëlimin e çmimeve për produktet elementare, 30.30% mendojnë se çmimet për produktet bazë janë zvogëluar me ndryshimin e normës së tvsh-së kurse 30.30% mendojnë se nuk ka ndikuar fare te çmimet.

Nga hulumtimi i realizuar mund të kuptojmë se bizneset nuk i kanë respektuar ndryshimet e tvsh-së duke ja mundësuar vetit sjelljen e një profiti edhe më të madh pasi vlera prej 8% e cila është dashur të zbritet është kthyer automatikisht në profit për biznesin pasi ai është i obliguar ti paguajë shtetit 8% tvsh ndërkohë pjesën tjetër prej 8% e ka kthyer në profit.

Në këtë aspekt duhet që mekanizmat përgjegjës për rregullimin e çmimeve të marrin masat e duhura për rregullimin e kësaj çështjeje pasi kjo ka ndikim të konsumatorët sidomos kur dihet se kemi të bëjmë me produkte elementare si Vaji, Mielli, Sheqeri, Barnat etj

3. Rritja e TVSh-së për produktet e luksit ne 18% i ka rritur çmimet ?

33 responses



E kundërta e asaj që ka ndodhur me produktet elementare është te produktet e luksit ku kemi me normën e re të tvsh-së kemi një rritje prej 2%. Dihet pra se tvsh është taksë që e paguan konsumatori dhe kjo ndikon drejtëpërdrejtë në xhepin e tij.


87.90% e të anketuarve në lidhje me këtë çështje mendojnë se çmimet janë rritur me rritjen e normës së tvsh-së, 9.10% mendojnë se çmimet nuk janë rritur kurse 3% mendojnë se kjo nuk ka ndikuar fare te çmimet.

Rritja e çmimeve në rastin konkret është normale të ndodh pasi ndryshimet eventuale te tvsh-së janë barrë që i ngarkohen konsumatorit mirëpo njejtë se si ka ndodhur rritja e çmimeve te produktet e luksit e njejtë është dashur të ndodhë edhe te produktet elementare ku është dashur te zbriten çmimet.

Në bazë të analizavë e gjithë kjo ecuri e ndryshimit te tvsh-së ka shkuar në dobi të bizneseve pasi ata kanë përfituar në rastin e produkteve elementare kur dihet se ato janë produktet me pjesëmarrjen më të madhe ne treg dhe dihet janë produkte që çdo familje i konsumon kurse te produktet e luksit kemi një pjesëmarrje më të vogël të konsumatorëve edhe pse kemi shumë më tepër artikuj të cilët janë pjesëmarrës me normën prej 18%.

4. Si mendoni se ka ndikuar ky ndryshim i TVSh-se ne buxhetin e shtetit ?

33 responses



Tatimi mbi vlerën e shtuar është një nga tatimet që i sjellë më së shumti të hyra buxhetit të Kosovës me rreth 47% pjesëmarrje në buxhetin e Kosovës. Fillimisht tatimi mbi vlerën e shtuar paguhet në momentin e arritjes së mallit në Doganan e Kosovës nesë malli është import mirëpo nëse malli është prodhim vendor atëherë tvsh i paguhet Administratës Tatimore të Kosovës dhe momentin e daljes në treg të produktit gjithë tvsh-ja paguhet nga konsumatori i fundit.


Një nga ndryshimet tjera që ka ndodhur në të njëjtën kohë me ndryshimin e normës së tvsh-se është edhe ndryshimi i pragut të tvsh-së prej 50,000 euro sa ka qenë deri në Shtator/2015 në 30,000 euro dhe kjo padyshim i ka sjellë dobi shtetit pasi qarkullimi i shumices së bizneseve të vogla dhe të mesme sillet në vlerat mes 30,000 deri në 50,000 euro.

Ndryshimi tjetër ka qenë se mënyra e arritjes së pragut në tvsh do të bëhet brenda vitit kalendarik 01 Janar deri me 31 Dhjetor metodë kjo që e ka ndryshuar formën e vjetër kur është llogaritur pragu i arritjes së tvsh-së brenda 12 muajve të fundit.

75.80% e të anketuarve mendojnë se ndryshimi i tvsh-së ka ndikuar pozitivisht në rritjen e buxhetit të shtetit, 21.20% mendojnë se nuk ka pasur kurrfarë ndikimi ndërsa 3% mendojnë se ka ndikuar negativisht pasi është zvogëluar buxheti.

5. A mendoni se qeveria është dashur të përdor ndonjë strategji tjetër në lidhje ndryshimin e normës së TVSh-së ?

33 responses



Shumica nga të anketuarit kanë qenë biznese dhe pjesa më e madhe e tyre 72.70% mendojnë se qeveria ka pasur mundësi më të mira, 18.20% mendojnë se qeveria nuk është dashur të ndryshojë ligjin e tvsh-së kurse 9.10% mendojnë se ky vendim i qeverisë ka qenë zgjidhja më e mirë.

Ndryshimet e tvsh-së nuk janë pritur mirë nga shumica e bizneseve pasi rritja e normës së tvsh-se ka rritur rritur çmimet dhe kjo ka ndikuar në shportën e konsumatorit.

Ndikimi tjetër ka qenë zbritja e pragut nga 50,000 euro në 30,000 dhe kjo ka ndikuar te shumica e bizneseve pasi momentin e arritjes së pragut për bizneset obligohen të sigurojnë fatura me tvsh për të zbritur tvsh-në që e realizojnë në shitje në të kundërtën do të ngarkohen me gjithë tvsh-në në shitje që është një barrë e madhe për bizneset sidomos ato të vogla.

Në anën tjetër qeveria ka përdorur një strategji mjaft të mirë për të sjellë të hyra buxhetit të Kosovës ku dihet se një pjesë e madhe e produkteve marrin pjesë të produktet e luksit ku ka ndodhur rritja nga 16% në 18% ndërsa strategjia më e mirë e qeverisë ka qenë zbritja e pragut të tvsh-së nga 50,000 euro në 30,000 euro ku dihet se një numër i madh i bizneseve të vogla dhe të mesme kanë arritur pragun e tvsh-së duke i sjellë buxhetit të hyra mjaft të mëdha.


Dihet se buxheti i Kosovës të hyrat me të mëdha i realizon nga tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi në fitim përmes institucioneve përgjegjëse si Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës përmes importeve deri të shitjet të konsumatori i fundit.

Ndërsa të pyejta për vërtetimin e hipotezës së dytë shohim këto rezultate :

Rritja eventuale e pagës minimale do të ndikonte pozitivisht te bizneset.

1. Si do të ndikonte rritja e pagës minimale te bizneset ne Kosovë ?

33 responses



Në pyetjen që ju kemi drejtuar 33 të anketuarve se si mendojnë se do të ndikonte rritja e pagës minimale në Kosovë kemi marrë këto përgjigje:


60.60% mendojnë se rritja e pagës minimale do të ndikonte pozitivisht te bizneset, 27.30% mendojnë se do të ndikonte negativisht kurse 12.10% mendojnë se nuk do të ketë asnjë ndikim.

Shumica e të anketuarve mendojnë se rritja e pagës minimale do të kishte ndikim pozitiv edhe pse bizneset do të ngarkohen me kosto më të madhe të pagave, kontributeve dhe tatimeve. Në anketën të cilën e kemi realizuar me 33 të anketuar kemi marrë këto përgjigje në pyetjen se si ka ndikuar taksat ndaj produkteve serbe në stimulimin e produkteve vendore: 84.80% mendojnë se ka pasur ndikim pozitiv, 12.10% mendojnë se ka pasur ndikim negativ dhe 3.10% mendojnë se nuk ka ndikuar fare.

Taksa 100% e vendosur ndaj produkteve serbe ka rritur kërkesën për produkte vendore.

1. Si mendoni se ka ndikuar taksa prej 100% ndaj produkteve serbe ne stimulimin ndaj produkteve vendore ?

33 responses



Duke e shikuar nga aspekti ekonomik, kemi disa nga efektet pozitive të cilat janë: Rritja e konsumit të produkteve vendore, rritja e të hyrave tatimore, krijimi i parakushteve për zëvendësimin të Serbisë – luftimi i politikave dumping të Serbisë në tregun e Kosovës, promovimi i produkteve “Made in Kosova”, mënjanimi i perceptimit se Kosova është e varur nga produktet e Serbisë. Ndërsa si efekte negative janë parë: Rritja e çmimeve për produkte të caktuara në tregun e Kosovës, dëmtimi i pjesës së prodhuesve vendor të cilët lëndën e parë e kanë importuar nga Serbia, rritja e kontrabandës veçanërisht në veri të vendit, importimi i mallrave serbe nga shtetet tjera të rajonit dhe rritja e importit. Në anketën të cilën e kemi realizuar me 33 të anketuar kemi marrë këto përgjigje në pyetjen se si ka ndikuar taksa ndaj produkteve serbe në stimulimin e produkteve vendore: 84.80% mendojnë se ka pasur ndikim pozitiv, 12.10% mendojnë se ka pasur ndikim negativ dhe 3.10% mendojnë se nuk ka ndikuar fare. Taksa, megjithë efektet pozitiv, pati edhe dobësitë e saj. Taksa u vendos për një periudhë shumë të shkurtër kohore dhe nuk ishte bërë një analizë e mirëfilltë për mënyrën e e zbatimit. Në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë, në departamentin ku regjistrohen markat tregtare, mungonte një bazë e mirëfilltë e të dhënave për markat ndërkombëtare. Shënimet ishin gjysmake dhe linte shumë për të dëshiruar. Nuk ishin vendosur kriteret se çfarë nënkuptonte marka ndërkombëtare.

Vertetimi I hipotezave

Ne baze te pyetsorit del se hipoteza e pare eshte hudhur poshte dhe ndryshimet e tvsh-se nuk i kane ulur qmimet e produkteve baze.

Hipoteza e dyte pranohet ,sepse rritja e pages ndikon pozitivisht te bizneset,mirepo keto biznese shumica nuk kane ne planet e tyre rritjen e numrit te punetoreve.

Hipoteza e trete pranohet e sakte, por me dyshime te larta.

Mirepo, taksa, megjithë efektet pozitiv, pati edhe dobësitë e saj. Taksa u vendos për një periudhë shumë të shkurtër kohore dhe nuk ishte bërë një analizë e mirëfilltë për mënyrën e e zbatimit. Në Ministrinë e

Tregtisë dhe të Industrisë, në departamentin ku regjistrohen markat tregtare, mungonte një bazë e mirëfilltë e të dhënave për markat ndërkombëtare. Shënimet ishin gjysmake dhe linte shumë për të dëshiruar. Nuk ishin vendosur kriteret se çfarë nënkuptonte marka ndërkombëtare.

Në fillim vendosja e taksës ishte e vogël, 10%, dhe nuk i atakonte markat ndërkombëtare. Efekti ishte i papërfillshëm dhe kjo u bë në 100 % për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Pika 2 e vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.01/76 të datës 21.11.2018 ka këtë përmbajtje:

Pavarësisht origjinës së mallit të paraparë në paragrafin 1 të këtij vendimi, masa prej 100 % nuk aplikohet për markat e njohura tregtare të vendeve të tjera të cilat prodhohen në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë, të cilat janë pjesë e aneksit të bashkangjitur me këtë vendim.

Në këtë regjistër ishin futur vetëm 8 biznese që lënë për të dyshuar se: ose ishte bërë në marrëveshje nga zyrtarët qeveritarë ose ishe padituri e tyre. Hipoteza e dytë u argumentua më vonë se nuk ishte shkaktari i seleksionimit diskriminimi i bizneseve, pasi në bazën e të dhënave ishin të regjistruar edhe shumë e shumë marka tregtare ndërkombëtare, të mbrojtura, por nuk ishin lejuar të importonin.

Qeveria nuk e respektoj vendimin që e kishte marrë vetë dhe bëri shkelje, sepse pas datës 21.11.2018, me vendimin nr.01/76 kishte futur në aneks vetëm 8 biznese me të drejtë importi, nëntë marka tregtare ndërkombëtare që lejoheshin të importonin.

Disa biznese kishin në depot e tyre doganore sasi të mëdha të mallit që pastaj me një vendim tjetër u lejuan ta zhdoganonin ato mallra pa taksën 100% në muajin shkurt 2019.

Qeveria nuk ka pasur një plan që t'i informonte importuesit në Kosovë për të gjetur tregje alternative për furnizimet e tyre.

LITERATURA

-Instituti GAP

<http://www.institutigap.org/lajme/2026>

https://www.institutigap.org/documents/13679_Ligji%20p%C3%ABr%20TVSH-%20final1.pdf

-Instituti Demokratik i Kosovës

<http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2019/02/13-TAKSA-100-Vazhdim-apo-Pezullim-Raport-ALB-02.pdf>

-Ministria e Financave

-Administrata Tatimore e Kosovës

-Dogana e Kosovës

NDIKIMI I SEKTORIT TË TURIZMIT NË RRITJEN E PUNËSIMIT INFLUENCE OF TOURISM SECTOR IN WORKING INCREASE

Msc. Servete Lleshi Ligataj

Msc. Manjola Striniqi Xhahysa

Abstracti

This paper will address various areas of the economy, but will mainly focus on the field of tourism and its impact on employment growth. Various authors have given many definitions on the principles of sustainable tourism, following a basic principle. The main principle for the development of sustainable tourism is based on the idea that meeting the current needs should not condition and should not limit the younger generations to meet their needs.

The impacts of tourism can be positive or negative, but the most important economic impact that tourism has is that it provides more employment for people in that area and thus increases the standard of living.

The destination that has been chosen to study and treat in this paper is Ulcinj, addressing various concepts in the field of tourism as well as the presentation of a general overview of the area in question.

A special place in this paper will have the investment made in the Ulcinj Riviera, where hundreds of jobs have been generated. Most seasonal but also annual.

In the last part, the conclusions for the tourist area of Ulcinj will be presented, based on the different treatments and concepts and how much the tourism sector in general has influenced the increase of employment and long-term economic development in this municipality.

Abstracti

Ky punim do të cekë sfera të ndryshme të ekonomisë, por kryesisht do të përqëndrohet në fushën turizmit dhe ndikimin e tij në rritjen e punësimit. Autorë të ndryshëm kanë dhënë shumë përkufizime mbi parimet e turizmit të qëndrueshëm, duke ndjekur një parim bazë. Parimi kryesor për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm bazohet në idenë që përmbushja e nevojave aktuale nuk duhet të kushtëzojë dhe nuk duhet të kufizojë brezat e rinj për të përmbushur nevojat e tyre.

Ndikimet e turizmit mund të jenë pozitive ose negative, por ndikimi më i rëndësishëm ekonomik që ka turizmi është se ai siguron më shumë punësim për njerëzit në atë zonë dhe në këtë mënyrë rrit standardin e jetesës.

Destinacioni që është zgjedhur për të studiuar dhe trajtuar në këtë punim është Ulqini, duke trajtuar koncepte të ndryshme në fushën e turizmit si dhe paraqitja e një panoramë të përgjithshme e zones në fjalë.

Vënd të veçantë në këtë punim do të ketë investimi i bërë në Rivierën e Ulqinit, ku janë gjeneruar qindra vende pune. Shumica sezonale por edhe vjetore.

Në pjesën e fundit do të paraqiten konkluzionet për zonën turistike të Ulqinit, bazuar në trajtimet dhe konceptet e ndryshme si dhe sa ka ndikuar sektori turizmit në përgjithësi në rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik afatgjatë në këtë komunë.

KAPITULLI 1: TURIZMI I QËNDRUESHËM

TURIZMI I QËNDRUESHËM

Metodologjia

Puna konkrete për realizimin e këtij punimi konsiston në mbledhjen e informacionit në formën e kërkimit duke shqyrtuar literatura të ndryshme mbi menaxhimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe materiale të tjera të aplikimit të praktikave të mira menaxhuese nëpër botë.

Për realizimin e këtij punimi janë përdorur kryesisht të dhëna sekondare nga rishikimi i literaturave të ndryshme, po kështu dhe shfrytëzimi i faqeve të ndryshme të internetit. Ndërsa të dhënat primare janë realizuar në formën e intervistave të realizuara pranë Entit për Statistika, Organizatës Turistike etj, në qytetin e Ulqinit.

Format e kërkimit janë eksploruese dhe deskriptive. Është përdorur kërkimi eksplorues i bazuar në literaturë. Kërkimi deskriptiv është përdorur për të dhënë karakteristikat përshkruese të zonës, profilet e turizmit etj.

1.1 TURIZMI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Turizmi përfshin aktivitetet e personave që udhëtojnë dhe qëndrojnë në vende jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm për jo më shumë se një vit me radhë për qëllime argëtimi, biznesi dhe qëllime të tjera që nuk lidhen me ushtrimin e një aktiviteti të paguar nga vendi i vizituar. Zhvillimi i qëndrueshëm u bë një nga shqetësimet kryesore të kohëve moderne. Përkufizimi i UNWTO për turizmin e qëndrueshëm mund të shprehet: Turizëm që merr parasysh plotësisht ndikimet aktuale dhe të ardhshme ekonomike, sociale dhe mjedisore, duke adresuar nevojat e vizitorëve, industrisë, mjedisit dhe komuniteteve pritëse. Sipas Travis (1994), turizmi i qëndrueshëm është "... të gjitha format e turizmit, zhvillimit, menaxhimit dhe aktivitetit që mundësojnë një jetë të gjatë për atë aktivitet kulturor, të cilin e quajmë turizëm, duke përfshirë një seri produktesh të turizmit ekonomik, që janë në përputhje me sigurimin e përhershëm të burimeve të trashëguara, qoftë natyrore, kulturore apo të ndërtuara, të cilat krijojnë turizëm".

Në mënyrë të ngjashme, Middleton dhe Hawkins (Middleton, 1998)⁹¹ deklarojnë se turizmi i qëndrueshëm "... është arritja e një kombinimi të caktuar të numrit dhe llojit të vizitorëve, efektet kumulative të aktiviteteve të cilave në një destinacion të caktuar, së bashku me veprimet e biznesit shërbyes, mund të vazhdojnë në të ardhmen e parashikueshme pa dëmtuar cilësinë e mjedisit në të cilin bazohen këto aktivitete".

Parimi kryesor për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm bazohet në idenë që përmbushja e nevojave aktuale nuk duhet të kushtëzojë dhe nuk duhet të kufizojë brezat e rinj për të përmbushur nevojat e tyre.

⁹¹ Middleton, V. T. C., & Hawkins, R. (1998). Sustainable tourism: A marketing perspective. Oxford: Butterworth Heinemann.

Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm duhet parë si një model përshtatës, pjesë e koncepteve prindërore të zhvillimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, dhe duhet të synojë që të kontribuojë në zhvillimin e objektivave në përgjithësi duke përcaktuar parimet specifike në dritën e koncepteve prindërore (Tosun, 2001)⁹²

Sistemi i qëndrueshëm i turizmit bazohet në tre shtylla të rëndësishme:

- Shtylla natyrore - potenciali fiziko-geografik
- Shtylla lokale - komunitet lokal
- Shtylla njerëzore - turist, operatorët turistikë, kategori të tjera të palëve të interesuara.

Është e qartë se konceptet themelore veprojnë si ndërmjetës midis territorit dhe banorëve, të cilat kërkojnë një metodë aplikimi pak a shumë sipas një partneriteti ndërmjet sektorit privat dhe publik.

NDIKIMI I TURIZMIT

Turizmi mund të ketë ndikim në komunitete dhe mund të jetë pozitiv ose negativ, dhe ndonjëherë të dyja. Fushat turistike mund të ndikojnë ndjeshëm në një komunitet dhe banorët e tij përfshijnë:

- Cilësinë e jetës
- Punësimin dhe mundësitë e biznesit
- Ndërtesat dhe paisjet
- Zhvillimi i infrastrukturës p.sh. hotele, vendpushime
- Rritja e popullsisë

Ndikimi më i rëndësishëm ekonomik që ka turizmi është se ai siguron më shumë punësim për njerëzit në atë zonë dhe në këtë mënyrë rrit standardin e jetesës. Në fakt, disa ekonomi funksionojnë kryesisht duke u bazuar në turizëm. Turizmi ndihmon edhe në zhvillimin e rajonit në tërësi dhe si rezultat, organet drejtuese mund të shfrytëzojnë fondet për të promovuar destinacionin dhe ta bëjnë atë më tërheqës për turistët. Zhvillimi në turizëm ka krijuar mundësi punësimi si në vendet e industrializuara ashtu edhe në vendet në zhvillim (vende punësimi të tipit të kualifikuar si dhe të pakualifikuar). Turizmi krijon tre lloje të punësimit në ekonomitë rajonale dhe kombëtare (Matheson and Wall)⁹³

1. Punësimi i drejtpërdrejtë: I referohet llojit të punësimit të ofruar në objektet turistike siç janë akomodimi, ushqimi, pija, transporti, agjentët e udhëtimit që ekzistojnë në sektorin e turizmit dhe plotësojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nevojat turistike.

2. Punësimi i ndikuar: I referohet punësimit shtesë në ekonomi që vjen si rezultat i ri-shpenzimit të të ardhurave të fituara përmes metodave të punësimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Individët, të ardhurat dhe standardet e jetesës së të cilëve janë rritur si rezultat i aktiviteteve të tyre turistike, krijojnë mundësi të reja punësimi duke shpenzuar këto të ardhura të fituara në sektorë të tjerë të ekonomisë.

⁹² Tosun, Cevat (2001); Challenges of sustainable tourism development in the developing world: the case of Turkey; *Tourism Management* 22, 289-303.

⁹³ Mathieson, A. & Wall, G. (1982). *Tourism: economic, physical and social Impacts*: Longman.

3. Punësimi indirekt: Mbulon punësimin në sektorë të tjerë të cilët nuk u shërbejnë direkt konsumatorëve turistikë, por marrin të ardhura nga sektorët e tjerë që sigurojnë kontribut për sektorin e turizmit. Dyqanet me pakicë jo-turistike etj.

Për të parë ndikimin në punësim është e nevojshme të shihen indikatorët e punës në turizëm:

- Fuqia totale e punës sipas llojit të punësimit, kontratës së punësimit dhe rajonit.
- Numri total dhe shkalla e qarkullimit të punonjësve sipas grupmoshës, gjinisë dhe rajonit.
- Orët mesatare të trajnimit në vit për punonjës sipas kategorisë së punonjësve.

Turizmi gjithashtu sjell përfitime për shoqëritë, duke përfshirë njohjen e kulturave të ndryshme dhe kuptimin më të madh të mënyrave në të cilat njerëzit jetojnë. Në nivelin e komunitetit, banorët mund të ndjejnë një ndjenjë krenarie dhe të marrin më shumë ndërgjegje për historinë e tyre dhe burimet lokale. Ndikimet socio-kulturore të turizmit konvencional të përshkruar këtu janë efektet mbi komunitetet pritëse të marrëdhënies të drejtpërdrejta dhe të tërthorta me turistët dhe të ndërveprimit me industrinë e turizmit.

1.2 STRATEGJIA EVROPIAN E TURIZMIT

Turizmi ka qenë gjithmonë pjesë e politikave të Komunitetit Evropian, por kryesisht nga viti 2009 institucionet evropiane të bazuara në Traktatin e Lisbonës kanë filluar një drejtim të ri. Komuniteti Evropian e vendos turizmin si një shqetësim kryesor midis prioriteteve të reja të përfshira në strategjinë "Evropa 2020" me qëllim që Evropa të mbetet "vendi i parë në destinacionet turistike botërore". Në këtë kontekst, vëmendja kryesore i kushtohet turizmit të qëndrueshëm. Kjo strategji, bazuar në Strategjinë e Evropës 2020, mbështetet në këto objektiva:

- **Rritje inteligjente** (Smart) bazuar në investime efikase në arsim, hulumtim dhe inovacion.
- **Rritje e Qëndrueshme** (Qëndrueshmëri) bazuar në vendimin për zgjedhjen e një ekonomie që është "e gjelbër" dhe ndotjes së ulët të CO₂.
- **Rritje e fortë** (solide) fokusuar në krijimin e vendeve të punës dhe reduktimin e varfërisë.

KAPITULLI 2: TURIZMI, KONTEKSTI I ZHVILLIMIT

ULQINI

Është qyteti i parë i madh në Adriatik, pasi të kalohet gryka e Otrantos, qendër me një rrethinë të madhe dhe pjellore, e cila shtrihet deri tek Liqeni i Shkodrës dhe mali i Rumisë, një vend i përshtatshëm për jetesë e sidomos për turizëm.

Ka një sipërfaqe prej 255km². Është shembull unik i bukurisë. Plazhet ranore më të gjata në Evropë, me detë të kristaltë dhe të pastër, Buna sy kaltëroshe, liqeni i mrekullueshëm i Shasit, dhe ullishta shekullore. Territorin e Ulqinit e karakterizon varianti Adriatik i klimës mesdhetare dhe vegjetacioni subtropikal. Ulqini ka klimë jashtëzakonisht të përshtatshme prandaj nga ky aspekt mund të krahasohet me qendrat më të njohura turistike në Mesdhe. Ajo çfarë e karakterizon Ulqinin është fakti se është vendi që gjatë vitit ka më shumë diell se çdo vend tjetër në bregdetin Adriatik. Mesatarja e ditëve me diell në Ulqin është 218 ditë, që do të thotë mesatarisht 2.706 orë në vit, ose 7.4 orë/ditë. Ulqini është i njohur si vend për pushim verorë dhe dimërorë.

Temperatura mesatare vjetore është 16,5o C.

Pjesa moçalike pas plazhit të Madh dhe Kripores bëjnë që Ulqini të jetë çerdhe e mijëra shpendëve. Vetëm gjatë dimrit në Kripore regjistrohen mbi 20 mijë shpendë. Në Kripore dimëron edhe pelikani, çafka, rosat, patat, grabitësit etj.

Ulqini, qyteti i 26.000 banorëve, me përkatësi multietnike, në verë pesëfishohet. Ulqinakët nuk jetojnë vetëm në sajë të turizmit. Kultura tipike e kësaj treve është ulliri. Në shkrimet e ndryshme cilësohet “druri i dashurisë”. Në periferi të tij gjendet ullishtja më e madhe në vend, me drurë qindravjeçarë. Kurora e tij me 80 mijë rrënjë i ndihmon ulqinakët në të ardhurat dytësore.

2.1 TURIZMI - SEKTOR EKONOMIK NË ZHVILLIM NË KOMUNËN E ULQINIT

Turizmi përfaqëson një nga aktivitetet ekonomike me rritjen më të shpejtë me ndikim të madh në rritjen ekonomike, zhvillimin social dhe punësim.

Ekonomia e qytetit të Ulqinit është shumë e varur nga industria e turizmit, duke qenë se 17.5% e popullsisë janë të punësuar në këtë fushë, dhe rreth 60% e familjeve kanë të ardhura parësore apo ndihmëse nga kjo degë ekonomike⁹⁴

Në qytetin e Ulqinit ndodhen disa pika turistike të cilat frekuentohen gjatë gjithë vitit siç janë muzeu, kalaja e Ulqinit dhe fshati turistik i Shasit. Ndërsa pikat e tjera turistike si plazhet dhe lumi Buna, vizitohen edhe gjatë vitit, por pikun më të madh e kanë kryesisht në verë, duke ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në rritjen e punësimit.

Numri i vizitorëve është në rritje nga viti në vit dhe në përgjigje të këtij fenomeni dhe oferta turistike është në rritje gjithashtu.

Sipas Organizatës Turistike në Ulqin numri i mysafirëve ka pësuar një rritje prej 13,40% për vitin 2016 – 2017. Për vitin 2017 – 2018, 6,11 % Ndërsa në 2019 numri i turistëve është rritur me mbi 15 %.⁹⁵

Numri më i madh i turistëve është nga Kosova, ndjekur nga Mali i Zi, Serbia, Maqedonia, Bosnia dhe Evropa Perëndimore. Gjithnjë e më shumë vërehet një interesim i mysafirëve nga Turqia të cilët kanë qenë të shumtë në numër në kuadër të udhëtimeve në shtete të ndryshme të Ballkanit. Kjo në sajë të natyrës së bukur dhe të një game të gjerë biodiversiteti që ofron Ulqini, duke e bërë atë unik në rajon.

Tabela 1.

Numëri i musafirëve dhe numri i bujtjeve në Komunën e Ulqinit në vitet 2016, 2017 dhe 2018.							
	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Rritja 2016/17 në num e %		Rritja 2017/18 në num e %	
Musafir	163.638	189.097	214.439	25.459	15,56 %	25.342	13,40 %
Bujtje	983.480	1.169.000	1.240.445	185.520	18,86 %	71.445	6,11 %

⁹⁴ Programi i Udhëheqjes së Ulqinit 2018-2022.

⁹⁵ Organizata Turistike e Ulqinit, datë 01.07.2019.

7.2 Punësimi

ABSTRAKT: Kemi zgjedhur këtë temë pasi është një temë mjaft aktuale ditët e sotme dhe shumë interesante për tu studiuar. Fuqizimi i gruas vitet e fundit është diçka që ndikon si në ndryshimet sociale ashtu edhe në ato ekonomike të një vendi. Gratë janë shndërruar në çelsin e suksesit të cdo kompanie pasi ato përbëjnë numrin më të madhë të konsumatorëve. Fuqia e tyre ka bërë që ato të jenë misteri më i madh për cdo kompani që do të rritet. Përfitimi i sa më shumë konsumatoreve femra do të thotë rritje e shitjeve. Megjithëse fuqizimi i grave është tashmë një fakt i pamohueshëm shumë kompani vazhdojnë ta neglizhojnë atë si një fuqi e madhe blerëse.

Hipoteza: Bizneset duhet ta orientojnë marketingun e tyre nga gratë pasi ato janë konsumatorët më të mëdha.

Si hipotezë kemi shtruar dy variabla që janë marketingu i bizneseve dhe gratë si konsumatorët më të mëdha. Duam të tregojmë lidhjen që këto dy variabla kanë, duke parë fillimisht se si ndikojnë gratë në rritjen e një biznesi dhe më pas duke parë sjelljen e bizneseve kundrejt grave.

Objektivi kryesor i zhvillimit të temës është të kuptohet rëndësia që gratë kanë në zhvillimin e biznesve. Fillimisht kemi trajtuar fuqizimin e femrës, sesi ajo është shndërruar nga një individ ku nuk kishte asnjë të drejtë në një individ që po bën revolucion në botë nëpërmjet fuqisë së saj.

FJALET KYCE: Ekonomia kombetare, Roli i gruas sipërmarrese, aktivitete ekonomike, SME, planifikim financiar, planifikim i burimeve, strategji konkurruese, planifikim dhe organizim.

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM:

Kemi trajtuar marrëdhënien midis grave dhe burrave si ka qënë dhe si ka ardhur në ditët e sotme. Ndikimi i arsimimit të grave në fuqizimin e tyre. Pjesëmarrja në arsim sipas gjinisë e më pas pjesëmarrja në tregun e punës si dhe vështirësitë që hasin gratë në për të qënë pjesë e këtij tregu. Kemi vazhduar zhvillimin e temës duke parë gratë si konsumatorët më të mëdha. Duke studiuar tregun e tyre jemi njohur me kërkesat që ato kanë ndaj marketerëve dhe arsytet se pse gratë blejnë. Kemi parë gratë si fuqia blerëse më e madhe dhe kjo gjë kthen ato në një treg mjaft të kërkuar nga marketerët.

Objektiva kryesore ne punim: Në fund kemi shqyrtuar tregun e kozmetikës, i cili është një treg mjaft i rëndësishëm për femrat. Kemi dhënë shembuj të disa kompanive të suksesshme të këtij tregu duke parë se si ato përpiqen të tërheqin gratë dhe të krijojnë një marrëdhënie afatgjatë me to. Gjithashtu kemi paraqitur se çfarë duhet të kenë parasysh marketerët kur u drejtohen tregut të grave. Duke hequr dorë nga synimi i turmës për të kuptuar dhe për të njohur blerëset e tyre më të mëdha.

Gratë kudo në botë kanë role të shumëfishta si nëna, gra, punonjëse, përgjegjëse të shëndetit dhe menaxhere të shtëpisë. Në dekadën që ne po jetojmë rreth një miliard gra po vazhdojnë të punojnë e të fitojnë (Silverstein & Sayre, What a Women Wont, 2008) ekonomikisht ato po sjellin ndryshime të rëndësishme në treg dhe në të gjithë botën. Shumë prioritete bien në kundërshtim me njëra-tjetrën pra: Jo vetëm se ka shumë gjëra në listën që duhet të bërë, por shumë nga to bien në konflikt se cila duhet bërë më para e cila më mbrapa.

1.2 Qellimi dhe rendesia e punimit shkencor:

Ndikimi ekonomik dhe politik i grave në sektorin privat dhe publik ka filluar që prej vitit 1940 ku për herë të parë gratë u larguan nga shtëpia për tju përgjigjur mungesës që u krijua nga largimi i shumë burrave në luftë por me kalimin e viteve gjërat filluan të ndryshojnë. Në vitin 2007 rregjistrimet e fundit tregojnë se për herë të parë në histori gratë e pamartuara e tejkalojnë numrin e grave të martuara në SHBA.

Këto të dhëna tregojnë qartë për një shpërndarje të grave nga varësia mashkullore dhe për një fuqizim të madh të tyre. Marrë në tërësi, të gjitha këto trende kanë prodhuar ndryshime sizmike si në shtëpi ashtu edhe në forcën e punës. Sot gratë janë ndoshta audiencia më e rëndësishme dhe forca më e madhe drejtuese.

XII INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE | KONFERENCA E XII-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE XII-ta NAUČNA MEDJUNARODNA KONFERENCIJA

Fuqia ekonomike e grave është në rritje. Një studim i kohëve të fundit nga Bordi i Rezerves Federale ka treguar se gratë kontrollojnë pak më shumë se gjysmën e të gjithë pasurisë personale në SHBA (51.3%). Por kjo është vetëm maja e ajzbergut. Ka të dhëna të sigurta se ky grup do të vazhdojë të rritet. Njeri prej treguesve është arsimimi. Sot më shumë gra së kurrë janë duke marrë arsim universitar. Gjatë 30 viteve të fundit të ardhurat e grave janë rritur më shumë se 60% ndërsa të ardhurat mesatare të meshkujve kanë qëndruar pak a shumë të njëjta. Ky fenomen tregon se ka asnjë shenjë rritëse.

Faktori i rritjes ekonomike nuk është e vetmja forcë e rëndësishme që gratë kanë. Shumë përfitime jo-ekonomike vijnë nga mbështetja dhe besnikeria e krijuar. Kur ju tregtoni për gratë, ju përfitoni nga mjete më të fuqishme të marketingut në botë: fjala e gojës. Shpërndarja e fjalës me anë të bashkëbisedimit është më e përhapur te femrat se te meshkujt pasi këta të fundit janë më të rezervuar. Gratë kur besojnë në një markë ato ndihmojnë që dhe të tjerët të besojnë duke përhapur fjalën e mirë në miq, familjare të afërm.

Nëpërmjet studimit të bërë ne do të përpiqemi të vërtetojmë rëndësinë e grave dhe pse bizneset duhet ta orientojnë marketingun drejt tyre.

Kjo do bëhet e mundur duke paraqitur faktet e ndryshimit dhe fuqizimit të gruas si dhe nëpërmjet pyetjeve kërkimore të tipit:

- *Pse duhet synuar tregu i grave?*
- *Çfarë i bën gratë një treg të vlefshëm?*
- *Pse blejnë gratë?*
- *Çfarë duhet të kenë parasysh marketerët kur i drejtohen grave?*

1.4 Metodologjia e përdorur në hulumtimin shkencor:

Studimi është zhvilluar mbi bazë të kërkimit sekondar. Duke qënë se punimi ka të bëjë me marrëdhënien e bizneseve me gratë në jemi bazuar kryesisht mbi literaturën që flet pikërisht për marrëdhënien e marketingut dhe të bizneseve me konsumatorin femër. Ndër to mund të përmendim: “Marketing to Women”-Marti Barletta, “Women Want More”- [M.Silverstein Katharine Sayre](#), “Just ask a Women”-Mary Lou Quinlan.

Si çdo kërkim dhe ky ka pasur probleme të shumta në mbledhjen e informacionit. Pjesa më e madhe është marrë dhe është përkthyer nga literatura e huaj pasi ishte e pamundur të gjeje një informacion zyrtar në gjuhën shqipe. Gjithashtu një tjetër problem i hasur gjatë punës është mungesa e informacioneve të rifreskuara për vitin aktual.

Gratë gjatë gjithë kohës kanë qënë duke luftuar me botën e meshkujve. Për të pasur të drejtat që meshkujt kanë, dhe të jenë të pavarura prej tyre. Kohët kanë ndryshuar, duke i bërë gratë shumë më të fuqishme edhe të afta për të patur të njëjtat të drejta si burrat. Gjatë dy shekujve të fundit gratë kanë treguar ndryshime në situata të reja dhe përmirësimin e rolve të tyre brenda shoqërisë. Për më tepër, roli i tyre është rritur (The role of women in our society has changed) me kalimin e kohës dhe sot ato janë të mbingarkuara me detyra dhe përgjegjësi të ndryshme. Së pari, në shekullin e 18-të gratë kishin shumë më pak të drejta nëse i krahasojmë me meshkujt. Gratë në përgjithësi ishin shtëpiake, merreshin me rritjen e fëmijëve dhe liheshin në mëshirën e burrit të tyre për tu mbajtur gjallë.

Një grua kishte vetëm mundësinë për të qënë një shërbëto e thjeshtë. Burrat i konsideronin gratë si qytetare të klasës së dytë dhe që nuk kishin asnjë të drejtë. Kjo situatë filloi të ndryshonte në shekullin e19-të sepse gratë u bashkuan për të luftuar me agresivitet për të drejtate tyre, diçka që gjithmonë është dukur sikur kishte zënë një vend të dytë në shoqëri. Së dyti, u deshën disa dekada që gratët të merrnin të drejtën e votës. Para të dyzetave grave nuk ju lejohej të votonin, vetëm meshkujt kishin këtë të drejtë. Kjo zgjati deri në vitin 1947, ku po në këtë vit u rregjistrua një amendament i Kushtetutës i cili i jepte të gjitha grave të drejtën e votës. Ato mund të zgjidhnin përfaqësuesin e tyre. Gratë zgjidhnin qeverinë e tyre, politikat e tyre dhe u lejuan të marrin pjesë në demokraci për herë të parë në jetë.

Gjithashtu në të njëjtin vit gratë filluan të luftojnë për të drejtat e tyre përsa i përket kushteve të punës. Shumë gra filluan të gjejnë mundësi punësimi në shumë fusha të ndryshme, kryesisht në sektorin e edukimit dhe infermierisë.

2. Analiza e punimit shkencor dhe studimi i literatures

Shumë prej nesh kanë parasysh ato rolet tradicionale në një familje ku burri shkon punon në zyrë ndërsa gruaja duhet të mbaj shtëpinë. Por kjo situatë tashmë ka ndryshuar. Në 2050 pritet që grate të përbëjnë mbi 47 % të fuqisë punëtore në Shtetet e Bashkuara ,ndryshe nga viti 1950 ku gratë kanë qënë 30 % e fuqisë punëtore megjithëse shumë ekspert thonë se në një kohë afat shkurtër numri i grave në fuqinë punëtore do e kaloj numrin e burrave. Kjo për arsye se në 2008-ën shumë punë dhe industri të dominuara nga burrat filluan të zhdukeshin si psh. puna e prodhimit.

Duke qënë se kohët kanë ndryshuar, rolet e burrave dhe grave janë më pak të përcaktuara. Mund të themi se këto ndryshime që kanë ndodhur e kanë rritur edhe më shumë rolin e gruas jo vetëm në familje por edhe në shoqëri e ekonomi.

Arsimimi është çelsi për krijimin e barazisë gjinore. Investimi në edukimin e grave do ishte një ndër investimet kryesore për vendet e varfra që duan zhvillimin. Në nivel makroekonomik arsimimi i gruas është i lidhur ngushtë me produktivitetin e lartë, kthim të lartë investimi etj. Ashtu si arsimi mbështet rritjen ekonomike edhe rritja ekonomike mbështet përmirsimet në arsim dhe shëndetësi. Shkollimi fillor dhe i mesëm njihen si çështjet themelore të ndryshimeve sociale dhe makro ekonomike. Më pak vëmendje shkon për shkollimin e lart i cili luan një rol kyç plotësues.

Si përmenda dhe më lart edukimi është një mjet i fuqishëm i reduktimit të pabarazisë midis gjinive. Ai mund të jap njerëzve aftësinë për të marrë në kontroll jetën e tyre. Gratë të cilat vazhdojnë të diskriminohen në shumë sfera të jetës kanë nevojë të veçantë për këtë mënyrë nxitje. Si ka cituar dhe fituesja e cmimit Nobel ne 2003 : “Një grua e arsimuar nuk do të mposhtet nga presionet e shumta që i shfaqen”.

Megjithëse sot ne jemi ende larg dhënies të së drejtës dhe shanseve të barabarta për edukimin e grave (Gender Statistics Manual, 2013) nëqoftëse i krahasojmë me mundësitë që meshkujt kanë. Në shumë shoqëri, familjet ende hezitojnë të dërgojnë vajzat e tyre në shkollë .Shpesh herë ato janë të parat që largohen nga shkolla në momentin e mos sigurimit të parave për edukimin e fëmijëve. Tekstet e përdorura në shkolla shpesh shërbejnë për të forcuar idenë tradicionale për gratë si nëna, amvsa dhe jo si persona aktive në jetën publike.

XII INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE | KONFERENCA E XII-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
XII-ta NAUČNA MEDJUNARODNA KONFERENCIJA

Edhe në ato shoqëri që çështja e barazisë në arsim nuk ka pasur shumë probleme, studentet femra ende priren të studiojnë ato degë që të çojnë në karriere me pagë më të ulët dhe me më pak status duke u krahasuar me meshkujt. Në tregun e punës gratë kanë ndërmarrë hapa të mëdha por ende nuk kanë mundur të arrijnë barazinë e plotë. Vajzat kanë tendencë të përparojnë më shumë se meshkujt në shkollë. Në shumicën e vendeve figuron se djemtë e përsërisin arsimin fillor më shumë se vajzat.

Në nivel global shohim se kemi një rritje si të shkallës së arsimimit ashtu edhe të barazisë gjinore këto 20 vitet e fundit. Shkalla e shkrim-leximit është rritur ndjeshëm krahasuar me vitet e mëparshme. Insituti i statistikave UNESCO-S ka nxjerrë të dhëna te reja mbi analfabetizmin dhe edukimin e të rinjve në Prill të vitit 2012. Në nivel rajonal normat e shkrim dhe leximit janë më të larta në Azinë Qendrore, Amerikën Latine, Karaibe, në Europën Qendrore dhe Lindore, Azinë lindore dhe Paqësorin. Niveli i shkollimit supozohet të jetë i lartë në Amerikën e Veriut dhe në Europën Perëndimore por nuk ka të dhëna të sakta në mënyrë që të bëhet e mundur llogaritja e një mesatareje rajonale. Normat më të ulta të arsimimit janë në shtetet Arabe, Azia Jugore dhe Perëndimore. Shkollimi i femrave globalisht është vlerësuar të jetë 80% në vitin 2010 duke u krahasuar me atë të burrave i cili shkonte 89%. Si rezultat gati 2/3 e popullsisë analfabete në vitin 2010 përbëhej nga gratë.

Rajoni	Shkalla e arsimit per te rriturve (%)			Shkalla e arsimit Per te rinjte (%)		
	Total	Meshkuj	Femra	Total	Meshkuj	Femra
Shtetet Arabe	74.7	83.3	65.7	89.1	92.4	85.6
Azia Qendrore	99.5	99.6	99.4	99.7	99.6	99.8
Europa Qendrore dhe Lindore	97.9	99.0	97.0	99.1	99.3	98.9
Azia Lindore dhe Paqësori	94.2	96.7	91.6	98.8	98.9	98.7
Amerila latine dhe Karaibet	91.4	92.1	90.7	97.2	97.0	97.4
Amerika e Veriut dhe Europa Perendimore	-	-	-	-	-	-
Azia Jug-Perendimore	62.7	74.0	51.8	80.5	86.6	74.7
Sub-Afrika	62.6	71.0	54.2	71.8	76.4	66.8
Bota	84.1	88.6	79.7	89.6	92.2	87.1

(UNESCO INSTITUTE FOR STATISTICS, 2012)


Prezenca e femrës në korporata të mëdha në botë, që është në rritje gjithnjë, është modeste nëse bëjmë krahasimin me suksesin e femrave si biznesmene dhe sipërmarrëse. Në vitin 2007, 40% e femrave zotëronin një firmë në Amerikë- në të cilat punësojnë 13 milion njerëz dhe gjenerojnë 1.7 trilion dollar me shitje. Bizneset që udhëhiqen nga femrat janë rritur gati dy herë në Amerikë në krahasim me bizneset që udhëhiqen nga meshkujt.

XII INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE | KONFERENCA E XII-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE XII-ta NAUČNA MEDJUNARODNA KONFERENCIJA

Femrat janë vazhdimisht në rritje në të gjithë botën (Gender and Development), duke kontribuar në të ardhurat familjare dhe rritjen e ekonomive kombëtare. Megjithatë, gratë përballen me shumë probleme si në kohë, kufizime njerëzore, fizike dhe sociale që kufizojnë aftësinë e tyre për bërë të mundur rritjen e bizneset të tyre. Po femrat sipërmarrëse po japin një kontribut të rëndësishëm në rritjen ekonomike dhe uljen e varfërisë në mbarë botën. Në SHBA gratë që kanë në pronësi firma po rriten gjithnjë e më shumë duke qenë përgjegjëse për 23 milione vende pune. Gjithashtu shihet një rritje e sipërmarrjes femërore në vendet e zhvilluara.

Femrat nuk synojnë të ardhura më të mëdha apo ndikohen nga ky fakt vetëm sepse dëshirojnë të fitojnë më shumë para. Ato përgjithsisht nuk janë akumulator të pasurisë apo të masin vetveten se sa fitojnë apo çfarë asetesh kanë. Sidoqoftë, paratë janë me rëndësi për femrat, fillimisht si markues të statusit të tyre dhe ndikimin në punët e shtëpisë. Kur femra i rrit të ardhurat financiare, kontribon në financat e shtëpisë dhe i kontrollon vet asetet e veta, ato janë më të fuqishme. Të gjitha femrat punojnë shumë për bilancin e parave në mes të shtëpisë dhe shpenzimeve të tjera dhe sa më shumë të fitojnë aq më të suksesshme janë në këtë detyrë. Paraja krijon edhe fleksibilitet tek femrat duke u mundësuar atyre të blejnë kohë shtesë.

Pavarisht progreseve të bëra gjatë dekadave të fundit për barazi gjinore dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në forcën punëtore, ende ka shumë për të bërë pasi problemi i barazisë vazhdon të ekzistoj dhe në ditët e sotme. Edhe pse shumë gra janë bërë sipërmarrëse të suksesshme ato ende janë të nënvlerësuara dhe jo shumë të përfaqësuara në bordet drejtuese në botë. Në botë gratë vazhdojnë të formojnë një shumicë të madhe të të punësuarve me të ardhura të ulta dhe që preken shpeshherë nga papunsia afatgjatë. Kjo vjen si pasojë e disavantazheve social-ekonomike të grave të shkaktuara nga diskriminimi me bazë gjinore.



(Employment rates by sex, 2011, 2012)

Sipas analizës së Institute Women Policy Researches (Institute for Women's Policy Researches, 2013) në raportin e punësimit të muajit Maj nga Byroja e statistikave të punës në SHBA numri i grave në tregun e punës është rritur ndjeshëm në muajin Prill në krahasim me muajin e mëparshëm. Ne 165.000 vende pune që ishin në total të shtuara nga aktivitetet e borderove, gratë fituan 117.000 vende pune (71%) ndërsa burrat 48.000 vende pune (29%).

Fuqizimi ekonomik i grave në të gjithë botën e pasur është një nga revolucionet më të rëndësishme të 50 viteve të fundit (Female power, 2009). Kjo është e rëndësishme për shkak të shtrirjes së madhe të ndryshimeve ku miliona gra të cilët dikur ishin të varura nga burrat kanë marrë kontrollin e tyre ekonomik, si dhe të fateve të tyre. Prirja e rritjes së grave në tregun e punës është pothuajse e sigurt për të vazhduar. Në Bashkimin Evropian gratë kanë plotësuar 6 milion prej 8 milion vende pune të reja të krijuara që nga viti 2000. Në Amerikë tre nga katër njerëz të hequr nga puna që nga fillimi i recesionit janë meshkuj. Shkalla e papunësisë tek femrat është 8.6%, kundrejt 11.2% që është papunësia e burrave.

Goldman Sachs llogarit që (Female power, 2009), duke lënë të gjitha gjërat e tjera të barabarta, duke rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës do të rritet GDP me 21% në Itali, 19% në Spanjë, 16% në Japoni, 9% në Amerikë, Franca dhe Gjermania, dhe 8% në Britani.

Nëkëto 3-4 dekada studimi e dallimeve mes grave dhe burrave. Shumë gjera janë mësuar, por shumë pak ka ndryshuar në lidhje me mënyrën se si "sistemi mashkull" dominon botën e biznesit. Gjinia është përcaktuesi më i fuqishëm se si një person e sheh botën dhe çdo gjë në të. Ky përcaktues është më i fuqishëm se raca, mosha, të ardhurat etj. Një gjë tjetër që ka ndryshuar këto tre dekadat e fundit, janë të gjitha faktet rreth roleve gjinore, fuqizimi i gruas, normat e diplomimit në kolegji, pjesëmarrjen në forcën e punës, shpenzimet e konsumatorëve, etj.

PSE DUHET SYNUAR TREGU I GRAVE?

Femrat përbejnë rreth 85% të gjithë blerjeve konsumatore duke filluar nga tregu I automobilave deri te kujdesi shëndetësor (She Economy). Gratë përbëjnë rreth 65% të konsumatorve për veshje, 52% të konsumatorve për blerjen e automjeteve te reja duke përfshirë këtu edhe 80% e ndikimit që ato kanë te të tjerët në këtë treg. Ato gjithashtu përbëjnë (Branding, Marketing ,Social) 45% të blerjeve të konsumit të produkteve elektronike, ato ndërmarrin rreth 80% të vendimeve rreth kujdesit shëndetësor për familjen,70% të vendimeve të udhëtimit,90% marrin pjesë në vendimet e investimeve, të sigurimit të daljes në pension.

Globalisht gratë kontrollojnë rreth 20 trilion \$ në shpenzime vjetore (Silverstein & Sayre, The Female Economy). Kjo shifer mund të shkojë në 28 trilion \$ në pesë vitet e ardhshme. Duke pasur parasysh këto shifra do të ishte qesharake injorimi apo nënvleresimi I konsumatoreve femra.

Femrat po kontrollojnë ekonominë (Silverstein & Sayre, Women Wont More, 2008), në këto kohë ato kanë më shumë para në portofolet e tyre dhe shumicën e tyre ato i kanë fituar vet. Në tërësi, femrat që punojnë në tërë botën fitojnë rreth 12 trilion dollar nga pagat. Punonjese femra në Amerikë fitojnë rreth 4.3 trilion dollar nga ky 12 trilionësh. Tre në dhjetë femra që punojnë (29%) fitojnë shumicën apo të gjithë të ardhurat në një familje dhe gjashtë nga dhjetë (62%) fitojnë rreth gjysmën e të ardhurave të familjes. Në ekonominë e zhvilluara, 40% e femrave kontrollojnë 91 nga 100% shpenzimet shtëpiake. Femrat në Amerikë kanë ndikim më të madh në fitimin dhe konsumin e të ardhurave-më shumë se 72% e fitimit total të familjes janë të kontrolluara nga femra.


Të kuptosh arsyen se pse një grua blen është hapi I parë dhe më i rëndësishëm për të rritur biznesin tënd. Pothuajse në çdo shoqëri në botë gratë janë përgjegjëset kryesore për fëmijët, të moshuarit ndaj ato shpeshherë blejnë në emër të të tjerëve. Lista është e gjatë nëqoftëse në përfshijmë bashkëshortin, fëmijët, miqtë, të afermit, prindërit e moshuar. Nëse dikush ka nevojë për një dhuatë propabiliteti që një grua ta ndihmojë për ta zgjedhur atë është shumë I lartë.

Femrat duan shumë.

Ato duan barazi, pjesëmarrje (Silverstein & Sayre, Women Wont More, 2008), shanse dhe drejtësi në vend të punës dhe shoqëri. Ato duan ndjeshmëri, mirekuptim, lidhje, shëndet, dashuri, siguri dhe lumturi. Ato duan që ti dëgjosh nevojat qe ajo ka. Ato duan që të kuptoni se si realisht i konsumojnë produktet apo shërbimet. Ato duan që ju të merrni parasysh pakënaqësitë e tyre. Ato duan një prodhim të ri që zhvillohet të orientohet drejt nevojave të tanishme dhe të dukshme. Ato duan që ju ta kuptoni që ato janë pjesë e një shoqërie punëtore të fuqishme dhe janë makina komunikuese shume te mira. Kjo do të thotë se ato tregojnë shumë për atributet e ndryshme të produkteve dhe shërbimeve,në mënyrë konstante dhe të përsëritshme.

Ato duan që ju të kuptoni se gratë kanë para për ti shpenzuar në mallra që ofrojnë vlera dhe kuptim si dhe kursejnë kohën por jo në produkte që janë stereotipe dhe që nuk kuptojnë nevojat e femrave. Ato duan që ju të dini që grate marrin shumë seriozisht çështjen e kohës dhe mungesës së saj. Ato duan që ju me anë të produkteve/sherbimeve që shisni të kujdeseni për jetën e përditshme, nevojat dhe dëshirat, shpresat dhe ëndërrat e tyre . Ato duan të i pyesni, ashtu si ne se : ” Çfare duan femrat” ?

Nëse gratë ndalojnë së menduari në këtë mënyre, shumë industri do të rrezoheshin brenda natës kjo sepse gratë shërbejnë si një port për të gjithë të tjerët. Çdoherë që ju ofroni një shërbim cilësor te një grua ajo ka efekt shumëfishues ne biznesin tuaj pasi ajo grua përfaqson një gamë të gjerë të konsumatoreve të tjerë të mundshëm. Ajo ka shumë mundësi tu tregojë të tjerëve për shërbimin cilësor qe ajo ka marre nga ju.




ÇFARË DUHET TË KENË PARASYSH MARKETIERËT KUR I DREJTOHEN GRAVE?

Kompanitë të cilat i kuptojnë femrat nuk fokusohen më tek popullata si një e tërë, por tek segmente të vecanta dhe tek nevojat e këtyre segmenteve. Për t’i kuptuar vërtetë femrat dhe për të shfrytëzuar mundësinë e ekonomisë femërore kompanitë ndjekin të ashtuquajturat katër R (Silverstein & Sayre, What a Women Wont, 2008) njohja (recognize), kërkimi (research), reagueshmëria (respond) dhe përmirësimi (refine).

Më poshtë jepen përkufizimet dhe cfarë kuptohet me katër R:

Njohja (recognize) – Kompanitë e fokusuar tek femrat njohin/kuptojnë se femrat kërkojnë të mira dhe shërbime që kursejnë kohë, ofrojnë vlerë, ofrojnë rehati, janë të shëndetshme, dhe janë të përgjegjshme për ambientin dhe shoqërinë. Ata njohin rëndësinë dhe influencën e femrave; kënaqësitë dhe pakënaqësitë e femrave;


kënaqësitë dhe tensionin në jetën e femrave; rolin që luajnë të mirat dhe shërbimet në jetën e grave; karakteristikat që kërkojnë gratë në të mirat dhe shërbimet.



Kërkimi (research) – Kompanitë e përqëndruara tek femrat zhvillojnë kërkime gjithëpërfshirëse. Ato dëgjojnë, kuptojnë ndjenjat e fermave, dhe u përgjigjen ëndrrave të grave për veten e tyre dhe për familjet e tyre. Kërkimet i zhvillojnë nëpërmjet: të dëgjuarit intensiv; analizës dhe kuptueshmërisë; analizës së produkteve dhe shërbimeve aktuale

Reagueshmëria (respond) – Kompanitë që kuptojnë gratë reagojnë ndaj asaj që mësojnë nga kërkimi duke ofruar zgjidhje të thjeshta dhe të drejtpërdrejta që cojnë në kursimin e kohës që duan femrat së bashku me përfitimet emocinale që kërkojnë femrat. Këto kompani komunikojnë me femrat në mënyrë që të krijojnë dhe ndërtojnë një marrëdhënie besimi. Kompanitë reagojnë nëpërmjet: dizenjimit dhe zhvillimit; testimit; përmirësimit dhe rafinimit; përshtatja ndaj segmenteve; të qenurit autentik dhe empatik; bërja e investimeve të guximshme.

Përmirësimi (refine) – Kompanitë që tërheqin gratë vazhdimisht përmirësojnë produktet dhe shërbimet për t’iu përgjigjur kërkimeve të reja, ndryshimit të gjendjeve, zhvendosjes së ndjeshmërisë. Linjat e produktit të këtyre kompanive nuk ndalen, këto kompani kërkojnë vazhdimisht përmirësime në dizeno, materiale dhe aplikacione, dhe për mënyra si të kursejnë kohën e përdoruesëve. Kompanitë reagojnë duke: kuptuar tregun; tregtimin; zhvillimin e ekspozimeve tërheqëse; komunikim autentik dhe josterotip; krijimin e komuniteteve.



Shembulli më tipik për të ilustruar suksesin e katër R-ve është ai i Westin Hotels & Resorts (WHR).

WHR kuptoi rëndësinë që kanë gratë si konsumatore dhe politikat e tyre u orientuan drejt përbushjes së nevojave të femrave. WHR pasi realizoi kërkime gjithëpërfshirëse kuptoi se femrat kërkonin ambiente të rehatshme, ushqim të shëndetshëm, mundësi për t'u stërvitur dhe mbi të gjitha një natë të qetë gjumi. Kështu që WHR e fokusoi kërkimin në gjetjen e shtretërve dhe dyshekëve që do të mundësonin relaksin e klientëve.

Hedhja në treg e krevatëve të rinj, “shtretërit qiellorë” coi në një përmirësim prej 5% të indeksit të kënaqësisë së klientëve në hotele. WHR e vazhdoi suksesin e “shtretërve qiellorë” duke zhvilluar më tej shërbimet për të ofruar shëndet dhe mirëqenie në kontekstin e hotelerisë. Banjat dhe palestrat ishin zhvillimet e mëvonëshme të cilat plotësonin nevojat e klienteve për pastërti dhe privatësi.

KONKLUZIONE

- Sfida më e madhe për marketerët sot është indiferenca e grave ndaj markave të tyre. Shumë marketer thonë se ata janë duke synuar të targetojnë gra dhe po e njohin rëndësinë që ato kanë, pasi janë ato që vendosin për shumicën e blerjeve. Por problemi i tyre më i madh është se ata mendojnë se të bësh marketing për gratë do të thotë ta pikturosh në rozë markën tënde. Është e rëndësishme të kuptohet se gratë duan gjithçka që duan meshkujt, thjesht ato duan më shumë.
- Për tu kuptuar dhe më qartë fuqia që gratë kanë në biznese cdo regjistrim në kompani për shitje produkti duhet të bëhet në bazë të gjinisë. Në këtë mënyrë çdo kompani do të kuptojë dhe do të njohë blerësin e produkteve të saj.
- Kompanitë duhet të dinë të përdorin përfitimet e 4R-ve (recognise, research, respond and refine) duke njohur dëshirat dhe pakënaqësitë e grave. Për tu ofruar atyre atë çfarë ato duan.

- Kompanitë duhet të dinë të shfrytëzojnë aftësinë shumëfishuese dhe besnikërinë që gratë kanë ndaj markave. Duke u përpjekur të tërheqë sa më shumë konsumatore femra për të rritur shitjet e tyre duke i përdorur ato si agjente shitjesh të pa paguara.

REKOMANDIME

- Kompanitë duhet të kenë parasysh se gratë gjatë gjithë ditës bombardohen nga mesazhe marketingu. Për këtë arsye duhet të jenë të kujdesshëm për krijimin e një mesazhi të thjesht, atraktiv dhe informues në mënyrë që të kenë vëmendjen e grave.
- Kompanitë duhet të bëjnë një fushatë marketingu të thjeshtë për tu kuptuar me personazhe reale dhe ngjarje të besueshme, duke pasur parasysh stresin e madh që gratë kanë gjatë ditës ato duan dikë që ta mbushi ditën e tyre dhe jo dikë që ta komplikoj më keq atë.
- Gratë ashtu si janë degjuese të mira gjithashtu duan dikë që ti dëgjoj. Kompanitë duhet të dëgjojnë kërkesat që ato kanë dhe të përpiqen ti plotësojnë ato. Në këtë mënyrë gratë krijojnë lidhje emocionale me kompaninë pasi shohin dikë që kujdeset për to.

Bibliografia:

- Barletta, M. (2003). *Marketing to Women*. Dearborn Trade Publishing.
- Branding, Marketing ,Social. (n.d.). Retrieved from Purchasing Power of Women:
<http://jamiedunham.com/stats-on-women/>
- Brennan, B. (2013, March 21). why women shop more than men. Retrieved June 10, 2013, from network of executive women: <http://www.newonline.org/news/120022/Why-women-shop-more-than-men-and-why-that-matters.htm>
- Clark, M. (2011, October). *Divine Cartolin*. Retrieved June 10, 2013, from Six Facts about Women in the Workforce: <http://www.divinecaroline.com/life-etc/career-money/six-facts-about-women-workforce>
- Closing the Gender Gap. (2012). Retrieved Jun 10, 2013, from OECD:
<http://www.oecd.org/gender/Executive%20Summary.pdf>
- Dockus, K., & Design, D. R. (n.d.). *Diversity Biznes*. Retrieved June 15, 2013, from What Women Wont:
<http://www.diversitybusiness.com/news/diversity.magazine/99200829.asp>
- Employment rates by sex, 2011. (2012, October 30). Retrieved June 2, 2013, from Eurostat:
[http://epp.eurostat.ec.europa.eu/statistics_explained/index.php?title=File:Employment_rates_by_sex,_2011_\(1\)_\(%25\).png&filetimestamp=20121030182958](http://epp.eurostat.ec.europa.eu/statistics_explained/index.php?title=File:Employment_rates_by_sex,_2011_(1)_(%25).png&filetimestamp=20121030182958)
- Female power. (2009). *The Economist* .
- Gender and Development. (n.d.). Retrieved May 29, 2013, from The World Bank:
<http://go.worldbank.org/UI27QY1330>
- Gender Statistics Manual. (2013, May). Retrieved June 10, 2013, from
<http://unstats.un.org/unsd/genderstatmanual/Educational-participation.ashx>
- Institute for Women's Policy Researches. (2013, April). Retrieved June 10, 2013, from Job Growth Slows for Both Women and Men.
- She Economy. (n.d.). Retrieved May 20, 2013, from <http://www.she-economy.com/facts-on-women>
- Silverstein, M. J., & Sayre, K. (n.d.). *The Female Economy*. Retrieved June 10, 2013, from
<http://news.curves.com/images/20003/HBR%20The%20Female%20Economy.pdf>
- Silverstein, M. J., & Sayre, K. (2008). *What a Women Wont*. New York: Harper .
- Silverstein, M. J., & Sayre, K. (2008). *Women Wont More*.
- Sneha. (2012, August 27). *BoldSky limitless living*. Retrieved June 5, 2013, from
<http://www.boldsky.com/insync/pulse/2012/women-spend-shopping-030666.html>
- Splash. (n.d.). Retrieved June 10, 2013, from <http://www.splashgroup.com.au/why-market-to-women>
- The role of women in our society has changed. (n.d.). Retrieved June 2, 2013, from girls inc:
<http://www.girlsinc.org/news/archives/role-of-women-society.html>
- UNESCO INSTITUTE FOR STATISTICS. (2012, April). Retrieved May 30, 2013, from International Education Statistics: <http://huebler.blogspot.com/2012/05/literacy.html>

FORTIFIKIMI I DRAGOSTUNJËS FORTIFICATION OF DRAGOSTUNJA

Ervin Kujtila

Doktorant: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti Arkeologjik, Tiranë.

Menaxher i guidave turistike Divjaka Resort, Divjakë.

Abstract

Prehistoric fortified settlements are known in Albania since the Bronze Age, from the North to the South. Shkumbini Valley is an area that has been inhabited since the early periods. Over the years 2013-2019, I have done surveys on some of the prehistoric fortifications, such as in Dragostunjë, Orenjë, Zdranjshë, collecting plenty of archeological material of archaeology of the plenty of, which gives us the opportunity to date the exact period, to which the fortification belongs, as well as the role it has played. I have a presentation of Dragostunja's fortification in this study, which, along with other fortifications of the Shkumbin Valley, represents a very advanced fortifying system of our country. The study is part of the doctoral studies I am attending at the Academy of Albanology Studies, Institute of Archaeology, Tirana, on the subject of "*Prehistoric Fortifications along the Shkumbin Valley*". Together with my Doctoral Thesis leader, Prof. Dr. Adem Bunguri, we conducted an archaeological survey at the Dragostunja fortification during 2018. The main objectives of the survey were:

- Chronological assessment of the fortifying system;
- Clarification of the planning type of the fortified settlements;
- Relevation and fortification planning.

This fortification has a planning that is similar to that of other fortifications located in the Shkumbin Valley, but also in Albania. It has the shape of a pressed ellipse. The line of the **prehistoric wall follows the ground, closing the paths, which one could climb. Within the** prehistoric wall there is another wall that belongs to late antiquity. Although we did not manage to obtain any of the intended material, the survey fully clarified the character of this fortification. Based on the elements available, we think this fortification belongs to the Kalivo phase. The fortification has served to protect local population.

Key words: Archaeology, fortification, Bronze Age, archaeological survey, prehistoric, antiquity.

Abstrakt

Në Shqipëri vendbanimet e fortifikuara prehistorike njihen që nga epoka e bronzit, duke filluar nga veriu deri në jug. Lugina e Shkumbinit është një zonë e cila ka qenë banuar që në periudhat e hershme, këtë e dëshmojnë edhe materialet e grumbulluara përgjatë gjithë luginës. Gjatë viteve 2013-2019 kam bërë sondazhe në disa nga fortifikimet prehistorike, si në: Dragostunjë, Orenjë, Zdranjshë duke grumbulluar një material arkeologjik të

XII INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE | KONFERENCA E XII-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
XII-ta NAUČNA MEDJUNARODNA KONFERENCIJA

bollshëm, i cili na jep mundësi ta datojmë saktë periudhën së cilës i përket fortifikimi, por edhe roli që ka luajtur. Në këtë studim kam për një prezantim të fortifikimit të Dragostunjës, i cili bashkë me fortifikimet e tjera të luginës së Shkumbinit përbën një sistem shumë të avancuar fortifikues të vendit tonë. Studimi është pjesë e studimeve doktrale që po ndjek në Akademinë e Studimeve Albanologjike, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë, me temë “Fortifikimet Prehistorike Përgjatë Luginës së Shkumbinit”. Gjatë vitit 2018 bashkë me udhëheqësin e temës së doktoraturës Prof. Dr Adem Bungurin realizuam një sondazh arkeologjik në fortifikimin e Dragostunjës. Synimet kryesore të sondazhit ishin:

- Vlerësimi kronologjik i sistemit fortifikues;
- Sqarimi i tipit planimetrik të vendbanimeve të fortifikuara;
- Realizimin e rievimit dhe planimetrisë së fortifikimit.

Ky fortifikim ka një planimetri të ngjashme me fortifikimet e tjera që ndodhen në luginën e Shkumbinit por edhe në Shqipëri. Ajo është në formë eliptike e shtypur. Linja e murit prehistorik ndjek terrenin duke mbyllur mirë shtigjet ku mund të ngjiteshe. Brenda murit prehistorik vihet re një mur tjetër që i përket antikitetit të vonë. Edhe pse nuk përfituam material të periudhës që synonim sondazhi sqarojë plotësisht karakterin e këtij fortifikimi. Duke u mbështetur në elementët që kemi mendojmë që ky fortifikim i përket fazës Kalivo. Fortifikimi ka pasur funksion mbrojtës për popullsinë vendase. I gjithë informacioni i grumbulluar është dokumentuar në institucionet përkatëse.

Fjalë kyçe: Arkeologji, fortifikim, epoka e bronzit, survei arkeologjik, prehistori.

Në një distancë rreth dy km larg rrugës automobilistike, në drejtim të kundërt të rrjedhës së përroit të Dragostunjës, ndodhet fortifikimi i Dragostunjës. Ai është e vendosur mbi një kodër në verilindje të fshatit që mban të njëjtin emër, (midis tij dhe fshatit Hotolisht),. Nga vendasit aty pranë kodra njihet me emrin “Kodra e Pazares”.



Fig.1 Pamje e fortifikimit të Dragostunjës.

Pikërisht në këtë majë që nuk është e vështirë për ta lokalizuar janë zbuluar rrënojat e mureve të fortifikimit. Ashtu si edhe shumë fortifikime të tjera të kësaj zone, ai zë një pozitë shumë strategjike e cila bën të mundur kontrollimin e gjithë zonës përreth. Nuk është aspak e vështirë që nga aty mund të kontrollosh me shumë lehtësi gjithë zonën

dhe madje me hapësirën që ka në drejtim të jugut nuk është aspak e vështirë që mund të shohësh edhe Gurin e Skëndërbeut, i cili ndodhet në Spathar.




Fig.2 Rilevim topografik dhe ciccë planimetrie e fortifikimit të Dragostunjës

Në këtë fortifikim vihet re një trakt muri i ndërtuar me blloqe gurësh të papunuar të vendosur në të thatë pa ndonjë mjet lidhës. Muri rrethon pjesën lindore dhe jug – lindore, me disa shkëputje. Ndërsa periudha e dytë e ndërtimit, duket edhe më e qartë, dhe është e bërë me gurë mesatarë që kanë dimensione 0,50 x 0,30 m.; 0,25 x 0,20 m. etj. Ndryshe nga pjesa e parë të ky mur është përdorur mjet lidhës (llaç e gëlqere). Në disa vende, lartësia e murit të ruajtur arrin deri në 1 m., ndërsa gjatësia e tij rreth 12 m.



Fig. 3 (Pamje jugore e linjës së murit prehistorik)

Në sipërfaqen brenda murit të kalasë janë gjetur mjaft fragmente qeramike si vegja, buzë e parete enësh, të cilat janë të zbukuruara me vija e tufa vijash të valëzuara të kohës antike të vonë¹²⁷.



Fig. 4 (Pamje e fasadës së murit prehistorik)



Fig. 5 (Pamje e fasadës së murit antik)

¹²⁷ KOKA 1985, 254.



Fig. 6 (Pamje e fasadës së murit antik)

Pas një vëzhgimi sipërfaqësor vendosëm që sondazhin ta hapim në pjesën perëndimore të fortifikimit, konkretisht brenda akropolit. Sondazhi u vendos aty sepse terreni ishte më i përshtatshëm qoftë për depozitimin e materialit arkeologjik, por edhe sepse aty kishte një pjesë toke e cila nuk kishte gur apo shkëmb. Përmasat e kuadratisë morëm 2x2 m.

Shtresa e parë US. 01 përbëhej nga dhe kafe i errët me një përbërje shumë të lartë të humusit, përshkak të bimësisë që kishte aty, dhe gjithashtu me rrënjë shumë nga shkurret që ndodheshin aty pranë, bushi ishte bima e cila mbushte me rrënjë të gjithë kuadratin e sondazhit që po gërmonim.



Fig. 7 (Pamje veriore US. 01 e sondazhit I)

Thellësia maksimale e sondazhit në US. 01 arriti 0.8 m në jug – lindje, dhe ajo minimale 0.3 m në veri – perëndim. Në njësinë e parë stratigrafike, hasëm edhe shumë gurë të vegjël dhe mesatarë, të cilët e bënë gërmimin edhe

më të vështirë. Përsa i përket materialit arkeologjik, u zbluan një numur i konsiderueshëm por që i përkiste periudhës së antikitetit të vonë. Parete enësh, buzë, si dhe fragmente tjegullash ishte materiali që u zbulua, gjithashtu edhe një thikë e vogël.

Pas përfundimit të njësisë stratigrafike US. 01, filluam me një njësi të re stratigrafike. Duke qenë se edhe karakteristikat ndryshuan, dhe bëhej me nga kafe i errët në të hapur, përshkak se mungonte humusi. Kishim një prezencë më të vogël të rrënjëve të bimëve, dhe një numur më të madh të gurëve qoftë atyre mesatarë por edhe të mëdhenj. Thellësia maksimale arriti në 1 m, në jug – lindje dhe ajo minimale në 0.45 m, në veri – perëndim. Ashtu si në njësinë tjetër edhe këtu kishim gjetje por që i përkasin periudhës së antikitetit të vonë. Fragmente tjegullash ishin 26 copë, parete të imëta 27 copë, parete vegjë, pjesë enësh 9 copë.



Fig. 8 (Pamje veriore US. 02 e sondazhit I)

Ndryshimi i ngjyrës së dheut filloj sërish duket u bërë nga kafe i errët në shumë të hapur, madje me nuance të kuqe tulle, kështu që ndryshuam sërish njësinë stratigrafike. Duke e emërtuar US. 03. Thellësia në njësinë e fundit arri konkretisht në: veri – perëndim 1.1 m, veri – lindje 1.3 m, në jug – perëndim 1.2 m; në jug – lindje 1.5 m. Ashtu si dy njësitë e tjera edhe këtu kishim gjetje të njëjtës natyrë, duke filluar nga parete, 3 tjegulla, buzë enësh dhe vegje, të cilat i përkasin antikitetit të vonë. Në tabanin e sondazhit ndeshëm një shkëmb natyror i cili zinte pothuajse gjysmën e kuadrantit, i cili përfundonte në dhe steril, pa gjetje. Ngjyra e dheut nga kafe e errët u bë në të kuqe tullë.



Fig.9 (Pamje lindore US. 03 e sondazhit I)

Meqenës arritëm në tabanin e sondazhit nuk vazhduam më tej. Në këtë njësi hasëm edhe me një numur shumë të madh të gurësh mesatarë dhe të mëdhenj, të cilët edhe i thyem për ti nxjerrë nga sondzhi. Pas përfundimit të sondazhit pastruam edhe një herë profilin për të parë qartë njësitë stratigrafike dhe në foto duken qartë nga përbërja dhe ngjyra e dheut.



Fig. 10 (Profili i përgjithshëm lindor i sondazhit I)

Ky sondazh nuk na dha material prehistorik i cili do na jepte një tablo të qartë të funksionit të këtij fortifikimi, por edhe të periudhës në të cilin është ndërtuar. Por nga ana tjetër ekzistenca e materialit që i përket antikitetit të vonë na bën të mendojmë për vazhdimësinë që ky fortifikim ka patur në periudhat e më vonshme.






Fig. 11 (Pamje e tabanit i sondazhit I)

Fig. 12 (Profili i përgjithshëm lindor i sondazhit I)

Sondazhi i realizuar në fortifikimin e Dragostunjës nuk dha material arkeologjik të periudhës prehistorike, por vetëm material të periudhës së antikitetit të vonë.

TAB. I



Dragostunjë

Fig. 13 (Tabela I)




Fig. 14 (Tabela II)

Përfundime:

Sondazhi i realizuar në vitin 2018 në Drgostunjë edhe pse nuk na dha material arkeologjik, në një farë mënyrë na dha informacion për karakterin e këtij fortifikimi. Ky fortifikim mendohet që ka shërbyer si një qendër strehimi në rast rreziku të jashtëm, jo vetëm në periudhën prehistorike por edhe gjatë antikitetit të vonë, fakt ky që e dëshmon edhe materiaku arkeologjik i antikitetit të vonë që është zbuluar dhe që unë e kam paraqitur në tabelat e më poshtëme, I dhe II.

Muri rrethues prehistorik ndjek linjën e kreshtës ashtu sikurse është karakteristikë për këto fortifikime dhe mendohet që ky fortifikim ka shërbyer si pikë vrojtuese e luginës së Shkumbinit si arterie kryesore që lidhte viset perëndimore me ato lindore që në lashtësi.

Bibliografia

1. KOKA Aristotel – *Kontribut për hartën arkeologjike të Librazhdit*, “ Almanak ”, 1, Librazhd, 1985.
2. CEKA Neritan, *Vështrim arkeologjik në rrethin e Elbasanit*, Monumentet, 3, 1972.
3. CEKA, Neritan – PAPAJANI, Lazër, (*Rruga e luginës së Shkumbinit në antikitet*), "Studia Albanica", 1972, 1
4. CEKA, Neritan, - PAPAJANI, Lllazar, *Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike*. "Monumentet" 1971, 1.
5. ISLAMI, Selim, *Ilirët dhe Iliria tek Autorët Antikë*. Burime të Zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, vëll. I.
6. KARAIKAJ Gj, *Fortifikimet e periudhës së parë të hekurit në pellgun e Korçës*, Kuvendi I i Studimeve Ilire, 1974 I.
7. KOKA, ARISTOTEL, *Kontribut për hartën arkeologjike të rrethit të Librazhdit*, Almanak 1, Librazhd 1985.
8. KOKA, Aristotel, *Disa vendbanime të lashta në rrethin e Librazhdit*, "Iliria", 1981, 1, f. 245-254, 3 fig., 2 tab.
9. PAPAJANI, ADRIAN, *Ndihmesë për hartën arkeologjike të rrethit të Librazhdit*, "Iliria", 1991, 1-2, f. 243-247, 1 tab.
10. PAPAJANI, Lazër, - CEKA, Neritan, (*Rruga e luginës së Shkumbinit në antikitet*), "Studia Albanica", 1972, 1, pp. 85-106, 2 pl., 12 fig.
11. PAPAJANI, Lazër, s/v nr. 145. *Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike*. "Monumentet" 1971, 1, f. 43-59. Res. Fr.
12. SHTYLLA, VALTER, PAPAJANI, LAZAR, *Të dhëna teknike mbi rrugën e luginës së Shkumbinit në antikitet dhe mesjetë*, "Monumentet", 1990, 1, f. 57-73, 31 fig.

**PADENJËSIA DHE HEQJA DORË NGA TRASHËGIMIA, DY KONCEPTE TË
TRASHËGIMISË NË SISTEMIN CIVIL LAW, TRAJTUAR NË NJË
KËNDVËSHTRIM KRAHASUES
*‘INHERITANCE AND ABANDONMENT OF HERITAGE, TWO CONCEPTS OF
INHERITANCE IN THE CIVIL LAW SYSTEM, TREATED FROM A COMPARATIVE
POINT OF VIEW’***

Xhuana Abazi

Florida Arrinaj

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Abstracti

Through this paper, we have tried to address Ignorance and the Abandonment of Heritage, in a comparative perspective within the Civil Law system. The methodology used is comparative, analyzing and then comparing the notion of unworthiness in different systems. The object of comparison is related to the unworthiness and renunciation of the inheritance in the framework of the larger systems of law by highlighting the similarities and peculiarities that these systems carry. Given the high variety of rights that will be taken for comparison, this comparison takes on a sociological character, more precisely, it is about legal ethnology. In order to be a real comparison and to achieve the desired goal, it is necessary to consider the elements of comparison from historical bases, with cultural and social data and legal techniques, highlighting the most appropriate method for our comparison, to understand whether the changes and similarities we encounter are due to the effect of the origin of the rights or whether they use the same legal techniques.

Abstracti

Jemi përpjekur që me anën e këtij punimi të trajtojmë Padenjësinë dhe Heqjen Dorë nga Trashëgimia, në një këndvështrim krahasues përbrenda sistemit Civil Law. Metodologjia e përdorur është ajo krahasuese, duke analizuar dhe me pas krahasuar nocionin e padenjesise ne sisteme te ndyshme. Objekti i krahasimit ka të bëjë me padenjësinë dhe heqjen dorë nga trashëgimia në kuadrin e sistemeve më të mëdha të së drejtes duke evidentuar ngjashmëritë dhe të veçantat që këto sisteme mbartin. Nisur nga shumëllojshmëria e lartë e të drejtave që do të merren për krahasim, ky krahasim merr karakter sociologjik, më saktë, bëhet fjale për etnologjinë juridike. Që të

jetë një krahasim i mirefilltë dhe që nga kjo të arrijmë qëllimin që dëshirojmë është e nevojshme të marrim në konsideratë elementet e krahasimit që nga bazat historike, me të dhënat kulturore dhe shoqërore dhe teknikat juridike duke evidentuar metoden me të përshtashme për krahasimin tonë, që të kuptojmë nëse ndryshimet dhe ngjashmëritë që hasim janë për efekt të origjinës së të drejtave apo nëse përdorin të njëjtat teknika juridike.

Hyrje

Ndalimi për të trashëguar për shkak të qënies së trashëgimitarit si i padenjë, shihet në dy pikëpamje të ndryshme. Sipas njërës, padenësia ka të bëjë me statusin juridik të personit (në këtë rast të trashëgimitarit) dhe e ndjek atë kudo. Në rast se një person, në bazë të ligjit të tij personal, do të deklarohej i padenjë, ai duhet të konsiderohet i tillë kudo. Këtu është fjala për dispozita që rregullojnë evolucionin e pasurisë trashëgimore dhe prandaj duhet që padenësia të rregullohet nga ligji që zbatohet për trashëgiminë. Një konfirmim të kësaj e gjejmë dhe në faktin se trashëgimlënësi mundet që ta falë trashëgimitarin me akt noterial ose testament, gjë që nuk do të ishte e mundur në rast se padenësia do të kishte të bënte me statusin personal të trashëgimitarit. Aspekt i rëndësishëm i insitutit të trashëgimisë është renoncimi ku sipas legjislacionit civil shqiptarë ka kuptimin: që trashëgimlënësi ka të drejtë të heqë dorë nga trashëgimia që i vjen në trashëgim. E drejta për të renoncuar një pasuri trashëgimore, ushtrohet pasi të jetë çelur pasuria trashëgimore. E drejta për të renoncuar nga pasuria që të vjen në trashëgim nuk prezumohet, kjo është një panoramë e përgjithshme mbi konceptin e Heqjes dorë nga trashëgimi. Ajo çka do të trajtohet në vazhdimësi është se si legjislacione të ndryshme rregullojnë padenësinë dhe heqjen dorë nga trashëgimia në kuadër të insitutit të trashëgimisë. Renoncimi përfaqëson shprehjen e një vullneti të lirë për të mos marrë pjesë në trashëgimin qoftë luigjore apo testamentare.

Krahasimi i Kodit Civil Francez, Rus, Italian dhe Gjerman, përsa i përket vetëm dispozitave që rregullojnë pjesën e padenjësisë dhe heqjes dorë nga trashëgimia.

Pavarësisht se në shumicën e rasteve kur kemi të bëjmë me krahasime për baze merret e drejta franceze, kjo për faktin që e drejta franceze është një nga të drejtat më të hershme që ka ruajtur trajtën deri në ditën e sotme. Por në rastin tonë krahasimi do të ketë karakter shumpalësh sepse do të krahasohen midis tyre shumë të drejta të huaja dhe e drejta franceze¹²⁸ është një e drejtë midis të drejtave të tjera.

Së pari në planin krahasimor do të marrim të drejtën franceze meqë kjo e drejtë për nga karakteristikat qëndron më lart, kodi civil francez është kodi më i lashtë dhe unik në përdorim që iu ka rezistuar koherave dhe ndërrimeve të sistemeve qeverisëse. Në trajtimin që i është bërë padenjësisë¹²⁹ dhe heqjes dorë nga kodi francez veçori

¹²⁸ Kodi civil Francez shquhet për karakteristikat e tij të aspektit historik dhe natyrës së rregullimit ligjor. Ai është një kod dyqind vjeçar, i cili hyri në fuqi më 21 Mars 1804.

¹²⁹ Më konkretisht Padenësia është e trajtuar në Artikullin 726 deri në artikullin 729-Në **Art.726** është parashikuar që *“Janë të padenjë e trashëguar dhe, si i tillë, duhet të përjashtohet nga trashëgimi : 1 ° Njëri i cili është i dënuar, si kryesor ose bashkëfajtorë, me një dënim të rëndë për të pasur dhënë qëllimisht ose tentuar për të dhënë vdekjen për të vdekur; 2 ° Njëri i cili është i dënuar, si kryesor ose bashkëfajtorë, me një dënim të rëndë për të paturit ushtruar goditje qëllimisht në ose ka ushtruar dhunë e apo sulmi që ka provokuar vdekjen e të ndjerit pa qëllim e duke shkakuar atë”*.

dalluese nga kodi italian¹³⁰, gjerman dhe rus është fakti që shkak i padenjesisë është me konkret dhe për plotësimin e tij nuk është e nevojshme për të referuar në dispozita të tjera apo ligje të tjera, pasi është shprehur qartë që janë *...të përjashtuar nga trashëgimi personat që janë dënuar për vrasjen apo për tentativën për vrasje të trashëgimlënësit...* kjo dispozitë është parashikur në mënyrë me të thatë nga legjislacionet e tjera si nga kodi italian, gjerman dhe rus në të cilin shprehet që *...të përjashtuar nga trashëgimi janë personat që kanë vrarë apo tëntuar të vrasin trashëgimlënësin...që kanë ushtruar dhunë fizike apo psikike ndaj trashëgimlënësit...* pra evidentohet qartazi fakti se në kodin italian¹³¹, gjerman dhe rus është e nevojshme të referohet në ndonjë dispozitë tjetër që të plotësohet kuptimi i kësaj dispozite dhe që të shpallet i padenjësishëm e nevojshme që të vërtetohet me një vendim gjykatës apo nga institucioni përkatës që personi të ketë vrarë apo tentuar të vrasë si dhe të ketë ushtruar dhunë ndaj trashëgimlënësit.

Përsa i përket dispozitave të tjera kemi ngjashmëri në trajtimin që i bëhet pjesë tjetër të padenjesisë. Të gjitha kodet që kemi trajtuar më sipër kanë pranur që është trashëgimlënësi që merr inisiativën për të shpallur trashëgimtarin e padenjësishëm dhe kjo mund të bëhet me anë të një deklarate të bërë nga trashëgimlënësi përpara një noteri ose mund ta parashikojë një gjë të tillë në testament.

Një pikë tjetër takimi mes këtyre kodeve është moskufizimi i fëmijëve të personit të shpallur të padenjësishëm për të marr pjesë në trashëgim si dhe parashikimi në dispozitat e tyre insitutin e faljes. Pavaresisht nga origjina dhe marrëdhëniet shoqërore që pasqyron kodi francez, italian¹³², gjerman dhe rus karakterizohen nga një frymë humanë mbështetëse dhe vënë theksin mbi personin duke ruajtur vlerat e tij. Mos përjashtimi i fëmijëve të personit që është shpallur i padenjësishëm bëhet që të mos iu hiqet e drejta e shejtë për të trashëguar fëmijëve nga veprimet e padrejta dhe abuzuese të prindërve të tyre. Dhe në të kundërt, parashikimi i insitutit të faljes nga ana e këtyre legjislacioneve e ka fillin tek marrëdhëniet familjare dhe të gjakut që e karakterizojnë insitutin e trashëgimise, në veçanti të asaj ligjore. Dhe nisur nga këto marrëdhënie trashëgimlënësi, duke qënë prindi i trashëgimtarëve në rastin më klasik

¹³⁰ E drejta Italiane ka një histori e cila identifikohet në fillim me historinë e të drejtës romake e cila ka qënë njëkohësisht edhe e drejta italiane eshe e drejta e vendeve të pushtuara nga Roma, si Franca, Belgjika, Holanda ,si dhe pjesët e Rinit dhe Bavarisë në Gjermani .Për këtë arsye historia e vërtetë e së drejtës italiane fillon pas rnies së perandorisë Romake të Përendimit dhe me pushtimin e e gadishullit Italian nga gjermaniket. Përsa i përket drejtësisë ajo është e ndërtuar mbi modelin e drejtësisë franceze,drejtësia italiane ka një hirearki të zakonshme dhe një hirearki administrative ,e cila ka në krye Këshillin e Shtetit

¹³¹ Në **nenin 463** citohet që : *“Eshte i përjashtuar nga trahegimia si i padenjësishëm:*

1) ato të cilët me dashje e ka vrarë ose ka tentuar të vrasë personin i cilit i është trashëgimtarë, ose, bashkëshortit ose një pasardhës, ose një ngjitje atë, me kusht që nuk ndodhë ndonjë prej shkaqeve të cilat e bëjnë përgjegjës ndaj ndëshkimit sipas ligjit penal;

2) ata që kanë kryer, në dëm të njërit prej këtyre njerëzve, një fakt për të cilin ligji deklaron vrasjen dispozita;

3) ata të cilët kanë denoncuar ndonjë këta persona për vepra të dënueshme me burgim të përjetshëm ose me burgim për një periudhë jo më pak se minimumi prej tre vjetësh, nëse ankesa është deklaruar shpifës në procedurë penale, ose nëse ka dëshmuar kundër atyre personave të akuzuar prej këtyre veprave penale, qoftë dëshmitar ishte shpallur kundër tij, false në procedurën penale;

4), i cili ka shkaktuar me dashje ,dhunë ndaj personit të cilit i është patundshme, për të bërë, të revokojë ose të ndryshojë vullnetin, ose ajo ka penguar;

5) ata të cilët kanë ndrydhur, fshehur ose ka ndryshuar vullnetin e vazhdimësisë nga e cila do të qeverisur;

6), i cili ka formuar një testament të rreme ose ka qënë me pa vetëdije të ekzistencës së tij.”

¹³² Në **nenin 466** dhe të fundit është parashikuar insituti i faljes apo siç quhet ndryshe në kodin civil italian rehabilitimi i të padenjësishëm dhe sanksionohet që: *”Kush eshte i padenjësishëm e lejuar të trashëgoje vetem kur trashëgimlënësi e ka shprehur vullnetariht në testament apo me nje akt publik Megjithatë, i padenjësishëm i hprehur jo në mënyrë të qartë, në qoftë se ajo është e përcaktuar në testamentin e tij, kur trashëgimlënësi dinte shkakun i jodinjitet është e lejuar të ndodhë brenda kufijve të disponim*

ai mund ta ketë të mundur që ta ushtrojë të drejtën e faljes ndaj trashëgimtarit dhe pas kësaj ai mund të trashëgojë pasurinë trashëgimore në masën që atij i takon.

Në kodin rus në lidhje me padenjësinë konstatojmë një veçori që deri tani nuk e kemi hasur ne kodet që kemi trajtuar më sipër, pikërisht është parashikimi i kompensimit nga ana e trashëgimtrit të shpallur të padenjë ndaj personit që ka kryer detyrimin e parashikuar ne testamentin që ka lënë testatori dhe që citohet *Nëse objekt i një besimi me testament ishte performanca e punës të caktuar ose ofrimi i një shërbimi të caktuar ndaj një përfituesi të padenjë, përfituesi do të rimbursojë trashëgimtarin që ka shpenzuar për vlerën e punës apo shërbimit të kryer për përfituesin padenjë*. Kjo është një metodë e re për të vendosur ne vend një të drejtë të shkelur apo për të parandaluar përfitimin e padrejtë të disa të mirave dhe shërbimeve, por mbi të gjitha ajo që duhet të theksojmë që kjo është një karakteristikë e veçantë për kodin civil rus.

Në trajtimin që i bëhet heqjes dorë nga trashëgimia vërejmë një ndryshim përse i përket formulimit dhe trajtimit që i bëhet vetë konceptit. Në kodin francez, duke qënë se ka sistemin e pranimit, këtë e barazon me konceptin e heqjes dorë, ku nëse trashëgimtari nuk e pranon trashëgimin në afatin e përcaktuar në kod ai prezumohet që ka hequr dorë nga trashëgimia pra është një trajtim më i komplikuar. Ndërsa në kodin italian, gjerman dhe rus kemi përdorimin e konceptit të mohimit të trashëgimisë në vend të përdorimit të heqjes dorë nga trashëgimi por një gjë e tillë nuk do të thotë që nuk përmendet. Në kodin rus shpesh përdoret koncepti i dhuratës në vend të përdorimit të konceptit të pasurisë trashëgimore apo trashëgimin, kjo është një veçori e kodit civil rus që mendoj se e ka prejardhjen nga ndryshimet që i janë bërë here pas here këtij kodi si pasojë e ndërrimit të sistemeve qeverisëse¹³³.

Është për tu përmendur një aspekt tjetër që evidentohet në kodin civil rus por që nuk është parashikuar në kodin francez, italian dhe gjerman pavarësisht frymës përendimore që kanë, ajo që parashikohet është dhënia e mundësisë trashëgimtarit që ka humbur afatin për të ushtruar të drejtën për të hequr dorë për tui drejtuar gjykatës në mënyrë që të rivendoset në afat kur arsyet i ka të përligjura.

Konkluzione

Parashikimi i disa dispozitave në kodin civil rus të ndryshme nga ato te kodeve civile franceze, italiane apo gjërmane vjen nga fakti që ky kod është i ndërtuar nën frymen e kulturës lindore të rregullimit të mardhenieve shoqërore në përgjithësi dhe asaj të trashëgimisë në veçanti, por pavarësisht kësaj karakterizohet nga një frymë demokratike dhe moderne. Tek heqja dore nga trashëgimi pavarësisht ndryshimeve që kanë në trajtimin e saj kodet gjejnë pika takimi ndërmjet tyre në trajtimin që i bëhet mënyrës së ushtrimit të kësaj të drejte. Si në kodin francez, italian, gjerman dhe rus që akti i heqjes dore të jetë i vlefshëm duhet të bëhet më një akt publik që ka kuptimin e aktit noterial nga vete trashëgimtari si dhe mund të bëhet nga trashëgimtari me një deklaratë përpara gjykatës. Afatet Brenda të cilave do të hiqet dore nuk janë të trajtuara në mënyrë të njëjtë nga kodet civile, vetëm kodi francez parashikon afatin 3 mujor dhe 6 mujor ndërsa ai italian dhe gjerman i referohen afatit të përgjithshëm ku për ta konkretizuar referojnë në dispozita të tjera. Ndërsa ne kodin rus janë parashikuar afate të shkurtra ,afate gjashtë javorë dhe tre mujore por në kuptimin e përgjithshëm të gjitha kodet i japin karakterin decadent afateve pavarësisht mënyrës se parashikimit të tyre ,pasi mos ushtrimi në afat të caktuar humbet të drejten për ta ushtruar

¹³³ Michel Fromond, Sistemet e Huaja më të Mëdha të së Drejtës, Ppirus 2009 faqe 55-58

atë më pas. Nga ajo që trajtuam më sipër arritëm të evidentojme rastet kur legjislacionet largohen nga njëra tjetra dhe rastet kur ato gjejnë pika kontakti gjithmonë në kuadër të padenjësish dhe heqjes dorë nga trashëgimia.

Po ti referohemi mënyrës se si trajtohen nga legjislacionet e huaja këto dy instrumenta verej që sidomos heqja dore nga trashëgimia ndryshon si koncept ,ai ndryshe emërtohet si instrumenti i pranimit. Ajo çka unë sugjeroj që në përberjen e dispozitave mbi heqjen dore te trashëgimisë është parashkimi i një dispozite mbi vendosjen e insitutit të rivendosjes në afat që në rasti kur trashëgimtari për arsye të përligjura nuk ka arritur ta ushtrojë këtë të drejtë në afatin ëe caktuar në ligj ai të mund ti drejtohet gjykatës me qëllim për tu vendosur përsëri në afat që të ushtrojë të drejtën e heqjes dore. Gjithashtu në lidhje me padenjësinë sugjeroj që dispozita e parë në të cilën jepet shkaku i shpalljes së personit të padenjë ,të bëhet me konkrete dhe e plote , pra që të plotësohet të mos jetë e nevojshme që të referojë ne dispozita të tjera por të parashikohet koncepti i dënimit në këto dispozita pra të parashikohet që .. *të përjashtuar nga trashëgimi personat që janë dënuar për vrasjen apo për tentativën për vrasje të trashëgimlënësi...*siç vërehet kjo është me konkrete dhe e plotë. Nëpërmjet një vështrimi krahasimor në këndvështrimin e sistemeve më të mëdha të së drejtës me jep idenë e rëndësisë që kanë këta instrumente në vendet e zhvilluar dhe se si ndikojnë në kuadrin e insitutit të trashëgimisë, insitut që është i ndryshëm në vende të ndryshme.

Bibliografia

Literatura shqiptare

Nazmi Biçoku,”E Drejta e Trashigimisë e Republikës së Shqipërisë” , Tiranë ,ALBPaper, 2011

N.Papuli,”Mjetet ligjore të trashigimtarit për realizimin e së drejtës së tij trashigimore”,Drejtësia Popullore,viti 1957,Nr.4

N.Biçoku”Mbi Trashigimine ligjore”Drejtësia popullore,viti 1954,Nr.1

Valentina Kondilli “E Drejtë Civile II” Pjesa Posaçme, Tiranë, Geer, 2008

Nazmi Biçaku, ” E drejta e Trashëgimisë e RSH” Onufri 1997, Tiranë

Arta Mandro “ E Drejta Romake”, Tiranë, Emal, 2007

Ardian Nuni dhe Luan Hasneziri, “Leksione të së Drejtës së Trashëgimisë”, Tirane, 2006

Agim Tartari, “Shkrime Juridike”, Albpaper, Tiranë 2008,

A.Sallabanda”Mbi Trashigiminë”Drejtësia Popullore,viti 1972,Nr.4

K.Koci”Disa çështje kryesore lidhur me insitutin e trashigimisë në shoqërinë tone”Drejtësia Popullore ,viti 1972,Nr4

Prof.Asoc.Dr.Ardian Nuni,Luan Hasneziri(MA)”Leksione të së drejtës së Trashigimisë “Tiranë 2007

Juliana Latifi, “E Drejta Civile Trashëgimia”, Tiranë, Geer, 2007 fq. 36

Abdullah Aliu, “E Drejtë Civile”, Tiranë, Albpaper,

Hilmi Dakli,Trashëgimia dhe Qiraja,Enti botues “Liria”Tiranë 1997

Sami Omari”E Drejta Familjare,botim Tiranë 2008

Ardian Nuni & Luan Hasneziri, “E Drejta Civile III” Trashëgimia , Tiranë, 2010

Michel Fromond, Sistemet e Huaja më të Mëdha të së Drejtës, Ppirus 2009

Literatura e huaj

Françesko Galgano ,E Drejta Private ,Botimi I, Shblsh Luarasi ,Tiranë 1999

Andre Borkowski dhe Paul du Plessis “ E Drejta Romake”, Tiranë, Dita 2000

Legjislacion

Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare 1929

Kodi Civil i RSH vitit 1981 neni 97

Kodi Civil i RSH Botim i Qendrës Së Publikimeve Zyrtare vitit 1994

Kodit Civil i RSH Botim i Qendrës Së Botimeve Zyrtare Maj 2009

Kodi i Proçedures Civile Qëshor, 2010

Kodi Civil Italian

Kodi Civil Gjerman, Libri 5, E drejta e suksesimit, Ndarja 2, Titulli 1, Pranimi dhe Heqja Dore nga Trashegimia seksioni 1943

Jurisprudenca

Vendimi i Gjykatës së Lartë (Kol.Civ.) Nr 905, datë 7.8.1952

Vendimi i Gjykatës së Lartë (Kol.Civ.) Nr.1284, datë 20.11.1953

Vendimi datë 17.11.1978, Drejtësia Popullore, viti 1979, Nr.1

Vendimi Nr 49, datë 22.7.1966, Drejtësia Popullore, Viti 1966, Nr,5 faqe 102

Vendimi I datës 14.7.1975, Drejtësia Popullore ,viti 1979, Nr 2

Vendimi Nr 24 date 13.03.2002 I kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Larte.

Udhëzim i Plenumit të Gjykatës së Lartë, Nr.3, datë 17.10.1977, Drejtësia Popullore, viti 1977, Nr.4,

Udhëzim i Plenumit të Gjykatës së lartë ,Nr3 datë 26.11.1953, Buletini Gjykatës së Lartë ,Nr.7

**AUTONOMIA E QEVERISJES VENDORE. DECENTRALIZIMI I PUSHTETEVE NË
KUADËR TË REFORMËS SË RE ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**
*AUTONOMY OF LOCAL GOVERNMENT. DECENTRALIZATION OF POWERS IN
THE FRAMEWORK OF THE NEW ADMINISTRATIVE-TERRITORIAL REFORM IN
THE REPUBLIC OF ALBANIA*

Florida Arrinaj

Xhuana Abazi

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Fakulteti i Drejtësisë

Abstract:

This paper will address the topic of local government autonomy, decentralization of power in the framework of the new administrative-territorial reform in the Republic of Albania, launched in 2014. The study aims at a brief theoretical-practical analysis of the principles of autonomy and decentralization of powers as extremely important principles, sanctioned by the Constitution of the Republic of Albania, as the basic and most important source of our domestic law and also by the European Charter of Local Autonomy, which was adopted in 1985 and entered into force in 1988. It continues with Law No. 8652, dated 31.7.2000 "On the Organization and Functioning of Local Government" and other laws that accompanied the current reform of local government, Law No. 115/2014

"On Separation Administrative-Territorial Units of Local Government Units in the Republic of Albania "; Law no. 139/2015 "On Local Self-Government" and Law no. 68/2017 "On Local Self-Government Finances", which will be analyzed in the continuation of this paper. We will focus on the concepts of decentralization and its types, which include deconcentration, delegation, and transfer. Also, autonomy in administrative, political and financial terms are other points analyzed in this paper. Also, regarding the evaluation of the implementation in practice and how much the new territorial-administrative reform has yielded so far, we will refer to the Report on Local Government in the Republic of Albania, prepared by the Association of Municipalities of Albania.

Keywords: local autonomy, decentralization of powers, administrative-territorial reform, European Charter of Local Autonomy

Send feedback

History

Saved

Community

Abstrakt:

Në këtë punim do të trajtohet tema e autonomisë së qeverisjes vendore, decentralizimi i pushteteve në kuadër të reformës së re administrative-territoriale në Republikën e Shqipërisë, e nisur në vitin 2014. Studimi synon një analizim të shkurtër teoriko-praktik të parimeve të autonomisë dhe decentralizimit të pushteteve si parime tejet të rëndësishme, të sanksionuara edhe nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si burimi bazë e më i rëndësishëm i të drejtës tonë të brendshme dhe po ashtu nga Karta Evropiane e Autonomisë vendore, e cila u miratua në vitin 1985 dhe hyri në fuqi në vitin 1988. Vijon më tej me ligjin Nr.8652, Dt 31.7.2000 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore" dhe ligjet e tjera që shoqëruan reformën aktuale të qeverisjes vendore, Ligji Nr.115/2014 "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë"; Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe Ligji Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", të cilat do të analizohen në vijim të këtij punimi. Do ndalemi tek konceptet e decentralizimit dhe llojeve të tij, që përfshijnë dekoncentrimin, delegimin dhe transferimin. Po ashtu, autonomia në aspektin administrativ, politik dhe financiar janë pika të tjera të analizuara në këtë punim. Gjithashtu, sa i përket vlerësimit të zbatimit në praktikë dhe sa ka dhënë rezultat deri tani reforma e re territoriale-administrative, do i referohemi Raportit mbi qeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë, të përgatitur nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë.

Fjalë kyçe: *autonomi vendore, decentralizim i pushteteve, reformë administrative-territoriale, Karta Evropiane e Autonomisë Vendore*

Hyrje

Të marrësh në diskutim qeverisjen vendore do të thotë të ndalësh në trajtimin e shumë çështjeve që janë vendimtare për mbarëvajtjen e shtetit dhe të demokracisë së tij. Shteti, veprimtarinë e tij të përditshme ekzekutive-

urdhërdhënëse nuk mund ta kryejë vetëm nëpërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe për këtë arsye, për më tepër efikasitet dhe rezultate, si pjesë e organeve të administratës publike, krahas organeve të pushtetit qendror janë ngritur dhe funksionojnë edhe organet e pushtetit vendor. Kjo bën pjesë edhe në të ashtuquajturën pushtet vertikal, që nënkupton raportin ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor. Shtetet, gjatë rrjedhës së historisë, që nga krijimi dhe konsolidimi i tyre e deri në ditët e sotme, njohin plot reforma politike të karakterit territorial-administrativ. Sistemi i organeve administrative të pushtetit vendor ngrihet dhe funksionon në bazë të parimit të ndarjes tokësore administrative të shtetit dhe kjo ndarje bëhet në bazë të disa elementëve me karakter material, ekonomik, politik, social etj.

E gjithë Evropa prej vitesh është përfshirë në reforma territoriale dhe këto në shumicën e vendeve erdhën si pasojë e krizave financiare dhe kërkesave gjithmonë në rritje për shërbime dhe ekonomi shkalle, por gjithashtu edhe tendencës drejt një qeverisje vendore sa më efektive e të qëndrueshme.

Çështja kryesore e ndarjes vertikale të pushtetit ka lidhje, siç u cek edhe më sipër, me raportin ndërmjet pushtetit normativ qendror dhe atij vendor, ku pushteti normativ ndahet sipas dy modelesh: unitar dhe pluralist, ku sipas modelit unitar ekziston vetëm një qendër e vendim-marrjes politike, ndërsa sipas modelit pluralist, pushteti qendror bashkëndon me organet e pushtetit vendor, pushtetin e tij normativ. Nëse i referohemi rastit të vendit tonë, Republika e Shqipërisë bën pjesë tek modeli unitar i decentralizuar, çka do të thotë që bëhet një ndarje e pushtetit normativ ndërmjet shtetit në nivel qendror dhe autoriteteve lokale. Ky raport ka ndryshuar gjatë viteve, por synimi i të gjitha reformave të viteve të fundit ka qenë arritja e një decentralizimi të mirëfilltë.

Koncepti i autonomisë dhe decentralizimit të pushteteve

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, qeverisja vendore ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore. Ajo është e organizuar në dy nivele. Bashkitë janë njësi bazë e qeverisjes vendore që përfaqësojnë edhe nivelin e parë të qeverisjes, ndërsa qarqet janë njësi të nivelit të dytë. Me qëllim përmirësimit të qeverisjes vendore dhe arritjen e një efikasiteti më të lartë të punës së organeve të qeverisjes vendore për arritjen e një niveli më të kënaqshëm në ofrimin e shërbimeve publike për komunitetin, për reduktim të shpenzimeve të tepërta administrative dhe me qëllim arritjen e një standarti më të lartë, çka do të thotë favorizim në integrimin e vendit në Bashkimin Evropian, Shqipëria, në vitin 2014, ndërmori iniciativën për një reformim të pushtetit vendor. Kjo reformë kishte për qëllim sistemimin e territoreve nëpër kufij të ri administrativ, me qëllim arritjen e një decentralizimi real.

Nëse i referohemi historikut të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, ajo para viteve '90 ishte një qeverisje e kontrolluar, me organe të kufizuara vetëqeverisëse, ndërsa pas viteve '90 qeverisja vendore mund të themi se ka kaluar në tre faza. Faza e parë 1992-2000 me Ligjin organik nr. 7572 i vitit 1992. Gjatë kësaj periudhe

kishim 314 komuna, 44 bashki dhe 36 rrethe. Në këtë fazë, decentralizimi fiskal dhe reformat ekonomike qëndrojnë në disavantazh përkundrejt atij politik.

Faza e dytë i përket viteve 2000-2015 me Ligjin organik nr. 8652 të vitit 2000. Kjo periudhë nisi me zhvillimin e rëndësishëm të ratifikimit të Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore në 1999. Statusi i pushtetit vendor filloi të ndryshonte dhe me hartimin dhe miratimin e Kushtetutës së re të Shqipërisë. Sipas Kushtetutës, Shqipëria është shtet unitar me dy nivele të pushtetit vendor: bashkia/komuna në nivelin e parë dhe qarku në një nivel më të lartë. Pushteti vendor në Shqipëri bazohet në parimin e decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore. Në këtë periudhë kishim 308 komuna, 65 bashki dhe 12 qarqe.

Faza e tretë i përket periudhës 2015 dhe aktualisht, pra periudhës së zbatimit të reformës territoriale me Ligjin 139/2015, periudhë në të cilën kemi 61 bashki.¹³⁴

Kontribut të vecantë kanë pasur programet dhe projektet e donatorëve strategjikë, paketa ndihmëse e të cilave ka pasur dhe vazhdon të ketë një vlerë të madhe për demokracinë dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe është plotësuese e boshllëkut dhe e pamunësisë për t'u ofruar nga ana e vetë shtetit.

Decentralizimi dhe llojet e tij

Reforma e decentralizimit ka përparuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve 1999 dhe 2000, duke u bazuar te Kushtetuta (1998) si burimi bazë dhe me i rëndësishëm i të drejtës tonë të brendshme; Karta Evropiane e Autonomisë Vendore, e cila është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr.8548, date 11.11.1999 dhe Strategjia Kombëtare e Decentralizimit, e miratuar në 1999. Hapi specifik më i rëndësishëm ishte miratimi dhe zbatimi i Ligjit Nr. 8652, 31.07. 2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, që sanksionon të drejtat dhe kompetencat e njësive të qeverisjes vendore në përputhje me Kushtetutën dhe Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore dhe që u pasua nga ligje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e qeverisjes vendore dhe konsolidimin e autonomisë.

Ndërsa aktualisht flasim për një reformë të re territoriale, e cila është në sfidat e implementimit gjithnjë e më efikas në praktikë, duke sjellë ndikime pozitive në zhvillimin lokal dhe kombëtar.

Decentralizimi është një term i gjerë, një proces, ku autoriteti dhe përgjegjësia për funksione të caktuara transferohet nga pushteti qëndror në njësitë e qeverisjes vendore. Në themel të decentralizimit qëndron parimi i subsidiaritetit, sipas të cilit “ushtrimi i përgjegjësive publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t’i takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve”. Kjo mund të përfshijë përgjegjësinë për planifikimin dhe menaxhimin e funksioneve të qeverisë, duke përfshirë rritjen dhe alokimin e burimeve.

Decentralizimin e shohim në aspektin politik, administrativ dhe financiar, të cilët ndërveprojnë ndërmjet tyre dhe për më tepër përfaqësojnë në thelb tre komponentët e pushtetit.

¹³⁴ Qeverisja vendore ne RSH. Raport mbi situaten aktuale. Tiranw 2019. Publikim i pwrgatitur nga Shoqata e Bashkive tw Shqipwrisw.

Nëse i referohemi decentralizimit administrativ, ai ka të bëjë me transferimin e pronave apo pasurive dhe funksioneve të qeverisjes nga niveli qendror për tek nivelet vendore, ku ky transferim përfshin autoritetin, pushtetin, funksionet, resurset dhe përgjegjësitë.

Decentralizimi mund të realizohet në tre forma:

- Dekoncentrimi si transferim i burimeve, përgjegjësi dhe autoritetit brenda një institucioni apo administrate qendrore. Ai e transferon pushtetin nga zyrat qendrore për tek zyrat periferike të të njëjtës strukturë administrative qendrore, ose e transferon përgjegjësinë në njësitë e administratës vendore që janë pjesë e strukturës së qeverisjes qendrore. Drejtimi, orientimi dhe vendimarrja, në thelb është e administratës qendrore. Megjithatë kjo lejon një lloj diskrecioni të zyrtarëve në zyrat vendore, të vendosin pa u referuar në çdo kohë tek zyra qendrore, por duke vendosur në bazë të një tërësie rregullash të përbashkëta. Të tilla janë drejtoritë arsimore apo shëndetësore të ngritura në çdo qark.

Në Republikën e Shqipërisë organet e dekoncentruara në nivel vendor (rajonale/lokal) përfaqësohen nga dy institucione: prefekti dhe drejtoritë/zyrat rajonale/lokale të ministrive të linjës. Roli i prefektit është të sigurojë mbikëqyrje të ligjshmërisë mbi veprimtarinë e qeverisjes vendore në emër të qeverisë qendrore. Roli i prefektit është rritur gjatë viteve dhe po konsolidohet më tej. Megjithatë, roli i tij si ndërmjetës për të siguruar bashkëpunimin ndërinstytucional nuk është i përcaktuar qartë në ligjin për Prefektin. Prefekti duket i pafuqishëm edhe kur ka marrëveshje dhe përgjegjësi të ndërthurura mes institucioneve të dekoncentruara të pushtetit qendror dhe njësive të qeverisjes vendore. Ai nuk ka legjitimitetin për të adresuar çështjet e koordinimit në aspektin ligjor dhe institucional, vetëm nëse institucionet e bazuar në nivel vendor funksionojnë në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta. Është e nevojshme të ndërmerren përmirësime ligjore për të përcaktuar një rol të qartë të prefektit, në dritën e dispozitave të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore. Zyrat rajonale/vendore të dekoncentruara, ose të ashtuquajturat “drejtoritë me varësi vertikale” janë krijuar nga disa ministri të linjës, të tilla si: arsimit, shëndetësisë, punës dhe çështjet sociale, bujqësisë, mjedisi etj., në çdo qark, dhe/ose qendra të ish-rretheve me funksionin për të menaxhuar zbatimin e politikave sektoriale në nivel vendor. Këto struktura veprojnë në nivel vendor, por janë plotësisht të varura nga ministrinë e linjës përkatëse. Bashkëpunimi ndërmjet organeve të dekoncentruara dhe njësive të qeverisjes vendore është rritur gjatë viteve të fundit, por shpesh ka mbivendosje të kompetencave apo pasiguri në fusha të ndryshme, në veçanti në lidhje me zbatimin e funksioneve të përbashkëta. Sektorë të tillë janë arsimit, mjedisi, shërbimet sociale, etj.

Ndarja e re territoriale do të sjellë rishikimin e shpërndarjes së organeve të dekoncentruara në nivel vendor dhe alokimin më të mirë të funksioneve midis këtyre organeve dhe njësive të qeverisjes vendore përfshirë bashkërendimin ndërinstytucional.¹³⁵ Por a janë realizuar gjitha këto nga reforma deri tani?

- Transferimi është forma më radikale e decentralizimit dhe ka të bëjë me transferimin e përgjegjësi dhe autoritetit vendimmarrës nga pushteti qendror tek pushteti vendor, ku këto pushtete dhe organet përkatëse të tyre nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore janë institucione krejtësisht të pavarura dhe legjitime dhe përfaqësojnë nivele të ndryshme të qeverisjes. Është një nga format e decentralizimit që njihen sot në botë dhe është mënyra se si është realizuar decentralizimi në Shqipëri.

¹³⁵ Strategjia Ndwrsektoriale pwr decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020

- Delegimi, si formë e decentralizimit që e dërgon përgjegjësinë dhe autoritetin në kryerjen e funksioneve të caktuara në institucione ose agjenci shtetërore ose gjysëm autonome të vendosura në nivel lokal. Kjo nënkupton një nivel kontrolli të lartë nga zyra qendrore në atë vendore (zyrat e gjendjes civile). Kjo e drejtë është e përcaktuar me ligj si e drejtë e organeve më të larta për të kaluar atributet e ushtrimit të pushtetit të tyre tek organet më të ulëta në shkallë hierarkie, brenda sistemit përkatës shtetëror. Me Ligjin për Qeverisjen Vendore, pushteti qëndror mund të delegojë kompetenca të vetat tek Pushteti vendor.

Koncepti i autonomisë vendore

Edhe parimi i autonomisë vendore na jepet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Karta Evropiane e Autonomisë Vendore, Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" etj.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 13 përcakton se: "*qeverisja vendore në RSH ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore*".

Ligji nr. 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore, përcakton se *Autonomia vendore* është e drejta dhe aftësia e njësisë të vetëqeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë.

Ndërsa Karta Evropiane e Autonomisë Vendore e përcakton autonominë vendore si të drejtën dhe aftësinë efektive të bashkësive vendore për të rregulluar e për të drejtuar, brenda ligjit, nën përgjegjësinë e tyre dhe në të mirë të popullsisë të tyre, një pjesë të mirë të çështjeve publike. Ku me "*aftësi*" kuptohet që e drejta ligjore për të rregulluar dhe menaxhuar çështje të caktuara publike duhet të shoqërohet me mjetet që e bëjnë të mundur realizimin efektiv të tyre. Përfshirja e shprehjes "brënda kufijve ligjorë" njeh faktin se kjo e drejtë dhe aftësi mund të përcaktohen më nga afër nga legjislacioni. "*Nën përgjegjësinë e tyre*" thekson që organet vendore nuk duhet të jenë të kufizuara vetëm në të vepruarin si agjentë të organeve më të larta. Është e pamundur të përcaktohen ekzaktësisht se çfarë çështjesh, organet vendore kanë të drejtë të trajtojnë dhe të menaxhojnë. Shprehje të tilla si "çështjet vendore" ose "çështjet e veta" janë kundërshtuar si shumë të përgjithshme dhe shumë të vështira për t'u interpretuar. Traditat e shteteve anëtare në lidhje me çështjet që konsiderohen se u përkasin organeve vendore janë shumë të ndryshme. Në fakt, pjesa më e madhe e çështjeve kanë implikime edhe vendore edhe kombëtare, dhe përgjegjësia rreth tyre mund të ndryshojë nga njëri vend në tjetrin, dhe njëra kohë në tjetrën, dhe madje kjo përgjegjësi edhe mund të ndahet ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Të kufizuarit e organeve vendore tek çështje të cilat nuk kanë ndikime më të gjëra, do të rrezikonte uljen e statusit të tyre, duke i lidhur organet vendore me një rol skajor. Nga ana tjetër, është pranuar që shtetet dëshirojnë të mbajnë funksione të caktuara për vete, si për shembull sigurinë kombëtare. Synimi i Kartës është që organet vendore të kenë një gamë të gjerë përgjegjësisë, të cilat mund të realizohen në nivelin vendor.¹³⁶

Karta vijon me tej duke përcaktuar se kompetencat bazë të bashkësisë vendore caktohen nga Kushtetuta ose nga ligji. Megjithatë kjo dispozitë nuk i pengon bashkësitë vendore të marrin kompetenca me qëllime të posaçme, në përputhje me ligjin. Bashkësitë vendore gëzojnë, brenda ligjit, liri të plotë për të ushtruar iniciativën e tyre për

¹³⁶ Karta Evropiane e Autonomisë Vendore

çdo çështje që nuk është jashtë kompetencës së tyre apo që mund t'i ketë kaluar një autoriteti tjetër. Ushtrimi i përgjegjësisë publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t'i takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve. Dhënia e një përgjegjësie një autoriteti tjetër duhet të bëhet duke patur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e aftësisë e të ekonomisë. Kompetencat që u besohen bashkësive vendore normalisht duhet të jenë të plota. Ato mund të diskutohen apo të kufizohen nga një autoritet tjetër, qendror apo rajonal vetëm brenda ligjit. Në rast se kompetencat i kalojnë një autoriteti qendror apo rajonal, bashkësitë vendore duhet të gëzojnë, brenda mundësisë, lirinë që ushtrimin e tyre t'ia përshtasin kushteve vendore. Bashkësive vendore duhet t'u kërkohe mendimi brenda mundësisë në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatëshme gjatë proceseve të planifikimit e marrjes së vendimeve për të gjitha çështjet që u përkasin drejtpërdrejtë.

Autonomia e organeve të qeverisjes vendore nuk është vetëm një autonomi administrative, por është edhe autonomi politike dhe financiare.

Nga pikëpamja **politiko-administrative**, organet e njësive të qeverisjes vendore janë të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre. Të zgjedhura drejtpërdrejtë (ose jo) nga ana e popullit, ato nuk kanë asnjë varësi me karakter politik nga ndonjë organ tjetër shtetëror. Për shembull, në vendin tonë, Prefekti, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në qark, nuk ka karakter epror ndaj organeve vendore, por ruan vetëm karakterin bashkëndues.¹³⁷ Decentralizimi politik synon t'u japë qytetarëve apo përfaqësuesve të zgjedhur prej tyre më shumë pushtet në procesin e marrjes së vendimeve politike. Ky lloj decentralizimi shoqërohet shpesh me politika pluraliste dhe qeveri përfaqësuese nga ana e pushtetit qendror, por gjithashtu mund të mbështesë demokratizimin duke iu dhënë qytetarëve ose përfaqësuesve të tyre më tepër influencë në formulimin dhe zbatimin e praktikave. Përkrahësit e decentralizimit politik argumentojnë se vendimet e marra në kushtet e një pjesëmarrjeje sa më të gjerë janë më të fokusuara tek interesat e shoqërisë, nëse krahasojmë me vendim-marrjen nga autoritetet politike kombëtare. Çka do të thotë se zgjedhja e përfaqësuesve nga juridiksionet lokale elektorale u jep mundësi qytetarëve të njohin më mirë përfaqësuesit e tyre politikë dhe u jep gjithashtu mundësi zyrtarëve të zgjedhur të njohin më mirë dëshirat dhe nevojat e zgjedhësve të tyre. Një decentralizim demokratik shpesh kërkon reforma kushtetuese, krijimin e partive politike pluraliste, forcimin e legjisllacionit, krijimin e njësive politike dhe inkurajimin e grupeve efektive publike.¹³⁸

Ndërsa **autonomia normative** shprehet në faktin se organet e gjitha njësive të qeverisjes vendore nxjerrin vendime, urdhra dhe urdhëresa. Këto akte normative duhet të kenë fuqi detyruese për të gjithë subjektet që jetojnë e veprojnë brenda një njësie territoriale që përfaqëson organi përkatës. Është e detyrueshme që këto akte të jenë në përputhje të plotë me ligjet, të cilat përcaktojnë parimet dhe procedurat për nxjerrjen e tyre. Pra, këto akte kanë një lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me ligjet dhe jo me aktet normative të qeverisë apo organeve të tjera qendrore.

Lidhur me **autonominë financiare**, e cila realisht është çështja më problematike dhe delikate e cdo reforme decentralizuese, shohim një lloj garancie edhe për arritjen e autonomisë politike, normative dhe administrative. Decentralizimi fiskal nënkupton transferimin e përgjegjësisë për të kryer shpenzime dhe për të mbledhur të ardhura

¹³⁷ Omari, L. & Anastasi, A. (2017) E Drejta Kushtetuese, fq 331

¹³⁸ Decentralizimi shpreh përmblendhje, Instituti I Bankës Botërore, redaktoi Jennie Litvack dhe Jessica Seddon, fq 2

XII INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE | KONFERENCA E XII-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
XII-ta NAUČNA MEDJUNARODNA KONFERENCIJA

drejt qeverive vendore. Autonomia fiskale dhe financiare merr kuptim kur kemi decentralizimin fiskal real dhe kur përmbushen këto kushte:

- Transferim të mjeteve financiare kombëtare tek pushteti vendor;
- Transferimin e përgjegjësive dhe të drejtës së kryerjes së shpenzimeve;
- Rritjen e të ardhurave të qeverisjes vendore;
- Autoritet i plotë në përcaktimin/vënien e taksave dhe tarifave vendore dhe shpenzimet; dhe
- Një kuadër ligjor që mundëson huamarrjen vendore.

Të tilla përkufizime janë përdorur para dhe pas reformës, por ende mbeten problem dhe sot zyrtarët vendorë ngrenë po të njëjtën problematikë të mungesës së decentralizimit dhe autonomisë financiare. Por a është kuptuar drejt decentralizimi fiskal dhe a ka vullnet për të shkuar drejt tij?

Sipas ligjit nr 139, date 17.12.2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", politikat kombëtare financiare garantojnë mjaftueshmërinë financiare të njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumëllojshmërisë së burimeve të të ardhurave. Funkcionet dhe kompetencat që u delegohen njësisve të vetëqeverisjes vendore shoqërohen kurdoherë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre. Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj. Njësisve të vetëqeverisjes vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur. Në rast se ndryshimet në politikën fiskale shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe bazës së taksave vendore apo të pjesës së të ardhurave të njësisve të qeverisjes vendore nga taksat e ndara, Ministria e Financave është e detyruar të marrë masat për kompensimin e uljes, nëpërmjet rritjes së transfertave financiare dhe mundësive për huamarrjen vendore dhe/ose formave të tjera. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

Edhe objektivat kryesore të strategjisë së zhvillimit ekonomik në fushën e decentralizimit perfshinin:

- ritjen e kapacitetit të të ardhurave vendore të njësisve të qeverisjes vendore për të përmbushur nevojat financiare për ofrimin e më shumë shërbimeve;
- përmirësimin e qëndrueshmërisë, thjeshtësisë dhe barazisë së sistemit të transfertave së bashku me rritjen e transparencës;
- sigurimin e më shumë kapaciteve për njësitë e qeverisjes vendore në përdorimin e huamarrjen dhe borxhit për financimin e investimeve kapitale, brenda politikave kombëtare të borxhit publik;
- forcimin e sistemit të administrimit të financave publike në nivel vendor.

Pavrarësisht punës së deritanishme mund të thuhet se ka akoma shumë punë për të parë rezultate praktike në drejtim të plotësisimit të këtyre objektivave.

Konkluzione

Shqipëria është pjesë e modelit unitar të decentralizuar ku pushteti normativ ndahet ndërmjet organeve të pushtetit qendror dhe autoriteteve lokale. Organizimi dhe funksionimi i organeve të pushtetit vendor është i një rëndësie të vecantë sa i përket funksionimit të një shteti, sidomos çështja e autonomisë vendore dhe decentralizimi i pushteteve. Për këtë arsye, në vitin 2014, u mor nisma për reformimin dhe sistemimin e pushtetit vendor, ku qëllimi kryesor ishte dhënia e më tepër pushteteve financiare dhe ekonomike, më tepër të drejta dhe përgjegjësi, e po ashtu kompetenca administrative e rregullatore, shërbimi dhe investimi, për funksionet bazike, duke shkuar dhe një hap më tej me transferimin e disa funksioneve të reja.

Me reformën territoriale të vitit 2014, konkretisht me Ligjin 115/2014 "Për ndarjen administrative dhe territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri" u vendos që Shqipëria të kishte përsëri 12 qarqe, por u suprimuan komunat duke u zëvendësuar me njësi administrative të qeverisjes vendore dhe gjithashtu të kishte 61 bashki, kjo për të minimizuar kostot e tepërta administrative dhe për rritjen e cilësisë së shërbimeve publike ndaj komuniteteve lokale. U pasua nga ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe duke vijuar më tej me Ligjin Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore". Nëse i referohemi koncepteve të autonomisë dhe decentralizimit, shohim që mbesin të njëjtat. Kemi po të njëjtat lloje të decentralizimit që përfshijnë dekoncentrim, delegim dhe transferim. Po ashtu autonomia mbetet në kuadrin e autonomisë administrative, politike, normative dhe financiare, por kërkohet që nëpërmjet reformës secila nga këto lloje të ketë më tepër zbatim praktik dhe më tepër efikasitet. Por, a është arritur dicka e tillë edhe pse kanë kaluar pak vite nga bërja e reformës. Për dhënien e konkluzioneve do i referohemi raportit mbi qeverisjen vendore të vitit 2019, të përgatitur nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë.

Raporti për qeverisjen vendore i vitit 2019 arrin në konkluzionin se edhe pas përpjekjeve të qeverisë dhe donatorëve, ka akoma shumë punë për t'u bërë për t'u arritur një decentralizim mirë fiskal dhe administrativ. Gjatë kësaj periudhe, vëmendja ka qenë më e përqendruar tek reforma territoriale ose ndryshimi i kufijve dhe bashkimi i njësive vendore sesa tek procesi i decentralizimit dhe reformës administrative. Gjithashtu, vëmendje mori pritshmëria për uljen e kostove, e cila nuk është arritur akoma në praktikë, ndërsa më pak punë është bërë në drejtim të sigurimit të vazhdueshmërisë së shërbimeve, sidomos për banorët e ish komunave me akses të kufizuar.

Sipas raportit, janë bërë hapa të rëndësishëm lidhur me transferimin e disa funksioneve të reja. Por debati mbetet akoma i hapur lidhur me transferimin e përgjegjësive të plota dhe mjeteve të duhura financiare. Shqipëria mbetet ende shumë pas vendeve të Bashkimit Evropian, por edhe vendeve të tjera të rajonit për sa i përket të ardhurave totale si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto dhe si përqindje e të ardhurave totale publike. Ligji 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" ishte një hap shumë i mirë. Megjithatë, mund të themi se reforma është ende në proces dhe do na duhet akoma që të shohim rezultat e pritura, sidomos pas realizimit të reformimit administrativ dhe decentralizimit fiskal.

Bibliografia

Omari, L. & Anastasi, A (2017) E Drejta Kushtetuese. Tiranë, Shtëpia Botuese ABC

Dobjani, E. (2016) E Drejta Administrative, pjesa e përgjithshme. Tiranë, Shtëpia botuese EMAL

Dobjani, E. & Puto, E. & Toska, E. & Dobjani, E. (2013) E Drejta Administrative. Kontrolli mbi administratën publike. Tiranë, Shtëpia botuese EMAL

Kushtetuta dhe legjislacioni për reformën në drejtësi

LIGJ Nr. 44/2015 KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

L I G J Nr.8652, datë 31.7.2000 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE
(Ndryshuar me ligj nr .9208, date 18.3.2004)

Ligji Nr. 115/2014 PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES
VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

LIGJ Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE

LIGJ Nr. 68/2017 PËR FINANCAT E VETËQEVERISJES VENDORE

Karta Evropiane e Autonomisë Vendore (miratuar më 1985 dhe hyrë në fuqi më 1988)

Strategjia ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore (2015-2020) versioni final Shkurt 2015

Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë, raport mbi situatën aktuale, Tiranë 2019

Sfidat e përkthimit të një poezie misionare: “Fjalët e qiririt”

Dr. Alva Dani

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti “Luigj Gurakuqi”

Shkodër, Shqipëri

alvadani2001@yahoo.it

Naim Frashëri, siç dihet tashmë botërisht është ndër figurat më të mëdha të letërsisë dhe të vlerave shpirtërore të kombit shqiptar. Me bukurinë e fjalës, me madhësinë e shpirtit dhe mënçurinë e mendimit, ai artikuloi si askush më parë aspiratat historike dhe nevojat shpirtërore të popullit shqiptar, në vitet më dramatike të jetës së tij. “Nuk u gabua prandaj Faik Konica kur tha se Naim Frashërin do ta ndjekë një komb i tërë”¹³⁹, duke u shndërruar në mësues dhe edukator, duke qënë pranë tij në çaste sprovashe të mëdha e dilemash dramatike, duke i shërbyer deri në vetëmohim, duke u shndërruar në simbolin që u përjetësua tek “Fjalët e qiririt”.

Kjo poezi, që përbën kredon e poetit, “auto da fe” – në e tij siç është quajtur me kohë nga studiuesit, vjen e përkthyer në gjuhën italiane nga shkrimtari dhe përkthyesi Ernest Koliqi. E boton dy herë me tituj të ndryshëm, herë parë e përkthen në revisten “Shejzat”, e drejtuar nga vetë Koliqi, në vitin 1962 me titullin “Cio che dice il cero” (Çfarë tha qiriu), ndërsa herën e dytë e boton në përmbledhjen me poezi shqiptare të përkthyer në italisht me titull “Antologia della lirica albanese” me 1963 me titullin e shkurtuar “Il Cero” (Qiriu).

Po të flasim për përkthimin e poezisë në përgjithësi mund të themi se është një nga përkthimet e vështira, si nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja. Është ndër aktet më të komplikuar dhe më të përpunuara nga ana gjuhësore. Ka nga ata madje që mendojnë si Robert Frost se poezia nuk mund të përkthehet, dhe se përkthimi i poezisë është një sipërmarrje e kotë. Por shekujt kanë treguar se përkthimi i poezisë është i pashmangshëm, prandaj duhet të bëhemi të vetëdijshëm së çfarë është përkthimi. Kur poezinë e përkthen një poet, në rastin tonë Koliqi, përparësitë janë më të mëdha. Duhet thënë se poetët janë më të përshtatshmit për t’u përballur me sfidën e përkthimit.

Koliqi është përkthyes shumë profesionist, përkthen “Poetët e mëdhej të Italisë”, me dëshirën e zjarrtë që populli shqiptar të njihë kulturën dhe qytetërimin e hershëm italian, e me të njëjtën dëshirë, që merr vlerën e një misioni patriotik ia hyn të përkthejë në gjuhën italiane pjesë nga Naimi, nga “Lahuta e Malësisë” e Fishtës, nga Çajupi, nga De Rada dhe nga poezia popullore, duke luajtur kështu rolin e

¹³⁹Ali Aliu, *Reflekse letrare*, Shtëpia botuese FLAKA, Shkup, 1999, f.24.

ndërlidhësit midis kulturës së vendeve evropiane dhe kulturës shqiptare. Poeti ka vesh të ndjeshëm që e bën të aftë të kapë emocionet më të fshehta e më vibruese. “Poeti – shkruan Rudolf Marku¹⁴⁰ – kinstiktin e lindur të ritmit, a shijen e duhur për zgjedhjen e fjalëve të sakta, asht i familjarizuar me strukturën poetike, ka mirëkuptimin e duhur përkundrejt stërhollimeve metaforike, i kupton instiktivisht aliteracionin, asonancën, tonin, humorin, suspensin... Poeti, kur përkthen, e njeh intistiktivisht kontrollin dhe balancën emocionale dhe di të shprehet me një zë natyral, që vjen pa ngërçe... “.

Duket se Koliqi e njihte mjaft mirë Naim Frashërin, në tërësinë e botëkuptimit të tij, aq sa e cilëson një nga tre poetët më të mëdhenj shqiptarë, një nga “ndërtimtarët shpirtnorë të vendit të vogël adriatik” përkrah Jeronim De Radës dhe Gjergj Fishtës, të cilët janë sintezë e shpirtit të kombit shqiptar, janë “tri shprehje të së njajtës pëshpirtni flakruese, tri degëzime të së njajtës rrajë, që fundon në thellësitë e mshehta të humusit etnik trako-ilir e që ushqehet me langjet ma të kullueta jetsore”¹⁴¹.

E prandaj “Fjalët e qiririt” është ajo poezia e thjeshtë e madhështore, e botuar me 12 gusht 1884, që meriton të lexohet shumë herë e të përkthehet në shumë gjuhë, një poezi që flet me gjuhën e shpirtit e me dashurinë e madhe për njeriun. Nga kjo poezi Koliqi përkthen vetëm 12 vargje tetërrokëshe nga 74 vargjet e poezisë së plotë, e natyrshëm janë ato që mbartin thelbin e mesazhit, misionin dhe botën e tij të brendshme. Kemi një përkthim të shkurtër, me ndryshime në titull, i cili vjen në dy struktura gjuhësore të ndryshme, ku forma e rimenduar, së cilës do t’i referohemi në vazhdim, është “Il Cero” ose “Qiriri”. Koliqi preferon në gjuhën italiane formën “Qiriri” në vend të origjinalit “Fjalët e qiririt”, duke ruajtur kështu simbolin që përfaqëson qiriri për Naimin, pa na paralajmëruar ende për misionin që do të mishërojë në brendësi të poezisë.

Koliqit i duhet të ndërmarrë misionin e poetit, jo vetëm të përkthyesit, të ndjenjë deri në palcë shkrirjen shpirtërore të poetit me njeriun, dhe për më tepër ta përçojë me një gjuhë që nuk është e tija, e drejt një populli që nuk e njeh historinë e tij. Me mjeshtërinë e një përkthyesi të sprovuar dhe me një njohje të shkëlqyer të gjuhës italiane, Koliqirindërton vargun tetërrokësh naimian, duke shpalosur zhdërvjelltësinë e atij që e njeh mirë tashmë thelbin e mesazhit, që e njeh mirë vargun shqiptar dhe atë italian.

Koliqi, është një përkthyes i guximshëm shkruan Klara Kodra duke iu referuar përkthimeve nga italishtja, “që gjallërohet nga sfidat dhe kështu arrin fitore jo të pakta duke përkthyer nga një gjuhë analitike dhe me leksik të pasur siç është italishtja, në një gjuhë më sintetike si shqipja”¹⁴². Por edhe në

¹⁴⁰Rudolf Marku, *Përkthyesi si poet i heshtur*, online.

¹⁴¹Ernest Koliqi, *Vepra 4, Tre poetët ma të mëdhaj të Shqipnisë*, Faik Konica, Tiranë, 2003, f. 103

¹⁴²K. Kodra, *Ernest Koliqi, përkthyes*, Studime Filologjike, nr.3-4, 2004, f. 92.

